



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 29
DHE 30 KORRIK 2008

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA, ODRŽANE 29. i 30.
JULA 2008. GODINE

Korrik – Juli 2008

R e n d i i d i t ë s

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të mbajtur më 15 korrik 2008,
2. Koha për pyetjet parlamentare,
3. Shqyrtimi parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L088 për miratimin e Buxhetit të Kosovës dhe shpenzimet e autorizuar për periudhën prej 1 janari deri më 31 dhjetor 2008,
4. Shqyrtimi parë i Projektligjit për partneritetet publiko-privat dhe koncesionet për sigurimin e infrastrukturës së shërbimeve publike dhe procedurat për dhënien e tyre,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për vula në institucionet e Republikës së Kosovës,
6. Shqyrtimi i Rekomandimit të Organit të pavarur përzgjedhës për emërimin e anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit,
7. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin 2007,
8. Shqyrtimi i kërkesës së Qeverisë së Kosovës për tërheqjen e ligjeve nga procedura e shpalljes,
9. Shqyrtimi i kërkesës së grupeve parlamentare të Kuvendit për procedimin e ligjeve të pashpallura në rishqyrtim në komisionet parlamentare.

D n e v n i r e d

1. Usvajanje zapisnika sa plenarne sednice od 15 jula 2008. godine,
2. Vreme za poslanička pitanja,
3. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmenama i dopunama Zakona br.03/L088 o usvajanju Budžeta Kosova i o autorizovanim rashodima za period od 1. januara do 31. decembra 2008.
4. Prvo razmatranje Nacrta zakona o javnoprivatnom partnerstvu i koncesijama, obezbeđenju infrastrukture javnih službi i o postupku njihovog dodeljivanju,
5. Drugo razmatranje Nacrta zakona o pečatima u institucijama Republike Kosova,
6. Razmatranje Preporuke Nezavisnog organa za izbor članova Organa za razmatranje prigovora u vezi sa nabavkama,
7. Razmatranje Godišnjeg izveštaja Kancelarije Regulatora energije za 2007. godinu,
8. Razmatranje zahteva Vlade Kosova za povlačenje zakona iz postupka proglašenja,
9. Razmatranje zahteva parlamentarne grupe Skupštine za procesuiranje neproglašanih zakona koji će se preispitati u parlamentarnim komisijama.

A g e n d a

1. Approval of the minutes from the plenary session held on 15 July 2008,
2. Time for parliamentary question,
3. First review of the Draft law on amendment and supplementation of the law nr.03/L088 in approving the Kosovo Budget and authorized expenditures for period from 1 January 31 until December 2008,
4. First review of the Draft law on public-private partnership and concessions in the delivery of public infrastructure and services and the procedures for their award,
5. Second review of the Draft law on Stamps in Republic of Kosovo Institutions,
6. Review of recommendation of the independent selection body in appointing members of Review Procurement Body,
7. Review of the annual report of the Energy Regulatory Office for year 2007,

8. Review of the request made by Government of Kosovo in withdrawing laws from Promulgation procedure,
 9. Review of request of parliamentary groups of the Assembly in proceeding un-promulgated Laws for revision by parliamentary committee's.
-

Drejton seancën: Kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuari zëvendëskryeministër,
Të nderuar ministra,

Mirë se keni ardhur në seancën e sotme plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës!
Për të konstatuar prezencën, ju lus që të shtypni të butonin!
Regjia, të përgatitet për shtypjen e butonit! Butojmë tash:
Prezentë janë 89 deputetë. Faleminderit!

Ju njoftoj që nuk ka votim të dyfishtë. Votimi ose do të bëhet me ngritje dore, ose me shtypje të butonit. Konstatoj se janë plotësuar kushtet për t'ia filluar punës.

Ju njoftoj se në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

- Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të mbajtur më 15 korrik 2008

Të nderuar deputetë, ju njoftoj se Procesverbali i seancës plenare të mbajtur më 15 korrik 2008, si dhe Transkripti nga kjo seancë, u janë shpërndarë deputetëve.

Pyes deputetët, nëse kanë vërejtje në procesverbal? Nuk ka. Konstatoj se Kuvendi miratoi Procesverbalin e seancës plenare të mbajtur më 15 korrik 2008.

Pika e radhës është:

- Koha për pyetje parlamentare

Ju njoftoj se në bazë të Rregullës 26.1 të Rregullores së Punës së Kuvendit, koha për pyetje të deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 50 minuta.

Koha për parashtrimin e pyetjes është e kufizuar në një minutë, përgjigjja në tre minuta, pyetja plotësuese - një minutë dhe përgjigjja në pyetjen shtesë -dy minuta.

Kërkoj respektim të këtyre rregullave.

Vazhdojmë me procedimin e pyetjeve.

Deputeti Xhevdet Neziraj, IRDK, pyetje për ministrin për Komunitete dhe Kthim, Boban Stankoviq. Fjalën e ka deputeti Xhevdet Neziraj. Xhevdet Neziraj, nuk është prezentë. Kalojmë në pyetjen e dytë, përsëri është Xhevdet Neziraj.

Vazhdojmë me pyetjen e tretë. Deputetja Myfera Shiniq, pyetje për ministrin e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, zotin Enver Hoxhaj.
Lus deputeten le ta parashtrojë pyetjen!

MYFERA SHINIK: Kosova Meclisi Çalışma Yönetmenliğinin 26.2 kuralı esaslı üzere, Meclisin ilerideki toplantısında Eğitim, Bilim ve Teknoloji Bakanı Enver Hoxhaj'dan sözlü yanıt almam amacıyla kendilerine şu soruyu yöneltiyorum:

Sn. Bakan Enver Hoxhaj

İlk ve orta öğretim Eğitim Yasası 7.5 Maddesiyle uyumlu olarak kurulan 7.6 Maddesine göre: KEBTB belediyelerle işbirliği yaparak derslere ait ders kitapları ve okuma kitapları, yazma ve çizme hazırlıkları olduğu gibi diğer ders araç gereçlerinin sağlanması gerekir.

Soru:

KEBTB tarafınca diğer dillerde olduğu gibi Türk dilinde de ilk okulların alt ve üst kademe sınıfları için ders kitapları basılmaktadır.

Bu baskı 2008-2009 eğitim yılı için tamamlanacak mı ve liselere ait türkçe ders kitaplarının baskıdan çıkması ne zaman gerçekleşecektir, yani ders kitapları öğrencilerin elinde ne zaman olacaktır?

KRYETARI: Faleminderit! Ministër, fjala është e juaja!

MINISTRI ENVER HOXHAI: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuari zoti Kryetar,

I nderuari zoti Kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra, kolegë ministra,

Shumë të nderuar dhe të respektuar deputetë,

Unë mjerisht nuk mbërrina që ta përcjell pyetjen në përkthim, meqë përkthimi ishte i ngadalshëm. Mirëpo, meqë pyetja është me shkrim, besoj që është përafërsisht ajo pyetje të cilën deputetja e ngriti.

Më lejoni t'ju informoj që procesi mësimor në gjuhën turke organizohet në të gjitha nivelet në sistemin tonë arsimor, edhe në nivelin parauniversitar, edhe në nivelin universitar dhe zhvillohet sipas plan – programeve të Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë të Republikës së Kosovës. Po ashtu, ka filluar edhe botimi i teksteve dhe i mjeteve mësimore të cilat tekste dhe mjete mësimore iu referohen plan-programeve të Ministrisë së Arsimit.

Në mes të vitit 2006 – 2007, viti shkollor 2006 – 2007 dhe 2007 – 2008 janë botuar deri më tash 49 tekste shkollore për klasën e parë, për klasën e dytë, për klasën e tretë, për klasën e katërt, për klasën e gjashtë, për klasën e shtatë, për klasën e tetë. Kur është fjala tek arsimi i mesëm, janë botuar edhe dy tekste për klasën e dhjetë, po ashtu ekziston edhe një tekst për klasën e nëntë.

Po ashtu, e kemi të botuar edhe gjithë dokumentacionin shkollor në gjuhën turke të nivelit parauniversitar, që përfshinë ditarët, librezat, dëftesat, diplomat, certifikatat, Librin për regjistrin e diplomave dhe të certifikatave të cilat lëshohen.

Unë do të jem në gjendje që t'iu siguroj edhe një listë të gjitha këtyre teksteve që i përmenda. Kur është fjala tek arsimi i mesëm, tek arsimi i mesëm profesional, ne gjatë këtij viti do të bëjmë përpjekje që t'i sigurojmë të gjitha tekstet shkollore nga Turqia. Po ashtu, do të sigurohen edhe të gjitha tekstet shkollore për gjimnazet nga Turqia, meqë tek vitin e ardhshëm do të jemi në gjendje që në përputhje me plan-programet tona vërtet të hartojmë tekste shkollore për arsimin e mesëm në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputete, ke pyetje shtesë?

MYFERA SHINIK: Jo, faleminderit! Faleminderit, zoti ministër!

KRYETARI: Faleminderit!

Vazhdojmë me pyetje. Edhe pse nuk është ministri i Punëve të Brendshme, deputetja Ritë Hajzeraj ka bërë pyetje për ministrin e Punëve të Brendshme, zotin Zenun Pajaziti. Deputete, dëshironi ta lexoni pyetjen?

RITA HAJZERAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Unë, vërtet zotëri Zenun Pajazitit ia kam dorëzuar pyetjen. Mirëpo, nëse do të ishte i gatshëm Kryeministri të më përgjigjet në këtë pyetje, e kisha bërë me gjithë dëshirë. A mund ta bëjë? Po!

Zoti Kryeministër,

Përpjekjet e popullit tonë për liri dhe për territor të plotë pëllëmbë për pëllëmbë të Republikës së Kosovës, bashkë me miqtë tanë, rezultuan me lirinë e Kosovës që nga 12 qershori i vitit 1999. Shqetësimi im ka të bëjë që kjo liri e fituar në krah të miqve tanë ndërkombëtarë, po tkurret sot në kohën e paqes. Konkretisht, sovraniteti i territorit të vendit tonë, si dhe Kushtetuta po shkelen në të katër anët e Republikës së Kosovës. Kësaj radhe, ngreh çështjen e hyrjes së trupave të armatosura të Malit të Zi brenda territorit të Kosovës si dhe të përndjekjes së shqiptarëve nga pronat e tyre private në veri dhe në pjesët e tjera kufitare.

Zoti Kryeministër,

A mendoni se shkelja e sovranitetit në këtë rast mund të quhet edhe shpallje lufte nga një shtet fqinj dhe cili është reagimi juaj si Qeveri, përkatësisht i Ministrisë së Brendshme, në këtë rast?

KRYETARI: Kryeministër, e keni fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: E nderuara deputete, Faleminderit për pyetjen tuaj! Të nderuar deputetë,

Ne të gjithë pajtohemi se kemi sakrifikuar për liri, shtet dhe sovranitet dhe, natyrisht, për të ushtruar kontrollin pëllëmbë për pëllëmbë në territorin e Kosovës dhe jemi duke punuar në atë drejtim. Unë jam në kontakt të vazhdueshëm me autoritetet e Qeverisë së Malit të Zi. Natyrisht se rajoni ynë ka probleme të veçanta që i takojnë mentalitetit të së kaluarës, por definitivisht në Kosovë, si shtet i pavarur, duke u respektuar dhe garantuar integriteti territorial i vendit tonë prej NATO-s, prej Shteteve të Bashkuara të Amerikës,

Bashkimit Evropian, të të gjitha vendeve demokratike, do të ketë paqe, do të ketë stabilitet dhe do të ketë bashkëpunim rajonal. Prandaj, Mali i zi ka bërë hapa progresiv në drejtim të njohjes së dokumenteve të udhëtimit si Republikë e Kosovës. Është në rrugë të mirë së bashku me vendet e tjera të rajonit të njohin vullnetin e popullit të Kosovës dhe ne jemi duke investuar në bashkëpunim për interesat e të dy vendeve dhe të dy popujve tanë. Prandaj, edhe njëherë rikonfirmoj se jemi duke punuar bashkë edhe me KFOR-in, edhe me autoritetet e reja civile në Kosovë dhe integriteti territorial i Kosovës si shtet është i paprekshëm dhe i pacenueshëm. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, Kryeministër! Ke pyetje shtesë, deputete? Fjalën e ka deputetja Rita Hajzeraj.

RITA HAJZERAJ: Faleminderit, zoti Kryeministër!

Unë e dëgjova me vëmendje rezymenë tuaj, kjo ishte një përgjigje në përgjithësi. Mirëpo, unë dëshiroj që konkretisht t'u thuash atyre qytetarëve të Kosovës që nuk ju lejohet të dalin në tokat e tyre se kur do të ndërmerret diçka nga autoritetet e shtetit të pavarur të Republikës së Kosovës?

KRYETARI: Faleminderit! Kryeministër!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Ne jemi takuar edhe me banorët e atyre fshatrave, jemi në kontakt të vazhdueshëm me Qeverinë e Malit të Zi. Kjo çështje duhet të rregullohet në të ardhmen shumë të afërt dhe jemi duke punuar konkretisht. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Pyetja e radhës. Deputeti Ibrahim Makolli, pyetje për ministrin e Punëve të Brendshme, zotin Zenun Pajaziti. Ministri nuk është këtu. Pyetjen, doni ta lexoni? Faleminderit!

Pyetja e radhës, deputetja Fatmire Berisha, LDK, deputetja Gjylnaze Syla, AAK dhe deputeti Arsim Rexhepi, kanë parashtruar pyetje të njëjtë për ministrin e Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor, zotin Mahir Yagcilar.

Pasi deputetja Fatmire Berisha ka bërë pyetjen së pari, le ta lexojë pyetjen deputetja Fatmire Berisha, LDK.

FATMIRE BERISHA: Faleminderit, i nderuari Kryetar!
I nderuari ministër,

Për një kohë të gjatë, preokupuese për pushtetin lokal të Mitrovicës, por edhe për një numër të madh të banorëve të këtij qyteti, është çështja e stacionimit të tri maunave me vaj disulfurik në repartin e organizatës punuese "Industria Kimike" në Mitrovicë. Ato janë vetëm nën mbikëqyrjen permanente të sigurimit fizikë të Trepçës. Substanca që gjendet në këto mauna, e që po u ekspozohet rezeve të diellit, ka efekte anësore që po manifestohen me kundërmim, me marramendje, iritim të syve, therje fyti, kollitje, tugë, probleme me frymëmarrje, e përhapja e tij në një përqindje më të madhe shkakton edem pulmonar dhe atakim direkt të sistemit nervor qendror.

Pyetja ime është kjo: Çka do të ndodhë me këto mauna dhe çka keni ndërmarrë ju si ministër i Mjedisit dhe i Planifikimit Hapësinor?

KRYETARI: Besoj që ministri e di cila është pyetja. A doni ta lexoni pyetjen, deputete Gjylnaze Syla? Mirë, urdhëro lexoje!

GJYLNAZE SYLA: Zoti ministër, pyetja ime është se kur do të bëhet zgjidhja definitive e problemit, me qenë se sekretari permanent i Ministrisë dhe drejtori i doganave janë shkarkuar, por maunat ende janë aty?

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Arsim Rexhepi, nuk është këtu. Tani, fjala është e juaja, zotëri ministër.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Faleminderit!

I nderuari Kryetar,
I nderuari Kryeministër, ministra,
Të nderuar deputetë,
Zonja deputete,

Problemi me mauna fillon më 22 maj, kur tri mauna, me licencën për importin e vajrave hidraulike, hynë në Kosovë përmes pikës doganore të Hanit të Elezit, pa vërejtje. Të njëjtën ditë, më vonë, në Suharekë nga policia janë ndaluar këto mauna nën dyshimin për mallin e transportuar dhe janë dërguar në pikën doganore në Vërmicë.

Gjatë ditëve të vikendit në vijim, nga Shërbimi Doganor dhe SHPK-ja kanë ardhur ankesa se nga maunat vjen erë e rëndë që shkakton djegie të syve, kokëdhembje, dhembje gjoksi dhe vjellje.

Me datën 27 maj, me vendimin e Grupit ad-hoc, maunat dërgohen përkohësisht në vendin Bresë, komuna e Dragashit. Me datën 3 qershor, pas ripaketimit të maunave, kërkohet të kthehet malli në vendin origjinë, Iran. Por, Maqedonia nuk lejoi transportimin.

Më 6 qershor, maunat dërgohen në parkun industrial “Trepçë”. Në atë moment fillon edhe përgjegjësia drejtpërdrejtë e Ministrisë ose e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ku zyrtarët e Ministrisë dhe anëtarët tjerë të Komisionit, për fat të keq, nuk janë marrë seriozisht me këtë problem.

Më 16 korrik, në Qeveri kam kërkuar me urgjencë të merret vendimi për asgjësimin e tyre si dhe sigurimin e mjeteve nga buxheti.

Më 21 korrik, sipas vendimit të Qeverisë, është hapur tenderi ndërkombëtar me procedura të përshpejtuara ligjore. Tenderi do të mbyllet më 31 korrik këtë vit dhe menjëherë do të vendoset për kompaninë e cila do të merret me një urgjencë të shpejtë për asgjësimin e materieve të rrezikshme.

KRYETARI: Faleminderit! Ka pyetje shtesë? Urdhëro, Gjylnaze Sylja!
Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Sylja.

GJYLNAZE SYLA: Duke marrë parasysh se kjo është çështje urgjente, se dihet që ka ndikim në shëndetin e qytetarëve të Mitrovicës, të mos flas, në radhë të parë të fëmijëve, të shtatzënave dhe të pleqve. Pse nuk është zgjidhur problemi në mënyrë urgjente, njëburimore?

KRYETARI: Edhe një pyetje shtesë, Fatmire Berisha.

FATMIRE BERISHA: Faleminderit, Kryetar! Nuk kam pyetje shtesë. Faleminderit!

KRYETARI: Mundeni tash të përgjigjeni, zoti Kryeministër!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Pse nuk është zgjidhur me urgjencë, dua të potencoj para të gjithë juve deputetë të nderuar, ministra, zëvendëskryeministra, por edhe para qytetarëve.

E para, ky proces negativ dhe kjo e keqe Kosovës i ka ndodhur në 4 vitet e fundit, por mrekullia e kësaj radhe qëndron se këto mauna kësaj radhe janë kapur. Gjatë katër viteve të fundit qytetarët e Kosovës nuk kanë ditur çka hynë, çka del dhe është dëmtuar shëndeti i 2 milionë qytetarëve të Kosovës.

Prandaj, unë e falënderoj Ministrinë e Brendshme për punën e mrekullueshme që kanë bërë në kapjen e këtyre maunave.

Tash shtrohet domosdoshmëria e zgjedhjes së këtij problemi. Është biseduar edhe në nivele ekspertësh dhe janë marrë edhe masa ndaj atyre që e kanë toleruar hyrjen e këtyre maunave në katër vitet e fundit, edhe ndaj atyre që kanë toleruar hyrjen, edhe ndaj atyre që kanë heshtur para qytetarëve dhe para institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës.

Prandaj, zotohem para jush se nuk do të tolerojmë gjëra të tilla më tutje që ka i kanë ndodhur Kosovës në katër vitet e fundit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, Kryeministër!

Pas ardhjes së ministrit të Punëve të Brendshme, zoti Zenun Pajaziti, po ia japim fjalën deputetit Ibrahim Makolli, që ta lexojë pyetjen.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuari Kryeministër,

Të nderuar ministra, kolegë,

Zoti ministër, UNMIK-u pat nxjerrë një udhëzim administrativ, me të cilin ka vazhduar afatin e gjithë patentë shoferëve të cilëve iu ka skaduar afati. Kjo zgjatje e afatit të patentë shoferëve vlen vetëm për territorin e Kosovës, ndërkaq jashtë territorit të saj, si në Maqedoni ose në Mal të Zi, qytetarët po ballafaqohen me gjoba të larta.

Zoti ministër, a keni ndonjë iniciativë që vlefshmëria e vazhdimin të afatit të këtyre patentë shoferëve deri në nxjerrjen e patentë shoferëve të ri të vlejë edhe në vendet jashtë Kosovës? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti ministër, e ke fjalën!

MINISTRI ZENUN PAJAZITI: I nderuar zoti Makolli,

Të nderuar deputetë,

Ministria e Punëve të Brendshme është ajo që ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ 2007/2, me të cilën rregullohet procedura për vazhdimin e afatit të patentë shoferëve. Përmes këtij Udhëzimi Administrativ u mundësohet qytetarëve që të vazhdojnë afatin e vlefshmërisë së patentë shoferëve në pajtim me procedurat e parapara ligjore.

Sa për informatën tuaj, poseduesi i patentë shoferit mund të aplikojë për vazhdimin e patentë shoferit 6 muaj para skadimit të afatit të vlefshmërisë. Ndërsa afati i vlefshmërisë së patentë shoferit të vazhduar është 5 vite nga data e lëshimit. Pra, ne po e vazhdojmë afatin e patentë shoferëve aktual dhe nuk kemi informata se qytetarët tanë që lëvizin jashtë vendit me automjetet e tyre po hasin probleme praktike.

Po ashtu, më lejoni t'ju përkujtoj se Ministria e Punëve të Brendshme është në finalizim të procesit të prodhimit patentë shoferëve të rinj dhe nëse vazhdohet me dinamikën aktuale, ne presim që në fillim të shtatorit të fillojmë me pajisjen e qytetarëve me patentë shoferë të Republikës së Kosovës, që vlerësohen dokumente të sigurisë së lartë dhe me një kualitet që përmbush të gjitha standardet ndërkombëtare.

Më lejoni t'ju them që një grup i ekspertëve ndërkombëtarë që ka përcjellë këtë proces, ka vlerësuar që kualiteti i patentë shoferëve që do të dalin tash të ri, patentë shoferë të Republikës së Kosovës, janë të kualitetit më të mirë në regjion dhe, si të tilla, ato do të jenë të pranueshme jo vetëm për regjionin, por për qarkullim të lirë në të gjitha vendet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputet, ke pyetje shtesë? Fjalën e ka deputeti Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti ministër për përgjigjen! Si duket, jemi keqkuptuar. Fjala është për vazhdimin me urdhëresë administrative që i bën të vlefshëm edhe patentë shoferët që ekzistojnë. Ju keni edhe në mesin e deputetëve të këtij Parlamenti, por sidomos të qytetarëve, të cilët në bazë të kësaj urdhërese administrative, me lejet të cilat i kanë, qarkullojnë nëpër territorin e Maqedonisë dhe aty gjobiten për shkak të kalimit të afatit. Po flasim për një urdhëresë administrative që ka qenë në fuqi që vazhdon ky afat që është.

KRYETARI: Ministër!

MINISTRI ZENUN PAJAZITI: Më lejoni t'ju them që vazhdimi i patentë shoferëve është kah bëhet, do me thënë sipas këtij udhëzimi administrativ. Ka qenë një kohë gjatë vitit të shkuar ose deri në pranverë të këtij viti që ka pasur probleme. Megjithatë, vazhdimi bëhet për të gjithë qytetarët. Po ashtu, validiteti i patentë shoferëve deri në ndërrimin e tërësishëm të tyre do të vlejë deri te skadimi, do me thënë edhe ata që i vazhdojnë tash para se të dalin patentë shoferët e Republikës së Kosovës, do të jenë me validitet të plotë përderisa nuk do ta marrin patentë shoferin e vetë dhe derisa afatin e skadimit ta kenë të shënuar në dokument. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputetja Donika Kadaj-Bujupi, pyetje për Kryeministrin, zotin Hashim Thaçi. Deputete, mund ta lexoni pyetjen!

DONIKA KADAJ- BUJUPI: Faleminderit, Kryetar!

I nderuar Kryeministër,

Në seancën e fundit, para këtij Kuvendit deklaruat se jeni angazhuar fuqishëm në luftën kundër korrupsionit. Cilat janë masat administrative konkrete që keni ndërmarrë si Qeveri për luftimin e korrupsionit, meqenëse kjo ka qenë temë kryesore e juaja edhe gjatë fushatës, edhe gjatë propagandës pas fushatës.

KRYETARI: Zoti Kryeministër, e keni fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: E nderuara deputete, Strategjia për luftë kundër korrupsionit është miratuar, është themeluar Grupi ndërministror për luftë kundër korrupsionit. Qeveria ka siguruar buxhetin qind për qind të kërkuar nga Agjencioni Antikorrupsion. Kemi shprehur gatishmërinë që të japim mjete shtesë për këtë çështje. Kam ftuar edhe organet e hetuesisë dhe gjyqësorin të jenë shumë më aktiv dhe konkret dhe të pakompromis. Po në të njëjtën kohë i kam ftuar dhe i ftoj edhe sot të gjithë qytetarët të bashkëpunojnë ngushtë me institucionet e Republikës së Kosovës në luftë kundër kësaj të keqeje, kundër korrupsionit, kundër krimit të organizuar dhe të gjitha dukurive negative. Ne të gjithë së bashku mund ta luftojmë më mirë dhe mund të jemi më efektiv gjithmonë duke mos dashur në asnjë rrethanë, në asnjë kohë ta politizojmë këtë proces, por ta pengojmë dhe luftojmë për të mirën e vendit dhe të gjithë qytetarëve dhe institucioneve tona në rrugën tonë të integritetit euroatlantik.

Ritheksoj se toleranca ndaj korrupsionit nga Qeveria e Kosovës dhe nga unë, personalisht, ka qenë, është dhe do të mbetet zero, luftë pa kompromis ndaj kujt do qoftë, kudo qoftë që paraqitet. Dhe, në çdo rast që mund të paraqitet, të jeni të bindur, siç edhe e kemi dëshmuar, do të ketë ndëshkime dhe nuk do të ketë asnjë kursim ndaj askujt. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Kryeministër!
Deputete, ke pyetje shtesë? Fjalën e ke!

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit! Derisa ju proklamoni zero tolerancë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, zëvendësministri i Ministrisë së Energjisë dhe Minierave fiton tender në Ministrinë e Shërbimeve Publike. Sigurisht, opinioni dhe deputetët këtu do të donin të dinin se si do ta shpjegoni këtë rast dhe çfarë masash do të merrni duke marrë parasysh që ky është konflikt interesi dhe është korrupsion i hapur. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Kryeministër,

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: E nderuara deputete, Donika. Unë vetëm mund të falënderoj për diskutimin tuaj shumë konkret, për mundësinë që edhe të përgjigjem në mënyrë të drejtpërdrejtë. Unë vetëm mund t'ju siguroj ju, personalisht, dhe të gjithë deputetët, edhe Qeverinë, Kryetarin e Parlamentit, të gjithë qytetarët e Kosovës, institucionet e Republikës së Kosovës, partnerët ndërkombëtarë, argumentojë me fakt një gjë të tillë, të jesh e sigurt se asnjë minutë, jo vetëm zëvendësministri, por asnjë ministër nuk do të rri në zyrë. Pastaj, është çështje e drejtësisë. Por, argumento! Perceptcion është diçka tjetër, apo thashetheme është diçka tjetër, por argumentojë, atëherë kërko përgjegjësi dhe, të jesh e bindur, do të marrë ndëshkimin politik nga unë dhe nga Qeveria, por natyrisht edhe aspekti juridik do të vazhdojë punën e vet si i pavarur, gjyqësori.

KRYETARI: Faleminderit, zoti Kryeministër!
Deputetja Rita Hajzeraj, pyetje për Kryeministrin, zotin Thaçi. Deputete, mund ta bëni pyetjen!

RITA HAJZERAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!
I nderuari zoti kryeministër,

Qeveria, në mbledhjen e mbajtur më 3 korrik 2008, nxori vendimin numër 02/25 me të cilin iu vazhdon mandatin anëtarëve të kuvendeve komunale dhe kryetarëve të komunave në Leposaviq, Zubin Potok, Shtërpçë, Zveçan dhe Artanë, njëherësh duke injoruar rezultatet e zgjedhjeve lokale të 17 nëntorit të vitit 2007. Ky veprim i Qeverisë ka lënë pa përfaqësues të tyre dhe ka shkelur vullnetin e votuesve të zgjedhjeve të 17 nëntorit në komunën e Shtërpçës dhe përmes ofertës së re tanimë Qeveria tenton që t'i rikthejë në pushtet disa kryetar të komunave me shumicë serbe që kishin marrë pjesë drejtpërdrejt në zgjedhjet e 11 majit, të organizuara nga pushteti i Beogradit.

Zoti Kryeministër,

Sa po zbatohet vendimi i Qeverisë për vazhdimin e mandateve të kryetarëve të komunave në vendbanimet me shumicë serbe?

KRYETARI: Zoti Kryeministër, e ke fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, deputete!

UNMIK-u edhe Qeveria, siç e dini, këto zgjedhje i ka shpallur jolegale, jolegjitime. Qeveria dhe autoritetet ndërkombëtare kanë vërtetuar mandatin e kryetarëve të mëparshëm dhe kanë kërkuar nga autoritetet e KFOR-it e të policisë që ta respektojnë vendimin. Prandaj, jemi duke përcjellë këtë proces nga afër në mënyrë që të respektohet vendimi për vazhdimin e mandateve të kryetarëve që kanë qenë të zgjedhur më herët.

KRYETARI: Deputete, keni pyetje shtesë?

RITA HAJZERAJ: Po, zoti Kryetar!

Zoti Kryeministër, a jeni në gjendje t'i deklaroni popullit tuaj se kur do të fillojë funksionimi i këtyre komunave në harmoni me vendimin tuaj 02/25 në zgjedhjet e nëntorit 2007 konform Kushtetutës së Kosovës?

KRYETARI: Faleminderit!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: E nderuara deputete,

Unë shpeshherë i kam deklaruar popullit tim gjëra të rëndësishme për të mirën e vendit dhe të të gjithë qytetarëve. Prandaj, edhe sot i ridekloj popullit tim, edhe juve, edhe partnerëve ndërkombëtarë, se në Kosovë do të funksionojë rendi dhe ligji, do të funksionojë Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, Kryeministër!

Deputetja Gjylnaze Sylja, pyetje për Kryeministrin, zotin Hashim Thaçi. Deputete, mund ta parashtroni pyetjen!

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Po ndërlihem me atë që posa e tha Kryeministri se Kushtetuta po zbatohet. Zoti Kryeministër, themelimi i Agjencisë Kosovare të Inteligjencës dhe emërimi i drejtorit, të zëvendës-drejtorit, të inspektorit të përgjithshëm, por edhe të ministrit të Mbrojtjes ka një rëndësi të madhe për sigurinë e vendit. Pse po vonoheni me emërimin e këtyre zyrtarëve të rëndësishëm për sigurinë.

KRYETARI: Kryeministër!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Duke respektuar Kushtetutën e Republikës së Kosovës, është në përgjegjësinë time që të propozoj njerëzit që duhet të zgjidhen për këto dikastere të rëndësishme shtetërore dhe, natyrisht, i gjithë ky proces është duke shkuar me procedurë normale në një periudhë të rëndësishme kohore, në një periudhë në të cilën kërkohen veprime shumë të përgjegjshme dhe, natyrisht, veprime e vendime që krijojnë një bazë shumë të fuqishme të konsolidimit dhe të funksionimit të institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës. Sot, para nesh, si institucione, flas si Qeveri, Presidencë, në bashkëpunim të ngushtë presim të marrim vendimet në ditët e ardhshme, pas konsultimeve që kanë ndodhur edhe për Shërbimin Inteligjent të Kosovës, ministri i Mbrojtjes do të caktohet gjatë kësaj jave, por natyrisht se ky proces është i ndjeshëm dhe jemi duke punuar në konsulta të ngushta gjithë autoritetet bartëse shtetërore të Republikës së Kosovës, duke respektuar të gjitha parimet më të mira të mundshme të përvojës moderne. Kosova nuk ka pasur dhe nuk ka vakum institucional të inteligjencës dhe mbrojtjes. Përkushtimi im është që të punojmë me përkushtimin më të madh dhe kjo do të ndodhë. Edhe kryeshefi i Shërbimit Inteligjent të Kosovës edhe gjithë Shërbimi Inteligjent i Kosovës do të jetë profesional, do të jetë multietnik, do të jetë në shërbim të paqes, të sigurisë së vendit dhe të të gjithë qytetarëve.

KRYETARI: Faleminderit, Kryeministër!

Deputete, ke pyetje shtesë? Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Zoti Kryeministër, nuk është Shërbim, është Agjension. Ndërsa ju vetë keni deklaruar në takimin e Qeverisë më 30 maj 2008 në Pejë se, po ju citoj: “Qeverisë së Kosovës do t’i shtohet për 2 javë edhe Ministria e Mbrojtjes, si dhe do të themelohet edhe Shërbimi Inteligjent i Kosovës. Do të thotë, më 15 qershor ju është dashur ta kryeni obligimin. Nuk e keni mbajtur fjalën.

E kam një pyetje: Nëse nuk ka vakum të inteligjencës, kush po e kryen këtë punë?

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Si ishte pyetja shtesë? OK.

Me Kushtetutë, institucionet që ju përmendët janë të themeluara, tash është vetëm çështje e emërimeve që do të ndodhin në ditët e ardhshme. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Sanije Aliaj, pyetje për ministrin e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, zotin Enver Hoxhaj. Deputete, mund ta bëni pyetjen!

SANIJE ALIAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

I respektuar Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Zoti Kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të respektuar deputetë,

I respektuar ministër Hoxhaj, sot në Kosovë ka një përfshirje tejet të vogël të fëmijëve në institucionet parashkollore, krahasuar me vendet e rajonit. Brengos përfshirja jo e kënaqshme e fëmijëve parashkollorë nga radhët e familjeve në gjendje të rëndë sociale.

Pyetja ime është: Cilët janë hapat konkret të MASHT-it për zgjerimin e kapaciteteve dhe krijimin e kushteve për gjithëpërfshirjen e fëmijëve në entet parashkollore, sepse aty është hapi i parë i formimit të personalitetit të fëmijëve në përkujdesje institucionale? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete!
Ministër, e keni fjalën!

MINISTRI ENVER HOXHAI: Faleminderit, shumë zoti Kryetar!
I nderuari zoti Kryetar,
E nderuara zonja deputete dhe deputetë,

Faleminderit shumë për një pyetje të tillë, meqë definitivisht edukimi parashkollor është ndër fazat më të rëndësishme në jetën e një njeriu, një qytetari, një individ. 50% e talentit të përgjithshëm intelektual arrihet deri në moshën 4 vjeçare. Ndërsa investimi në edukimin parashkollor përcillet edhe me trendet e tjera pozitive. Ata të cilët thjeshtë kanë ndjekur edukim parashkollor, e rritin efikasitetin e mësimnxënies në 30%, përderisa e zvogëlon edhe përsëritjen në arsimin e detyruar, të njëjtën kohë e zvogëlon edhe mundësinë e braktisjes së shkollimit.

Në një drejtim të tillë, për Ministrinë e Arsimit dhe për Qeverinë e Kosovës një euro e investuar në edukimin parashkollor shtatfishohet në kohën e ardhme.

Strategjia e Ministrisë së Arsimit synon mbi të gjitha që gjatë vitit të ardhshëm të fillojë me ndërtimin e disa çerdheve në disa qytete të Kosovës, sidomos për atë kategori të cilën ju e përmendët, e nderuara deputete. Po ashtu, do të synojmë që edhe një pjesë e kësaj çështjeje të mbulohet nga sektori privat. Trendi botëror dhe trendi evropian është që entet parashkollore, edukimi parashkollor të mbulohet kryesisht nga sektori privat edhe në shtetet të cilat kanë mirëqenie të mirëfilltë. Mirëpo, është obligim i Ministrisë së Arsimit që përmes Departamentit të Inspeksionit ta shohë gjendjen në këto çerdhe, ta shohë gjendjen në këto institucione parashkollore. Po ashtu, ne kemi hartuar edhe një hartë shkollore, në të cilën hartë i kemi 1200 objekte shkollore të cilat i ka Kosova, ku janë të vendosura edhe çerdhet, edhe shkollat fillore, edhe shkollat e mesme, edhe institucionet e arsimit të lartë, kemi një lloj schoolman, e cila do të plotësohet gjatë vitit të ardhshëm dhe ne do të bëjmë përpjekje maksimale që ta rrisim përfshirjen. Aktualisht i kemi 20 mijë fëmijë në arsimin parashkollor dhe jemi të interesuar që gjatë 2 – 3 viteve të ardhshme ta rrisim një pjesëmarrje me 4000 – 5000 nxënës më shumë në edukimin parashkollor.

Përveç kësaj, jem të interesuar që edhe Fakulteti i Edukimit ta rrisë cilësinë në kuptimin e aftësisë dhe të ngritjes profesionale për edukatorët. Unë ju falënderoj për një pyetje të tillë, po ju do të shihni që gjatë viteve të ardhshme ne do të bëjmë përpjekje maksimale që vërtet edukimin parashkollor ta shndërrojmë në një prioritet të rëndësishëm, ku karshi rolit që do ta ketë Qeveria e Kosovës, edhe një partneritet mes sektorit publik dhe atij privat është i mundur që ta adresojë një çështje të tillë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!
Deputete, ke pyetje shtesë? Urdhëro!

SANIJE ALIAJ: Zotëri ministër, Ministria e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë e ka Strategjinë 10 vjeçare. Në realizimin e kësaj strategjie, për sa kohë mendoni që Ministria juaj do të rrisë kapacitetet që përfshirja e fëmijëve në institucionet parashkollore të jetë e përafërt fshat - qytet, sepse në këtë drejtim në fshat, në zonat rurale pothuaj se mungojnë në shumicën e vendbanimeve. Ju faleminderit, shumë!

MINISTRI ENVER HOXHAI: Faleminderit, përsëri për pyetjen shtesë!

Strategjia e arsimit parauniversitar është ndër dokumentet më të mira që i ka Kosova në fushën e politikave arsimore. Mirëpo, meqë fokusi ynë është mbi të gjitha që gjatë këtij viti dhe vitit të ardhshëm ta tejkalojmë gjendjen, që të mos ketë mësim në tri ndërrime, katër ndërrime edhe në kryeqytetin tonë, edhe në qytetet tjera.

Pjesa më e madhe e investimeve do të fokusohet në ndërtimin e shkollave fillore dhe të shkollave të mesme dhe tek pas dy viteve ne do të bëjmë përpjekje që përmes investimeve në infrastrukturë, vërtet të ndërtojmë çerdhe të reja.

Ajo çfarë është planifikuar me Strategjinë e arsimit parauniversitar që ndodhë deri në vitin 2017, që mësimi në Kosovë të arrihet me dy ndërrime në shkollat fillore dhe në shkollat e mesme, ne si Qeveri bëjmë përpjekje që ta arrijmë për dy vite, brenda një hapësire kohore prej dy vitesh. Kuptohet që pasi të tejkalohet gjendja e investimeve në infrastrukturën shkollore të nivelit parauniversitar, ne jemi të interesuar që të investojmë edhe në nivelin parafillor. Prandaj, Strategjia do të fillojë të implementohet tek pasi të tejkalohet gjendja në arsimin fillor dhe të mesëm. Më duhet të them që edhe Ligjin që e kemi për entet parashkollore është një ligj jashtëzakonisht modern dhe ai ligj dhe Strategjia na obligojnë si Qeveri që karshi nevojave të qytetarëve dhe të qytetarëve më të rinj, thjesht të reagojmë në formën më të shpejtë të mundshme. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër!

Deputetja Sanije Aalijaj, pyetje për Kryeministrin, zotin Hashim Thaçi. Deputete, e keni fjalën!

SANIJE ALIJAJA: Ju faleminderit, zoti Kryetar,
I nderuar Kryeministër,

Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin për barazi gjinore. Agjencioni për Barazi Gjinore ka hartuar programin për barazi gjinore, njëherësh edhe zhvillimi i proceseve në Kosovë kërkon që Kuvendi i Kosovës të rishqyrtojë, pra të plotësojë dhe të amendojë Ligjin për barazi gjinore.

Pyetja për Kryeministrin: Sa angazhoheni ju dhe Kabineti i juaj, zoti Kryeministër, që të zbatohet Ligji për barazi gjinore në përmbajtjen aktuale që ka, në krijimin e kushteve dhe të perspektivave të barabarta për femrat në fushën e punësimit dhe në përfshirjen e institucioneve vendimmarrëse përafërsisht që edhe gruaja ta ketë vendin e saj të merituar. Ju faleminderit!

KRYETARI: Zoti Kryeministër, e keni fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Ju faleminderit, deputete për pyetjen! Natyrisht, Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin për barazi gjinore, Agjencioni për Barazi Gjinore, gjithashtu që funksionon pranë Qeverisë së Republikës së Kosovës, ka hartuar programin për barazi gjinore. Se a është e domosdoshme apo jo koha dhe rrethanat për ndryshimin apo plotësimin e këtij ligji, natyrisht se unë mendoj se çdo herë një ligj ka mundësi të përmirësohet, të ndryshohet, të plotësohet, t'iu përshtatet kushteve dhe rrethanave, funksionimit më të mirë dhe jemi në favor të kësaj.

Sa i përket pyetjes së drejtpërdrejtë se sa angazhohemi ne dhe Kabineti im që të zbatohet Ligji për barazi gjinore, unë dua ta potencoj se ka avancim në këtë drejtim dhe në të gjitha dikasteret e institucioneve të Republikës së Kosovës është duke u respektuar

ky parim për integrimin sa më të avancuar, përmbajtjesor për femrat në fushën edhe të punësimit, por edhe të marrjes së përgjegjësi shtetërore. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, Kryeministër!
Deputete, a ke pyetje shtesë?

SANIJE ALIJAJ: Zoti Kryeministër, menjëherë pas zgjedhjes suaj Kryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës, në një prononcim tuajin keni theksuar në mediat elektronike se një shtet dhe një shoqëri që synon të demokratizohet, nëse investon në resurset e të rinjve dhe në resurset e grave, perspektiva e atij shteti është e ndritur. Unë po shtoj se vërtet bëhet Kosova demokratike. Prandaj, kërkoj që këtë premtim tuajin ta bëni realitet. E kam bërë këtë pyetje se jam në Bordin e grupit joformal të grave dhe nga ne kërkohen përgjegjësi, prandaj në të ardhmen do të jeni në fokusimin tonë që përqindja e përfshirjes së femrës në institucionet e Kosovës, konkretisht edhe në Kabinetin tuaj, të rritet në përqindje. Ju faleminderit!

KRYETARI: Përgjigje nuk ka nevojë, më duket. Vazhdojmë, deputetja Sanije Alijaj, përsëri, pyetje për ministrin e Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor, zotin Mahir Yagcilar.

Deputete, lexoje pyetjen!

SANIJE ALIJAJ: Ju faleminderit, zoti Kryetar!
Ministër Yagcilar, janë mbi dhjetë deponi të automjeteve të prishura gjatë rrugës Prishtinë – Ferizaj, por edhe gjithandej nëpër rrugët e Kosovës. Këto deponi përveç që e shëmtojnë dhe e dëmtojnë ambientin jetësor, krijojnë pasqyrë dhe imazh të keq për shtetin e ri të Republikës së Kosovës.

Pyetja është: Cilët janë hapat a konkret që do t'i ndërmerrni ju, zoti ministër, dhe Ministria e juaj që ju e udhëhiqni, në mënjanimin e këtyre deponive apo në largimin e tyre nga aksi rrugor kudo në Kosovë, në mënyrë që t'u lihet hapësirë ambienteve të gjelbëruara. Ju faleminderit!

KRYETARI: Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Edhe një herë, faleminderit!
Zonja deputete, mbështetur në nenin 10 të Ligjit për mbeturina, sipas nenit 10, pika 1, magazinimi, çmontimi, trajtimi, hedhja e mbeturinave dhe të komponentëve të tyre do të kryhen na operatorët e licencuar.

Licencën për trajtimin e këtij lloji mbeturinave e lëshon Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor, por sipas Ligjit, e gjithashtu edhe sipas Udhëzimit Administrativ të Ministrisë, përgjegjësitë e komunave janë të lejojnë lokacionin për qendrën grumbulluese dhe të definojnë numrin e tyre në territorin e tyre, të organizojnë grumbullimin, transportimin dhe deponimin në qendrat grumbulluese, pra në pajtim me këtë Udhëzim Administrativ.

Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor përmes Inspektoratit ka bërë identifikimin e tyre, u kemi dërguar të gjithëve shkresë për përgatitjen e dokumentacionit për marrjen e licencës, e cila do të jetë e kufizuar, jo të gjithë do të

pajisen me licencë. Gjithashtu, me Ligj jemi të obliguar ta hartojmë Strategjinë e menaxhimit të mbeturinave, të cilën besojmë se së shpejti do ta përfundojmë.

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër!
Deputete, keni pyetje shtesë?

SANIJE ALIJAJ: Zoti ministër, unë për çdo ditë udhëtoj në relacionin Prishtinë-Ferizaj dhe anasjelltas. Mua po ma vrasin për çdo ditë syrin, e lëre më atyre të cilët kalojnë dhe na e donë të mirën, që shteti i Kosovës të ketë një perspektivë të ndritur në mbrojtjen e ambientit. Prandaj, ju kërkoj, i di kompetencat e kuvendeve komunale, i di edhe të nivelit qendror të Qeverisë së Republikës së Kosovës, po bashkërisht koordinoni punët dhe së paku ato nga arteriet kryesore të Kosovës të hyjnë diku më në thellësi. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Ministër!

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Po, po besojmë se me një koordinim më të mirë edhe me hartimin e strategjisë, do të përmirësohet situata.

KRYETARI: Deputetja Gjylnaze Syla, pyetje për zëvendëskryeministrin, zotin Hajredin Kuçi. Deputete, mund ta bëni pyetjen!

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Greva e ish punëtorëve të RTP-së ka filluar që 24 ditë dhe kërkesat e tyre janë 5: kthimi në shtëpinë e tyre, kompensimi për 9 vitet e shkuara, pranimi i përvojës së punës, moslejimi i tjetërsimit të pronës së RTP-së dhe zgjidhja e çështjes së punëtorëve me kërkesa sociale.

Zoti zëvendëskryeministër, Ju jeni takuar dhe ju keni premtuar përmbushjen e së paku 2 pikave. Çfarë keni bërë për këtë?

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Ju faleminderit, zonja deputete për pyetjen që e bëtë. Është e vërtetë se çështja e ish-punëtorëve të RTP-së është aktuale dhe fatkeqësisht ende gjenden në grevë ata. Ne i kemi pasur disa takime me ish punëtorët e RTP-së, përfshirë bashkë me zëvendëskryeministrin zotin Manaj. Takimin e fundit e kemi mbajtur mbrëmë.

Është e vërtetë që takimet e para në këtë problem të trashëguar, besoj jo nga kjo Qeveri, por edhe më herët, ndoshta 18 vite, në veçanti nga '99 e më tutje, iu kemi mundësuar dhe iu kemi thënë që kemi mundësi t'i bëjmë dy gjëra, ato për të cilat na jep kompetencë ligji dhe për ato që kemi mundësi buxhetore.

Në kuadër të kërkesave të tyre, ne kemi garantuar se do ta njohim stazhin e punës së tyre që kanë punuar nga vitet '74 deri në vitet '90 dhe po ashtu kemi thënë që do të mundohemi që përmes Agjencisë Kosovare të Privatizimit të shikojmë pronën e ish RTP-së, për çka i kemi dërguar një letër Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Ka edhe raste sociale, të cilat kemi menduar se duhet të trajtohen përmes Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Kemi tentuar apo ka qenë një vullnet i mirë edhe nga ne, që ta bëjmë një takim të përbashkët në mes të grevistëve dhe Bordit të RTK-së. Kam kontaktuar disa herë me kryetarin e Bordit të RTK-së, nuk ka pranuar ta bëjë një takim të tillë, duke supozuar që ata nuk i përgjigjen Qeverisë, por i përgjigjen Kuvendit të Republikës së

Kosovës. Unë kam pasur mirëkuptim, kjo është e drejtë e tyre ligjore. Ne nuk përzihemi në politikën e tyre menaxheriale, redaktoriale apo edhe kadrovike. Mendoj që është në dorën e Kuvendit të Kosovës, i cili është themelues i RTK-së, që të merret më shumë me këtë çështje.

KRYETARI: Ju faleminderit! Deputete, a ke pyetje shtesë? Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla

GJYLNAZE SYLA: Zoti zëvendëskryeministër, nuk është çështje e Bordit të RTK-së ta zgjedhë këtë problem. Pyetja ime konkrete është: Kur ju, saktë datën, meqenëse njerëzit janë në grevë, do t'i plotësoni kushtet?
Ju faleminderit!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Ndoshta nuk isha shumë i qartë në përgjigjen time, ndoshta edhe nuk më keni kuptuar drejt. Unë thashë që ne kemi dhënë premtime në kuadër të ligjit dhe të mundësive buxhetore. Qeveria nuk e ka në kompetencë që t'i kthej në vende të punës në RTK dhe nuk ka asnjë kompetencë mbi RTK-në për politikën kadrovike. Themelues i RTK-së është Kuvendi i Kosovës me ligj, dhe besoj sipas kësaj procedure, në Bordin e thashë, arsyeja kryesore është, i vetmi organ që u përgjigjet institucioneve të Kosovës, respektivisht Kuvendit, është Bordi i RTK-së, dhe përmes Kuvendit të Kosovës me Bordin e RTK-së, mund të bëjë zgjidhje të tjera.

Jemi në favor të zgjidhjeve që na garanton Kushtetuta, na garantojnë ligjet dhe mundësitë buxhetore. Ajo çka dua të them është një problem që ka pasur edhe më herët greva të njëjta, ka pasur premtime edhe më herët. Ne kemi qenë të kujdesshëm dhe nuk do të japim premtime që nuk mund t'i mbulojmë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, zëvendëskryeministër! Koha për pyetje parlamentare prej 50 minutash mbaroi. Vazhdojmë me pikën e radhës të rendit të ditës.

Pika e radhës është:

- **Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L088 për miratimin e Buxhetit të Kosovës dhe shpenzimet e autorizuar për periudhën prej 1 janar deri më 31 dhjetor 2008**

Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 25 të Ligjit nr. 03/L088 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, ka hartuar dhe Kuvendit ia ka paraqitur për shqyrtim dhe miratim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Buxhetin e vitit 2008.

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve.

Ftoj Ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, zotin Ahmet Shala, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë Projektligjin.

Mirë, ftoj Kryeministrin që paraprakisht ta prezantojë para deputetëve të Kuvendit, Projektligjin në fjalë.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!
Unë do ta prezantoj një pjesë hyrëse, në pika të përgjithshme.
I nderuari Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,
Të nderuar ministra,

Kosova sot ndodhet në një periudhë shumë të rëndësishme të zhvillimit të saj ekonomik. Të gjithë e dimë se një numër i madh i vendeve të fuqishme e ka njohur pavarësinë e Shtetit tonë, dhe një numër i vendeve të tjera janë në proces të njohjes.

Në të njëjtën kohë, një proces shumë i rëndësishëm veç sa ka filluar. Ai është anëtarësimi në institucionet financiare ndërkombëtare, siç janë: Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore. Presim përgjigje sipas procedurës që kanë këto institucione dhe, natyrisht, përgjigja do të jetë pozitive.

Ju, po ashtu e dini se javë më parë është mbajtur edhe Konferenca e Donatorëve për Kosovën, në të cilën Konferencë një ndihmë të jashtëzakonshme financiare prej 1.2 miliardë eurosh është zotuar për vitet e ardhshme për Kosovën.

Ky zotim i donatorëve ndërkombëtarë është rezultat i punës së mirë të institucioneve të Republikës së Kosovës, të Qeverisë së Kosovës dhe i besimit të partnerëve ndërkombëtarë në punën dhe në qeverisjen e mirë.

Kjo edhe njëherë tregon se partnerët tanë ndërkombëtarë janë shumë të zotuar që të ndihmojnë Kosovën në zhvillimin ekonomik dhe në ecjen e saj drejt integritit në Bashkimin Evropian dhe në NATO.

Një fushë tjetër në të cilën Qeveria ka qenë shumë e fokusuar, është ajo e rishikimit të buxhetit për vitin 2008. Të gjithë ne e dimë se buxheti i vitit 2008 ishte përgatitur në një periudhë shumë të shkurtër. Kjo ishte bërë për arsye të mos vonesave në fillimin e ekzekutimit të buxhetit, e në veçanti të ekzekutimit të shpenzimeve kapitale.

Që nga periudha e aprovimit të buxhetit për vitin 2008 e deri më tani, kur edhe e kemi bërë rishikimin e buxhetit, kemi trende pozitive. Përderisa ekzekutimi i shpenzimeve kapitale ka shënuar një rritje krahasuar me vitin e kaluar, në të njëjtën kohë kemi parë një rritje të të hyrave në raport me ato të planifikuara.

Normalisht, se faktori... i këtyre trendeve është edhe puna e përgjegjshme e Qeverisë së Kosovës, duke ditur se një nga brengat e së kaluarës ka qenë ekzekutimi i vogël i shpenzimeve kapitale, duke marrë parasysh edhe vështirësitë që kanë qenë të arsyeshme, nganjëherë edhe neglizhencë.

Një vëmendje të veçantë i kemi kushtuar pikërisht kësaj çështjeje. Si rezultat, ministritë në lindje, të cilat edhe absorbojnë buxhetin më të madh për investime kapitale, kanë filluar përgatitjet me kohë dhe tani kur kanë kaluar jo më shumë se rreth 4 muaj nga aprovimi i buxhetit, zotimet për këtë kategori janë të një niveli të mirë. Në të njëjtën kohë, Qeveria e Republikës së Kosovës vazhdimisht është angazhuar për përmirësimin e performancës së Administratës Tatimore të Kosovës dhe të Shërbimit Doganor, dhe si rezultat kemi parë një rritje të konsiderueshme të të hyrave totale buxhetore.

Ajo që vlen të theksohet këtu para jush, është se i kemi bërë rishikimin e të hyrave dhe krahasuar me projeksionet fillestare të fillimit vitit, tani presim që të hyrat totale të jenë më të larta për rreth 27 milionë euro. Këto të hyra shtesë priten të vijnë nga të hyrat kufitare dhe të hyrat jotatimore. Në anën tjetër, kemi një rritje të shpenzimeve të cilat

rritje do të shkojnë kryesisht në edukim, në shëndetësi, në rend dhe ligj, energji, institucione të tjera, infrastrukturë rrugore, pra në të gjitha segmentet e institucioneve të Republikës së Kosovës, në të gjitha segmentet e Qeverisë në nivel qendror, por edhe lokal.

Të nderuar deputetë,
I nderuari zoti Kryetar,

Unë nuk do të flisja më tepër nga se për detajet e këtij rishikimi mund të flasë edhe ministri i Ekonomisë dhe i Financave, zoti Ahmet Shala. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, zori Kryeministër!
Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI AHMET SHALA: Ju faleminderit, i nderuari Kryetar!
I nderuari Kryeministër,
Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,
Kolegë të nderuar deputetë,
Ligji mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë e vitit 2008, nr. 03/L088, mundëson bërjen e modifikimeve në buxhetet e aprovuara më parë.

Këto ndryshime në Ligjin e aprovuar buxhetor, zakonisht referohen si rishikime gjashtëmujore dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, me datën 16. korrik ka diskutuar dhe miratuar propozimin për rishikimin e vitit 2008. Këtë Draftpropozim të rishikimit gjashtëmujor, Qeveria e Republikës së Kosovës ia ka dorëzuar Kuvendit të Kosovës për shqyrtim dhe për aprovim më 18 korrik.

Më 30 qershor 2008, Ministria për Ekonomi dhe Financa ka kërkuar nga të gjitha organizatat buxhetore të ofrojnë rekomandime për ndryshime në këtë ligj, për miratimin e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës. Natyrisht, në këtë proces ishim të vetëdijshëm se duhet të mbuloleshin përgjegjësitë e reja pas krijimit të shtetit të ri të Kosovës dhe nevojat e paparashikuara të cilat dalin nga rreziqet e ndryshme, në mos mundësinë e ndikimit të Kosovës në trendet globale ndërkombëtare. Megjithatë, shumë nga organizatat buxhetore kanë kërkuar resurse shtesë. Rritja totale e kërkuar nga organizatat buxhetore, pra nga ministrinë, nga komunat dhe institucionet e tjera, kanë qenë rreth 147.300.000 euro.

Statusi i tanishëm, pra i këtij ligji: Për t'i adresuar kërkesat për financim gjatë vitit 2008, Qeveria e Republikës së Kosovës ka aprovuar shumën prej 111.700.000 euro. Këto fonde janë siguruar nga këto burime: 59.000.000 nga kursimet e buxhetit të vitit 2008, prej të cilave 42.000.000 euro nga Projekti i shpronësimit për autostradën Merdar – Morinë, 12.000.000 euro nga Fondi pas statusit; 5.000.000 nga kursimet e Ministrisë së Shërbimeve Publike. Pra, Qeveria ka vendosur që fondet për të cilat dihet që tani, ashtu siç, mbase ka ndodhur në shumicën e rasteve në të kaluarën, fatkeqësisht, se nuk mund të vijnë për ekzekutim brenda këtij viti, të paktën jo tërësisht, t'i përdorë për projektet kryesisht të karakterit zhvillimor, 22.000.000 euro nga rritja e të hyrave doganore. Kjo vjen si pasojë e analizës së gjashtëmujorit të parë të realizimit të të hyrave, kryesisht në vjeljet nga Dogana dhe Administrata Tatimore, të cilat kanë shtuar një rritje të dukshme, pa marrë parasysh problemet që i kemi në pjesën veriore, dhe 4.000.000 euro nga të hyrat jotatimore, kryesisht të hyrat komunale dhe të hyrat tjera të ministrive të ndryshme, të cilat kryejnë shërbime të caktuara konform ligjit. 0,85 milion,

përkatësisht 850.000 euro nga të hyrat vetanake, 25,9 milionë euro është ngritur deficiti buxhetor, përkatësisht suficitet nga vitet e kaluara.

Më poshtë ofrohet një përmbledhje e disa prej ndryshimeve më përmbajtjesore që propozohen në rishikim në gjashtëmujorin e ardhshëm. Rritjet më të mëdha janë, si vijon: 1.200.000 euro për Ministrinë e Punëve të Jashtme, me qëllim të mbulimit të nevojave për funksionimin e ambasadave dhe të përfaqësive diplomatike; 3,4 milionë për Ministrinë e Punëve të Brendshme, kryesisht për mbulimin e dokumenteve të reja identifikuese të Republikës së Kosovës, që i zëvendësojnë dokumentet e UNMIK-ut dhe shërbimet e tjera konform ligjit; 2.000.000 euro për licencimin e arsimitarëve; 7,8 milionë euro për Ministrinë e Shëndetësisë, prej tyre 3,8 milionë euro për barërat esenciale, 2.000.000 euro për trajtim mjekësor jashtë vendit, 2.000.000 euro për borxhet e mbetura nga vitet e kaluara.

Pastaj, 42.000.000 euro për nevojat e zhvillimit të KEK-ut dhe nevojat e importimit të rrymës gjatë periudhës së vjeshtës, kryesisht prej tyre 25.000.000 euro për import të energjisë pra, dhe 17.000.000 për kontingjentin për Minierën e Sibovcit.

Natyrisht, edhe ne kemi brengën tonë për ndarjen e këtyre mjeteve, por sigurisht që të gjithë pajtohemi se siguri i energjisë elektrike është i domosdoshëm për qytetarët tanë dhe posaçërisht për zhvillimin e sektorit privat dhe sigurinë e vendit.

35.000.000 euro janë në Ministrinë e Transportit dhe Post -Telekomunikacionit, kryesisht këto mjete do të jenë në funksion të zhvillimit ekonomik, pasi do të adresojnë ndërtimin e rrugëve të reja, rehabilitimin e rrugëve magjistrale, mirëmbajtjen e rrugëve ekzistuese dhe bashkëfinancimin e projekteve të përbashkëta me kuvendet komunale.

Dëshiroj t'ju njoftoj se vetëm përreth 3 muaj, Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit ka zotuar dhe shpenzuar rreth 70% të buxhetit të paraparë për vitin 2008.

Më lejoni t'ju them se në këtë fazë të tranzicionit, Qeveria e Republikës së Kosovës është dashur t'u përgjigjet edhe kërkesave të tjera që kanë të bëjnë me statusin e ri të Kosovës, siç janë kërkesat për ndërkombëtarizimin e sportit, bartjet e përgjegjësive nga UNMIK-u te Qeveria e Republikës së Kosovës në fushën e drejtësisë, rendit, përkatësisht SHPK-së, policisë, në fushën e ekonomisë, në sektorin e sigurisë, financat lokale dhe fushat e tjera publike.

Rishikimi në gjashtëmujor nuk bën ndryshime përmbajtësore në shumat për shpenzimet operative, për paga e mëditje, mallra e shërbime, shërbime komunale, kurse të subvencionet e transferet dhe shpenzimet kapitale ndryshojnë ndjeshëm, dhe atë: shpenzimet operative kryesisht mbulojnë vetëm nevojat imediate për sektorin e shëndetësisë, përgjegjësitë e reja ose bartjet e përgjegjësive nga UNMIK-u në Qeverinë e Republikës së Kosovës, ngritjet e çmimeve të tregut për sektorin e drejtësisë, sidomos në furnizim. Nëpër burgje dihet që trendet e rritjes së çmimeve të furnizimeve, të nevojave ditore të tyre ka pësuar ndryshime dhe planifikimet nuk kanë mund t'i mbulojnë të gjitha ato nevoja, prandaj ka ngritje. Subvencionet e transferet kryesisht kanë të bëjnë me importin e energjisë elektrike.

Te shpenzimet kapitale, janë rritur 18,7 milion euro vetëm. Pra, pa marrë parasysh që në shikim të parë shihet shifra, shpenzimet kapitale në tërësi janë rritur 18,7 milionë euro.

Gjithmonë kemi pasur kujdes që alokimet e brendshme t'i bëjmë përbrenda të njëjtës kategori të buxhetit.

Natyrisht, kjo rritje do të ndikojë në zgjerimin e bazës materiale për të gjithë qytetarët tanë. Këtu gjithsesi më duhet të cek se krahas kësaj rritjeje kemi zhvilluar një proces tjetër cilësor, që ka të bëjë me kursimet nga projektet që nuk mund të zhvillohen këtë vit, dhe këto mjete i kemi transferuar në projekte të cilat janë të gatshme për fillim brenda këtij viti buxhetor me një siguri të lartë se shumica e tyre do të përfundojnë.

Të nderuar deputetë,

Më lejoni t'ju njoftoj se përmes këtij procesi ne kemi siguruar edhe rregullimet e brendshme brenda organizatave buxhetore me qëllim që të zvogëlojmë në minimum nevojën për ndërhyrje përmes tarnsfereve, pasi që ligji në fuqi ju garanton organizatave buxhetore deri në shkallë të caktuar këto lëvizje.

Fare në fund, ju ftoj të aprovoni rishikimin gjashtëmuor të këtij buxheti, duke qenë i bindur se përmes këtij procesi ne do të ndihmojmë zhvillimin e shumë projekteve të gatshme për implementim, e të cilat ndikojnë në ngritjen e mirëqenies së qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe në implementimin e shumë përgjegjësisve të reja që rrjedhin nga pozita e re e shtetit të pavarur të Republikës së Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, Ministër!

Tani radhën për diskutim e ka kryetari i Komisionit raportues për Buxhet dhe Financa, deputeti Gani Koci.

GANI KOCI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuari zoti Kryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne, si Komision e kemi shqyrtuar paraprakisht këtë propozim të Qeverisë për rishikim të Buxhetit. Në mbledhje të Komisionit kanë qenë prezentë edhe ministri edhe zëvendësministri me bashkëpunëtorët e vet, të cilët na i kanë dhënë arsyetimet lidhur me këtë shpërndarje, të cilën e tha këtu para nesh sot në Kuvend.

Në parim, ne si Komision kemi kërkuar që ky Ligj të shqyrtohet në Kuvend, duke pasur parasysh se në leximin e dytë disa vërejtje që, po them, parimore i ka bërë Komisioni, në formën e amendamentuar, do t'i përfshijmë dhe ato do të sillen në leximin e dytë të këtij Projektligji.

Dua ta them edhe një çështje, që është hera e parë që ballafaqohemi me një proces të rishikimit, sepse deri tash nuk kemi pasur, dhe ndoshta vetë koha na ka pamundësuar që në mënyrë të detajizuar ta përfundojmë deri në fund dhe me sukses më të mirë, por megjithëse nuk ka lëvizje të mëdha dhe lëvizjet janë kryesisht brenda organizatës buxhetore dhe brenda asaj që quhet kornizë ligjore dhe dispozitave ligjore, konsiderojmë se ky Projektligj duhet të kalojë në mënyrë që të procedohet më tutje dhe të kemi vazhdimin e aktiviteteve buxhetore pas kësaj. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Sipas radhës, fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, zoti Ramë Buja.

RAMË BUJA: Zoti Kryetar i Kuvendit,
Zoti Kryeministër, zëvendëskryeministra,
Kabinet Qeveritar,
Të nderuar dhe të respektuar kolegë deputetë,
Falënderim fillimisht për Kryeministrin dhe ministrin e Ekonomisë dhe të Financave për sqarimet që na i përplotësuan krejt imazhin e asaj që edhe kishin krijuar, në përpunimin që e kishin bërë në materialin e këtij buxheti të rishikuar. Natyrisht, është për t'u përshëndetur një kujdes i veçantë i këtij rishikimi, kësaj analize dhe këtij peshimi shumë profesional dhe logjik për kohën, në proporcionet që janë krijuar në bazë të rrjedhave ekonomike që ka pasur Kosova.

Unë dhe Grupi Parlamentar e kemi parë me shumë kujdes këtë material të këtij rishikimit të buxhetit dhe jemi gjithsesi për ta përkrahur dhe mbështetur në leximin e parë, sepse duke u nisur nga pozicioni i parë i krijimit të institucioneve të reja, që është parë me shumë kujdes, tek mallrat dhe shërbimet, subvencionet, investimet kapitale dhe të hyrat, është bërë një përllogaritje që vërtet ia vlen për t'u përkrahur dhe mbështetur, natyrisht pa pretenduar për të thënë se është i përkryer. Vërejtje mund të ketë, por gjithsesi nga Grupi Parlamentar do të jetë i përkrahur. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!
Fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar të LDK-së, Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!
Zoti Kryeministër, ministra
Të nderuar kolegë,
Grupi parlamentar i LDK-së e mbështet në lexim të parë rishqyrtimin buxhetor, kufijtë e paraqitur. Natyrisht, Grupi Parlamentar i LDK-së gjatë diskutimeve të sotshme dhe gjatë punimit të Komisionit për Buxhet, para leximit të dytë do t'i paraqet vërejtjet parimore që kanë të bëjnë me kufijtë buxhetorë, që kanë të bëjë me balancin e prioritetëve që ka paraqitur Qeveria, të politikave eks-sektoriale, të kapaciteteve, të ndërtimit të kapaciteteve harxhuese të Qeverisë në mënyrë që mjetet e planifikuara buxhetore dhe mjetet e donatorëve si pjesë e politikave, në këtë pjesë të dytë të vitit dhe në vitet tjera të jenë në përputhje me prioritete dhe me politikat sektoriale që Qeveria i ka paraqitur dhe ne e kemi miratuar këtë pjesë të buxhetit. Edhe më herët e kemi tërhequr vërejtjen për kapacitetet harxhuese, sepse shihet se po shkojmë drejt një suficitit të planifikuar domosdoshmërisht, sepse ka të bëjë kryesisht me kapacitetet harxhuese. Besoj që Qeveria, në këtë rast Kryeministri, do të kujdeset në veçanti që pjesa e dytë e këtij viti të jetë e fokusuar në realizimin e këtyre projekteve që janë paraparë dhe të prioritetëve sektoriale që janë paraqitur.

Shihet qartë se shëndetësia dhe Ministria e Telekomunikacionit janë përfitues kryesor të rishikimit buxhetor, sipas prioritetëve që absolutisht ne i japim mbështetje, por duke dashur në vazhdimësi të gjenden mënyra që politikat tona të orientohen drejt prioritetëve të sundimit të ligjit, të rendit, të arsimit dhe të angazhimeve tjera.

Për të përmbledhur fjalën time në emër të Grupit Parlamentar, zoti Kryetar i Kuvendit, ka të bëjë që angazhimi ynë në debat të drejtpërdrejtë, deputetët të paraqesin sigurisht vërejtjet parimore, besojmë që në leximin e dytë do ta arrijmë që ta ndihmojmë Qeverinë që ta përmbledh këtë pjesë të punës që ndryshimi i ligjit apo rishikimi buxhetor të jetë në interes të zhvillimit të vendit, në interes të realizimit të projektit të Qeverisë dhe në

interes të zhvillimit që parashihet sipas këtij rishikimi apo planifikimi buxhetor. Ju faleminderit shumë!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar AKR, kryetari Ibrahim Makolli e ka fjalën. Shkumbin Demalijaj.

SHKUMBIN DEMALIJAJ: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuari zoti Kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Kolegë të nderuar deputetë,

Meqenëse para nesh sot ekziston Projektligji për ndryshimin e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës, ndryshimi i Ligjit nr. 03/L 088 mbi miratimin e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës dhe të shpenzimeve të autorizuara për periudhën 1 janar deri me 31 dhjetor 2008, meqenëse ndryshimet që bënë në skenën politike dhe statusore të Republikës së Kosovës, bien poshtë vendimet e veçanta që ka mund të nxjerrë Qeveria për mundësinë e ndryshimeve të pjesshme buxhetore në ato pjesë ku ka mundur, është një obligim kushtetosh që tani Qeveria e ka nxjerrë para nesh edhe ne jemi të obligueshëm që ta çojmë deri në fund këtë punë që e kanë bërë.

Grupi ynë Parlamentar, pas një analize që i ka bërë këtij materiali mjaft voluminoz për një kohë relativisht shumë të shkurtër, ka arritur që t'i hartojë vërejtjet tona dhe ato vërejtje i sublimojmë në dy pjesë, në vërejtjet parimore dhe në vërejtjet konkrete.

Në kudër të vërejtjeve parimore lidhur me Buxhetin e Kosovës, ne do të veçonim me sa vijon: ekziston një mosbalancim i të hyrave dhe të dalave të mjeteve buxhetore, që paraqet njërin ndër parimet kryesore të buxhetit. Në dokumentin buxhetor, saktësisht duhet të përputhen të hyrat dhe të dalat, përkatësisht me shpenzimet.

Dy, paraqitja e suficitit buxhetor që u bë dukuri dhe me vite po e përcjellë buxhetin e Kosovës, që është i pajustificueshëm e aq më pak i pranueshëm për rrethanat ekonomike dhe sociale në të cilat gjendet Kosova në periudhën pas luftës dhe tani aktualisht.

Prezenca e invazionit buxhetor, që po ashtu është bërë dukuri, e që është rezultat i veprimt të kontrabandës ekonomike, ekonomisë informale dhe të krimit të organizuar, e tjera.

Vërejtjet konkrete janë të shumta. Në vazhdim po i paraqesim vetëm ato më kryesore, duke mos u lëshuar në detaje, të cilat i kemi vërejtur gjatë analizës sonë bërë materialit të Projektligjit të shqyrtimit të Buxhetit të Kosovës. Në bazë të të dhënave në Tabelën kumulative nr.1, të prezantuar në materialin që po e shqyrtojmë, rezulton se totali i të hyrave buxhetore është rritur për 26.8 milion euro, ku pjesa kryesore e tyre parashihet të grumbullohen nga të hyrat tatimore - 22.000.000 euro, apo 81.5%. Ndërkaq, totali i shpenzimeve buxhetore sipas të dhënave të të njëjtës tabelë, do të shtohet apo rritet për 52.7 milion euro. Në këto të dhëna rezulton se bilanci bankar i akumuluar apo i shfrytëzueshëm, do me thënë suficiti i mjeteve buxhetore nga mjetet buxhetore paraprahe, përfshin vlerën 423.000.000 euro.

Në Tabelën nr. 2 të këtij materiali, janë të dhënat e të dalave pas rishikimit të buxhetit të sistematizuara sipas bartësve, që paraqet pjesën analitike të shpenzimeve buxhetore të Kosovës për vitin buxhetor 2008.

Në vazhdim do të prezantojmë rritjen globale të shpenzimeve buxhetore, të nxjerra nga ky material, dhe atë në dy mënyra. Së pari, do të prezantojmë rritjen globale të shpenzimeve sipas bartësve dhe, së dyti, do të bëjmë disa analiza nga aspekti i riorientimit të rritjes së shpenzimeve buxhetore, duke i prezantuar ato nëpër ministri, departamente dhe projekte.

Vlera globale e shpenzimeve buxhetore sipas bartësve, të nxjerra sipas të dhënave të prezantuara në këtë dokument, janë me sa vijon: Kuvendi i Republikës së Kosovës, me rishqyrtimin e buxhetit, këtu janë paraparë të rriten shpenzimet për 307.245 euro. Vlen të theksohen këtu, se në Komisionin për Buxhet ne nuk kemi pasur edhe një kërkesë që kryesisht është një koordinim i Kryesisë së Kuvendit bashkë me përfaqësuesit e Qeverisë, në këtë rast që pa ardhur në adresën e Komisionit, do të thotë është anashkaluar Komisioni për Buxhet, është bërë një kërkesë që të rriten pagat e anëtarëve të Kryesisë, që dallojnë shumë nga ato të deputetëve dhe punën që e bëjnë në komisione, duke përfshirë këtu, sepse po lodhen shume duke na e caktuar rendin e ditës edhe një pikë e rendit të ditës na vjen pesë herë në seancat e Kuvendit. Duhet të hiqet.

Zyra e Presidentit, këtu janë të parapara të rriten shpenzimet vetëm për 50.000 euro, ndërkah në Zyrën e Kryeministrit janë paraparë të rriten shpenzimet për 1.224.442 euro, çka do të thotë se 98% të këtyre shpenzimeve shkojnë për çështje jorezidente, që do të thotë nuk ka një planifikim të caktuar.

Ministria e Ekonomisë dhe i Financave, këtu është paraparë të rriten shpenzimet për 32.876.595 euro.

Agjencia Kosovare e Privatizimit, këtu janë paraparë shpenzime në vlerë prej 4.876.600 euro.

Ministria e Shërbimeve Publike, këtu është paraparë që të zvogëlohen shpenzimet për 2.403.309 euro edhe përkundër asaj se ka shkelje, sepse është thye vendimi i përparshëm i Qeverisë për numrin e të punësuarve në Shërbimin Civil të Kosovës, ku kemi mbi 500 punëtorë që kanë hyrë në punë duke përjashtuar edhe resore të reja, ministri të reja që tani veç janë themeluar, sepse aty ekziston vetëm stafi politik edhe ne si Kuvend, po nuk di, edhe Qeveria e ka një organogram të tillë se si është e paraparë struktura organike brenda këtyre ministrive.

Ministria e Bujqësisë, e Pylltarisë dhe e Zhvillimit Rural, këtu është paraparë të rriten shpenzimet për 1.128.901 euro.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, edhe këtu rriten shpenzimet për 512.280 euro.

Ministria e Transportit dhe e Post-Telekomunikacionit, këtu është paraparë të rriten shpenzimet për 44.856.420 euro. Është e rëndësishme se nga pozicioni për trasenë e rregullimit të autostradës së Kosovës, hiqet pozicioni prej 42.000.000 euro, sepse ende Qeveria nuk ka një projekt të tillë, deri tani kanë thënë se i kemi projektet, mirëpo sot nuk dinë kah i bien traseja dhe 42.000.000 milion janë shpërndarë nëpër xhepa të

ministrive të ndryshme dhe në projekte të vogla, që disa kolegë të mi në Komisionin për Buxhet kanë thënë se do të shtrohen të gjitha rrugët të sokaqeve nëpër Kosovë, kryesisht edhe nëpër ato vende ku nuk ka ndonjë stimulim për komunat e vogla, përpos në Komunën e Malishevës, sepse ata e kanë paguar tatimin në pronë më së shumti, edhe besoj në zonat ku përmenden, ku do të shtrihet kjo infrastrukturë që do të rregullohet një numër i madh i tyre, kanë 5 – 6 shtëpi apo nuk dinë edhe çka është tatimi në pronë, duke akumuluar atë pjesë të tatimit në pronë ku parashihen objektet e ndërtimit, sepse neve për pronat, tokën kryesisht, nuk paguajmë ende tatim dhe nuk ekziston diçka e rregulluar me ligj për këtë çështje.

Ministria e Shëndetësisë, këtu është paraparë të rriten shpenzimet për 9.778.910 euro.

Ministria e Kulturës, e Rinisë dhe Sporteve, edhe këtu rriten shpenzimet për 2.695.307 euro.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë, edhe këtu është paraparë të rriten shpenzimet prej 3.683.207 euro.

Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, rriten shpenzimet për 226.529 euro.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, edhe këtu rriten shpenzimet për 1.129.399 euro.

Ministria për Komunitete dhe Kthim, rriten shpenzimet për 726.811 euro.

Ministria për Administratën e Qeverisjes Lokale, edhe këtu rriten shpenzimet për 5.155.534 euro.

Ministria e Punëve të Brendshme, këtu është paraparë të rriten shpenzimet për 4.571.857 euro.

Ministria për Energjetikë dhe Miniera, edhe këtu rriten shpenzimet për 193.000 edhe kalkulimet që bëhen në kuadër të borxhit, të kredisë që jep çdo vit mjete të mëdha monetare Buxheti i Kosovës, mirëpo edhe kësaj radhe ne me Buxhetin e Kosovës do të jemi bashkëfinansues të KEK-ut dhe rryma po na ndalet edhe gjatë punimeve të Kuvendit, edhe gjatë bisedës së Kryeministrit kur ishte në foltore.

Ministria e Drejtësisë, është paraparë që të rriten shpenzimet për 1.561.890 euro.

Duke u mbështetur në këto shifra të sipër cekura, që janë nxjerrë nga ky material, dhe duke i krahasuar me shpenzimet e Rregullores buxhetore 2008/13, del se rritja e paraparë e shpenzimeve të përgjithshme, përfshirë vlerën prej 114.548.206 euro, nëse nuk ka gabime teknike në material dhe në llogaritjen tonë, si Grup parlamentar, shuma shtesë e shpenzimeve buxhetore sipas bartësve, pra analitikës, as përafërsisht nuk përkon me vlerën e prezantuar në tabelën nr. 1. Pra, në të dhënat kumulative, përkatësisht në pasqyrën përmbledhëse, ku vlera e rritjes së shpenzimeve buxhetore prezantohet se është 52.7 milion euro, diferenca mes vlerës së shpenzimeve buxhetore të shtuara dhe të paraqitura në pasqyrën analitike, pra sipas bartësve, përkatësisht sipas ministrive dhe ajo kumulative, është 61.9 milion euro. Andaj, duke u mbështetur në këto shifra, Grupi Parlamentar i AKR-së shtron pyetje: Çka në fakt paraqesin këto të dhëna që nuk

përputhen mes vete? Cila është rritja reale e shpenzimeve buxhetore pas rishikimit buxhetor - 52.7 apo 114.5 milionë euro?

Me sa kemi konstatuar, duke u mbështetur në të dhënat analitike të kësaj materie, rritja e shpenzimeve buxhetore nuk është 52.7 milionë euro, por është 114.6 mi....

KRYETARI: E keni harxhuar kohën. Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Zoti Kryeministër,

Deputetë të nderuar të Kuvendit të Kosovës,

Mendoj se Projektbuxheti të cilin e ka paraqitur Qeveria e Kosovës sot para nesh, realisht reflekton me konceptin qeverisës të deritanishëm të cilin e kemi parë, me konfuzitet, me gjërat të cilat janë kamufluar dhe janë fshehur. Nuk ke faj ti Shkumbin, nuk shihet se nuk e kanë shkruar, por tash të tregoj unë se qysh del kjo punë.

Në një dyqan i cili fotokopjon material, makina fotokopjuese është investim kapital, por për Qeverinë e Kosovës nuk është investim kapital, janë mallra dhe shërbime. Në shumë pika nuk shënohet. Për shembull, thuhet projektet të cilat nuk janë realizuar nga Buxheti i Kosovës deri më tani, quhen kursime. Ju lutem, një projekt i cili nuk ka filluar fare, e i cili është paraparë me buxhet të vitit 2008, prej 1 janarit ose me 7 shkurt që e kemi miratuar dhe tani thuhet se është kursim, ministër, gjuha shqipe ka fjalë. Janë projektet që nuk janë realizuar. Nuk është kursim tërheqja e mjeteve të autostradës, ajo është mosrealizim i projektit dhe duhet të thuhet - është mosrealizim i projektit, nuk është turp.

Çështja tjetër është Ministria e Shërbimeve Publike. Nuk ka kursye, por nuk ka realizuar hiq projektet, domethënë janë projekte që nuk janë realizuar fare edhe tash na thotë janë kursyer mjetet. Qysh bre janë kursye, kursehen kur një projekt është paraparë të kushtojë 5 milionë dhe ka kushtuar 4 milionë, atëherë themi se i kemi kursyer 1 milion, por nëse projekti nuk nisat hiq, ai nuk është kursim, është mosrealizim i projektit.

Pyetja tjetër që duhet të na bëjë përshtypje të gjithëve këtu është a i ndihmon ky projektbuxhet implementimit të mjeteve të zotuar nga donatorët? Po ju them se jo, mirëpo duhet t'i lëmë kohë vetvetes që të presim dhe koalicioni është i madh, i keni votat, ju e votoni, mirëpo do ta shihni në fund që votimi i këtij projektbuxheti kësisoj qysh ka ardhur, do të ketë ndikim esencial në implementimin e zotimeve të mjeteve të donatorëve për shkak se ka donatorë shumë të fuqishëm këtu që i kanë rekomanduar Qeverisë të mos e sjellë këtë projektbuxhet kësisoj qysh është edhe ne nuk e kemi dëgjuar asnjë fjalë se ashtu është.

Tjetra është, thuhet që tani, domethënë Lidhja Demokratike e Kosovës thotë se do t'i inkorporojmë disa çështje në buxhet të Kosovës deri nesër. Shikoni, kjo ka të bëjë me mënyrën se si sillet buxheti në Kuvendin e Kosovës. Si po mendoni se mund të ndryshohet pika buxhetore për 12 orë? Kushdo që ka marrë pjesë, është shumica e deputetëve, këtu kanë marrë pjesë në proces buxhetor, e dinë që për 12 orë nuk ka kurrfarë gjasash për t'i lëvizur asnjë pikë, diçka, ndoshta, vetëm kozmetike, asgjë reale nuk mund të lëvizë. Kjo ka të bëjë prapë me mënyrën se si është sjellë buxheti. Sikur Qeveria të ishte ngutur vetëm tri ditë pune, do të thotë diku 24 orë totale, e që ka pasur mundësi, ne këtë buxhet do ta kishim marrë para seancës së kaluar plenare dhe

atëherë Komisioni për Buxhet dhe Financa do ta kishte pasur një javë të plotë minimum që të merret me amendamentet, që të konsultohen njerëzit në mes veti dhe, ndoshta, të amendohet ky buxhet. Kur i lihet buxhetit 24 orë prej leximit të parë, në leximin e dytë nuk ka gjasa. Edhe ne me plotë të drejtë besojmë që kjo bëhet gjithmonë me qëllim për shkak se nuk është hera e parë, sikur të kishte ndodhur veç një herë, ne kishim thënë në rregull, ka ndodhur kësaj here se nuk ka pasur kohë, mirëpo, kur në vazhdimësi ndodh, që të gjitha çështjet që janë kontraverze dhe të vështira sillen para Kuvendit në mënyrë urgjente, atëherë ne besojmë se këtu ka çështje serioze të cilat bëhen me qëllim realisht.

Ne mendojmë se ky buxhet tregon se Qeveria largohet prej interesave afatgjata strategjike, siç është autostrada dhe fillon të punojë me projekte të cilat janë të vogla, nëpër rrugica, nëpër rrugica të Kosovës, të cilat janë të domosdoshme, në rregull, mirëpo mendoj se ne të cilët jemi pjesë e shtetit i vendosim prioritetet. Nuk mund të themi se tani më të rëndësishme janë rrugicat se autostrada. Rrugicat janë më të rëndësishme në demokraci kur ka zgjedhje, para zgjedhjeve vrapojnë njerëzit dhe mbarojnë rrugica se duhet t' i fitojnë votat, mirëpo tash nuk e dimë ne a kemi zgjedhje a jo, nëse kemi zgjedhje tregoni. Mirëpo, buxheti i cili i largon investimet kapitale siç është autostrada dhe i dërgon ato në rrugica, është buxhet më së paku interesant edhe është zgjedhor.

Tjetra është, nuk ka raport paraprak, ne nuk kemi marrë, kush prej deputetëve e ka marrë një raport paraprak të shpenzimeve për gjashtëmujorin e parë, të paktën që ta dimë dhe ta kuptojmë ne tash cilat janë elementet, cilat janë mjetet e "kursyera" në cilin do prej ministrive. A janë mjete të kursyera a çka janë, do me thënë nuk e kemi marrë, ka qenë dashur që të kemi raport paraprak para se të fillojmë të diskutojmë për rishikimin e buxhetit. Rishikim të buxhetit ka pasur vjet për vjet.

Elementi tjetër është shpërndarja jo e drejtë buxhetore. Unë nuk do të ndalem pikë për pikë, me siguri se do të ketë kolegë deputetë të cilët do të flasin. Shpërndarja buxhetore është totalisht jo e drejtë edhe kushdo që e sheh edhe e voton, prapë do ta konstatojë se kjo është ndarje esencialisht e padrejtë buxhetore, kjo është ndarje. Dikush ka mësuar po më duket prej kohës së kaluar, e jo qysh duhet.

Element tjetër tepër brengosës janë 50 milionë për blerje të rrymës. Tani ne duhet shikuar, duhet t' i kemi raportet. Çka ka bërë Qeveria e Kosovës që të rritet inkasimi? Çka ka bërë Qeveria e Kosovës që të ketë prodhim të energjisë elektrike në Kosovë? Pse të blejë 50 milionë rrymë kur kanë premtuar se do të ketë 24 orë rrymë, nuk kanë thënë se do ta blejmë, kanë thënë ne i kemi kapacitetet tona. Është dashur të thuhet 24 orë rrymë po i shpenzojmë të hollat e taksapaguesve të rregullt, për shkak se e kemi një punë këtu. Të gjithë njerëzit që e paguajnë rrymën, kanë tendencë të jenë taksapagues të rregullt dhe çka bëjmë ne tash? Të njëjtëve njerëz ju marrim edhe taksat, ju marrim edhe të hollat me të cilat e paguajnë rrymën që e kanë shpenzuar edhe tjerët që nuk e paguajnë hiq, realisht janë krejt në rregull. Jemi duke i dënuar njerëzit dy herë, në vend se me ato mjete të taksave të veta të ndërtohen rrugë, ne blejmë rrymë për ata që nuk e paguajnë. Këtë e bënë Qeveria e Kosovës.

Buxheti është i paqartë dhe pak fola për këtë element të buxhetit shumë të paqartë, ju thashë kemi elemente ku, për shembull, nuk mund të tregojë dikush a janë mallra dhe shërbime, a janë investime kapitale, a është domethënë një aparat fotokopjues, investim kapital në Kosovë apo nuk është, apo është mallra dhe shërbime?

Kemi një element tjetër që është tepër brengosës, është centralizimi i shpenzimeve. Shikoni listat buxhetore edhe do ta shihni se 90% e tenderimit kryhet në nivelin qendror edhe rrugët lokale, të cilat nuk janë në kompetencë e nivelit qendror, por janë kompetencë e komunave, merren përsipër nga niveli qendror. Kjo është tenderoromani, se arsyeja e vetme pse të njëjtat mjete të cilat do të shpenzohen për të njëjtën rrugë, nuk i bartën komunës, por i mbeten nivelit qendror, ma merr mendja që nuk do shumë koment kjo punë.

Në fund të fundit, po them edhe një herë, problemet kryesore janë se ky buxhet nuk do të na ndihmojë. Ju do ta votoni, krejt në rregull, e kam njëfarë ndjenje se i keni votat si koalicion, mirëpo ne do të kthehemi te ky buxhet, do të ktheheni edhe ju për shkak se ka elemente konceptuale me të cilat nuk keni për t'u mburr shumë shpejt. Do të vijë fundi i vitit shumë shpejt dhe nuk keni për t'u mburr me këtë projektbuxhet të cilin e ka sjellë Qeveria e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Para se t'ia jap fjalën shefit të Grupit Parlamentar të LDD-së, Lulzim Zeneli, kërkoj nga deputetët që nëse nuk e kanë të ndezur mikrofonin të mos flasin.

Fjalën e ka deputeti Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti Kryetar!
Të nderuar deputetë,
Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,
Zoti Kryeministër,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë ka analizuar me shumë vëmendje Projektligjin për shikimin e buxhetit për vitin 2008 dhe me shumë keqardhje konstatojmë se ky planifikim i buxhetit më së mirë i reflekton dhe i vërteton shqetësimet tona të mëhershme se kjo qeveri e ka të vështirë të qeverisë vendin në kushte normale. Pra, kjo qeveri me këtë vizion dhe qasje çfarë po demonstroi jep të kuptojmë se vepron mbi baza jo të shëndosha, gjë që për ne është shqetësuese.

Argumenti më i mirë i krejt kësaj që e thashë më herët është se ky planifikim i buxhetit, ky rishikim që sot po e diskutojmë nuk përputhet, është në diskrepancë të madhe me kornizën afatmesme të shpenzime buxhetore. Është për çudi si asnjë prej deputetëve këtu nuk e shprehi këtë, kjo është shqetësuese dhe do të jetë shqetësuese në vijim. Qeveria jonë duhet ta kuptojë se të krijosh politikë qeveritare dhe qeverisësh është përgjegjësi.

Ky rishikim i buxhetit jep dy përgjigje shumë të qarta.

E para, demanton deklaratimet dhe zotimet e vazhdueshme të kësaj qeverie të gjertanishme, e cila me shumë agresivitet ka paraqitur para opinionit ose lirisht mund të them po ndërron kursin politik para opinionit dhe qytetarëve të Kosovës. Në një takim kur është pyetur një zyrtar i Qeverisë në një fushatë se cili do të jetë prioriteti i kësaj qeverie nëse vini ju në pushtet, përgjigja ka qenë: janë tri prioritete - edukimi, edukimi dhe e treta edukimi. Prandaj, duke vazhduar me programin për shëndetësi dhe luftën ndaj krimit dhe korrupsionit, e sot për fat të keq të gjitha këto demantohen. Pse demantohen? Se ky Kuvend sot para qytetarëve të Kosovës duhet t'ju thotë të vërtetën, t'ju thotë punonjësve të arsimit, mësuesve se do të vazhdoni të trajtoheni njësoj ashtu siç jeni trajtuar deri më sot. T'ju thotë punëtorëve shëndetësorë se do të keni edhe në vijim paga fyese, t'ju thotë edhe pensionistëve se do të keni të njëjtin tretman që keni pasur deri më sot dhe një tretman të padenjë dhe shumë kush e ka cituar si një gjendje shumë të rëndë buzë

skamnores. Kjo është pasqyra reale sot, prandaj kjo qeveri është dashur të mendojë shumë më herët para se të bëjë një rishikim të buxhetit.

Zoti Kryeministër,

Në kuadër të këtij planifikimi ekzistojnë disa dilema. E para, agjencionet buxhetore ju i keni trajtuar në mënyrë shumë selektive, çka është e çuditshme dhe në bazë të preferencave tuaja. Shembulli më i mirë është Agjencioni Kundër Korrupsionit ku jo pak herë janë ngritur në opinion shqetësimet se këtij agjencioni duhet t'i ndihmojmë. Ky agjencion ka nevojë për mjete, ka nevojë për kapacitete të reja. Prandaj, në këtë planifikim nuk është prekur, nuk është prekur as për një euro dhe kjo është shqetësuese. Prapë po e them se shkalla e korrupsionit dhe e krimit ashtu siç e keni potencuar edhe vetë është alarmante.

Zoti Kryeministër, a mund të krahasohet rritje e planifikuar e shpenzimeve për Ministrinë e Transportit dhe Postë Telekomunikacionit në krahasim me ministrinë tjera, si Ministrinë e Punëve të Jashtme, që po e marrë shembullin konkret. Politika e jashtme e Kosovës edhe ashtu mungon edhe më tej, pra nuk do të jetë prioritet i kësaj qeverisje. Mos të flasim se këtu janë shumë për t'u dëshiruar ato premtime për hapjen e ambasadave të reja. Deklarimet e vazhdueshme të kësaj qeverie për të cilat janë atakuar në vazhdimësi ish-qeveritë e kaluara është se kjo qeveri që sot qeverisë Kosovën kushton më lirë. Nëse e krahasojmë vijën buxhetore për mallra dhe shërbime, atëherë del diçka e kundërta dhe kjo qëndron se diçka që deklarohet në publik prej kësaj qeverie apo zyrtarëve të saj, ky Kuvend do t'i ketë parasysh se sa po arrin t'i realizojnë ato.

Buxheti i Kosovës, ne e dimë që është buxheti i shtetit dhe është shqetësimi jonë se ne kemi shprehur edhe më herët faktin se kjo qeveri qytetarëve të Kosovës do t'iu kushtojë shumë dhe faturën për këtë do ta paguajnë ata vetë, ndërsa për ne si deputetë të Kuvendit të Kosovës e kemi për detyrë që në mënyrë të argumentuar t'iu themi vërejtjet dhe shqetësimet tona për të cilët nuk janë të pakta dhe kjo qeveri me këtë qasje po që demonstroi në vijim, nuk është Qeveri e progresit të Kosovës dhe nuk është Qeveri e cila krijon stabilitet politik social e mos të flasim për atë ekonomik. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, deputeti Sadik Idriz.

SADIK IDRIZ: Hvala, Predsedniče!

Parlamentarna grupa „7+“ će kao partner u koaliciji podržati ovaj Nacrt zakona o rebalansu buxheta za ovu godinu. Mada smatramo da je ovo više jedna prekompozicija budžeta koji je bio planiran, koji nije realizovan do sada, posebno u oblasti transporta, i nerealizacije dosadašnjih projekata za ovu godinu auto-puta Vrmnica – Merdare.

Mi kao Parlamentarna grupa „7+“ poržavamo nastojanje Vlade da dodeli sredstva ponovo najviše Ministarstvu za transport, koje je u ovom periodu pokazalo izuzetnu aktivnost i u sredinama u kojima žive manjine. Želimo da tako nastavi da, ono što su započili, završe zato što je i to jedna pomoć manjinama koje žive na Kosovu, da računaju da Vlada, da ova Vlada Kosova misli o njima. Takodje, podržavamo i sredstva koja su planirana za odsek farmaceutike u Ministarstvu zdravlja, koji je bio uzuzetno težak u prethodnoj godini, u poredjenju sa ovom godinom, bio je duplo manji, kao i kategoriju lečenja vani, koja je takodje bila problematična, i mislim da će u ovom Ministarstvu neke stvari ići nabolje. Medjutim, ostaje i dalje problem plata i ličnih primanja i u zdravstvu, i u obrazovanju i u drugim segmentima koji će imati i dalje taj

negativan trend, odnosno osećanje negativnog, negativno osećanje kod zaposlenih. U zdravstvu bio sam ministar, ali puno godina nije se pomerilo sa jedne tačke i to stvara jedno nezadovoljstvo koje se kasnije reflektuje na ukupno stanje u zdravstvo.

Želim kazati da određena ministarstva koja treba da rade za manjine, ponekad ne ispunjavaju svoju funkciju. Pomenuću Ministarstvo za zajednice i povratak i moram pomenuti jedan program za integraciju zajednica, kod kojih dodeljivana sredstva za zajednice treba preispitati projekte koji su dodeljeni, jer ima sukoba interesa. Mi smo upoznali Vladu, zamenik premijera je upoznat i još neki drugi. Nemoguće je da projekt dobije neko koji je dodeljivao projekte i da dodeli sebi, ili da se neki projekti iz tog programa dodele i poslanicima i drugima. Ako nije sukob interesa, da zamo, ali mislim da je bolje da se projekti ulažu u zajednice, nego da se dodeljuju nekim imaginarnim nevladinim organizacijama koje, najmanje što rade, jeste da na sumljiv način vrše raspodelu i od onoga što je predviđeno iz kosovskog budžeta, ovom prilikom će se dogoditi da budu nagrađeni oni koji su protiv Kosova, koji rade, koji promovišu paralelne strukture na Kosovu, i ovo je jedan udarac kosovskim institucijama. Znači, želim i ministru i svima da kažem da preispitaju ove projekte. Mi smo ukazivali do sada, ali do sada nije ništa učinjeno.

Na kraju, želim da kažem da će Parlamentarna grupa „7+“ glasati za ovaj rebalans budžeta, za ovaj Nacrt zakona o rebalansu budžeta, s namerom da se u preostalim mesecima, do kraja godine, znači ono što nije realizovano, završi. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, Bojan Stojanović

BOJAN STOJANOVIĆ: Hvala, gospodine predsedniče!

Uvažene kolege poslanici,

Želim da kažem da je ovo jeste velika tema, i za sve velike teme stoji velika priča. Naravno, kada je novac u pitanju svi smo zainteresovani. Svi znamo bolje od nekih drugih. Po onom starom pravilu, kada sediš na klupi za rezervne igrače, uvek kažeš da bolje igraš od onih koji igraju u prvom timu, ali rezultati su oni koji pokazuju sve to.

Naravno, ovde ima puno primedbi što se tiče i sa naše strane, međutim svesni smo da Vlada ipak ne predstavlja ljude koji su prvenstveno umađioničari, nego su stručnjaci. U punoj kući je lako biti dobar domaćin, tamo gde nema sredstava, treba ih obezbediti i implementirati i pravilno menadžirati. Naravno, 6 meseci nije neki period gde možemo samo oštro da kritikujemo Vladu, treba sačekati još malo da vidimo šta je to realno što je ona do sada uradila, šta je to realno što može da uradi. Plate su male, to je nasledjeno stanje, 9 godina su plate male, nisu plate male 6 meseci. Svi zajedno moramo da radimo na tome da se to poveća. Infrastruktura nije dobra. Naravno, ono što mene interesuje jeste i fond kojim se dodeljuje naknadno sredstvo za Ministarstvu za zajednice, za povratak, jer je Ministarstvo neosporno pokazalo, bez obzira na neke primedbe ovde, da zna da menadžira ta sredstva, međutim mi ćemo u drugačijem pristupu sa Vladinom kabinetom pokušati da ta sredstva bar za narednu godinu uvećamo, a ono što je sada bitno stvar za mene kao predsednika Srpske zajednice i ... ostalih zajednica, verovatno je da ostala ministarstva sredstva koji imaju planirana za zajednice, da pravilno menadžiraju.

Naravno, mi čemo kroz funkcionalne komisije pokušati da damo neke primedbe i sugestije, ali svakako u ovom momentu smo spremni da podržimo ovaj predlog Valade o prvom razmatranju Nacrta zakona o rebalansu budžeta. Hvala!

KRYETARI: Para se të shkojmë në pauzë, me qëllim që planifikimi i kohëzgjatjes së debatit lidhur me Projektligjin për rishikimin e buxhetit të shtetit, lus deputetët që të paraqiten tani, në mënyrë që ne ta kemi këtë renditje edhe ta vazhdojmë debatin menjëherë pas pauzës.

(Pauzë 15 minuta).

KRYETARI: Të nderuar deputetë, ju lus t'i zini vendet tuaja.
Vazhdojmë me diskutimet.
Fjalën e ka deputetja Donika Kadaj.

DONIKA KADAJ: Faleminderit!

I nderuar Kryetar,

Përfaqësues të Qeverisë,

Kolegë deputetë,

Ndarja buxhetore e tatimpaguesve të çdo vendi demokratik bëhet përmes një politike gjithëpërfshirëse, në proporcion me numrin e banorëve dhe territorin e komunës, respektivisht prioriteteve të parapara, por asnjëherë investimi nuk duhet të bëhet në bazë të orientimeve partiake e rajonale, të cilat janë paraqitur në këtë projektligj që e kemi para nesh.

Që të mos tingëllojë si paragjykes ky konkludim imi, në vijim do t'ju paraqes të dhëna konkrete me theks të veçantë në Ministrinë e Arsimit dhe në Zyrën e Kryeministrit.

Në Projektligjin për rialokim buxhetor për vitin 2008 parashihet, ndër të tjera, ndërtimi i një morie shkollash nëpër komuna të Kosovës, që do të ishte lajm i mirë po që se edhe këto shkolla nuk do të ishin të politizuara nga dita e parë qysh prej fillimit të ndërtimit të tyre. Shembull konkret, komuna e Skenderajt, përmes këtij projektligji parashihet të përfitojë, jo më pak se 8 objekte shkollore për këtë vit, ndërsa fëmijët e komunës së Deçanit, e cila ka numër për afërsisht të njëjtë të banorëve, do të kenë vetëm një shkollë. Njëjtë sikurse komuna e Istogut, do të shikojë ndërtimin e pesë shkollave në Drenas, mirëpo do t'i gëzojë vetëm dy objekte shkollore. Jo më mirë kaluan as Podujeva dhe Kamenica, në raport me komunat e lartpërmendura, edhe pse shembull konkret në Podujevë kemi një numër dyfish më të madh të banorëve.

Duke marrë parasysh që prioritet i Qeverisë së Kosovës çdoherë është paraqitur arsimit, unë mund të them që edhe nga ky projektligj del se deri më sot Ministria e Arsimit, sidomos duke u bazuar kohëve të fundit në dy dështimet e saj rreth akreditimit - e para, dhe teksti i maturës - e dyta, ku nuk kemi marrë, ministër, asnjë raport si Kuvend, ta dimë se çfarë po ndodhë dhe në çfarë baze janë marrë ato vendime tuaja, si ministër i Arsimit dhe më tepër - jeni marrë me ndërtimtari dhe jo me ngritjen e cilësisë së arsimit në Kosovë, për të cilin jeni thirrur që do të jetë prioritet i juaj.

Nevoja e rialokimit të buxhetit është përgjigje ndaj nevojës për të pasur një menaxhim më të mirë të shpenzimeve publike dhe në bazë të dhënave të cilat i kemi marrë, po ndodh e kundërta. Të gjitha projektet kapitale po investohen në komuna ku udhëheq Partia Demokratike e Kosovës, madje, po anashkalohet edhe Lidhja Demokratike, e cila është partner i koalicionit.

Në një formë, Qeveria – Thaçi, po shfrytëzon të gjitha mjetet për t'i futur nën kontroll të gjitha institucionet e pavarura, siç janë: mediat, shoqëritë civile, së fundi po i ndëshkon edhe votuesit e Kosovës, duke investuar në ato zona ku ka fituar më shumë vota.

Përveç kësaj, kjo qeveri ka trumbetuar për një menaxhim të mirëfilltë të buxhetit – zero tolerancë kundër krimit, zvogëlim të shpenzimeve, e në realitet po ndodh e kundërta.

Në vijën buxhetore të Zyrës së Kryeministrit kemi të alokuara 200.000 euro për blerje të veturave.

Nëse, në të gjitha periudhat kohore keni proklamuar që ju po bëni minimizimin e shpenzimeve, që ju nuk po i përdorni veturat zyrtare, atëherë çfarë ndodh që ju nevojitet edhe 200.000 euro shtesë për të blerë vetura të reja? Realisht, po ndodh e kundërta, po bëhet ndërrimi i veturave të cilat janë shfrytëzuar më herët nga veturat e reja, të cilat u kushtojnë shumë tatimpaguesve të Kosovës.

Gjithashtu, është bërë ngritja e shpenzimeve në mallra dhe shërbime, lëndë djegëse, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. 5 milionë euro janë bërë shpenzime për dreka dhe darka në tremujorin e parë të këtij viti. Pra, definitivisht kjo nuk paraqet ndonjë kursim.

Edhe pse format e ndryshme janë përdorur që të bëhen kamuflime dhe mashtrime të stilit, ndërrimi i targave të veturës zyrtare apo dalja me një deklaratë apo raport e ministrit të Financave që thotë se realisht nuk ka pasur ngritje të shpenzimeve, faktet e paraqitura nga raportet e ndryshme të autoriteteve të pavarura tregojnë se kjo qeveri ka një keqmenaxhim të cilin po e institucionalizon përmes uzurpimit të gjitha pozitave kyçe nëpër institucione dhe ndërmarrje publike, të cilat realisht duhet të jenë larg duarve të politikanëve.

Edhe ky projektligj, është në vazhden e ndëshkimeve për ata që kanë koncept ndryshe, e që realisht nuk duhet të ndodhë, pasi që buxheti i Kosovës janë mjete të tatimpaguesve të mbarë Kosovës dhe ju apo askush tjetër nuk kanë të drejtë që t'ua mohojnë komunave zhvillimin përkatës për shkak të koncepteve dhe bindjeve partiake apo për shkak të votave - numrit të votave të cilat i ka marrë Partia Demokratike e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në radhë për të marrë fjalën është deputetja Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: I nderuari, zoti Kryetar,

Të nderuar qeveritarë,

Deputetë të nderuar,

Debati për plotësimin e buxhetit, gjegjësisht ndryshimin e buxhetit duhet bërë në mënyrë shumë serioze dhe atë në secilën linjë buxhetore. Janë së paku dy arsye të rëndësishme. Arsyeja e parë është përgjegjësia jonë ndaj xhepit të qytetarëve të Kosovës dhe, e dyta, është përgjegjësia që kemi ndaj qytetarëve të shteteve donatore.

Por, çka do të thotë ky ndryshim i propozuar nga Qeveria për jetën e shtetasve të Kosovës? A do të përmirësohet kualiteti i jetës? Jo!

Zoti Kryetar, ndryshimet e propozuara në buxhet nga Qeveria janë zhgënjim për mua dhe sidomos për ata që kanë votuar, duke u bazuar në premtimet e Qeverisë, si rrymë 24 orë, jetë më të mirë, papunësi të zvogëluar. Por jemi vendi më i varfër në Kosovë, prandaj, ky

vizion nuk është vizioni që ka premtuar zoti Thaçi kur e ka kërkuar votën. Nuk është vizion që ka ofruar në Konferencën e Donatorëve. Ndryshimet e propozuara për buxhet janë thyerje e një varg premtimeve të dhëna.

Ky ndryshim duhej të ndikonte në rritjen e zhvillimit të ekonomisë, zvogëlimin e papunësisë dhe varfërisë dhe duhet të jetë në pajtim me prioritetet të cilat i ka shtruar vetë Qeveria sipas kornizës afatmesme të shpenzimeve.

Të nderuar deputetë,

Çfarë synohet të ndryshohet? Është e domosdoshme të kuptohet për çka është ky ndërrim. Por, për të bërë një analizë të mirëfilltë, së pari, zoti ministër, është dashur të respektohet neni 45 i Ligjit për menaxhimin e financave publike, i cili kërkon që raportet tremujore buxhetore t'i parashtrohen Kuvendit të Kosovës. Kështu do ta kishim një pasqyrë më të qartë se çfarë ka shpenzuar Qeveria, sa ka shpenzuar dhe a ka kursyer apo jo?

Por, më lejoni të koncentrohem më tepër në aspektin praktik të buxhetit. Sipas dokumentit të ofruar, totali i shpenzimeve në buxhetin e miratuar ishte 1.119.000.000. Me rishikimin e buxhetit është 1.172.000.000. Kjo do të thotë se Qeveria ka rritje të shpenzimeve për 52.7 milionë euro ose 7% të produktit të përgjithshëm të vendit.

Rritja e shpenzimeve, po ashtu, është bërë në këto fusha: pagat dhe mëditjet 7.2 milionë euro; mallrat dhe shpenzimet 12.6 milionë euro; subvencionet dhe transferet 27.9 milionë euro; shpenzimet kapitale 18.7 milionë euro. Rezerva është zvogëluar për 700.000. Me një fjalë, ky është buxhet deficitar.

Qeveria ka dhënë si shpenzim buxhetor një kredi për KEK-un në shumën afër 49.000.000 euro edhe pse kjo nuk paraqet shpenzim. Subvencionimi i KEK-ut ngarkon buxhetin, ndikon në mos pagesën e rrymës nga qytetarët dhe prodhimin e rrymës.

Prandaj, shtroj pyetjen tani për zotin ministër: a do t'i kërkonte KEK-ut kthimin e kredisë?

Këto të dhëna janë shqetësuese, sepse pikërisht këto shpenzime buxhetore janë kritikuar vazhdimisht nga Qeveria aktuale, me fjalë, të cilat kanë qenë: kriminalitet, keqpërdorime e tjera. Ua lë juve, në ndërgjegjen tuaj, tani ju t'i klasifikoni.

Aspektet tjera praktike të buxhetit janë që në tërë nivelin qendror, shpenzimet për mallra dhe shërbime janë të larta. Tash do t'i theksoj disa shifra për Zyrën e Kryeministrit, ku pagat dhe mëditjet janë 1.078.000 euro, kurse mallrat dhe shërbimet janë 3.500.000. Ministria e Shërbimeve Publike pagat i ka 1.444.000, mallrat dhe shërbimet 6.188.000.

Një aspekt i rëndësishëm i buxhetit për zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien e qytetarëve është patjetër përputhshmëria me prioritetin dhe prioriteti, sipas kornizës afatmesme, numër 1 është rritja ekonomike.

Po ashtu, qeverisja është prioritet, por nuk vërehet fokus për rritjen e kapaciteteve menaxhuese të Qeverisë dhe efikasiteti i saj e vë në dyshim aftësinë absorbuese të fondeve, sepse nuk mund të ngritën kapacitete aq sa duhet brenda një periudhe të shkurtër kohore.

Kështu, për shembull, edhe pse shëndetësia dhe arsimi janë prioritete dhe janë paraparësi sektorë kryesor për zhvillimin e resurseve humane, megjithatë, nuk ka propozim për

ndryshimin e tyre kualitativ. Rritja e propozuar prej 9.7 milionë euro për Ministrinë e Shëndetësisë ose 2 milionë për Ministrinë e Arsimit, nuk mjafton për arritjen e objektivit të parashtruar.

Prandaj, të nderuar deputetë, kur ta merrni vendimin, ju ftoj që të mendoni si për kuletën tuaj.

Për të gjitha arsyet që i përmenda, këto ndryshime nuk janë ndryshime të cilat sigurojnë se do të ketë zhvillim ekonomik, se do të ketë mirëqenie të qytetarëve, prandaj unë nuk do ta votoj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete! Fjalën me radhë e ka deputeti Rasim Selmanaj.

RASIM SELMANAJ: Faleminderit!

I nderuar zoti Kryetar,

I nderuar zoti zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në këtë debat për miratimin e buxhetit të Kosovës do të fokusohem në atë se çka ka paraparë Qeveria e Republikës së Kosovës të investojë në Deçan, meqenëse unë, si deputet, vi nga kjo trevë.

Deçani, në këtë buxhet, sikurse është harruar për investime për vitin 2008. Është e pabesueshme, por e vërtetë se, për këtë vit Deçani ka përfutur më pak se 300.000 euro nga buxheti i Kosovës. Mbase atje, në Deçan, me të drejtë po krijohet opinioni se ajo trevë do të mbetet e anashkaluar. Në komunë thuhet se projektet i kemi dorëzuar, por ato kanë mbetur nëpër sirtarë të ministrive.

Këtu është një e vërtetë. Deçani, krahasuar me komunat tjera, ka mbetur pa asnjë investim kapital. Buxheti është i Kosovës, prandaj Qeveria, përveç prioritetëve, duhet të ketë edhe një balancim të investimeve.

Në ditët në vijim, shpreh bindjen dhe besimin tim se Qeveria do të gjejë një linjë buxhetore për ndërtimin e palestrës sportive në Deçan, më 31 korrik projekti dhe destinimi i lokacionit janë të gatshëm.

Prandaj, pres që më në fund, në Deçan, këtë vjeshtë, të dëgjohet zhurma e eskavatorëve të Qeverisë, që do të ngjallë shpresat e humbura të rinisë dhe sportistëve në Deçan. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputeti Driton Tali, le të përgatitet Sabri Hamiti.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar të pranishëm, këtu shumë gjëra u thanë, andaj nuk do të doja që ato t'i përsëris. Megjithatë, duhet t'i komentoj disa pika të propozuara në këtë rishikim të buxhetit apo në këtë projektligj për ndryshimin e Ligjit për miratimin e buxhetit të konsoliduar.

Së pari, Partisë më të madhe në pushtet, por edhe partneres së saj, do t'ia rikujtoja dy premtime sublimë, të cilat ia bënë elektoratit të vet, domethënë ofertën e Qeverisë mbi të cilën është bërë kontrata me elektoratin e vet.

Nën një, ishte se do të zvogëlohet aparati shtetëror, duke zvogëluar burokracinë. Domethënë 74.400 të punësuarit e kaluar do të zvogëlohen për shkak se, siç e dimë, përqindja e buxhetit të Kosovës në të kaluarën për shpenzimet për paga dhe mëditje ishin rreth 25% apo 26%, më falni, kurse në rajon janë 18%.

Me këtë zvogëlim ata garantonin se do ta rritnin efikasitetin e aparatit shtetëror, duke implementuar ekspertizën dhe profesionalizmin dhe njëkohësisht duke luftuar partizanshin, mediokrinë dhe nepotizmin.

Dhe, oferta e dytë, mbi të cilën është nënshkruar kontrata me elektoratin, është se parandë publike do ta shpenzojnë me kujdes të madh, do të kursehet me nikoqirllëk, se shpenzimet enorme në luks “të Qeverisë së dështuar”, e kam fjalën për qeverinë e kaluar, do të zvogëlohen.

Këto premtime, vlejné, siç e thashë, edhe për partnerin tjetër qeveritar.

Të nderuar të pranishëm, kjo qeveri, ky koalicion qeveritar nuk është duke iu mbetur besnik këtyre premtimeve. Pra, t'i marrim dhe t'iu hedhim një sy bordeve të ndërmarrjeve publike dhe institucioneve të tjera me rëndësi shtetërore, si Banka Qendrore apo Agjencia Kosovare për Privatizim, do të shohim se aty, më së paku ka profesionalizëm apo ekspertizë, domethënë meritokraci, por ka partizanshin, ka nepotizëm, servilizëm, mediokër.

Sa i përket shpenzimit të parasë publike, parasë së taksapaguesve, është e vërtetë se shpenzimet kapitale janë rritur, por janë rritur edhe shpenzimet në paga dhe mëditje, sepse ka rritje në numrin e shërbyesve civilë në dikasteret, flas për ato ekzistuese, jo për ato të cilat do të krijohen apo janë në krijim e sipër, përkundër zotimeve të saja, por edhe kërkesave apo rekomandimeve të institucioneve shumë të respektuara ndërkombëtare, siç është Fondi Monetar Ndërkombëtar. U mor vesh, nga të punuarit rishtas, gjithmonë e kam fjalën. Dhe, nga këta të punësuar, dominojnë partizanët partiak, mediokritet, servilët, domethënë, mungojnë ekspertët. Ja, e marrim, për shembull, Zyrën e Kryeministrit, e cila është rritur për 39 të punësuar. Veç në Kabinetin e Kryeministrit i kemi 19 veta më shumë. Tashti Kabineti i Kryeministrit është rritur nga 29 në 48 veta, nga të cilët 24 janë këshilltarë politikë. Se çka e këshillon kjo brigadë e këshilltarëve Kryeministrin, një Zot e din!

Përshtypja është se ata aty janë vetëm si një shpërblim për aktivitetin e tyre politik, partiak, për të mos i lënë në rrugë, t'u jepet nga një vend pune

Pastaj, kemi rritje edhe në ministrinë e tjera. Marrim, për shembull, Ministrinë e Bujqësisë, që parashihet të jetë rritja në 136 punëtorë. Flas gjithmonë për të punësuar të shërbimit civil në krahasim me Ligjin e miratuar për buxhet – shpenzimin buxhetor.

Pastaj, kemi edhe rritje të shërbyesve civilë në Kuvend, e kështu me radhë.

Logjikisht, do të ketë edhe rritje në shërbime dhe mallra. Thënë shkurt e shqip, kjo qeveri, me këtë propozim i rrit apetitet për luks, për mëditje, dreka, darka, derivate,

telefona, vetura e kështu me radhë – të gjitha ato çka nënkuptojnë në shërbime dhe mallra.

Ja, për shembull, të nisemi dhe ta analizojmë atë se çka ofrohet këtu. Do të nisesha nga të hyrat dhe kursimet, domethënë, pa i marrë parasysh rialokimet apo lëvizjet e brendshme. Siç u tha, të hyrat buxhetore, sipas rishikimit janë rritur për 26.8 milionë, nga të cilat, të hyrat tatimore, sipas rishikimit, janë 22 milionë më shumë sesa janë paraparë me Rregulloren e buxhetit 2008/13, atë të cilën e kemi miratuar. Dhe, të tërat janë nga doganat. Domethënë, nuk kemi të bëjmë këtu me efikasitet të institucioneve qeveritare, por kemi të bëjmë me një rritje të eksportit. Plus, i kemi të hyrat vetanake dhe ato komunale për shkak të decentralizimit, 8 milion më shumë se që është paraparë. Domethënë, nuk kemi ngritje të efikasitetit të institucioneve qendrore. Dhe i kemi të kursyera nga kostoja e pas statusit rreth 13 milionë euro. Siç dihet, shpenzimet sipas rregullores buxhetore të vitit 2008 për pas statusit ishin planifikuar 30.6 milionë euro, kurse janë harxhuar 17.6 milionë euro, domethënë kanë tepruar 13 milionë, siç u tha.

Ne nuk e dimë, për shkak të mungesës së transparencës, se ato a tepruan për shkak të nikoqirllëkut të mirë të Qeverisë, domethënë të kursimit të Qeverisë, apo ato ishin mjete jo të planifikuara mirë. Përshtypja është se kanë qenë të paplanifikuara apo jo të planifikuara mirë. Kur e them këtë, kam parasysh shpenzimet enorme në blerjen e flamujve, siç me cinizëm e komentuan mediat të marigonave turke, mendoj të marigonave të Turqisë dhe atë shumën enorme që iu bë kompanisë Media solucion që ishte aspak e arsyeshme. Domethënë, Qeveria i ka 39.8 milion më shumë se që është paraparë me rishikimin buxhetor dhe nga këto, në paga dhe mëditje shkojnë 7.2 milionë më shumë, gjersa në mallra dhe shërbime 12.6 milionë. Domethënë, totali në luksin qeveritar, të thuhet, janë rreth 19.8 milionë, do të thotë 49.7% apo 50% i gjithë këtyre të hyrave shkojnë kot, dhe, do të thotë, bëhen “rrush e kumbulla”, kurse vetëm 18.7 milionë janë paraparë për rritjen e shpenzimeve kapitale për atë që është zotuar kjo qeveri dhe madje na ka shurdhuar duke na shpjeguar se sa shumë është duke i rritur investimet kapitale.

Që të mos e zgjas, sepse u thanë shumë gjëra të tjera këtu, unë kam parasysh se nuk bëhet shumë shpesh të vish në qeveri dhe, kur të vish në qeveri, ke qejf kështu të shijosh ato të mirat e qeverisë, ia pafshi hairin. Faleminderit!

KRYETARI: Kujdes në fjalorin parlamentar! Fjalën e ka Sabri Hamiti, le të përgatitet Haki Shatri.

SABRI HAMITI: Zoti Kryetar i Kuvendit,
Zotërinj zëvendëskryeministra, ministra,
Kolegë të nderuar,

Do t’i bëja disa pyetje, por meqë kemi të bëjmë me ekonomi, ku nuk jam ndonjë specialist, po heq dorë prej pyetjeve vullnetarisht për t’iu lënë në dorë atyre që e kanë zanat dhe për mos bërë gabime të tipit qysh dëgjova unë këtu, po e zëmë, “invazion” iu tha “evazionit”. Domethënë, mos të bëjmë gabime të tilla.

Ajo që më intereson veçanërisht sot, është çka do të bëhet me kulturën në këtë përpjekje të rebalancimit të parave publike që i menaxhon Qeveria e Kosovës?

Unë u gëzova kur e pashë një shifër përtej 2 milionëve që do të jepen para për kulturën dhe u përpoqa ta analizoj ku janë planifikuar të shkojnë. Gjeta se këto nuk janë këto për

kulturën, por janë për Ministrinë e Kulturës, e cila është edhe e Kulturës, edhe e Rinisë, edhe e Sporteve dhe tutje.

Mendoj që edhe kjo pjesë që është paraparë t'i jepet kulturës, prapë ka një destinim shumë të veçantë që ka të bëjë kryesisht me atë që te ne quhet me një emër të përgjithshëm – trashëgimi kulturore, e në të vërtetë s'ka të bëjë me trashëgiminë kulturore, por kryesisht me atë që quhet trashëgimi materiale, që ka të bëjë me konservime shtëpish e institucioneve që konsiderohen me një rëndësi të identitetit kulturor.

Ajo që mua më intereson është çfarë do të bëjë kjo qeveri me atë që unë e quaj kulturë të gjallë, ajo që krijohet sot, që pretendohet të bëhet identitet i këtij vendi, që përmbledh krijuesit që i kemi dhe ky identitet çfarë të bëhet të ndihmohet që të bëhet identitet përfaqësues ose promovues jashtë? Tani, Kosova është shtet i deklaruar dhe i pranuar dhe Kosova duhet ta identifikojë kulturalisht vetveten edhe përtej atyre që quhen kufij të vet dhe kufij nacional.

Prandaj, unë u përpoqa që me një konsultim kolegjal me ministrin e Financave të shoh mundësitë. Thashë, me ministrin e Financave, për shkak se ministri i Kulturës nuk është këtu e ndoshta vjen nesër, që kjo pjesë e parave të riorientohet me një shumë të saj në atë që unë, pa gjetur një emër më të përshtatshëm, po e quaj kulturë e gjallë e Kosovës, që do të kishte ndihmesë institucionale, jo më në shtëpi, por në njerëz. Dhe, këtu, unë po përmendi tri fusha: kinematografi, teatër dhe botime, ku do të hynin botimet që në gjithë botën e kultivuar quhen botime kapitale. Pse insistoj në këtë? Insistoj për shkak se te ne kopjohen modele të vendeve të tjera ku botimet dhe vlerat kulturore kalojnë fazën e krijimtarisë dhe kthehen në treg. Në Kosovë treg kulturor të veprave kulturore nuk mund të krijohet dhe këtë duhet ta dimë të gjithë së bashku. Ata që krijojnë e dinë më së miri, por duhet ta dinë edhe të tjerët. As s'mund të keni botime që bëhen për treg, as s'mund të keni kinematografi, as teatër. Ky vend, që do një identitet të vetin kulturor, duhet të financojë vepra të rëndësishme identifikuese dhe identitare të këtij vendi.

Unë, edhe një herë po kërkoj, meqë unë e di që ligji, nëse votohet kështu që bëhet ligj, që nesër, pa u votuar, në një bashkëpunim të ministrit të Kulturës dhe të atij të Financave të ndahet një pjesë e parave për këto tri pika që i thashë: kinematografi, teatër, botime kapitale. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Haki Shatri. Le të përgatitet Ibrahim Gashi.

HAKI SHATRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar ministra, zëvendëskryeministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Dokumenti i Qeverisë, që sot po e shqyrtojmë lidhur me rishikimin e buxhetit, përveç të mirave që ka dhe është ardhur me kohë dhe pretendon të rregullojë disa çështje lidhur me buxhetin për periudhën deri në fund të vitit, ka edhe disa lëshime të cilat besoj me qëllim të mirë mund të eliminohen dhe në këtë mënyrë do ta kemi një dokument të përshtatshëm për shpenzime deri në fund të vitit.

Ajo që mua më brengos e që kam arsye personale ta ndiej si brengë, është mospërputhja e dokumentit të buxhetit me kornizën afatmesme të shpenzimeve. Dokumenti Korniza afatmesme e shpenzimeve e obligon, në bazë të ligjit, ligjin vjetor të shpenzimeve

buxhetore që të jetë në harmoni të plotë. Aq më tepër, Qeveria, me datën 12 korrik, para donatorëve në Bruksel e ka prezantuar një dokument, i cili, brenda 6 ditëve, po nga Qeveria është ndryshuar dhe atë në pika përmbajtjesore. Konkretisht, ndryshimet në të hyra dhe në shpenzime për rreth 27 milionë.

Personalisht, mbështes rritjen e buxhetit, edhe të hyrave edhe të kufijve të shpenzimeve, por si do të harmonizohet Qeveria me donatorët në kohën kur brenda një jave ka bërë ndryshim të dokumentit pa u harmonizuar me komunitetin e donatorëve? Halli është të vërejtjet që bën Fondi Monetar rekomandimet e të cilit, po nuk u përfillën, Qeveria do të ketë telashe në realizimin e donacioneve.

Unë e di sa janë cikërrimtar ata në këto çështje dhe jam i bindur se do të ketë shumë telashe në këtë drejtim.

Konkretisht, mospërputhje ka në atë që janë marrëveshje të cilat duhet të respektohen me çështjen e numrit të shërbyesve civilë. U përmend edhe nga disa parafolës, në krahasim me dokumentin bazë të buxhetit për këtë vit, për shërbyes civil është shtuar numri me rishikim për 500 persona vetëm në pjesën e institucioneve vetëqeverisëse që janë titulluar më herët, kurse tani janë ministritë dhe organizatat tjera buxhetore qendrore.

Pra, është fjala për 500 persona që nuk do të jetë lehtë të arsyetohet para strukturave ndërkombëtare që mbështesin donacionet për Kosovën, pa i përfshirë ministritë e reja, normalisht.

Është një diskrepancë, po ashtu, edhe te struktura e shpenzimeve vijuese. Afër 20 milion janë shtuar në krahasim me buxhetin bazë për mallra e shërbime. Një pjesë e tyre e kanë një arsyetim, që është ndarë për Ministrinë e Shëndetësisë për furnizim me barna, por pjesa tjetër dërmuese është rritje e thjeshtë e kategorisë mallra dhe shërbime.

Po ashtu, në këtë rritje, nuk janë përfshirë ministritë e reja nga ajo pjesë që më herët është quajtur kostoja e pas statusit

Kategori tjetër, e cila është rritur, po ashtu, pa u harmonizuar me komunitetin e donatorëve dhe dokumentin që është obligues për Qeverinë - është kategoria e subvencioneve dhe transferove që kjo, në total, ka pësuar linjë rritje për rreth 40 milionë. Pjesa dërmuese e tyre ka hyrë në kategorinë e importit të rrymës elektrike për periudhën deri në fund të vitit. Siç e dini, 19.0 milionë kanë qenë të parapara dhe 4.5 milionë për familjet që s'kanë mundësi t'i paguajnë janë 23.5 dhe 25.0 që bëjnë afër 50 milionë për këtë destinim. Po të ishte përcjellë ky rekomandim për shpenzime me vendimet për masat që duhet të merren për t'u përgjigjur kësaj rindarje në aktivitetet për përmirësimin e performancës së KEK-ut, kjo do të ishte e arsyeshme, mirëpo në dokument, në letrat shpjeguese nuk shihet se ka diçka të tillë.

Në tabelën 4, disa çështje që duken teknike, por që janë brengose, janë plotësisht mospërfillja e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. I

Shihni tabelën 4. Shumë projekteve iu mungon pip-kodi. Ministri i Financave e din çka do të thotë ai, besoj edhe shumë tjerë që janë marrë me këtë punë. Nuk e di si do të realizohet shpenzimi buxhetor pa këtë evidencë? A ka plotësuar kritere për t'u renditur në shpenzimet, buxhetore një projekt që i mungon, do të thotë, një element qenësor-esencial.

Në kuadër të prioriteteve sektoriale, që ka përcaktuar vetë Qeveria, rindarja – propozimi për ndarje nuk ka respektuar vendimin, sepse vetëm disa sektorë janë mbështetur me rishikim, proporcionalisht me prioritete, kurse disa sektorë nuk janë mbështetur. Fjalën e kam se sundimi i rendit dhe ligji, nuk është mbështetur me shtesë të mjeteve përkatëse, proporcionalisht me vendin që zë në prioritetet e Qeverisë. Arsimi, nuk është mbështetur në masën adekuate që i takon në prioritete. Shëndetësia, nuk është mbështetur në masën e nevojshme.

Unë kam parasysh shumat që janë ndarë, por shumat e ndara në shëndetësi nuk e mbështesin forcimin e sektorit. E mbështesin blerjen e barërave dhe shërimin jashtë vendit, por prioriteti sektorial ka mbetur anash, i papërfillur.

Po ashtu, brenda sektorëve, prioritetet nuk janë respektuar. Këtu po lidhem me vërejtjen që është bërë lidhur me autostradën. Janë hequr 49 milionë nga eksproprijimi dhe janë shpërndarë në njëfarë forme në pjesë të ndërtimit të rrugëve lokale, nga 15 milionë, sa është caktuar në fillim të vitit, në 25 milionë,

Rrugët lokale, janë një e mirë për shoqërinë dhe ngritin standardin jetësor, por nuk janë në prioritete që krijojnë bazë të infrastrukturës për zhvillim dinamik ekonomik, prandaj ky ndryshim duket formal por është shumë esencial dhe është në përgjithësi jo i favorshëm për zhvillime në të ardhmen.

Me këto vërejtje, që u përpoqa t'i përmbyll me një korrektësi, karshi Ministrisë së Financave dhe sektorëve të tjerë, mendoj se në përgjithësi në një shikim buxheti ka tentuar të rrëshqas nga buxheti investues në buxhet konsumues, sepse nga shuma e mjeteve në tërësi që janë rishqyrtuar dhe janë rekomanduar për rindarje, vetëm 20 e sa milionë thuhet se shkojnë në investime, kurse pjesa tjetër, me transfere sociale, në 9 milionë paga, për të cilat vetëm për 2 milionë e dimë ku janë dhe në mallra dhe shërbime.

Besoj se me një ndryshim në mes dy leximeve, buxheti mund të përmirësohet dhe të shkojë më tutje për miratim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit edhe nga ti. Fjalën e ka Ibrahim Gashi, le të bëhet gati deputetja Muzejene Selmani.

IBRAHIM GASHI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Përsëritje zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Natyrisht shumëçka lidhur me temën që po diskutojmë sot u tha nga ekspertë e ne që nuk jemi të fushës nuk kemi çka t'i shtojmë, e që natyrisht ne mund të bisedojmë vetëm për konsekuencat e atyre vërejtjeve që u thanë dhe për refleksionet që kanë ato vërejtje në imazhin e përgjithshëm të shtetit të Kosovës në këtë fazë tepër delikate nëpër të cilën po kalon.

Vërejtjet konsistojnë në shpërndarjen joracionale sipas bartësve buxhetor, në disharmoni me kornizën afatmesme zhvillimore dhe në vërejtjet e mundshme që mund të vijnë nga Fondi Monetar Ndërkombëtar.

Unë do të dëshiroja që në këtë shpërndarje sipas bartësve buxhetor të shihja ministrinë që, mendoj janë kryesore për Kosovën, siç është Ministria e Arsimit, ku ka një rritje, por që

nuk është e mjaftueshme dhe që mendoj do të reflektojë konsekuenca të pashmangshme edhe të aspektit politik dhe të aspektit zhvillimor.

Pastaj, Qeveria, sikundër e dimë, shumë herë është prononcuar si Qeveri e shtet ndërtimit dhe ne kemi disa ministri të reja që janë kruciale, siç është Ministria e Sigurisë dhe e Mbrojtjes, Ministria e Punëve të Jashtme që në njëfarë mënyre përbëjnë segmente të rëndësishme të shtet ndërtimit dhe unë pash një mbështetje shumë të vogël që i është dhënë me këtë rishikim të buxhetit, pikërisht këtyre dy segmenteve.

Unë nuk e di, e do të doja ndoshta edhe nga ministri i Jashtëm të dëgjoj se a nuk ka pasur plan zhvillimor Ministria e Punëve të Jashtme apo nuk ka pasur mirëkuptim Qeveria kur i ndanë vetëm 1.2 milion euro, pikërisht në një fazë kur ajo synon të sendërtojë strukturën e saj si Ministri, në një fazë kur duhet të ndërtojë shërbimin diplomatik së paku në dhjetë shtetet e para dhe në një fazë kur duhet të bëjë shumë shpenzime për të lobuar për njohjen e shtetit të Kosovës.

Natyrisht, po aq e rëndësishme, sipas mendimit tim, është edhe Ministria e Mbrojtjes. Ne duhet të reflektojmë tashmë sepse jemi shtet, duhet të sillemi si shtet dhe duhet të performojmë në raport me shtetet e rajonit e po aq si dhe ato në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes, me kapacitetet tona, natyrisht.

Kam edhe vërejtje lidhur me ato që quhen subvencione dhe transfere për KEK-un. Unë mendoj se mjaft është subvencionuar e kredituar, domethënë, një kompani jo profitabile dhe ndoshta kemi pasur shpresë dhe premtime se ndryshe do të sillet kjo qeveri ndaj këtij gjiganti që më shumë i merr se sa i jep Kosovës. Kjo nuk ka ndodhur.

Për fat të keq, subvencione që pret popullata, nuk kemi në fusha siç është bujqësia. Tani jemi në prag të mbjelljeve vjeshtore dhe asnjë cent për të subvencionuar fushatën e mbjelljeve vjeshtore për bujqit që mezi e presin këtë. Të mos të flasim për fazat e mëhershme të regresivit diçka në këtë fushë, që e kemi mirëkuptimin se, ndoshta, ka qenë pjesa e buxhetit kur është miratuar dhe nuk ka mund të parashihet, por, tash ka qenë momenti që diçka të bëhet për këtë kategori.

Dhe sigurisht, tërheq vëmendjen për vërejtjet që mund të jenë e ato i thanë edhe ekspertët me shumë argumente, për vërejtjet që mund të ketë FMN. Unë pak brengosem dhe shqetësohem për impaktin që mund të kenë këto vërejtje në fazën e pranimi. Kosova ka aplikuar për t'u pranuar në Fondin Monetar Ndërkombëtar. Dhe nëse ende pa u pranuar vijnë vërejtje të mëdha në adresë të Qeverisë për çështjet ekonomike, përkatësisht rritjen e të punësuarve në sektorin ku është thënë se duhet të ketë reduktim, atëherë kam frikën se do të interferojë pashmangshëm edhe në politikën e pranimi të Kosovës në FMN.

Dhe, krejt në fund, edhe pse është lënë një periudhë tepër e shkurtër për të bërë diçka në leximin e dytë, unë mendoj se duhet Qeveria të ketë konsideratën dhe jo të mbështetet vetëm në numrin e votave që e ka për ta kaluar kështu si është.

Unë tërheq vërejtjen se me konsekuencat e këtyre nënvizimeve që u vërejtën nga ekspertët, konsekuencat do t'i bartim të gjithë, por mbi të gjitha do t'i bartin qytetarët e Kosovës. Mirëpo, edhe kjo Qeveri, në fund, do të ketë konsekuencën e drejtpërdrejtë nëse diçka nuk është planifikuar dhe nuk ka shkuar aty ku duhet. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Myzejene Selmani, le të përgatitet deputeti Gani Koci.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Faleminderit Kabinet qeveritar,

Kisha dashur të bëj një koment të shkurtër në lidhje me rishqyrtimin e Projektbuxhetit.

Ne kemi analizuar çështjen e rishqyrtimit të buxhetit për vitin 2008 dhe, si i tillë, mendojmë se kanë vend për t'u komentuar dhe argumentuar shumë çështje.

Ne mendojmë se është dashur të kemi në dispozicion kohë dhe mundësi që gjithë ky dokument, shumë i rëndësishëm, të analizohet hollësisht para se të procedohet në Parlament.

Orientimi kryesor në hartimin e buxhetit është një detyrë mjaft komplekse për çdo organizatë buxhetore e cila duhet t'i arsyetojë kërkesat dhe nevojat.

Mos kreditimi i prioritetëve mund të ndikojë në komplikime të ndryshme të cilat mund të jenë me pasoja për alokimin dhe menaxhimin e drejtë të buxhetit.

Rishikimi i buxhetit, i përgatitur nga Qeveria, është në shpërpjesëtim të plotë me kornizën afatmesme të shpenzimeve që u prezantuan në Konferencën e Donatorëve, në të cilën Kosova përfitojë 1.2 miliard euro dhe dëshirë e madhe e të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës do të ishte që Kosova në këtë Konferencë të përfitojë edhe më shumë donacione, por pikërisht mospërputhja në mes buxhetit të rishikuar dhe kornizës rrezikon që Kosova t'i humbë edhe këto 1.2 miliard euro donacione.

Në Projektligjin për ndryshimin e Ligjit për miratimin e të hyrave buxhetore dhe shpenzimeve në buxhetin e konsoliduar të Kosovës, të miratuar, atëherë Kosova kishte 52 milion më shumë se në kohën kur është miratuar ky buxhet, herën e kaluar, me vlerë prej një miliard e 99.000 eurosh, ndërkaq zërat kryesor që kanë pasur rritje janë: subvencioni 27.8 milion euro, pagat 7.2 milionë euro, pagat komunale 1.1 milion euro dhe nëse themi se shtyllë kryesore të shoqërisë janë: arsimi, shëndetësia e siguria, atëherë shtrohet pyetja a e kemi ndarë drejt buxhetin edhe për këto segmente të rëndësishme të jetës. Mendoj se nuk kemi pasur një qasje apo shpjegim shtesë për hartimin e prioritetëve në të gjitha njësitë buxhetore, prandaj propozojmë që disa prioritete buxhetore të rishikohen dhe ndarja e buxhetit të bëhet sa më racionale në mënyrë që buxheti të jetë në funksion të aktiviteteve për të cilat është i destinuar, kuptohet për të ardhmen.

Ne sot po flasim për një buxhet i cili është shpenzuar dhe për të cilin nuk kemi kurrfarë qasje dhe rrjedhimisht nuk kemi informata të nevojshme për mënyrën e shpenzimit të këtij buxheti. Por edhe nëse themi se të gjitha këto aktivitete financiare kanë qenë OK, atëherë do të ishte jo e ndershme nga ana jonë të procedojmë me një kërkesë të tillë pa argumente, formën e operimit dhe shpenzimeve që janë bërë dhe mendohet të bëhen. Thjesht kemi një disekuilibër në mes të shpenzimeve dhe programit që Qeveria e ka prezantuar me një vonesë në Parlamentin e Kosovës.

Ne kujtomë se ndryshimi i destinacioneve të mjeteve nga projektet me rëndësi kombëtare, siç është rasti i projektit të autostradës, kur është bërë dislokimi i një shume prej 49 milion euro të cilat hiqen nga ky projekt dhe destinohen në projekte të vogla, siç janë rrugët lokale – dëshmon për një subjektivizëm në shpenzimet e mjeteve financiare si

dhe shpenzimet e paplanifikuara të mjeteve buxhetore. Ndryshimi i destinacioneve në këto shuma të mëdha, për një kohë të shkurtër, është një dëshmi e mirë që Qeveria nuk ka vizion dhe program përcjellës për shpenzimet e mjeteve buxhetore si dhe vizion të qartë dhe se çfarë planifikon të bëjë në të ardhmen kur kemi parasysh se kemi shumë çështje për t'i realizuar në këtë fazë. Këtu parashihet qartë se 49 milionët e paraparë për ekspropriimin e pronës për autostradën Morinë-Merdar që në këtë Kuvend u shpall zonë me interes të veçantë nacional, tash me rishqyrtim janë 7 milion dhe alokohen te parat në bashkëfinancim me komuna rreth 25 milion.

Shtrohet pyetja, a dëshiron Qeveria një zhvillim të madh ekonomik në Kosovë, kur dihet se kjo Ministri në Konferencën e Donatorëve ka pasur një përkrahje mjaft të madhe.

Gjithashtu, orientimi i 25 milionëve në blerjen e energjisë, ku do të kemi një rritje të trefishtë krahasuar me buxhetin 2007, pasqyron një çështje delikate për harxhuesin më të madh të buxhetit të Kosovës.

Na tregoni, nëse keni përgjigje, se cila është esenca e këtyre subvencioneve – blerja e energjisë apo investimeve të cilat kanë qenë për qëllim të përmirësimit e të menaxhimit të KEK-ut? Kjo bie në kundërshtim me planifikimin e 19 milionë eurove, zoti ministër, për importin energjisë; 4.5 milionë euro për pagesat e rasteve sociale. Rritja e mjeteve në KEK për import të energjisë është edhe një vërejtje nga Fondi Monetar Ndërkombëtar të cilën e merr Qeveria. Me blerje të energjisë nga buxheti i Kosovës nuk mund të them se do të kemi zhvillim të hovshëm ekonomik i cili i duhet më së shumti Kosovës tash.

Të njëjtën gjë ju e bëni edhe me rritjen e numrit të punëtorëve, prej 500, ku jeni duke humbur edhe një hap për ta arsyetuar hartimin e një politike të qartë për paga. Kjo qeveri ka ardhur në pushtet me premtimin se do t'i ulë shpenzimet në paga e mëditje, mirëpo në realitet ndodh e kundërta. Këtu, në bazë të raporteve të Fondit Monetar Ndërkombëtar, aparati shtetëror është i stërngarkuar me staf civil, pra, kjo është edhe një vërejtje tjetër nga ky fond për Qeverinë.

Me të drejtë parashtrohet pyetja - cila është strategjia e veprimit të qeverisjes për periudhën tjetër? Edhe sa mjete do të ketë nevojë të ripozicionohen deri në fund të vitit fiskal për paga?

Ne e dimë se kemi pasur raporte dhe komente të mediave nga organizatat dhe Agjencioni Antikorrupsion i Kosovës për korrupsion në menaxhimin e mjeteve publike të Kosovës, prandaj, me të drejtë lind dyshimi në ndërrimin e kaheve të mjeteve financiare në vlera të mëdha në këtë fazë. Kjo tingëllon në jo profesionalizëm dhe mjaft dyshuese, zoti ministër. Mjafton të themi se kemi ndarë mjete për shërbime ose prioritete pa u kontrolluar kur ato si janë shpenzuar. Nëse kemi përgjegjësi ta miratojmë këtë buxhet, atëherë, patjetër, na intereson të kemi përgjigje se si janë shpenzuar mjetet e buxhetit të Kosovës? Ne nuk do të japim komente dhe vërejtje tona për çdo detal veç e veç, ngase ka shumë për të diskutuar dhe nuk jemi të interesuar ta prolongojmë, por dëshirojmë të kontribuojmë me angazhimin tonë në projektbuxhetin e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI IBRAHIM GASHI: Faleminderit, deputete Selmani! Fjalën e ka deputeti Gani Koci, le të përgatitet deputetja Zylfije Hundozi.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti kryesues,
I nderuari Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Unë do të përpiqem të jem shumë i shkurtër këtu, sepse parafolësit sikur i thanë të gjitha. Vërejtjet e mia në këtë projekt të rishikuar të buxhetit qëndrojnë në faktin që Ministria e Ekonomisë dhe Financave është dashur bashkërisht të na e sjell edhe dokumentin që quhet "Kornizë afatmesme e rishikimit të buxhetit e shpenzimeve buxhetore" dhe mbi bazë të saj, pastaj, ne të gjykonim edhe për rishikimin që e kemi këtu përpara.

Në këtë vit kemi kaluar vërtet periudha të caktuara, me një dinamizëm shumë të madh dhe, ndoshta, kjo ka qenë pengesa e Qeverisë, por dua t'u them parafolësve se Korniza afatmesme e shpenzimeve nuk është një dokument statik dhe që nuk mund të lëviz. Ligji për menaxhimin e financave publike, i miratuar më 15 qershor të këtij viti, e thotë hapur se me rishikim të buxhetit bëhet edhe rishikimi i Kornizës afatmesme të shpenzimeve, gjë që besoj se në një periudhë sa më të shkurtër do ta kemi në dorë këtë dokument.

Sa i përket asaj se kemi vërejtje prej mekanizmave ndërkombëtarë, vërejtjet e atyre mekanizmave i kemi gati të gjithë të shkruar dhe konsistojnë në tri çështje për të cilat, ndoshta, do të duhej ministri pak më detajisht të na japë sqarime, sidomos për atë që u tha rreth subvencionimit të KEK-ut me 25 milion, pastaj të shpenzimeve, mallrave dhe shërbimeve si dhe për atë që po manipulohet me një shifër të rritjes së numrit të punëtorëve që futet në linjën paga dhe mëditje prej diku 500 punëtorëve. Sa kam unë informacione, në shumë organizata buxhetore në ministri, deri më tani, ata që janë quajtur shërbyes civil nuk kanë qenë shërbyes civil të rregullt, por kanë qenë punëtorë me kontratë, me ato kontrata që i kemi quajtur mbi veprën dhe tash është dashur të sistemohen dhe të futen në linjën e caktuar buxhetore, në linjën e pagave dhe të mëditjeve dhe kjo ndoshta mund ta rrisë këtë linjë, por i zbret ato linjat tjera për të cilat, ndoshta, janë paguar deri më tash ata punëtorë. Kështu është te Ministria e Bujqësisë, më duket, pastaj e kemi te Ministria e Kulturës, sepse shumica e punëtorëve të atyre ministrive kanë qenë punëtorë me kontratë mbi veprën dhe jo shërbyes të rregullt civil. Këtë fakt do të duhej, të nderuar, ta kishit pasur parasysh.

Do të ishte mirë dhe diskutimet, ndoshta, do të ishin orientuar shumë drejt dhe qartë sikur paraprakisht të kishim pasur para veti raportet e auditorit gjeneral për shpenzimet buxhetore për auditimet që janë bërë për vitin 2007 dhe në bazë të atyre krahasimeve pastaj do të vinim deri te një përfundim i drejtë, i saktë ose jo i drejtë edhe për këtë buxhet të rishikuar këtu. Prandaj, ju sugjeroj që, vërtet, nëse auditori gjeneral s'ka mund të na e jap ne një nga një, ta vizitojmë ueb faqen e atij mekanizmi dhe të shohim pastaj se si është vepruar dhe si është menduar të veprohet tash e tutje me këtë buxhet dhe me këtë rishikim të buxhetit.

Çështja, për të cilën do të duhej ministri të na sqaronte, që është shumë kontestuese dhe shpesh po thuhet heqje dorë nga shpenzimet e karakterit nacional, shpenzimet e kapitalit, interesit madhor, siç është autostrada, të heqjes nga linja buxhetore për shpronësim që ishte 49 milion dhe ulja në 7 milion. Pse është bërë kjo dhe cilat janë arsyet?

Ndërsa, sa i përket aspektit të shpërndarjes rajonale, sinqerisht, me keqardhje po e them, më duket nuk ka vend në Kosovë që nuk vërehet puna e kësaj qeverie, puna e resorëve të caktuar të Qeverisë, qoftë nëpër ato rrugica ose sokaqe që i quajnë, qoftë në zgjerimin e rrugëve dhe magjistraleve, po edhe në fillimin e realizimit të projekteve të reja.

Unë dua t'i them zonjës Kadaj këtu se në Drenicë, po ju them sinqerisht, në Skenderaj për 6 vjet të qeverisjes nuk mund t'i bësh 500.000 euro investime. Po, absolutisht, nuk më

vjen keq pse në rajone tjera është investuar dhe tash i ka ardhur radha, ndoshta edhe Drenasit, edhe Skenderajt, por besoj se edhe Deçani nuk është keq në këtë drejtim, absolutisht dhe e dinë më mirë ata të Deçanit. Edhe Gjakova, nuk është keq në këtë drejtim, as Podujeva nuk është keq në këtë drejtim.

Sa kam informacione, si kryetar i Komisionit për Buxhet, nganjëherë edhe Qeveria nuk ka mund kërkesat, të cilat kanë qenë të komunave, për rishikimin, sa më duket, kanë qenë diku afër 19 milion dhe në këtë rast ka arritur vetëm Ministria e Transportit dhe të Telekomunikacionit t'i përballojë me 5 milion të tilla, gjë që, mua më duket pak, duke pasur parasysh se ne mund t'i bëjmë rrugët e gjera edhe asfaltet dhe autostradat, por që lidhjet me këto sokaqe balta do të na silltet prapë në ato rrugë dhe do të na i prishë ato rrugët e gjera dhe që mendojmë se duhet t'i afrohem Evropës.

Për këto çështje po them kam një vërejtje. Ne kemi këtu edhe zëvendësministrin e Transportit dhe Telekomunikacionit, e njëkohësisht është edhe deputet dhe në këtë drejtim pse Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, ndoshta, në këtë rishikim, pak më shumë Ministria e Telekomunikacionit pak më shumë ka thithur mjete nga ky rishikim do të ishte mirë të na sqarojë zoti Adem në këtë rast, në mënyrë që ne si deputetë t'i kemi fjalët më të pakta. Po them, duke pasur parasysh se është hera e parë për një rishikim të tillë, dinamika e këtij viti nuk dyshoj se projektet madhore, siç janë autostrada, Qeveria do t'i lë pas dore. Në fund të fundit ato janë projekte kombëtare dhe nga projektet kombëtare nuk ka të drejtë asnjë qeveri dhe as Qeveria e Thaçit të heqë dorë prej tyre. Prandaj, mendoj se kështu si i tillë do të duhej të miratohej ky buxhet, me mundësi që të amendamentohet dhe të shikohet ashtu ku është e mundshme për një rialokim të mjeteve. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputet Koci! Fjalën e ka deputetja Zylfije Hundozi, le të përgatitet deputeti Adem Salihaj.

ZYLFIJE HUNDOZI: Zoti kryesues,

Zotërinj ministra,

Deputetë të nderuar,

Nga ky revizion i buxhetit mund të vërehet se planifikimi i tij qysh në fillim nuk ka qenë i mirë, gjë të cilën edhe e kemi cekur në diskutimin për miratimin e tij.

Unë do të ndalem në dy çështje, sepse deri tash u fol mjaft e të mos përsëriten gjërat. Njëra është heqja e 49 milionëve për ndërtimin e autostradës, me pretekst që me këto të holla do të bëhet zhvillimi ekonomik i Kosovës e që paraqet një non-sens, gjegjësisht gabim logjik, sidomos kur del prej gojës së ministrit për Ekonomi. Ky veprim, jo që nuk do ta çojë Kosovën përpara, por prapa.

Kjo qeveri është zotuar se caku i ardhshëm është integrimi në Unionin Evropian. Nuk ka integrim në Unionin Evropian pa ndërtimin e infrastrukturës rrugore dhe pa bashkëpunim rajonal dhe po më çudit që zoti Hajredin Kuçi nuk ka reaguuar në këtë drejtim pasi që është zotuar se Kosova do ta nënshkruajë Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit në vitin 2010. Ne edhe ashtu jemi vendi i fundit në këtë drejtim dhe me këtë ne do të vonohemi edhe më shumë.

Çështja e dytë, është buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë, për të cilin qysh herën e parë kam thënë se nuk është i mjaftueshëm dhe nëse analizohen shifrat që janë dhënë shihet se kjo është më se e vërtetë.

Pa ekzistuar fare mbulesa në buxhet, kjo ministri i ka harxhuar 2 milionë e gjysmë euro për shërim jashtë vendit, edhe pse në buxhet për këtë janë ndarë vetëm 500.000 euro, gjegjësisht 2 milionë më shumë se që ka ekzistuar në buxhetin e kësaj ministrie. Domethënë, Ministria e ka çuar në minus buxhetin dhe atë për diçka që është në kundërshtim me programin e saj, sepse ministri i Shëndetësisë është zotuar se do ta rrisë aq shumë kualitetin e shërbimeve shëndetësore në Kosovë sa që pacientët prej vendeve tjera të rajonit do të vijnë dhe do të shërohen në Kosovë. Mirëpo, jo vetëm që s'ka ndodhur kjo, sepse shërbimet shëndetësore, gjegjësisht kualiteti i tyre është duke shënuar rënie dita-ditës, sepse pacientët me të madhe po shkojnë jashtë vendit dhe po shpenzohen, kurse me këta 2 milionë vetëm po zbrazet arka e buxhetit të Kosovës.

Për këtë, kjo qeveri dhe askush nuk po lodhet që të sanohet gjendja, pasi që, nëse sëmuren vetë, do të shkojnë jashtë vendit të shërohen. Kjo nuk është vetëm supozim, por fakt i vërtetë, sepse nëse merren dhe analizohen strukturat sociale e pacientëve që frekuentojnë klinikat e Qendrës Klinike Universitare do të shihet se gjendja materiale e tyre është më se e rëndë. Në Kroaci, ministri i Shëndetësisë ka dhënë dorëheqje pse ka shkuar të shërohet jashtë vendit. Por, Kroacia është Kroaci, atje ka përgjegjësi. Mua veç po më intereson a i ka rënë ndërmend ministrit të Shëndetësisë se ato të holla që kanë dalë jashtë dhe janë shpenzuar, që të investohen brenda këtu në Kosovë dhe të ngritën shërbime shëndetësore dhe me të vërtetë me shërbime cilësore të tërhiqen pacientët nga vende tjera ashtu sikur keni premtuar. Edhe pse kjo tash duket ëndërr se në çfarë gjendjeje është shëndetësia kosovare, por me një planifikim të mirë, me punë të sinqertë, jo vetëm me premtime, mund ta ndryshojmë situatën.

Njëjtë janë harxhuar të holla pa mbulesë edhe për shërbimin farmaceutik. 8.900.000 euro dhe këto nuk kanë qenë të parapara në atë buxhetin që janë dhënë, domethënë 6.300.000 më tepër dhe prapë pa mbulesë fare dhe tash në këtë rishikim parashihet që për programin farmaceutik të shpenzohen 11.500.000, gjë që prapë tregon që do të punohet me hua, sepse janë harxhuar 4 milionë më tepër se është paraparë.

Kosova ka nevojë për investime në të gjitha sferat e jetës, por një neglizhencë e vërtetë nga ana e kësaj Qeverie ndaj shëndetit të popullatës në Kosovë është evidente. Analizoni vetëm buxhetin për Ministrinë e Shëndetësisë dhe do të shihni sa e vërtetë është kjo.

Në përgjithësi, janë bërë disa përmirësime kozmetike, sikur ato 9 milionë në këtë buxhet, që veç janë harxhuar, i është rritur buxheti Qendrës Klinike Universitare, mirëpo ai është prapë më i vogël se në vitin e kaluar. Nuk merret parasysh se kjo qendër po e bartë barrën kryesore të shërbimeve shëndetësore në Kosovë. Në Prishtinë nuk ka shërbim shëndetësor sekondar, domethënë, nuk është menduar për t'u investuar ndërtimi i një spitali, që të mbulohen shërbimet sekondare e jo të barten në një qendër, siç është Qendra Universitare. Shërbimi primar i referon rastet gjithmonë në Qendrën Klinike Universitare dhe njëjtë edhe spitalet rajonale. Kjo qendër dita-ditës po e merr tatëpjetën dhe për këtë nuk po i intereson askujt. Në këtë buxhet nuk shihet se janë ndarë të holla për punësimin e specialistëve të rinj, për shkak të sistemit të centralizuar në shëndetësi, një kohë të gjatë po përsëritet praktika e njëjtë. Mjekët po e kryejnë specializimin, po investohet në shkollimin e tyre dhe kur po e kryejnë specializimin ata po mbesin rrugëve. Leverdia e kujt është që njerëzit me edukim superior të shëtisin rrugëve pa punë e të hollat e buxhetit shpenzohen pa plan? Ky nuk është stimulim për gjeneratat e reja që të shkollohen pasi që, sipas kësaj, del se shkollimi është investim i gabueshëm dhe kjo krejt

se Qeveria nuk din ta shfrytëzojë potencialin ekzistues njerëzor që ta çojë shëndetësinë, por edhe krejt vendin në përparimin aq të pritur.

Edhe në projektligjin e kaluar edhe tash figuron pjesa për programe tjera, që është një shumë e konsiderueshme prej 7 milionëve e nuk shpjegohet askund se cilat janë ato programe as herën e parë e as tash, përndryshe, pjesët tjera ishin përshkruar detajisht. Ministritë tjera i kishin shpjeguar detajisht të gjitha shpenzimet, nëse nuk shpjegohen, ka vend për manipulime.

Është momenti i fundit që në sektorin e shëndetësisë, por edhe në përgjithësi, të merren gjërat seriozisht, sepse edhe ashtu tash janë jashtë kontrollit të çfarëdo funksionimi dhe nesër do të nevojiten shumë të holla dhe shumë energji që të krijohet një shëndetësi e mirëfilltë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputete Hundozi! Fjalën e ka deputeti Adem Salihaj dhe pastaj do të shkojmë në pauzë.

ADEM SALIHAI: Faleminderit, zoti kryesues!

Kur kemi diskutuar në fillim të këtij viti për projektbuxhetin e vitit 2008, unë pata kritikuar me arsyetim se nuk është bërë një ndarje e drejtë e buxhetit.

Mendoj se edhe tash, në rishikim të buxhetit, e kemi dukurinë e njëjtë dhe ka vazhduar ajo dukuri që ka qenë edhe në fillim të këtij viti. Në fakt, ne në Kosovë kemi komuna të mëdha dhe të vogla, kemi kontribuues të mëdhenj dhe të vegjël në buxhetin e Kosovës, por në të njëjtën kohë ndarja e mjeteve të buxhetit ose shpenzimi i mjeteve të tyre nuk është as përafërsisht në proporcion me kontributin që japin komunat e ndryshme.

Unë, po marr shembull komunën e Ferizajt, e cila është ndër kontribuuesit më të mëdhenj, është edhe një komunë ndër më të mëdhatë dhe në fakt jep mjaft kontribut në mbushjen e buxhetit të Kosovës. Në anën tjetër, merr shumë pak mjete nga ky buxhet dhe ballafaqohet me probleme të mëdha, veçanërisht në sferën e arsimit, në furnizim me ujë, në infrastrukturë rrugore e tjera. E kam theksuar edhe herën e kaluar se në qytetin e Ferizajt kemi shkolla ku ka vetëm gjysmë metri katror për një nxënës, që është larg jo normave evropiane, por larg edhe normave të vet Kosovës. Pra, në shumicën e pjesëve të Kosovës gjendja është shumë më e mirë se sa në Ferizaj, ndërsa edhe në këtë rishikim nuk kemi një ndryshim serioz në investime në këtë aspekt.

Një problem tjetër me të cilin ballafaqohet Ferizaj, po e zëmë, është furnizimi me ujë. Ferizaj gjatë sezonit veror nganjëherë furnizohet vetëm me 40 litra ujë në sekondë, që është përafërsisht vetëm 10% e nevojave të qytetit për furnizim me ujë. Edhe këtu s'kemi aspak ndryshime serioze pozitive.

Në anën tjetër, në infrastrukturë rrugore, për një kohë të gjatë investohet shumë pak në Ferizaj, kjo vazhdon edhe tash dhe kemi investime në shumë komuna të Kosovës ku nuk janë kontribuues të mëdhenj, ndërsa ata kontribuues të mëdhenj lihen pas dore.

Mendoj se anëtarët e Kabinetit qeveritar dërgojnë investime në rajonin e tyre, madje kemi dukuri në investime nëpër, siç u tha këtu shumë herë e më duhet ta përsëris, asfaltohen rrugica të lagjeve të ndryshme prej nga vijnë anëtarët e Kabinetit qeveritar dhe lihen anash rajone të tëra që kanë nevojë imediate për këtë infrastrukturë.

Një mungesë serioze e mjeteve të buxhetit vërehet në investimet në hapjen e ambasadave të Qeverisë së Kosovës. Pra, jemi duke u ballafaquar me një stagnim serioz në njohjen e Republikës së Kosovës dhe në anën tjetër Qeveria edhe në ato vende të cilat e kanë njohur Kosovën nuk investon në hapje të ambasadave dhe zyrave konsullore dhe kjo është një mosnjohje e Republikës së Kosovës nga vetë ne apo nga vetë institucionet e saj dhe e bën të pamundur jo vetëm një vendosje të marrëdhënieve diplomatike, por nuk e mundëson as kryerjen e shumë shërbimeve për qytetarë të Republikës së Kosovës që jetojnë në ato vende.

Në të njëjtën kohë, kemi pasur premtime të mëdha se qytetarëve do t'u kryhen me shpejtësinë më të madhe shërbimet për dokumente personale dhe ju mund të jeni dëshmitarë, sepse për çdo ditë në sportelet e institucioneve të Qeverisë ka tollovi të mëdha, ka shtyrje me bërryla, ka pakënaqësi, sharje e fyerje dhe kemi të kundërtën e asaj që është menduar se do të jetë.

Në të njëjtën kohë, pra, kemi rritje të mëdha të shpenzimeve të Zyrës së Kryeministrit të segmenteve të ndryshëm të Qeverisë, rritje të shpenzimeve për paga e shërbime dhe, ndoshta, kjo e shpjegon se pse e kemi një situatë të tillë nëpër shumë segmente të Qeverisë.

Kemi shkurtim, siç u tha këtu, të mjeteve në projektin më kapital për zhvillimin ekonomik të Kosovës, pra në autostradën e Kosovës dhe në anën tjetër kemi rritje të mëdha të shpenzimeve për zyra të ndryshme. Kemi, siç u pa këtu, numër enorm të këshilltarëve në zyrën e Kryeministrit dhe nuk e di a është e saktë kjo që u tha këtu, por do të ishte shumë shqetësuese dhe ata mund të jenë në fakt vetëm, ndoshta, këshilltarë që vijnë nga partia e tij dhe shpenzojnë mjete të buxhetit të Kosovës. Ata kanë shpenzime, përveç pagave edhe shpenzime tjera të mëdha për telefona, për shpenzime tjera dhe mendoj se edhe ky projektbuxhet i rishikuar i Kosovës është storie e njëjtë apo tregim i njëjtë sikur me buxhetin e këtij viti dhe, ndoshta, efektet do të jenë të njëjta edhe më tutje.

Mendoj se nuk kemi arsye dhe mendoj se edhe vetë koalicioni qeverisës duhet ta shohë pak më realisht gjithë këtë dhe ta analizojë e të mos votojë symbyllur për një buxhet i cili, ndoshta, nuk është shumë në interes të vetë qytetarëve të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Ka shumë diskutues, por propozoj që të merremi vesh dhe të bëjmë pauzë për një orë apo një orë e gjysmë. A jeni dakord? Faleminderit!

Atëherë, në orën 15,00 vazhdon seanca. Në radhë për diskutim do të jetë Gani Buçinca.

(Vazhdimi i seancës pas pauze)

KRYETARI: Ju lus, të nderuar deputetë, t'i zini vendet tuaja. Fjalën e ka Gani Buçinca.

GANI BUÇINCA: Disiplinoi pak, zoti Kryetar!

KRYETARI: Ju lutem, meqë e keni marrë fjalën, vazhdoni, sepse s'mund t'i disiplinojmë ne deputetët.

GANI BUÇINCA: I nderuari, zoti Kryetar,

Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar dhe ju kolegë deputetë,
Me vëmendje përcolla diskutimin, përkatësisht debatin rreth Projektligjit, të cilin po e shqyrtojmë sot dhe t'ju them të drejtën, një pjesë e miqve të mi të opozitës më zhgënjyen shumë me nivelin e ulët profesional që rrezatuan gjatë vlerësimit të këtij projektligji.

U tha këtu nga një diskutues se vërejtjet profesionale iu bënë këtu këtij ligji dhe s'kisha dëshiruar që t'i përsëris. Unë, t'ju them të drejtën, asnjë vërejtje profesionale, me një përjashtim të vogël të ish-ministrit të Financave, zotit Shatri, i cili bëri disa përpjekje që në mënyrë profesionale të japë një vlerësim kritik për ligjin, të tjerat nuk ishin aspak profesionale. Bile, u inkurajova shumë që edhe unë të futem në sferën e ekonomisë dhe të diskutoj për këtë projektligj.

Mund të them se Qeveria aktuale e Kosovës për një periudhë gjashtëmujore ka shënuar rezultate të rëndësishme në të gjitha sferat e qeverisjes. Unë uroj që kjo qeveri të vazhdojë me këtë ritëm, me këtë ndjeshmëri dhe përgjegjësi për t'i kryer obligimet ndaj qytetarëve të Kosovës.

Projektligjin, që e kemi sot, unë e vlerësoj shumë pozitiv dhe të gjitha ato ndërhyrje financiare që janë bërë nëpër ministri padyshim do të jenë në shërbim të qytetarëve të Kosovës.

Ndarja e mjeteve për Ministrinë e Shëndetësisë, pa dyshim do të jetë shumë me leverdi për qytetarët e Kosovës dhe kësaj sigurisht do t'i gëzohen pacientët të cilët kanë shumë nevojë për ndihmë në këtë sferë.

Gjithashtu, ndarja e mjeteve për Ministrinë e Arsimit është në kuadër të prioritetëve, të cilat i ka kjo qeveri, bashkë me partnerin e koalicionit dhe besoj rezultatet nuk do të mungojnë as në këtë sferë.

Ndarja e mjeteve financiare për Ministrinë e Punëve të Jashtme, gjithashtu, në këtë fazë ishte mjaft e domosdoshme dhe e qëlluar. U tha këtu se ato janë pak mjete për Ministrinë e Punëve të Jashtme. Unë mund t'ju them se Gjermania është një shtet që i ka rreth 100 milionë banorë dhe në shërbimin diplomatik i ka rreth 15 mijë të punësuar. Sipas këtij standardi, ne në Kosovë do të duhej t'i kishim në shërbimin diplomatik 300 të punësuar.

Duke u nisur prej zhvillimit ekonomik që e ka Gjermania, që është në disproporcion shumë të madh me zhvillimin ekonomik të Kosovës, mendoj se Qeveria nuk duhet të ngutet dhe të ndajë mjete enorme për shërbimin diplomatik, megjithëse është shumë i nevojshëm dhe i domosdoshëm në këtë fazë kur i tërë buxheti i Kosovës nuk do të mjaftonte vetëm për një ministri e lëre më për të gjitha ministrinë që i kemi.

Ne, në politikën e lobimit i kemi miqtë tanë ndërkombëtarë, të cilët na kanë njohur ndërkombëtarisht dhe besoj se ndihma e tyre në këtë drejtim nuk do të mungojë dhe Kosova sa më shpejt të ketë një numër më të madh të njohjeve ndërkombëtare.

U tha këtu se janë ndarë pak mjete për fushën e sigurisë – për Ministrinë e Sigurisë. Mund t'ju them se Kosova kurrë nuk ka qenë më e sigurt dhe qytetarët e Kosovës kurrë s'kanë qenë më të sigurt se aktualisht, për arsye se këtu kemi aleancën më të fuqishme politiko-ushtarake dhe nuk duhet të brengosemi shumë për çështjet e sigurisë në Kosovë. Pra, nuk është prioritet i Qeverisë të harxhojë mjete enorme kur dihet se vetë shtetet anëtare të NATO-s japin vetëm 2% nga buxheti i përgjithshëm për ushtri.

U tha këtu dhe u bë përpjekje të diskreditohet Qeveria dhe politikat e saj se gjëja ka politikë proteksioniste - rajonaliste dhe i orienton investimet në rajone të ndryshme.

Unë mund t'ju them se kurrë në jetën time deri sa do të jem këtu, si deputet, nuk do të përkrah asnjë qeveri e cila bën diskriminimet rajonale në Kosovë.

Kosova është një tërësi dhe është sa një lagje e Munihut ose një kuart i Nju-Jorkut dhe nuk mund të ndahet.

Mirëpo, desha të theksoj se ekziston një studim këtu që janë në Kosovë dhjetë komuna, të cilat kanë nevojë për mjete shtesë për arsye se tradicionalisht kanë qenë të diskriminuara që nga një shekull dhe në kuadrin e këtyre komunave janë edhe dy komuna që u anatemuan këtu – komuna e Skenderajt dhe e Drenasit. Të dyja këto komuna, që një shekull diskriminohen për shkak të bindjeve politike. Mirëpo, t'ju them të drejtën, as pas luftës, qeveritë që kanë qenë edhe atëherë kur kemi qenë në partnerë qeverisës, nuk kanë qenë shumë dashamirëse ndaj këtyre dy komunave, kurse nevojat në këto dy komuna janë jashtëzakonisht të mëdha.

Qeveria aktuale, po shfrytëzoj rastin të them, nuk i ka favorizuar këto dy komuna në asnjë segment. Për herë të parë nuk janë diskriminuar këto dy komuna, kurse asnjë favor nuk e kanë pasur as në infrastrukturë rrugore, as në infrastrukturë të arsimit. Mirëpo, po them, për herë të parë nuk janë diskriminuar. Unë besoj se në të ardhmen Qeveria do të ketë parasysh këto dhjetë komuna, ku janë edhe në disa rajone të Kosovës dhe këtyre komunave t'iu ndajë një buxhet shtesë që të rrudhet ngecja në zhvillimin e këtyre komunave në Kosovë.

U tha këtu se po na munguaka një palestër sportive në një komunë atje... Unë pyes zotin Rasim Selmanaj, kolegun tim të nderuar – pse nuk e ka ndërtuar ish-qeveria palestrën sportive. Unë mund t'ju them se kjo qeveri ka për ta ndërtuar palestrën sportive edhe në Deçan. Jam i bindur se do ta ndërtojë. Thellësisht jam i bindur. Mirëpo, është një problem. Është dashur të mos ia leni kësaj Qeverie ta ndërtojë, ju ta kryeni më herët. Por, jam i bindur se kjo Qeveri do ta ndërtojë palestrën sportive.

Një kolegë tjetër, i nderuar, që ka qenë edhe kryetar komune në komunën e Ferizajt dhe ka qenë edhe zëvendëskryeministër, tha se komuna e Ferizajt vuan për ujë. Unë e pyes atë kolegë: çka ka bërë ai kur ka qenë kryetar komune dhe zëvendëskryeministër që nuk e ka zgjidhur problemin e ujit në komunën prej nga vjen ai.

Unë e di se qytetarët e Ferizajt kanë nevojë shumë për ujë, e po ashtu edhe shumë rajone të tjera të Kosovës dhe uroj që Qeveria ta ketë parasysh këtë dhe sa më shpejt këta qytetarë të pajisen me ujë.

U tha këtu se nuk mjaftojnë paratë për shëndetësi, se nuk janë dhënë para në sektorët zhvillimor të shëndetësisë. Unë jam i bindur se ministri aktual i Shëndetësisë ka marrë hapa konkretë dhe çdo ditë është duke u përmirësuar gjendja në Ministrinë e Shëndetësisë dhe këto para që janë ndarë tani do të ndikojnë ndjeshëm në përmirësimin e shërbimeve shëndetësore ndaj qytetarëve të Kosovës.

Kishte këtu edhe disa diskutime tendencioze se gjëja Qeveria nuk e ka planifikuar buxhetin në mënyrë profesionale. Të jeni të bindur, kolegë të nderuar, ky buxhet është

shumë i vogël për qytetarët e Kosovës. Dhe, ju kisha lutur, kolegë të nderuar të opozitës, që të perceptoni ambientin politik dhe ekonomik në Kosovë realisht dhe të merreni me real-politikë dhe të jeni më racional në vlerësimet tuaja dhe të kontribuoni më shumë duke i kontribuar kësaj qeverie me vërejtje profesionale e jo të stilit propagandistik, siç ishin përgjithësisht diskutimet që u bënë këtu.

Unë e kisha përgëzuar një diskutim këtu, që më pëlqeu shumë, të profesorit Hamiti, që nuk është këtu, kur thotë: që të shikohet sinqerisht që në lëmin e kulturës të bëhen investime më të mëdha dhe të rriten investimet, edhe pse janë rritur investimet, por të ketë investime edhe më shumë për arsye se kultura, sporti dhe rinia kërkojnë një vëmendje më të madhe. Besoj se në të ardhmen Qeveria do të ketë parasysh këtë sektor. Po ashtu, deputeti Hamiti e përmendi filmin, teatrin dhe disa lëmenj të tjerë, e unë kisha shtuar që edhe muzika këtu duhet zënë vendin e merituar.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit, deputet. Fjalën e ka deputeti Mark Krasniqi, le të përgatitet Berim Ramosaj.

ADEM SALIHAI: Kemi të drejtë në replikë, Kryetar!

KRYETARI: Urdhëro! E ka fjalën Adem Salihaj!

ADEM SALIHAI: Faleminderit! Unë mendoj që ishte e nevojshme t'i them disa fjalë lidhur me diskutimin e kolegut paraparak.

Me të vërtetë mund të ketë të drejtë kur thotë pse nuk i kam zgjidhur problemet, derisa kam qenë kryetar i Ferizajt. Unë sot nuk kërkoja nga Qeveria që t'i zgjidhë problemet, por të ketë investime edhe në Ferizaj për ato probleme të mëdha që janë aty, sepse të zgjidhet një problem aq i madh sikur është problemi i ujit nuk është i mundshëm as për një vit as për dy, e ndoshta as për pesë vite. Po, unë isha i fokusuar në faktin se nuk ka investime të këtij buxheti për zgjidhjen e atyre problemeve. Po ashtu, edhe për çështjen e shkollave, është problem se nuk është i ri, është problem që zgjatë ndoshta 50 a 60 vite dhe kërkon një angazhim serioz për një periudhë më të gjatë.

Pra, më duket se kolegu s'e ka kuptuar sa duhet diskutimin tim dhe është fokusuar gabimisht në disa çështje.

Problemet duhet të shihen në proces. Zgjidhja e tyre do të jetë në proces dhe nuk mundet për një mandat askush t'i zgjidhë, por unë e kisha fjalën për mungesën e angazhimit, mungesën e projekteve kapitale dhe për zgjidhjen e atyre problemeve që janë në Ferizaj, që janë shumë të mëdha. Ministri i Arsimit e di sigurisht, por e dinë edhe të gjithë të tjerët. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Mark Krasniqi. Urdhëroni, profesor!

MARK KRASNIQI: I nderuar Kryetar i Parlamentit,
Të nderuar qeveritarë dhe kolegë deputetë,
Buxheti është themeli i jetës ekonomike i çdo shteti. Ky është një burim nga i cili plotësohen të gjitha nevojat e qytetarëve dhe të shtetit si institucion suprem. Të gjithë qytetarët i kanë sytë drejt këtij burimi.

Republika e Kosovës ka shumë probleme dhe vështirësi për t'u konsoliduar si shtet i ri që është, sepse ka trashëguar një ekonomi shumë të varfër, madje të shkatërruar dhe të plaçkitur edhe nga okupatori serb.

Nga ana tjetër, shumica dërrmuese e qytetarëve janë larg këtij burimi ekonomik, janë pa punë, bile, siç dihet, një përqindje e madhe është në kufirin e varfërisë së skajshme, ndër të cilat janë edhe pensionistët, të cilëve u është mohuar e drejta e tyre ligjore për ta gëzuar në pleqëri frytin e punës së tyre shumëvjeçare, të ruajtur e të deponuar sipas dispozitave ligjore. Por, edhe ata që janë në punë, mund të thuhet, shumica dërrmuese, gjithashtu, janë të varfër, sepse me pagat e tyre prej 150 deri në 300 euro, më parë mund të thuhet se marrin një lëmoshë a ndihmë të vogël sociale se sa shpërblim për punën që kryejnë. Si mund të jetohet me 10 euro në ditë, duke i plotësuar të gjitha obligimet e domosdoshme individuale, familjare dhe shoqërore? Si mund të konsiderohen pagë kompensimi i punës, të ardhurat e mjekut specialist prej 250 euro në muaj, përkatësisht 8 euro në ditë, duke pasur parasysh përgjegjësinë shumë të madhe për shëndetin dhe jetën e pacientit. Mësuesi, edukatori i brezit më të ri, merr një shpërblim simbolik për punën e tij të përditshme, e kështu me radhë.

Kulaçi i buxhetit në sofrën e Kosovës është i vogël dhe rreth sofrës janë shumë kandidatë të uritur. Prandaj, ky kulaç duhet të ndahet me shumë kujdes dhe mirëkuptim, madje me drejtësi tradicionale të zotit të shtëpisë, i cili e ka kulaçin në dorë.

Por, edhe në këtë situatë, populli është ai që duhet ta mbushë arkën buxhetore të shtetit. Tatimi në pronat e varfra bujqësore, në banesa, në zejtari të vogël e tjera, sado i vogël që të jetë, prapë është shumë i rëndë në këtë situatë të vështirë të varfërisë kosovare. Në këtë situatë, shteti, përkatësisht Qeveria, duhet të luajë rolin e bariut të kujdesshëm të grigjës së deleve, i cili delet i qeth, por nuk i rrjep.

Mendoj se duhet bërë çmos për ta mëkëmbur industrinë e Kosovës, e cila dikur nuk ka qenë e vogël. Duhet të aktivizohen kombinatet e mëdha, siç janë: Trepça, Industria e Gjakovës dikur shumë e madhe, e Pejës, Ferizajt, Gjilanit e tjera, ku kanë qenë të punësuar me dhjetëra- mijëra punëtorë. Kombinatat e mëdha industriale janë burimi më i madh i mjeteve buxhetore.

Falë mirëkuptimit të donatorëve ndërkombëtarë, buxheti i Kosovës ka marrë një injeksion të fortë ekonomik. Ne jemi shumë mirënjohës ndaj miqve tanë për këtë përkrahje bujare të tyre. Duhet të merren masa rigorozë kundër keqpërdoruesve të këtyre mjeteve dhe mjeteve të tjera të mëparshme. Hajnat janë armiku më i madh i ekonomisë së shtetit dhe i prestigjit të tij.

Nga ana tjetër, mendoj se shteti nuk duhet të privatizojë gjithçka. Shteti duhet ta ketë në duar të veta një pjesë të mirë të burimeve ekonomike. Sot, për ta zbutur varfërinë momentale dhe për të plotësuar disa nevoja të domosdoshme, më duket se po nxitohet duke bërë pazar të lirë me sektorin privat. Nëse vazhdon kështu ky proces i tjetërsimit, atëherë mund të ndodhë që një ditë edhe institucionet shtetërore të nxirren në pazar.

Pa shtet të fortë ligjor, ekonomik e policor, populli nuk mund të dalë nga varfëria dhe shumë nevoja të tjera të domosdoshme. Privatisti, para se gjithash, është tregtar. Ai shikon interesin e vet e jo të shtetit, por për fat të mirë, ka edhe përjashtime. Duhet të përqendrohen të gjitha forcat tona me vetëdije të lartë shtetformuese dhe kombëtare për

konsolidimin e Republikës së Kosovës për përparimin e saj nga çdo aspekt, sepse shteti është shtëpi jona e përbashkët. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, profesor! Fjalën e ka deputeti Berim Ramosaj, por meqë nuk është këtu, fjalën e merr deputeti Riza Smaka. Le të përgatitet deputeti Numan Baliq.

RIZA SMAKA: I nderuar, zoti Kryetar i Kuvendit,
Zoti Kryeministër, ministra,
Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
E kemi përpara një dokument ligjor dhe do të përpiqem t'i bëj disa vështrime të shkurtra të karakterit legal.

Fillimisht, ju lutem, thuhet këtu, në nenin 1. “Në mbështetje të nenit 25 të Ligjit për menaxhimin e financave, të rregullores” e tjera, e tjera. Nuk mund të ndodhë askund, prandaj as këtu dhe duhet të fshihet dhe të riformulohet ky tekst, sepse ligji nuk mund të mbështetet në dispozitë ligjore. Mund të mbështetet vetëm akti nënligjor. Pra, është fjala për gabim juridik material që nuk mund të tolerohet dhe është qesharak.

Ose, te neni 2. “Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit të tij në Gazetën zyrtare”, që nuk është e saktë. Është në kundërshtim me Kushtetutën. Ka rregulla për pormullgacionin e ligjit. Njëherë duhet të miratohet këtu, më pastaj duhet të pormullgohet nga Kryetari, dikush thotë Presidenti i Republikës. Më pastaj duhet të shpallet dhe duhet të kalojë një afat që quhet vakacio legis.

Ose, vendimi i Qeverisë, i datës 16 korrik 2008. Thotë: “Miratohet Projektligji”. Edhe serbisht, boshnjakisht “usvaja se”, në vend që të thuhet “utvrđuje se” dhe këtu duhet të jetë “përcaktohet”, sepse “përcaktohet” projektligji.

Te neni 4, - zbatimi “Departamenti i buxhetit të MEF”, në ligj askund nuk duhet dhe nuk mund të bëhet kjo dhe s’duhet të lejohet në të ardhmen, bile së paku, që me shkurtesa, gjithmonë duhet emërtimi të jetë i plotë dhe “të gjitha organizatat buxhetore janë përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji”. Kurrresi, kjo është Qeveri. Çështja e këtij ligji është çështje madhore. Nëpërmjet ministrisë, ama jo kurrresi që të delegohet në nivelin e një segmenti të një ministrie.

Te neni 8 thuhet: “Ky ndryshim dhe plotësimi i Projektligjit nuk ka implikime financiare për zbatimin e tij”. Po të mos kishte, s’do të ishte vënë në rend dite fare. Ose “rishikimi i buxhetit ka efekt neutral”. Kjo është non sens, qysh neutral.

Edhe në këtë dokument, ju lutem, ka pozicionime, ka orientime të parasë, për të cilat mund të flitej pa fund, apo jo. Varet nga qëndrimi, nëse ka qëndrim tendencioz për të qortuar, mund të flet mjaft, apo jo, por edhe në qoftë se e merr pozicionin për ta mbrojtur, mund të flitet. Kështu, jam i bindur se edhe propozuesi – autori ka dilema. Prandaj, nuk do të isha ndalur shumë për këtë, por do të kisha apeluar që kjo mund të bëhet dhe do të duhej të bëhej dhe në vend që të financohet dhe të sponsorohet e të favorizohet administrata në kuptimin e kuantumit, do të duhej që të racionalizohej administrata, ju lutem, natyrisht të modernizohej në favorin e pozicioneve të tjera që janë tepër insuficiente sa iu përket burimeve.

Ose, do të isha angazhuar, në vend të blerjes së rrymës, që u referua këtu – 2 milionë e sa euro, që të meditohej dhe të projektohej diçka konkretisht në investim për prodhimin e

rrymës dhe jo nga kjo termo, por nga hidro. Ne kemi lumenj, edhe pse nuk jam ekspert, por kam lexuar, kam dëgjuar që me investime më të ulëta mund të bëhet mbrojtja e ambientit, mund të prodhojmë rrymë.

Ose, u tha ndër të tjera se janë dizajnuar 2 milionë euro për mjekime jashtë vendit. Ju lutem, sa unë di, mendoj se relativisht mirë jam i informuar, kemi ekspertë të mirë në Kosovë, por mungojnë mjetet materiale, teknike e kështu me radhë. Mendoj se do të ishte dashur që politika e Qeverisë të jetë e orientuar që pacientët tanë nevojtarë për mjekim, të mjekohen këtu, të bëhen investime që këtu të mjekohen sa është e mundshme edhe pse e dimë, për disa raste, momentalisht nuk mund t'i bëjmë. Me kaq, ju përsëndes. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Numan Baliq, le të përgatitet Esat Brajshori që, si po duket, nuk është këtu. Nëse nuk vjen Esati, fjalën mund ta marrë Besa Gaxherri.

NUMAN BALIĆ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Želim da kažem nekoliko riječi, koje se tiču ovog pitanja o kojem pričamo već nekoliko sati i, nažalost, većina nas smo umorni nakon ove duge rasprave.

Ja bih obratio pažnju samo na nekoliko pitanja koje smatram važnima. One se tiču, prije svega, sistema plaćanja odnosno plata.

Da budem vrlo neposredan. Vlada, ukoliko hoće da napravi snažan zaokret u svom dijelovanju, onda to prije svega mora obratiti pažnju u sektoru plata.

Zakon koji pominje izmene i dopune budžeta, u najmanju ruku mora dati bar naznake da će doći do povećanja plata u najvažnijim sektorima, kao što su policija, sudstvo, zdravstvo i školstvo. Ovo su četiri stuba sistema i četiri stuba na kojima počiva ovo društvo i kao što svi zajedno znamo i kao što smo svijesni opšteg nezadovoljstva u društvu koje postoji, niti ova Vlada, niti bilo koja druga vlada neće napraviti taj odlučujući zaokret dok ne dodje do povećanja plata.

Dakle, mi razumemo da postoje teškoće, razumemo okolnosti na koje ukazuje Medjunarodni monetarni fond, unutrašnja ekonomska kretanja i sve ostale pokazatelje koji su poznati ljudima koji se bave tim stvarima, ali je neizbježno da Vlada mora naći načine da podigne plate.

Ovo je po ko zna koji put potsjećanje da u cijeloj regiji, i u Makedoniji i u Crnoj Gori, koje su od prilike na istom nivou kao što je i Kosovo, pa i u drugim zemljama - Bosna, Srbija i tako dalje, već su davno dvostruko, trostruko i petostruko povećane plate u odnosu na Kosovo.

Bez ovakvog povećanja, kosovsko društvo ne može ići naprijed. Vlada mora naći načina da ostvari ekonomski rast, da poveća proizvodnju, da stimuliše ulaganja i ostvari ta ulaganja a ne samo da ih nabraja, da poboljša sistem carina, poreza, ubiranja taksa i tako dalje. To je jedan stub na kome počiva celokupno ovo društvo.

Ovaj zakon, u najmanju ruku, odnosno izmene i dopune kojima se popravljaju stvari, trebaju bar dati naznake. Meni je veoma jasno da ovim izmenama i dopunama se ne mogu propisati ove važne promjene o kojima govorim, ali se moraju bar dati naznake.

Ako podjemo od toga da će sledeća godina biti godina koja bi od prilike trebalo da predstavlja maksimum rada ove Vlade, već u sledećoj godini plate bi trebale da budu dvostruko veće – 100% veće. Znači, jedan policajac umesto da ima 200 evra, treba da ima 400 evra platu, ili lekar specijalista koji i dalje ima 220 evra, mora imati dvostruko više. To su nužni uslovi bez kojih nema kretanja ovog društva u pravcu naprijed.

Da napomenem vrlo kratko vezano za pojedine sisteme. Zdravstveni sistem takodje mora se riješiti. Ovim načinom kako je krenuto, radi se o drastičnom padu budžeta koji predviđa, koji se odvaja za zdravstvo. Ja ne vidim da u predloženom zakonu ima promjena tog drastičnog pada. Dakle, od nekadašnjih 70 miliona, sada je budžet pao na, ne znam, ispod 50 miliona. To se mora zaustaviti ako se hoće spriječiti katastrofalan raskol koji već postoji u zdravstvu. Zajedno sa ona dva neophodna sistema koji su vrlo važni, a koji se tiču sistema rukovodjenja i sistema podrške koju Vlada mora jasno dati. Znači, Vlada mora dati jasne naznake da će spasiti zdravstvo koje je u kolapsu. Inače, zdravstvo ne samo da će kolabirati, nego će biti u jednoj permanentnoj krizi kojoj se ne vidi kraja. I da napomenem, naravno, da ostali sistemi o kojima sam govorio – sistem socijalne zaštite, penzioni sistem i tako dalje, to su osnovne poluge na kojima počiva ovo društvo. I meni se desilo, kao i mnogim od vas, prije nekoliko dana sam razgovarao sa jednim sekretarom suda koji odlazi u penziju posle 40 godina rada i imaće penziju 75 evra. Isto kao i moja tašta koja nije radila ni jedne godine. Dakle, molim vas, ili mnogi naši prijatelji. To su neke društvene nepravde koje se moraju ispraviti.

I, sada sam došao do takodje jedne važne poruke. Kosovo je širomašna zemlja i mi svi to znamo. Ali, prvi korak u stabilizaciji situacije, sigurnosne, ekonomske, zdravstvene, socijalne i svake druge jeste pravedna...

(Ndërhyrje)

....da naravno, može da se produbi, svakako. Znači, prvi korak je pravedna podijela budžeta, ono što bise u albanskoj verziji vrlo dobro reklo „ndarja e drejtë e buxhetit“. Dakle, ajmo ovo sirotinje što postoji, neka se pravedno podijeli, a ne nekima da se da mnogo, drugima mnogo manje, a nekima ništa. To su moje najdobronamjernije primedbe koje se tiču ovoga.

I, još dvije stvari, da napominjem, vrlo kratko, vezano za Ministarstvo za zajednice. Bilo je riječi oko ovog ministarstva. Ja, takodje, sa najboljim namerama moram da kažem: 2 miliona evra koji su do sada postojali za individualne projekte vezane za razvoj u oblasti drugih zajednica, su potpuno nedovoljni i ponižavajući. Mi smo imali jedan okrugli sto, na kome su bili vladini predstavnici, na kome ste bili i vi, gospodine predsjedniče parlamenta, gde sam ja jasno rekao, mislim da sam bio u pravu – da ovaj budžet od 2 miliona evra, koji je u stvari 0,2% budžeta Kosova, dakle petstoti dio od ukupnog budžeta Kosova, on mora biti povećan. Mora biti povećan!

Ne možemo mi druge zajednice smjestiti najprije u jedan rezervat, pa unutar toga rezervata odvojiti 2 miliona evra. Ako hoćemo da nam stvari idu dobro, Vlada mora pokazati širokogrudost i izdvojiti mnogo više para a ne samo 0,2% za razvoj zajednice, za projekte.

Inače, da napomenem još uz ovo, da što se tiče ovog Ministarstva, naravno da ima mnogo opravdanih kritika, ali ima i odredjenih nakana koje pokazuju da će se i projektima koji

su u toku i nekim drugim projektima stvari popraviti i mi se nadamo da će biti mnogo bolje. I, takodje, moram da istaknem da ima jedna službenica tamo koja dobro radi, uprkos kritikama sa druge strane koje smo čuli, gde su ove godine projekti mnogo bolji usmjereni nego možda u drugim nekim periodima. Naravno, rezerva da se sve stvari trebaju i moraju nabolje promeniti.

I na kraju, ono što imam obavezu, nakon razgovora sa gradonačelnikom Peći i našim ljudima koji tamo postoje, mislim da se moraju dati naznake u najmanju ruku da su opštinski grantovi, nažalost, neusklađeni i da opštinski grantovi, uprkos tome što su u pojedinim opštinama dobro riješeni, nisu dovoljno dobro riješeni u nekim opštinama. Recimo, vladin grant za Opštinu Peć je 9 miliona evra. Ako imamo u obzir da je ona nekada bila uz rame sa Prizrenom i Mitrovicom, taj budžet je sada dvostruko manji. Dakle, to su uskladjivanja koja su neizbježna. Neravnomjernosti koje postoje na nivou Kosova se moraju popraviti, tako da pojedine opštine koje su zapostavljene, ovde mislim na sve građane i sve zajednice, moraju se ispraviti.

To su moje primjedbe koje sam imao da dam sa najboljim namerama. Hala vam ljepa! Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Besa Gaxherri. Le të përgatitet Heset Cakolli. Si duket, Esati, ka hequr dorë!

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Kolegë deputetë,

I nderuar Kabinet gjysmë qeveritar, sa jeni këtu,

I nderuar Kryetar dhe kolegë deputetë,

Në shtetet me demokraci të zhvilluar, kur diskutohet buxheti, vërtet respektohen procedurat. Në qoftë se ato shkelen, shkelen për ta zgjatur procedurën e shqyrtimit të buxhetit, e jo për ta shkurtuar procedurën, që ndodh në Kosovë dhe kjo prej pas çlirimit e deri më sot.

Në qoftë se kjo Qeveri do të arsyetohet se një gjë të tillë e ka bërë edhe Qeveria e kaluar, kjo është vërtet e papranueshme. Është krejt e qartë se vërtet çdo qeveri ka vepruar në kushte të tjera, edhe kjo Qeveri vepron në kushte shumë të ndryshme me qeveritë e tjera, duke pasur parasysh se tashmë në këtë vit, fatbardhësisht, Kosova është e pavarur.

Në qoftë se kemi parasysh atë ditë kur është diskutuar buxheti për vitin 2008, për të cilin, natyrisht, se janë dhënë vërejtje, kuptohet, nga opozita, ju – Qeveria juaj e keni mbrojtur atë buxhet dhe sot po e rishqyrtojmë buxhetin.

Ju jeni zotuar se me buxhetin e këtij viti do të bëni, natyrisht, ngritje të pagave. Ju jeni zotuar se me këtë buxhet do ta përmirësoni gjendjen e energjetikës, jeni zotuar se me këtë buxhet do të përkrahen: bujqësia, arsimi, shëndetësia, por do të investohet edhe në infrastrukturën rrugore dhe në bazë të këtij dokumenti, sepse ne nuk dimë çfarë t'i referohemi tjetër, si dhe harrova të them se jeni zotuar të bëni kursime në buxhetin e vitit 2008. Në qoftë se i referohemi këtij dokumenti, shohim se fatbardhësisht ka ngritje të të hyrave buxhetore, por fatkeqësisht të hyrat buxhetore në Kosovë janë ende nga tatimi dhe doganat. Dhe, në bazë të këtyre të hyrave nuk shohim se ka kursime. Po ua jap vetëm një shembull. Nga të hyrat tatimore nga 752 milionë janë 774.3 milionë, domethënë ky është një fakt që ju na e keni ofruar dhe që nuk i keni rritur të hyrat nga kursimet, por natyrisht nga tatimet.

Shtrohet pyetja, sa e ka orientuar kjo Qeveri drejt këtë ngritje buxhetore? Ku ka menduar që ta ngritë buxhetin me këto të rritura të këtij buxheti.

Kjo Qeveri ekskluzivisht i ka orientuar mjetet ose më mirë të thuhet projektin nacional të Kosovës në magjistralin Merdar -Vërmicë, që me fanatizëm edhe ju e keni mbrojtur. Kjo Qeveri nuk ekziston më sot. Kjo qeveri nuk e ka në programin për vitin 2008. I keni marrë ato mjete dhe i keni shpërndarë, për çka unë pajtohem që mundësisht çdo lagje të ketë infrastrukturën rrugore, ujore, shkolla e të gjitha, por vërtet në kushtet çfarë i ka Kosova, që vërtet ju keni premtuar se do të ketë shumë rrugë apo magjistrale me katër korsi e gjashtë korsi, ndërsa në projektet tuaja nuk shihet asnjë. Kosova, në këto kushte, domosdo duhet të ketë infrastrukturë rrugore që ndikon drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik dhe natyrisht se ne do të jemi ata që do të punojmë vazhdimisht për t'i asfaltuar edhe rrugët e lagjeve tona sa herë bëhemi ministra e kryeministra. Realisht, Qeveria duhet ta ketë parasysh që të investojë ku ka zhvillim ekonomik dhe nuk mund t'i ikim, nëse e kemi studiuar këtë dokument që e keni ofruar ju, sepse nuk mund t'i referohemi dokumentit tjetër, që ndarja në të gjitha ministrinë është bërë shumë e padrejtë. Mua më vjen keq, në qoftë se e theksoj cilëndo komunë dhe qytetarët e asaj komune mund të mendojnë se paskan diçka kundër, por është shumë e vërtetë se të gjitha investimet janë orientuar andej ku kanë dashur individët dhe nuk janë marrë prioritetet parasysh. Për një gjë të tillë mund të jap edhe fakte. Megjithatë, për gjithë këtë buxhet, është mjerim që nuk shihet absolutisht ndonjë subvencion apo përkrahje, për shembull, për bujqësi. Unë nuk di kjo Qeveri çka ka parasysh dhe në çfarë baze mendon të fillojë zhvillimin ekonomik, kur vërtet nuk merret absolutisht me asnjë lloj industrie apo prodhimi, por ekskluzivisht program të vetin për të hyrat i ka vetëm tatimet dhe propagandon sikur po e shohim se do t'i ulë tatimet. Po me çfarë do ta mbushë buxhetin nëse ulë tatimet, kur nuk ka prodhim, kur nuk ka zhvillim ose për energjetikën që, vërtet deri më sot, jeni marrë vetëm me komente të gjendjes reale. Asnjë ndryshim në asnjë segment të kësaj fushe që, vërtet, është shumë e rëndësishme, me përjashtim që rritni ose kërkon para nga qytetarët që, të shkretit, paguajnë dy herë për të dhënë subvencione apo hua KEK-ut, e që vërtet është gjë e papranueshme.

Një gjë që dua ta kërkoj nga ministri i Financave. Kisha dashur t'i referoheni, zoti ministër, tabelës 4 – Ministria për Ekonomi e Financa dhe unë do t'i referohem, natyrisht, vetëm investimeve kapitale.

Kalojmë dhe dalim te Projekti – autostrada, që tashmë e thamë, 7 milionë.

Fillimi i shpronësimit për autostradën Merdar-Morinë 7 milionë.

Kisha dashur konkretisht të pyes – njësia për politikë dhe monitorim e ndërmarrjeve publike, çka është kjo, që i keni 59.108.000 euro?

Pastaj, ajo që më ka bërë përshtypje është se, nga këtu ku thuhet “huaja e KEK-ut, deri te KOST”, janë projekte të radhitura që s'do t'ju marr kohë për t'i lexuar, por po ju referohem juve dhe pastaj më vonë do t'ju bëj një pyetje konkrete.

Pastaj, vjen KOST me investimet, siç i keni parashikuar ju me projekte të caktuara, hekurudhat, që është për çudi, nuk shkojnë ende tek ne në Ministrinë e Telekomunikacionit, por janë ende në Ministrinë e Financave, sikur Ministria e Telekomunikacionit ka të bëjë vetëm me asfalt, e këto tjerat janë problem i tjetërkujt.

Ngrohja qendrore, uji dhe hedhurinat, Agjencia Kosovare e Privatizimit, domethënë në fund është Trepça dhe janë projektet të cilat ju na i keni referuar me shuma të caktuara.

Me këtë dua të dal tash, i kalojmë shumë ministri, siç është Ministria e Shërbimeve Publike dhe vijmë dhe i referohemi prapë tabelës 4 dhe tash është Agjencia Kosovare e Mirëbesimit.

Zoti ministër, si e shpjegoni ju që, në kuadër të shpenzimeve kapitale tek Ministria e Ekonomisë dhe e Financave shumë, ne jse s'do të referohem unë me të gjitha ato, sepse po e dini për çka e kam fjalën. Të njëjtat projekte, por me kode tjera dhe me shumë tjetër referohen tek Agjencia Kosovare e Mirëbesimit. Të njëjtat, me emër, që i kam studiuar, vijë për vijë buxhetore dhe atje përmenden tek Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe tash del një shtyllë apo vijë tjetër buxhetore – Agjencia Kosovare e Mirëbesimit që i referohet me hekurudha, ujë dhe hedhurina, KOST, ngrohja qendrore, energjia – të gjitha këto me të njëjtat projekte, por kodi është tjetër dhe shuma është tjetër. Për mua është e paqartë dhe është e papranueshme.

Zoti ministër, së paku, dhe kolegë deputetë, mos e merrni se po flasim nga opozita, sepse ky dokument është në favor të opozitës, por vërtet është në disfavor të qytetarëve të Kosovës edhe vetë dokumenti, edhe vetë mënyra që pretendoni t'i menaxhoni këto mjete.

Andaj, ju kisha lutur, jo vetëm të flasim, por edhe të mendojmë me arsye dhe të shikojmë mirë, sepse nuk është nevoja të miratohet ky buxhet me procedurë të shpejtuar. Pse e merrni këtë përgjegjësi kur ju s'keni qenë në gjendje së paku Komisionit të Buxhetit t'i ofroni kornizën e shpenzimeve tremujorëshin dhe gjashtëmujorin. Dhe, në çfarë baze ne duhet t'ju arsyetojmë juve se cilat shpenzime janë bërë dhe tash çka pretendoni të bëni? Cilat projekte janë realizuar, cilat pretendoni t'i realizoni? Këto janë gjëra që, vërtet, janë të pakapërdishme dhe të papranueshme. Jeni tejet jo transparentë dhe fundi i fundit, një shumë e cila është ngritur dhe ju ka zënë në befasi, sepse ju s'keni qenë në gjendje të planifikoni se do të ketë të ngritura të hyrave buxhetore, tash ju nuk jeni në gjendje t'i arsyetoni dhe nuk doni t'i arsyetoni dhe nuk janë ato të bahçes së babës tuaj. Ato janë para të qytetarëve të Kosovës që në radhë të parë, ne të deleguarit e qytetarëve kemi obligim t'i kërkojmë për çdo cent transparencë, të cilën ju nuk jeni në gjendje ta ofroni, qoftë në fillim pa program të Qeverisë, qoftë tash mënyrën qysh doni t'i shpenzoni. Domethënë, ju mund t'i parashikoni vetë prioritetet dhe s'keni nevojë të diskutoni fare me Komisionin e Buxhetit, fare me Kuvendin e Kosovës, me procedurë të shpejtuar e miratoni, kjo nuk është në rregull. Dhe të gjitha këto po i them për qytetarët e Kosovës, sepse vërtet opozitës i konvenon ky dokument....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Esat, a doni ta merrni fjalën? Urdhëroni! Fjalën e ka Esat Brajshori. Le të përgatitet Dragisha Miriq.

ESAT BRAJSHORI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Zoti zëvendëskryeministër, Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,

Është vështirë të flasësh për një segment që unë desha ta ngreh këtu si problem aq sa e kam parë këtë buxhet të rishikuar nga Qeveria, sidomos kur i referohemi kulturës, artit dhe sportit në krahasim me këto problemet tjera që po i nxjerrin kolegët deputetë.

Kam njëfarë ndjenje se kjo fushë edhe në debate, përgjithësisht, por edhe sa i përket vetë Qeverisë, sikur është lënë jashtë programit, jashtë vijave buxhetore për aq sa ka nevojë.

Sido që të jetë, është mirë që ky rishikim i buxhetit vjen disi më në kohë se sa Projektligji për buxhetin e Kosovës të këtij fillim viti. Pra, në aspektin kohor të prezantimit të këtij buxheti, është deri diku në rregull, por jo edhe me substancën që ofron ky rishikim i mjeteve buxhetore, përkatësisht rindarja e drejtë e këtyre mjeteve.

Përveç vërejtjeve konkrete dhe parimore që kanë të bëjnë me mosbalancimin e të hyrave dhe të dalave të mjeteve buxhetore, siç janë: suficiti buxhetor, evazioni buxhetor, rindarja e mjeteve buxhetore deri tek bartësit qendror, mendoj se është bërë së tepërmi në dobi të njërit institucion dhe në dëm të institucionit tjetër. Në këtë mes, nuk do të doja të besoj se kjo është bërë edhe sipas kodit miqësor.

Sido që të jetë, unë do të ndalem tek buxheti i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Sipas Projektligjit për buxhetin e konsoliduar të Kosovës, si dhe vendimit të Qeverisë së Kosovës 01/5, të datë 2 shkurt 2008 kësaj Ministrie i janë ndarë 9.048.201 euro. Pas rishikimit të këtij buxheti, kësaj Ministrie i shtohen për shpenzime edhe 2.695.307 euro. Tani, edhe pse për ne nuk janë të njohura prioritetet e kësaj Ministrie, pra se në çfarë fushash do t'i përdorë këto mjete, siç tha profesori edhe më herët, e vërteta është se këto mjete janë tepër të pakta për ta filluar lëmshin e krijuar në fushën e kulturës, rinisë e sportit tek ne.

Unë e kuptoj se prodhimtaria kulturore në Kosovë duhet që hap pas hapi të shkëputet nga varësia e financimit institucional, pra duhet që në hapa të shkohet drejt vetëfinancimit në bazë të vlerave që prodhohen, siç është kudo në botë. Por që të vihet deri te kjo, është domosdoshme mbështetja financiare institucionale dhe nuk është vështirë të kuptohet se ky ribuxhetim i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve nuk i arrin këto objektiva.

Po përmendi këtu vetëm disa nga fushat që mbulon kjo qeveri, e që të gjitha së bashku kanë vetëm një emërtim: ndodhen në një gjendje, si të thuash, kome. Mos mbështetja, përkatësisht mos fuqizimi i rinisë, përkundër deklarimeve retorike politike në mungesë të një ligji bashkëkohor për rininë.

Sporti, i cili është kthyer më shumë në betejë shqelmash, me një infrastrukturë të shkatërruar dhe aspak kompatible me standardet rajonale dhe evropiane.

Libri, filarmonia, teatri, filmi – janë disa nga këto fusha, të cilat po përfundojnë si mos më keq dhe është e kuptueshme se për të ringjallur shpirtin aristokrat të këtij populli në këtë fazë të zhvillimit të vendit tonë është e domosdoshme mbështetja financiare institucionale e kulturës, e rinisë dhe e sporteve.

Është për të ardhur keq që artistët tanë janë kthyer në kamerier restorantesh për shkak të pagave të tyre prej 150 eurove, pensionistët një numër i madh i tyre në lypsar rrugësh dhe arsimtarët në cigareshitës.

Ajo çka është akoma më e dhembshme, është derdhja e trurit. Pra, një pjesë e madhe e rinisë sonë që merr rrugën akoma të kurbetit për të gjetur mundësi të tyre profesionale më tepër.

Atë, që desha ta them, si përmbyllje të gjithë kësaj është se ne mund të flasim dhe të na dëgjojë populli, por për të është e rëndësishme të kuptojë se cili është hapi konkret në drejtim të punësimit të njerëzve. Sot në Kosovë jo vetëm që është vështirë për të gjetur një punë, por ka shumë familje që kanë nevojë edhe për bukën e gojës. Pra, punë, dinjitet dhe program të qartë të Qeverisë deri në mbarim të këtij viti. Ju faleminderit për durimin e treguar!

KRYESUESI IBRAHIM GASHI: Faleminderit, deputet Brajshori! Fjalën e ka deputeti Dragisha Miriq, le të përgatitet deputeti Zafir Berisha.

DRAGIŠA MIRIĆ: Hvala! Dame i gospodo poslanici, Ne slažem se sa ovim budžetom. Smatram da je ovo jedna formalistika jer je mnogo malo novca idvojeno za Ministarstvo za povratak i zajednice. Sa tim novcem mi ne možemo 50 kuća da vratimo.

Kada je u pitanju Ministarstvo za povratak i zajednice, ja ne vidim lično dosadašnju realizaciju u Ministarstvu za povratak i zajednice. Toliko je novca potrošeno a i dalje Srpska i ostala zajednica živi po raznim kontejnerima i šupama. Zato, tražim od gospodina ministra Bobana Stankovića da podnese konkretan izeštaj Skupštini za ovih 6 meseci šta je uradjeno i šta će se dalje raditi.

Gospodine predsedniče Skupštine,
Gospodine zameniče predsednika Vlade,
Gospodo poslanici,
Prenosim vam glas Srpske zajednice na Kosovu gde su totalno nezavodoljni radom Ministarstva za povratak i zajednice. Svi, koji žive na teritoriji Kosova nemaju uslove za ostanak i povratak na Kosovu. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit, deputetit Miriq. Fjalën e ka deputeti Zafir Berisha, le të përgatitet Heset Cakolli.

ZAFIR BERISHA: Të nderuar, kolegë deputetë,
I nderuar kryesues i seancës,
Ministra, zëvendëskryeministra,
Realisht, unë kam pritur më shumë nga kolegët e opozitës që të jenë më konkret, por megjithatë disa gjëra që i kanë përmendur, mendoj se ministri i Ekonomisë do të ketë përgjigje dhe pres përgjigjen që edhe për ne, edhe për qytetarët disa gjëra do të sqarohen, sepse po shoh më shumë po shkohet në propagandë si në fushatë elektorale se me diçka konkrete.

Edhe pse po shihet që ka përpjekje, që me rishikimin e buxhetit të ndërrohen disa pozicione, mendoj se ka pasur edhe më shumë mundësi të bëhet edhe më shumë në shumë fusha.

Kur shikojmë tabelën numër 4, shihet se janë bërë disa lëshime të vogla për të cilat unë shpresoj se Kabineti qeveritar do t'i ketë parasysh me miratimin e buxhetit për vitin 2009

pasi që e kemi të qartë se nga miratimi i buxhetit deri në rishikim është krijuar një rrethanë krejt e re.

Unë do të ndalem pak te disa organizata buxhetore të cilat, megjithatë, në rajonin e Prizrenit i kanë harruar dhe mendoj se Prizreni, bashkë me komunën e Sharrit, të Rahovecit dhe Suharekës në disa organizata buxhetore nuk janë përfshirë, për çka kisha preferuar të marrin si shembull Ministrinë e Transporteve dhe të Arsimit, të cilët, megjithatë, janë munduar të prekin shumë komuna, ndoshta ndonjë komunë më tepër për shkak se disa komuna që nga paslufta kanë qenë të harruara kështu që po bëhet njëfarë kompensimi me gjasë.

Ajo që mendoj unë, që Kabineti qeveritar dhe hartuesit e këtyre projektligjeve buxhetore duhet përqendrimin ta kenë në mekanizmat e sigurisë duke pasur parasysh se pa një siguri të qëndrueshme nuk do të ketë edhe ekonomi dhe zhvillim të qëndrueshëm.

Prandaj, mendoj se në Ministrinë e Punëve të Brendshme është bërë pak, veçanërisht në pajisjet, do të thotë, për policinë dhe ngritjen e infrastrukturës. Në këtë rast unë do të jap si vërejtje, për të cilën do të pajtohen shpresoj të gjithë deputetët dhe qytetarët se ne, megjithatë në këtë ministri kemi një mungesë të infrastrukturës, veçanërisht, të objekteve për dhënie të dokumenteve personale dhe ne në këtë kohë kemi një rrëmujë dhe shqetësim të arsyeshëm të qytetarëve. Pra, konsideroj se në këtë gjashtëmujorin e dytë ka pasur mundësi të zbutet me qëllimin më të mirë që sezoni i ardhshëm, veçanërisht për mërgimtarët, të jetë më komod në nxjerrjen e dokumenteve pasi që shumë kuvende komunale, realisht, me të drejtë ankohen sepse një pjesë e këtij sektori të Ministrisë është e koncentruar në administratën komunale.

Çështje tjetër, që është shumë me rëndësi, është se unë e di që shumëçka propagandohet në fushata elektorale për ish- ministrin e pushtetit lokal dhe zëvendëskryeministrin Lutfi Hazirin... Në vitin e kaluar ka ndodhur një ngjarje shumë tragjike për qytetarët dhe për institucionet kur është djegur një objekt komunal, që kap vlerën prej 1 milion euro. Është premtuar atëherë dhe realisht nuk është planifikuar në buxhetin e vitit 2008 dhe, sipas gjasës, edhe në rishikim nuk është planifikuar. Unë konsideroj që po rrezikohet diku një administratë prej 300 punëtorëve dhe, natyrisht, është një hije e keqe për qytetin e Prizrenit.

Sa i përket kulturës, unë pajtohem me profesor Hamitin. Ne, megjithatë, kemi një identitet. Unë mendoj se duhet të ruhet identiteti në trashëgiminë kulturore dhe është fatkeqësi, për sa e kam përcjellë edhe si këshilltar i Asamblesë kur kam qenë, janë nga 70.000 euro që barten për çdo vit dhe realisht unë me përgjegjësi mund të them se ato 70.000 euro për renovimin e Kalasë së qytetit të Prizrenit nuk janë të mjaftueshme edhe për vetëm mjetet e punës të çohen deri në kala.

Prandaj, konsideroj se në këtë drejtim duhet të kemi një qasje më serioze, përndryshe, realisht shumë objekte, jo vetëm Kalaja e Prizrenit, por edhe shumë objekte të rëndësishme të veçantë historike janë para shkatërrimit total.

Ajo për çfarë vazhdimisht po vërehet një lëshim, i cili ndoshta është nga ana profesionale për moskoncentrimin e asnjërës qeveri, është në fushën e hotelierisë. Realisht, Prizreni, Sharri dhe Peja janë disa qytete të cilat mendoj se duhet të kenë një prioritet për shkak se ky segment i ekonomisë do t'i bjerë shumë të mira edhe Qeverisë edhe qytetarëve dhe, natyrisht, ne dalëngadalë duhet të mendojmë edhe për turizmin vendor.

Prandaj, unë konsideroj se në lexim të parë, me kalimin e këtij projektligji, po shpresoj se disa nga vërejtjet e deputetëve, edhe pse s'pati shumë vërejtje serioze, do të kalojnë dhe sigurisht ky debat do t'iu shërbejë edhe ministrave dhe deputetëve që në planifikimin e buxhetit për vitin 2009, faktikisht për disa sektorë të merren më seriozisht. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Haset Cakolli, le të përgatitet deputetja Edita Tahiri.

HESET CAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,

Të respektuar kolegë deputetë,

Projektligji për ndryshimin e Ligjit numër 03/L38 për miratimin e buxhetit të konsoliduar të Kosovës dhe të shpenzimeve të autorizuara për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2008, qëllimin kryesor e ka ndryshimin dhe plotësimin e këtij projektligji dhe rishikimin e buxhetit, autorizimin, ndarjen buxhetore dhe menaxhimin sa më të mirë të shpenzimeve publike për vitin 2008.

Buxheti i konsoliduar i Kosovës në shumën prej 888.9 milionë euro nuk është i mjaftueshëm për plotësimin e të gjitha nevojave të organizatave buxhetore, si dhe kërkesat e shumta për investime kapitale. Prandaj, rishikimi për gjysmëvjetorin e dytë të këtij viti duhet të bëhet me shumë kujdes, duke pasur parasysh kërkesat e shumta të shoqërisë kosovare.

Ne, si shoqëri, kemi si synim kryesor- ngritjen e cilësisë në arsim në të gjitha nivelet, prandaj edhe duhet të bëhen reforma dhe investime të menjëhershme në këtë sektor.

Nga ministri për Ekonomi dhe Financa është premtuar se do të ketë përmirësim të gjendjes materiale për punëtorët e arsimit nga shtatori i këtij viti. Ndërsa, ministri i Arsimit, Shkencës dhe Kulturës ka thënë se do të ketë përmirësim të gjendjes materiale për punëtorët e arsimit, sepse do të ketë njëkohësisht edhe gradime, varësisht nga përgatitja shkollore dhe përvoja e punës.

Nëse i referohemi planit për shpërndarjen e mjeteve materiale në arsim, në pjesën e dytë të gjysmëvjetorit të këtij viti, nuk vërehen ndryshime të mëdha në krahasim me periudhën e gjashtëmujorit të parë. Këtu e kam fjalën për arsimin në të gjitha komunat e Kosovës.

Numri i punëtorëve në arsim, në bazë të raportit, është 29.780 punëtorë dhe për paga e shtesa është paraparë shuma 76.661.333 euro, ndërsa për një punëtor do të thotë i bie mesatarisht diku 2.574 euro, që është pothuaj se e ngjashme me shumën që ka qenë e paraparë në gjashtëmujorin e parë, e cila është diku 2.563.4 euro.

Unë mendoj se duhet të bëhet një rritje e të ardhurave bazë për të gjithë punëtorët e arsimit e pastaj të shkohet edhe në rritjen sipas gradimeve. Për t'u realizuar kjo ngritje unë mendoj se, ndoshta, shuma e cila është planifikuar të ndahet nga Ministria, nuk mund t'i përmbushë të gjitha këto kërkesa.

Prandaj, në fund, shpresoj se në këtë sektor të arsimit do të bëhet rritja e të ardhurave të punëtorëve të arsimit me qëllim të stimulimit material e moral dhe me qëllim të arritjes së sukseseve, të cilat të gjithë ne i dëshirojmë për arsimin.

Në raportin për Ministrinë së Bujqësisë, gjithashtu, është dhënë numri i të punësuarve, ku në fillim të këtij viti ka qenë numri 598, ndërsa në raport tani figuron numri 739. Shtrohet pyetja, si ka ndodhur të bëhet kjo rritje e numrit të punëtorëve gjatë kësaj periudhe? Ndoshta, në një formë, edhe deputeti Koci e dha përgjigjen rreth kësaj çështjeje.

Edhe Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, si duket do ta përcjellin edhe këtë vit probleme të njëjta, që do të thotë se Qeveria nuk ka paraparë mjete për subvencione në sektorin e bujqësisë.

Vendimi i Qeverisë për subvencionimin e naftës për autokombajna, gjatë korrje-shirjeve këtë vit ka pasur efekt shumë pozitiv jo vetëm në aspektin material, por shumë më tepër ka pasur përkrahje morale që iu është bërë fermerëve nga ana e Qeverisë së Kosovës. Prandaj, Qeveria duhet të bëjë përpjekje maksimale, të sigurojë fonde të veçanta për subvencionin e imputeve gjatë mbjelljeve vjeshtore këtë vit me qëllim të rritjes së prodhimtarisë bujqësore në vitet në vijim. Ju faleminderit për vëmendjen!

KRYESUESI: Faleminderit, deputetit Cakolli. Fjalën e ka deputetja Edita Tahiri, le të përgatitet deputeti Memli Krasniqi.

EDITA TAHIRI: Ju faleminderit!

Zoti kryesues,

Deputetë dhe qeveritarë të nderuar,

Është një ditë e gjatë edhe ne që mbetëm për pasdite, nuk e di a jemi mjaft të koncentruar? Megjithatë, më lejoni të them se sfida e buxhetit apo e rishqyrtimit të buxhetit është zakonisht ndër sfidat më të mëdha të çfarëdo qeverie dhe me këtë rast gjithmonë kur buxheti është i madh i një vendi, problemet janë të mëdha, mirëpo kur është buxheti i vogël, problemet janë shumë më të mëdha. Prandaj, edhe diskutimi i sotëm në fakt është diskutim që nxjerr në sipërfaqe problemet dhe sfidat, por edhe kontributin që diskutuesit dhe deputetët e dhanë sot në këtë debat.

Unë nuk jam eksperte për këto çështje, por më lejoni të jap disa observime të mia në planin parimor dhe të them se nevoja për rishqyrtimin e buxhetit është e lidhur me disa faktorë dhe unë do t'ju përmend disa, që mendoj janë kryesorët.

Së pari, janë efektet e pavarësimit të Kosovës, që janë shoqëruar me krijimin e institucioneve të reja, por edhe me rritjen e vëllimit të punëve në ministri të ndryshme, siç është Ministria e Drejtësisë, e Shërbimeve Publike dhe sektorë të tjerë.

Së dyti, unë nuk e dëgjova këtu dhe kam pritur të dëgjoj nga ish -qeveritarët – problemin e borxheve që i ka lënë qeveria e kaluar dhe që i barten obligim dhe sfidë kësaj qeverie dhe mendoj se ka qenë e rendit që ish- qeveritarët ta bëjnë këtë këtu në Parlament, sepse i kontribuojnë realitetit dhe vlerësimit më të mirë të diskutimit të sotëm, por edhe afrimit të pikëpamjeve tona për ta miratuar këtë propozim.

Së treti, rritja e çmimeve nuk është problem vetëm i Kosovës. Rritja e çmimeve është problem global dhe bashkë me këtë problem global edhe Kosova, por edhe Qeveria e saj, natyrisht, kanë sfida dhe vështirësitë e tyre.

Duke i marrë parasysh krejt këto arsye, unë mendoj se duhet t'i japim mbështetje parimore këtij propozimi. Më lejoni me këtë rast të jap disa rekomandime të mia, që mendoj se duhet të merren parasysh. E kam parasysh kohën e shkurtër, por sikur të kihet

vullnet dhe organizim më i mirë, ma merr mendja se edhe kjo periudhë e shkurtër kohore mund të reflektojë në korrigjime të caktuara.

Mendimi im është që, për fushën e arsimit duhet të mendohet mirë, sepse ka premtuar jo vetëm kjo qeveri, por kanë premtuar të gjitha qeveritë që kanë ardhur në Kosovë, pra, pas luftës dhe gati secila ka dështuar në këtë plan. Mos të flas për kontributin e arsimit dhe mësimdhënësve, sepse të gjithë e dimë dhe nuk po dua të bëj marketing politik, por është një fushë për të cilën duhet të kemi kujdes të veçantë.

Pastaj, vijnë fushat tjera, siç u përmendën edhe nga kolegët tjerë, shëndetësia dhe fushat e tjera, mirëpo unë dëshiroj ta vë theksin te fusha e konsolidimit të sovranitetit të Kosovës dhe me këtë rast dua të përmend se duhet të mendohet më mirë për Ministrinë e Mbrojtjes, për çështjen e Policisë dhe për Mitrovicën.

Sovraniteti i Kosovës, në mënyrë drastike po cenohet në Mitrovicë dhe ne duhet të bëjmë investime strategjike që t'i arrijmë synimet tona të zhbërjes së strukturave paralele, të riintegritetit të minoritetit serb dhe të tejkalojmë problemet që prekin drejtpërdrejt sovranitetin.

Në fund, unë gjendem në mjedisin ku jam e lobizuar nga njerëz që vijnë nga fusha e kulturës dhe këto ditë po zhvillohen hulumtimet arkeologjike në Ulpianë. S'di sa e dini dhe sa jeni të informuar, por zhvillohen me një minimum të mbështetjes financiare, ndërkohë që Ulpiana urgjentisht duhet të shpallet zonë e interesit të veçantë.

Dhe, sa për relaks, dua të bëj analizën e dy-tre diskutuesve të opozitës, sepse ashtu si Qeveria dhe ne deputetët që i takojmë koalicionit qeveritar, jemi zotuar t'i përmbushim premtimet elektorale, opozita ka premtuar të jetë konstruktive.

Më lejoni të përmend dy-tri raste të cilat i dëgjova sot.

E para. Një diskutues thotë “Dokumenti, ashtu siç ka ardhur, i buxhetit, nuk është në interes të qytetarëve, por është në interes të opozitës”. Pyetja ime është: a është opozita me qytetarët apo kundër?

E dyta. Një diskutues ka thënë kështu: “I kemi dënuar dyfish qytetarët duke i detyruar të paguajnë taksa dhe duke paguar energji”. Qytetarët nuk dënohen duke paguar taksa dhe energji. Ato janë obligime të tyre, por duhet dënuar ata që nuk i paguajnë.

E treta. Ishte një diskutim, që thoshte: “Rialokimi i pjesës së shpronësimeve, nënkupton se kjo qeveri nuk e ka parasysh projektin nacional të autostradës”. Pyetja ime është kjo: Po krejt këto qeveri, që nuk bënë asnjë milimetër të autostradës, athua edhe ata s'e paskan pas projekt nacional këtë autostradë? Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit deputete! Vazhdojmë. E ka fjalën Memli Krasniqi, le të përgatitet deputeti Bahri Hyseni.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Padyshim se po shqyrtojmë një projektligj tepër të rëndësishëm dhe kjo po vërehet edhe nga numri i diskutuesve nga diskutimet pasionante të disa deputetëve, veçanërisht të

atyre që i përkasin opozitës. Dëgjuam këtu lloj-lloj matematikash, lloj-lloj llogaritjesh dhe përlllogaritjesh të ndryshme. Unë kam vetëm një kërkesë. Thjesht, i lus kolegët e mi të mos manipulojnë me shifra dhe të mos fshehën pas terminologjive teknike, por t'i thonë gjërat troç, ashtu siç janë. Kur flasim për këto rritje, që disa po i trajtojnë si gjëra shqetësuese, duhet të themi pse janë këto rritje. Kur flasim, ta zëmë, për rritjen në vijën buxhetore në paga dhe mëditje, duhet të themi se ka rritje për shkak se kemi institucione të reja ku ka njerëz të rinj në këto vende të punës, të tregojmë se ka një legalizim të atyre punëtorëve që, siç u tregua edhe më herët nga disa kolegë, më parë në qeverisjen e kaluar kanë punuar me kontrata mbi veprën dhe kanë punuar për një kohë të gjatë, ndërsa kjo Qeveri i ka legalizuar nëpërmjet procedurave ligjore këta punëtorë që kanë punuar në ministri të ndryshme dhe në institucione të tjera shtetërore. U la pa u përmend pse ka rritje, sepse është ndarë një buxhet i konsiderueshëm që të rriten pagat e arsimtarëve, që është herë e parë që ndodh një gjë e tillë, 9 vjet pas luftës, dhe që do të fillojë menjëherë pas procesit të licencimit i cili është duke vazhduar dhe që nga 1 shtatori, për herë të parë do të ketë rritje të pagave në sektorin e arsimit. Për këtë arsye, do të thotë, kemi rritje në këtë vijë buxhetore.

Kemi rritje në vijën e shërbimeve dhe të mallrave, sepse ka investime shtesë, që s'ka pasur më herët. Në sektorin e shëndetësisë është rritur buxheti për barërat nga lista esenciale, por të mos harrojmë se janë duke u paguar edhe borxhet e viteve të kaluara, që kjo Ministri ia ka lënë kësaj Qeverie.

Sa i përket qasjes së Qeverisë në shërbime e mallra dhe “të Qeverisë në dietë” që e kemi quajtur, ajo u bë publike hiq më larg se dje dhe me shifra konkrete është treguar se për gjashtëmujorin e vitit të parë të vitit 2008 në krahasim me një vit më herët kjo Qeveri ka shpenzuar 28% më pak, që janë përmbi 1 milion.

Këto janë shifra konkrete, të cilat i kuptojnë edhe qytetarët e thjeshtë.

Me terma nënçmuese, pak a shumë, u tha se kjo Qeveri po ndërton rrugica dhe sokaqe. Ju lutem, kolegë deputetë, ato rrugica a sokaqe, që i quani ju, janë të rëndësishme për jetën e përditshme të qytetarëve tanë, sepse edhe varfëria e tyre ka një korrelacion drejtpërdrejt me mungesën e infrastrukturës rrugore. Dhe, nëse jeni mësuar të ndërtoni në kohën tuaj rrugica veç në kohë të fushatave, kjo Qeveri nuk merret me fushatë, por merret me qeverisje të këtij vendi dhe nuk ndërton rrugë tre muaj para zgjedhjeve, por 24 orë në ditë, 7 ditë në javë, për krejt mandatin sado që t'i zgjasë. Nëse për dikë prioritet është diçka tjetër, për qytetarët e fshatrave që janë duke marrë benificione prej kësaj Qeverie të Kosovës për herë të parë, janë prioritet pikërisht këto rrugica dhe pikërisht këto sokaqe. Pastaj, duke i shtruar këto rrugica ose sokaqe, po harroni të përmendni se pothuaj të gjitha kompanitë e ndërtimit të këtyre rrugëve në Kosovë, që momentalisht janë duke punuar në të gjitha cepat e Kosovës, pa përjashtime rajonale, janë edhe 5.000 punëtorë në Kosovë që janë duke marrë paga pikërisht pse po shtrohen këto rrugë anembanë Kosovës.

Pat njëfarë kritike, mu duk, pse po mbarohen shkolla, se Ministria e Arsimit po merret me ndërtimtari e jo me reforma në arsim. A mund të më tregojë ndokush, që mund të jetë më i mençur, qysh mund të ketë reforma arsimore kur s'ka infrastrukturë. Qysh mund të reformohet një sistem arsimor nëse ka mungesë të hapësirës shkollore? Fatkeqësisht, që tetë vjet nuk kemi arritur të kemi infrastrukturë dhe hapësirë shkollore sa duhet, por anash prej ndërtimtarisë, janë bërë edhe shumë hapa tjetër konkret, bile – bile kisha për të thënë shumë të guximshëm nga Ministria e Arsimit dhe nga Qeveria e Kosovës pikërisht në drejtim të reformimit të sistemit arsimor, duke filluar nga sistemi parashkollor e deri

te sistemi universitar. Këtu kam parasysh edhe vendimin për akreditimin e universiteteve private në Kosovë.

Ndoshta një pikë kontestuese, me të cilën mund të pajtohen shumë prej nesh, shumë qytetarë besa, është edhe subvencionimi për KEK-un. Është e vërtetë se është vështirë për shumicën prej nesh të pajtohemi që duhet të jepen ende kaq shumë të holla për KEK-un. Por, meqenëse keq menaxhimi aq i thellë që atje mbretëron për kohë kaq të gjatë, nuk po mund për një kohë kaq të shkurtër të çrrënjohet, atëherë ne duhet ta përprijmë edhe një herë një subvencionim duke shpresuar se është hera e fundit. Sepse, cila është alternativa: nuk e subvencionojmë, vjen dimri, keq menaxhimi prapë i qet blloqet prej sistemit dhe ne duhet t'i lëmë qytetarët në terr. Nëse ka opozitarë të tillë që mendojnë se më mirë të lihen në terr qytetarët se sa ta subvencionojmë KEK-un, atëherë këtu kemi dallim të madh në qasje.

Pajtohem që ky buxhet do të ishte mirë që t'u japë pak më shumë hapësirë aktiviteteve kulturore, aktiviteteve rinore dhe sportive, sepse me të vërtetë për shumë vjet nuk ka pasur buxhet të mjaftueshëm në këtë drejtim dhe mbështes çfarëdo iniciativë në këtë drejtim dhe shpresojmë se Qeveria do të ketë parasysh, qoftë në amendimin e tashëm, qoftë për buxhetet e viteve të ardhshme.

Dhe, në fund të them, nëse ky buxhet del, siç u tha, që është buxhet deficitar, ma merr mendja se ne duhet ta vështrojmë këtë fakt si aftësi, si kapacitete që kjo qeveri ka për të shpenzuar të hollat, sepse viteve të kaluara qeveritë e kaluara s'kanë pasur kapacitete shpenzuese. I kanë pasur paratë, i kanë zotuar, s'kanë arritur t'i harxhojnë dhe kështu kanë pësuar qytetarët e Kosovës, sepse projektet që është dashur t'i kenë, nuk janë realizuar. Nëse kjo qeveri arrin t'i realizojë, qoftë edhe duke hyrë në deficit, kjo është për t'u përshëndetur, sepse flet për punë e madhe që është duke u bërë. Dhe, prapë, Ministria e Transportit është shembull shumë i mirë në këtë drejtim, sepse për 6 muaj i ka harxhuar 70% të buxhetit, që e ka pasur të parashikuar.

Mund të them se vërejtjet konkrete dhe korrektuese, besoj për të gjithë, janë të mirëseardhura dhe në rend të parë duhet të jenë për Qeverinë dhe shpresojmë se do të ketë më shumë në diskutimet në vijim sepse ishin pakicë, dorën në zemër, deri tash. Por, shpresojmë se këto komente ose këto kritika propaganduese dhe joparimore të marrin fund, sepse qytetarët po na shohin, qytetarët e dinë, nuk mund t'i mashtrojmë me manipulime e me shifra, siç tentuan disa deri tash. Ju faleminderit për vëmendjen!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni, le të përgatitet deputetja Njomëza Emini, e cila është pa kartelë dhe herët ka aplikuar për diskutim.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Jemi në fund të debatit për një çështje shumë të rëndësishme dhe pak e kemi më vështirë ne që po diskutojmë në fund për shkak të mos përsëritjes së gjërave rreth një çështjeje shumë me rëndësi për Qeverinë e Kosovës dhe për ne në përgjithësi edhe si Kuvend, edhe si qytetarë të Kosovës.

Që në fillim, kam pritur që deputetët e Kuvendit të Kosovës, me sugjerime dhe rekomandime do të ndikojnë pozitivisht që Ministria për Ekonomi e Financa të ketë

parasysh që nga opinionet që do t'i fitojë nga rekomandimet që do të dalin nga ky kuvend të ketë një orientim të drejtë në ndarjen buxhetore, si çështje më e rëndësishme për mua, për funksionimin edhe të vetë Qeverisë, por edhe të institucioneve në përgjithësi.

Mirëpo, si po duket, më tepër jemi të prirë që të japim opinione politike se sa opinione konkrete që do të ndikonin pozitivisht që ministri për Ekonomi e Financa të shikojë që në ndarje të buxhetit nëpër zëra të buxhetit të ketë parasysh edhe rekomandimet që dalin nga Kuvendi i Kosovës.

Unë po potencoj që në fillim se asnjëherë dhe asnjë qeveri nuk ka mundësi që të balancojë çështjen e të hyrave dhe të dalave në këtë situatë tani çfarë është, sepse çështja e të hyrave dhe të dalave vazhdon, është proces i vazhdueshëm dhe askush nuk mund të prej një raport të qartë, të cilin po e kërkojnë deputetët këtu në Kuvend.

Çështja tjetër. Pse po ndodhë rishikimi? Rishikimi është i domosdoshëm, në çdo proces buxhetor, sepse asnjë qeveri nuk është kompjuter për të planifikuar apo të bëjë planifikime për procesin 12-mujor apo për tërë vitin fiskal, sepse planifikimi në fillim bëhet nga të hyrat aktuale të cilat i ka qeveria në atë moment. Prandaj, kjo që ka bërë Qeveria, në këtë moment, konsideroj se është shumë e rëndësishme, sepse ka krijuar një situatë ku të hyrat janë rritur për një shumë të caktuar dhe natyrisht rishikimi ka qenë i domosdoshëm dhe ndarja është bërë, ndoshta, jo në mënyrë më perfekte, mirëpo deri diku sipas nevojave dhe projekteve aktuale që kanë qenë.

Vlen të përmendet që me plot të drejtë u ngrit çështja e kornizës afatmesme të shpenzimeve, mirëpo korniza afatmesme nuk duhet të jetë rob, ne nuk duhet të jemi rob të kësaj kornize nëse institucionet e Kosovës kanë krijuar situatë që në Kosovë të ketë të hyra më shumë se që janë planifikuar në bazë të objektivave që i ka pasur Qeveria. Prandaj, Qeveria e Kosovës po të kishte shpërndarë buxhetin vetëm në dy zërat në mallra dhe shërbime dhe në paga dhe mëditje do të ishte me të vërtetë, ndoshta, interes që të kërkohej këtu që quhet korniza afatmesme e shpenzimit, mirëpo, meqë ka një balancë edhe në zërin më të rëndësishëm të buxhetit në investimet kapitale, atëherë nuk ka asnjë pengesë që edhe korniza afatmesme e shpenzimeve të shikohet dhe të modifikohet me ndarjen e buxhetit që është bërë në tri zërat.

Pa dyshim që Qeveria ka rritur dhe ka paraparë rishikim të buxhetit edhe për dy zërat-shpenzimet për mallra dhe shërbime, pagat dhe mëditjet. Mirëpo, për ne ka qenë, ndoshta, shumë me interes që Qeveria nuk e ka lënë anash zërin më të rëndësishëm të buxhetit investimet kapitale dhe nga kjo që kam parë asnjë organizatë buxhetore nuk ka shpenzime në mallra dhe shërbime më shumë se shpenzimet kapitale. Pra, ju e dini, vetëm kthehuni pak në të kaluarën ku ka pasur organizata buxhetore që kanë pasur shpenzime kapitale 100 mijë euro, ndërsa kanë pasur mallra dhe shërbime 2 – 3 milion euro.

Çështje tjetër me interes është se të gjitha kërkesat që kanë ardhur nga organizatat buxhetore, që përafërsisht janë 150 milionë, është për t'u befasuar që Qeveria ka arritur që këto kërkesa t'i mbulojë së paku 85% dhe të bëjë propozimin për miratim diku për 111 milionë që është interes, domethënë për organizatat buxhetore që kanë ofruar projektin.

Natyrisht, interes më i madh është menaxhimi i mirë, sepse të hyrat që janë krijuar janë rezultat i një politike të drejtë që ka krijuar Qeveria në këtë rast dhe, natyrisht, në fillim ka qenë e pamundur të parashihet.

Unë i kam disa vërejtje konkrete lidhur me Ministrinë e Ambientit. Ministria e Ambientit ka bërë një kërkesë për disa projekte kapitale. Pra, më vjen keq që është një projekt i cili qëndron pezull që 3 – 4 vjet edhe në Qeverinë e kaluar për disa shtëpi të cilat nuk i pret as nata, ndoshta, janë familje të rrezikuara për shkak të rrëshqitjes së tokës, për shkak të lejeve që janë dhënë për gurthyesit në mënyrë të magjishme dhe nuk janë paraparë si objektiva, por si prioritete. Këtu është fjala për jetën e njerëzve, prandaj kjo ka qenë dashur të kihet parasysh, sepse këtu janë disa veta të cilët presin me ankth se kur shtëpitë e tyre do t'i përfshijë uji. Fjala është për fshatin Brod të komunës së Shtërpçës.

Gjithashtu, kishte sugjerime pse janë ndarë mjete më tepër për Ministrinë e Transportit. Me të vërtetë nga ajo që kemi paraparë dhe nga ajo që po shihet në praktikë, Ministria e Transportit është Ministri shumë e suksesshme. Ajo ka arritur të realizojë projekte në çdo pëllëmbë të Kosovës, ka arritur ta përmirësojë infrastrukturën rrugore dhe në ato vende ku nuk ka investuar kurrë. Nuk po flas për sistemin e kaluar, por për Qeverinë tonë aktuale që kemi pasur pas luftës. Prandaj, vetë fakti që Ministria e Transportit ka arritur të shpenzojë 70% të buxhetit brenda kësaj periudhe dhe ne jemi shumë të vetëdijshëm që ministritë tona asnjëherë nuk kanë arritur deri në përfundim të vitit fiskal të shpenzojnë buxhetin 80%, por muaji i fundit ka qenë muaji kur procedurat janë përsheptuar dhe mezi që kemi arritur 80%. Natyrisht, që kjo Ministri meriton që t'i ndahet buxhet më tepër, sepse ka treguar një menaxhim të suksesshëm dhe ju ka përmbajtur edhe procedurave të domosdoshme.

Dhe, krejt në fund, do të ishte me interes që edhe në këtë projektligj që është ofruar të mos përdoret fjala buxhet i konsoliduar. Nuk e di për çka, zoti ministër, po përdoret fjala konsolidim. Kjo ka pasur nevojë të përdoret në vitet e para në Qeverinë e parë, ndoshta, në themelimin të buxhetit dhe në kohën kur Kosova nuk ka mund të krijojë buxhetin vetë. Mirëpo, tani nuk ka nevojë krejt në brendi të dokumentacionit të përdoret fjala dhe IVQ edhe kjo nuk ka të bëjë me këtë kohë, sepse tanimë nuk kemi institucione të përkohshme të vetëqeverisjes dhe është mirë që së paku këto çështje teknike që nuk janë të rëndësishme, ndoshta, për procesin, por së paku të mos figurojnë fare në këtë dokument. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputet Hyseni.

Fjalën e ka deputetja Njomëza Emini. Le të përgatitet deputeti Ardian Gjini.

NJOMËZA EMINI: I nderuari kryesues,
I nderuar Kabinet qeveritar,
Kolegë deputetë,

Në këtë dokument që na është ofruar kemi shumë vërejtje, sepse ka shumë mangësi, por nuk do të ndalesha te të gjitha, sepse u thanë nga kolegët edhe nga ju që jeni prezent, por unë do të veçoja Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për të cilën nuk janë paraparë mjetet aq sa duhet. Dihet se çdoherë qeveritë paraprake janë krenuar me rininë tonë dhe kanë folur shumë dhe kanë dhënë shumë premtime, mirëpo pak është bërë, sepse deri më tash nuk ka pasur buxhet të mjaftueshëm, mirëpo kanë shpresuar që së paku nga kjo Qeveri do të ketë një buxhet më të madh për rininë dhe që të paktën këta të rinj që i kemi ne, që janë 2/3 e popullsisë, të mos sillen rrugëve, por të bëhet diçka për ta në bashkëpunimin edhe me organizatat rinore. Andaj, nuk do t'ju merrja edhe shumë kohë, sepse u thanë shumë gjëra që unë nuk dua t'i përsëris. Kërkoj nga Qeveria që të shpërndajë buxhet dhe të ketë më shumë sa i përket rinisë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ardian, replikë ? Urdhëro!
Ka replikë edhe pa e përmendur emrin.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, Kryetar!
Pasi që dy herë iu referuan fjalës sime dy diskutues, do të flas shkurt.

Çështja e parë është kështu: Kur them se dëmtohen njerëzit, i them deputetes Tahiri, edhe që paguhet dy herë, është shumë e qartë. Njerëzit nuk i paguajnë taksat që me taksa të tyre të paguhet rrymë, për shkak se dikush tjetër nuk e paguan rrymën, kjo është ajo çka po them unë. Zonjën Edita Tahiri nuk po e shoh, me siguri nuk është këtu. Ajo disponon me përgatitje shkollore, i njeh shifrat.

Çështja tjetër për të cilën u referua këtu është, nuk e di, është shumë interesante kjo punë. Janë bërë 7 muaj qysh se është formuar Qeveria edhe po me duket kjo qeveri do ta përfundojë mandatin duke u thirrur në gabimet e ish- Qeverisë, po mirë- në rregull është, bën edhe ashtu. Mirëpo, dikush po thotë që ju kanë tepruar parat, i kemi lënë 350 milion rezervë. Dikush tjetër po thotë, kemi mbetur borxh, e tregona tash çfarë borxhi kemi mbetur? Vendosi një herë, a kemi mbetur borxh, a kemi lënë para tepër? Unë po ju them që në arkë të shtetit të Kosovës kanë mbetur 350 milionë, nuk ka pasur borxhe.

Dhe, në fund të fundit, është lehtë të shpenzohen të hollat, nëse nuk mund t'i shpenzosh për çka ke paraparë fillimisht, i heq edhe i çon diku ku shpenzohen lehtë . Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Lus deputetët, kur ta kërkojnë fjalën, të flasin me mikrofoni!
Fjalën e ka deputetja Vlora Çitaku. Le të përgatitet Synavere Rysa.

VLORA ÇITAKU: Faleminderit shumë, zoti Kryetar!
Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë,

Së pari, nuk e kam pasur ndërmend të diskutoj sot, por u frymëzova shumë nga diskutimet e kolegëve të mi deputetë, posaçërisht të atyre që vijnë nga opozita dhe vendosa të flas, sepse këtu u hodh shumë hi syve. Unë e di që krejt çka kam për të thënë, ju e dini, por edhe ju e dini që ne e dimë që ju e dini, megjithatë do ta them.

E para, u tha këtu që kjo qeveri po investon vetëm në komunat në të cilat ka fituar PDK-ja. Po ndaluni edhe shikoni rezultatet e zgjedhjeve lokale. PDK-ja udhëheq në shumicën e komunave. Nëse ia shtojmë këtu edhe ato të partnerit tonë të koalicionit, mbesin veç tri komuna në të cilat udhëheq opozita që është në opozitë në nivelin qendror, e madje edhe në ato komuna Qeveria e Kosovës ka bërë investime më shumë se sa qeveritë paraprake. Janë 7 milionë euro të ndara për infrastrukturën rrugore dhe janë 2 milionë euro të ndara për infrastrukturën shkollore. Vetëm në qytetin e Pejës, ta zëmë, investohet në shkolla më shumë se sa në Skenderaj. Shihni për këtë numrat, shihni tabelën.

E dyta, u tha këtu që kjo qeveri nuk po i mbanë premtimet. Unë konsideroj që pikërisht investimet në infrastrukturën rrugore, në atë shkollore, investimi në arsim, shtoj këtu edhe 2 milionë euro të ndara për licencim, 800 mijë euro të ndara për kompjuterizimin e shkollave, janë përmbushje e drejtpërdrejtë e obligimeve që kemi marrë para qytetarëve të Kosovës.

Dikush tha këtu që kjo qeveri nuk po e zbut papunësinë, nuk po e bënë zhvillim ekonomik, po unë vetëm dua t'ua përkujtoj që më nuk kemi ekonomi të planifikuar, por kemi ekonomi të lirë edhe të tregut edhe krejt çka mund të bëjë Qeveria për zbutjen e papunësisë është krijimi i infrastrukturës, qoftë asaj rrugore, qoftë asaj energjetike dhe krijimi i lehtësirave për bizneset, gjë që shihet edhe me pakon e re fiskale të cilën Ministria e Ekonomisë dhe Financave e ka përgatitur.

U përmendën shumë këtu edhe termat e mallrave dhe të shërbimeve, pagat. E para, pagat nuk janë ngritur tek shërbyesit civilë, por ne vetëm kemi bërë ngritjen e kapaciteteve me ministritë e reja dhe kemi bërë sistemimin e atij personeli i cili ka ekzistuar në institucionet e Kosovës, posaçërisht në Ministrinë e Bujqësisë, ku shumica e personelit ka punuar me kontratë mbi veprën dhe nuk ka pasur asnjë lloj statusi në kuadër të Ministrisë.

Dikush tha këtu që kjo qeveri ka hequr dorë nga investimet nacionale me interes kombëtar, autostradat dhe po merret me rrugicat.

E para, edhe nëpër ato rrugica jetojnë qytetarët e Republikës së Kosovës dhe autostradat nuk na nevojiten asgjë nëse me to nuk i lidhim njerëzit.

E dyta, nga ato 47 milionë euro, vetëm 7 milionë kanë mbetur në atë fond, aq sa mund të shpenzohen për këtë vit, ndërkaq pjesa tjetër është rialokuar.

Dikush tjetër tha se shumë pak janë ndarë mjete për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe po të kishim pasur para më shumë, do të na kishin njohur më shumë shtete. Kjo është logjikë e gabuar. Unë besoj që ministri ka një plan të qartë edhe po ashtu mendoj që lobimi më i madh që mund ta bëjmë ne për Kosovën është t' i kryejmë punët tona këtu dhe nëse këtu punojmë mirë, edhe njohjet do të jenë më të shpejta edhe më kualitative.

Pajtohem që për KEK-un subvencionet janë pak si të tepërta, mirëpo duke pasur parasysh që kemi vetëm një zgjidhje ndërmjet territ edhe subvencioneve, unë jam për subvencionet. Po më duken pak këto kritika qesharake kur po vijnë nga ata që kanë vepruar shumë më keq kur kanë qenë në Qeveri edhe kjo po ma kujton atë proverbin popullor kur i verbëti kishte qenë duke hëngër darkë bashkë me një mik të tij edhe po i thotë: “Pse po hanë me dy lugë”, kurse ai thotë:” Po, ku po më sheh ti që po ha me dy lugë? – “Unë s'po të shoh, por ashtu kam pas bërë unë”. Unë po ju them juve kolegë të opozitës, që ne nuk do të bëjmë qysh keni bërë ju, por do të punojmë dhe do t' i realizojmë premtimet që i kemi dhënë para qytetarëve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Urdhëro Driton, replikë. Po hajt prej vendit bëje replikën, o Driton!

DRITON TALI: Është bërë në modë për të dalë këtu, për atë edhe dola.

Unë, atë që e thashë, u bazova në të hyrat tatimore, nuk u mora me rialokimet. Të hyrat tatimore të Kosovës apo të këtij buxhetit të rishikuar, në krahasim me atë të miratuar të Ligjit numër 03/L-088, i kemi kështu: 26.8 milionë më shumë, të paktën kështu na i keni paraqitur këto shifra, domethënë është paraparë që të jenë 862.1 milionë dhe është rritë në 888.9 milionë dhe nga këto i kemi 22 milionë dogana më shumë të ardhura, i kemi 8 milionë nga niveli komunal, do të thotë nga krejt ajo që është hyrë, i kemi 89.8 milionë duke marrë parasysh edhe 13 milionë të kursyera nga kostoja pas statusit dhe nga këto

merrni llogaritni, shumë mirë del se ngritjet për paga dhe mëditje janë 7.2 milionë më shumë dhe për mallra dhe shërbime 12.6 milionë. Nuk na keni shpjeguar se çka keni llogaritur në mallra dhe shpenzime. Unë po flas për atë çka na keni dhënë. Pra, nga kjo del se shpenzimet në paga dhe mëditje dhe në mallra dhe shërbime janë 50% të këtyre parave ekstra që na kanë ardhur, apo që i kanë ardhur Qeverisë dhe 46.9 i keni ...

KRYETARI: Faleminderit, Driton, edhe pse nuk ishte replikë! Fjalën e ka deputetja Synavere Rysha, le të përgatitet Nait Hasani. Deputete, e keni fjalën!

SYNAVERE RYSHA: Faleminderit, kryetar!

Edhe pse u fol dhe u tha mjaft për buxhetin, megjithatë unë do t'i them disa fjalë shkurtimisht dhe do të mundohem ta bëjë një analizë të shkurtër të këtij materiali i cili na është afuar nga ana e Qeverisë.

Një lëvizje kaq e madhe e mjeteve të buxhetit nga pozicioni në një pozicion tjetër dhe madje largimi i projekteve kapitale me vlerë diku rreth 50 milionë euro nga projektet e Qeverisë dhe shtyrja për afate të tjera për vite të tjera, na bën për të kuptuar se Qeveria nuk është e gatshme për të hyrë në investime afatgjata dhe në investime të mëdha, por momentalisht punon në projekte të shkurta dhe në projekte që më lehtë e ka për t'i realizuar deri në fund të vitit.

Nga ky material që na është ofruar, i gjithë buxheti është paraqitur në mënyrë tabelare dhe nuk ka sqarime të mjaftueshme dhe të nevojshme. Sidoqoftë, nga një analizë e shkurtër shihet se edhe për vitin 2008 buxheti i Kosovës do të ketë suficit dhe atë, ndoshta, edhe më të lartë se vitin e kaluar.

Unë do të bëj përpjekje të paraqes disa pozicione në buxhet që janë paraparë dhe nuk di se si do të shpenzohen ato mjete.

Agjencia Kosovare e Privatizimit, nuk paraqitet numri i të punësuarve, ndahen mjete rreth 2800 euro për paga dhe mëditje, nuk dihet sa ka të punësuar, diku rreth 2 milion e 39 mijë euro për mallra dhe shërbime dhe i gjithë buxheti është diku rreth 5 milionë euro. Prandaj, për derisa nuk kemi staf dhe nuk kemi të punësuar në këtë agjencion, kush do t'i shpenzojë këto mjete dhe si do të menaxhohen ato, nga kush do të menaxhohen? Kjo të bën të kuptosh se këtu kemi të bëjmë automatikisht me mjete që do të shkojnë në suficit, përdërisa kemi para vetes edhe 4 muaj, sepse muaji gusht është muaji i pushimeve dhe s'e di sa do të jetë në gjendje Qeveria t'i shpenzojë këto mjete për derisa nuk ka staf dhe nuk ka njerëz që do t'i menaxhojnë këto mjete.

Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit, edhe këtu nuk paraqitet numri i të punësuarve, por me gjithë atë kemi paga dhe mëditje diku 222 mijë e 279 euro. Gjithashtu, edhe tek Zyra e Rregullatorit të Energjisë nuk e kemi numrin e stafit, mirëpo kemi pozicionin për paga dhe mëditje mbi 400 mijë euro. Prandaj, është pyetje për Qeverinë dhe ministrat se kush do t'i menaxhojë dhe kush është duke i menaxhuar këto mjete, pse nuk jepet numri i stafit apo edhe ndoshta nuk dëshirohet të dihet se sa janë pagat e këtyre zyrtarëve në këto agjenci ?

Ndërmarrjet publike po trajtohen në mënyra të ndryshme dhe këndvështrime të ndryshme. Subvencioni apo përkrahja ndaj KEK-ut, është një vlerë e madhe, mirëpo nuk po veprohet njësoj me operatorët e tjerë që janë në Kosovë apo ndërmarrjet tjera publike, siç janë PTK-ja dhe Aeroporti i Prishtinës. këto dy kompani të cilat janë profitabile dhe

kanë profit të lartë, nuk janë në gjendje të deponojnë dhe Qeveria nuk është e gatshme të bashkëpunojë dhe pjesën e mbetur apo tepricën ta kthejë në buxhetin e vet, mirëpo kur është problemi me KEK-un, domethënë e subvencionon dhe e përkrah me forma të ndryshme apo edhe me forma të kredive. Ndoshta, kjo do të jetë edhe forma e fundit apo avansi i fundit që do t'i jepet KEK-u dhe KEK-u do të mbijetojë vetë.

Edhe më tutje shumë pak po bëhet për pjesën më vitale të shoqërisë, për rininë, sepse edhe në këtë projektbuxhet që është paraparë me rishikim, rinia pothuajse më së paku është përkrahur, apo të mos themi fare.

Arsimit shumë i është premtuar dhe për të është folur mjaft, por arsimtarët dhe punonjësit e arsimit edhe në këtë rast nuk kanë përkrahje edhe nuk ka asgjë konkrete për këta punonjës.

Hekurudhat e Kosovës kanë një buxhet që janë diku 2 milionë e 600 mijë euro. Nuk na përshkruhet në këtë projekt se si do të shpenzohen. Mirëpo, vetëm do t'ju them një fakt, me qenë se ministri nuk është këtu, në komunën e Ferizajt kemi një problem që vazhdimisht kemi humbje të jetës së qytetarëve nga pamundësia e ndërtimit të kalimeve të ndryshme, mbikalimeve apo nënkalimeve, mirëpo në këtë rast nuk është paraparë asgjë. Ndoshta, do të ishte mirë në këtë kohë të rishikimit të buxhetit të mendohet diçka për mbikalime apo nënkalime në komunën e Ferizajt.

Diku rreth 3 milionë euro ndahen si promovim për Kosovën. Cili është ky pozicion, apo ndoshta është forma më e mirë dhe më e lehtë për të menaxhuar qysh donë ministrat, apo edhe nuk di si do të shpenzohen këto mjete, sepse janë mjete të promovimit për Kosovën, mirëpo nuk kemi projekt konkret dhe nuk di se Qeveria a ka ndonjë program të veçantë se si do t'i shpenzojë këto mjete? Prandaj, edhe kjo do të jetë pjesë e suficitit, me gjasë, ose mbulesë e shpenzimeve të padestinuara.

Mjetet për Ministrinë e Punëve të Brendshme ose janë shumë të vogla ose janë shumë të mëdha, sepse 1 milion e 200 mijë euro janë shumë pak, ose janë shumë. Nëse mendohet në hapjen e ambasadave me 1 milion e 200 mijë euro, atëherë është shumë pak, por nëse është menduar vetëm për stafin, atëherë nuk e di sa është kompletuar kjo ministri dhe sa janë të arsyeshme këto mjete. Sido që të jetë, këtë e dinë më mirë qeveritarët.

Ndërtimi i rrugëve nga Ministria e Transportit e që, si duket, më së shumti po punon apo është më e famshme, diku rreth 70% e shpenzimeve të këtyre mjeteve hiqet dorë nga investimet kapitale dhe shkohet në ndërtimin e rrugëve apo, siç do t'i quaja rrugica. Nuk e di sa është e arsyeshme të hiqet një projekt kapital dhe të futen projekte të vogla, por megjithatë edhe këto janë pjesë e Qeverisë që, në fund të vitit, do të kemi mundësi t'i shqyrtojmë edhe njëherë në raportin vjetor.

Rritja e numrit të stafit të punëtorëve u arsyetua edhe nga kryetari i Komisionit, por edhe nga një deputet. Me të vërtetë mua po më duket shumë e paarsyeshme dhe jashtë logjikës nëse arsyetohet se gjatë dy vjetëve të fundit kemi zvogëlim të stafit, domethënë në vitet 2006 dhe 2007, me kërkesë dhe me rekomandim të Fondit Monetar Ndërkombëtar kërkohet të zvogëlohet numri i të punësuarve. Përkundrazi, sivjet kemi rritje të numrit në 500 punëtorë apo në 500 të punësuar. Dhe, nëse arsyetohet kjo nga kontrata mbi veprën nëse kanë vepruar ata dhe tash pas 6 muajsh kur dihet fakti se si punohet me kontrata në vepër, ajo bëhet vetëm për 3 muaj, ripërtërihet edhe për 3 muaj, 6 muaj dhe mandej nuk ka vende të punës për ata punëtorë. Mirëpo, si po i arsyeton kryetari i Komisionit dhe

deputetët këto, kontrata mbi veprën për mua është shumë e papranueshme dhe shumë e pajustificueshme, prandaj edhe nuk është mirë të arsyetohet në këtë formë.

Nga ky rishikim që na është afuar shihet qartë se edhe këtë vit Qeveria nuk është e gatshme t'i menaxhojë drejt mjetet e veta, nuk do të ketë mundësi t'i shfrytëzojë të gjitha mjetet e veta, por sido që të jetë, le të veprojë sepse do të vijë fundi i vitit dhe do ta kemi raportin final dhe të shohim më tutje si do të shpenzohen këto mjete. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Gani Koci, për replikë!

GANI KOCI: A të dal atje?

KRYETARI: Prej vendit, Gani!

GANI KOCI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Në të vërtetë, edhe unë pajtohem se nuk është dashur të mbahen ata punëtorë me kontrata në vepër dhe ky është një defekt, një gabim i Qeverisë dhe mirë që e përmirëson tash në këtë rishikim të buxhetit. Prandaj, pikërisht për këtë duhet të miratohet ky rishikim i buxhetit, ndërsa sa i përket disa të tjerave se nuk u përmend ku kanë shkuar ato mallra dhe shërbime, kush e ka dëgjuar ministrin në fillim e ka përmendur me shifra se 7 milionë janë për barëra atje, e pastaj prodhimi i dokumenteve zyrtarë që do të vijë tash dhe ky 7 milionëshi tjetër i rritjes të pagave dhe mëditjeve në linjën është pikërisht që të vihen në baza ligjore trajtimi i atyre punëtorëve që janë punëtorë të agjencioneve buxhetore dhe që nuk janë trajtuar si shërbyes civilë. Këtë është dashur ta thotë ministri këtu, por besoj që e ka lënë për fund, por e ka thënë vetëm i kishte ta përsërisë, prandaj është mirë të dëgjojmë vërtet çka thuhet dhe si thuhet, në mënyrë që të mos i përsërisim gjërat. Do të thotë, rritjet janë dhe janë definuar qartë edhe në raportin që e keni atje, edhe në Projektligjin për rishikimin e buxhetit.

Unë si anëtar i Komisionit nuk kam thënë asgjë më shumë se sa shkruhet në dokumentin të cilën e kemi përpara që po e shqyrtojmë. Vetëm ta lexojmë si duhet dhe mos ta lexojmë arabisht.

KRYETARI: Faleminderit!

Kërkoj nga diskutuesit që, mundësisht, të jenë më racional e të mos përsërisin vetveten dhe njëri-tjetrin, se kemi vazhdimisht nxitje nga diskutimet.

Fjalën e ka deputeti Nait Hasani. Pasi Sllavisha Petković nuk është këtu, le të përgatitet deputeti Ibrahim Makolli.

NAIT HASANI: Faleminderit, Kryetar!

Përsëendetje ministra,

Sot, pasi po diskutojmë për këtë projektligjin, ka 2 muaj që kam thënë që Kosova është shndërruar në një punishte ndërtimi. Mund të them që si subjekt politik në fushatën zgjedhore kemi premtuar që do të realizojmë objektivat tona politike dhe programore, të cilat janë inkorporuar në programin e Qeverisë, ndër to janë: arsimi, shëndetësia, bujqësia, pensionet, plus duhet rregulluar rrugët për qytetarët.

Kur është fjala për transportin ose për rrugët, shumë këtu te ne po përmenden rrugicat. Mund të them që për dikë janë edhe rrugica, për dikë sokaqe e ku ta di unë, megjithatë

në Kosovë po punohet në ndërtimin e tyre. Këto punishte shtrihen prej Podujevës deri në Vërmicë, prej Dragashit deri në Mitrovicë, prej Pejës deri në Gjilan, pra anë e mbanë Kosovës. Premtimi ynë kryesor gjatë fushatës ka qenë autostrada Vërmicë – Merdare. U tha shumë këtu që i keni tërhequr paratë, i keni shtuar parat, po mungoni, nuk po i jepni etj. Premtimi ynë ka qenë edhe në Programin e Qeverisë është që në shtator do të fillojë ndërtimi i autostradës. Kemi edhe ky muaj afat për ta parë në vepër që edhe kjo vepër madhore do të realizohet. Ndoshta, për këtë ka nevojë më shumë buxhet, por unë kam menduar që bëhet fjalë për diku 200 – 300 milion buxhet që do të shtohet, po edhe për 18.2 milionë buxhet për këtë kohë sipas rivlerësimit, mendoj që nuk është dashur, ndoshta, të diskutohet aq shumë. Duhet të shtohet që nëse kemi një shëndetësi edhe një shëndet të mirë të qytetarëve, do të kemi edhe një arsim dhe edukim të tillë. Pra, duhet të kujdesemi për të gjitha shtresat e shoqërisë të cilat i kemi dhe i kemi trashëguar, siç janë pensionistët. Pra, edhe për ta duhet ta kemi një kujdes, sepse ata janë prindërit tanë, për prindërit tanë duhet të kem kujdes se edhe ne jemi prindër edhe do të bëhemi edhe ne pensionistë dikur.

E meta më e madhe e gjithë shoqërisë ka qenë dhe tani mendoj që duhet të përmirësohet – bujqësia, sepse Kosova është një vend bujqësor, të ardhurat e bujqve edhe të një shtresë shumë të madhe pikërisht janë nga bujqësia. Ne kemi lejuar që në Kosovë të hyjnë mallra pa doganë ose në bazë të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të hynë nga vendet e ndryshme të cilat prodhimet tona bujqësore i dëmtojnë rëndë, kështu që kemi pasur nevojë që ta themelojmë një doganë të caktuar afatizuese 2 – 3 muajshe që bujqve tanë t’ju ndihmojmë në këtë drejtim.

Prandaj, mendoj që Kosova, me ndërtimin e autostradës, me përmirësimin e shëndetit të qytetarëve, me edukimin apo arsimin e qytetarëve, me ndihmën për bujqit, do të jetë më e përparuar se sa ka qenë. Dikush thotë që para 10 vjetëve ka qenë ndryshe, por edhe para një viti ka qenë ndryshe. Ekonomistët para 3 – 4 vjetëve kanë thënë që kur na kanë tepëruar paratë, e kanë quajtur sukses. Disa ekonomistë herën tjetër thanë që kur na kanë tepëruar paratë, është dështim. Unë mendoj që kur tepërojnë paratë, është dështimi i Qeverisë, pikërisht, sepse nuk ka projekte. E miraton një buxhet të caktuar dhe atë buxhet nuk mund ta realizojë. Në momentin që nuk mund ta realizojë buxhetin ose nuk ka projekte, ose nuk ka vizion, atëherë kjo Qeveri e përcakton edhe dështimin e saj. Kur ne sot kërkojmë shtimin e buxhetit, ne shohim se Qeveria ka një vizion për të ardhmen, ka një mundësi zhvillimi dhe ka arsytet, ka limit ku të përcaktojë këtë buxhet. Prandaj, mendoj që nuk jam partizan politik, por i shoh se këtu ka mjaftë partizanë të cilët luftojnë për partizanllëk. Po më vjen keq që nuk po mund të bëhem komandat, megjithatë uroj që Qeveria të ecën përpara dhe ta shohim që në fund të vitit do ta vlerësojë këtë që e thamë sot. Pra, Kosova është punishte që në fund të vitit do ta shohim si kantier të ndërtimit që e ka bërë Qeveria. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka Ibrahim Makolli, le të përgatitet Qamile Morina.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Po më vjen shumë mirë që po e pranoni më në fund se opozita po ju inspiron, sepse deri tash është thënë që opozita është shumë neglizhente. Është mirë që sot e pranuat që po ju inspirojnë.

Unë, të nderuar kolegë, do të përqendrohesh vetëm në një çështje, sepse kjo më së miri e dëshmon thënien që “Ai që e ka barkun plot, nuk do të ndijë për atë që e ka zbraztë”.

Është shumë e vërtetë që shumica e të punësuarve në sektorin publik kanë pritur me padurim rishqyrtimin e buxhetit të këtij viti, me shpresë se do të ketë rritje të pagave të tyre që ka qenë edhe një premtim i koalicionit të tashëm qeveritar gjatë fushatës zgjedhore, por për fat të keq, nuk shihet që ka pasur ndonjë lëvizje. Gjithë ne po themi se, dhe në veçanti pozita lufton kundër korrupsionit, por nuk di deri kur do të ketë mundësi të luftohet korrupsioni me këtë nivel të pagave. A kemi të drejtë morale që të kërkojmë nga ana e policëve të Kosovës, nga ana e drejtësisë, nga ana e shëndetësisë, punëtorëve të shëndetësisë e të arsimit veprim më të madh me këtë nivel të pagave që është sot? Kujtoj që edhe ato ankesat e vazhdueshme dhe të policisë kohëve të fundit, por edhe të tjerëve, për nivelin e ulët të pagave dhe kërkesat e tyre për rritje të pagave ose në të kundërtën do të ketë protesta, më së miri flet që kjo Qeveri nuk ka pasur qasje të drejtë ndaj kësaj problematike që, ndoshta, do të duhej të shikohej kjo mundësi.

Së dyti, ky koalicion qeveritar para disa muajsh, kjo Qeveri para disa muajsh ka qitur ose ka theksuar se do të qesë në tender shitjen e rreth 400 automjeteve tepriçë që i kanë institucionet e Kosovës, ndërkaq tashmë po e shohim që këtu kemi rreth 1 milion ose mbi 1 milion euro që janë të dedikuara për blerjen e automjeteve të reja. Pra, si duket, zyrtarët tanë nuk do të mund të vozisin automjetet të cilat i kanë kaluar një vjet të përdorimit.

Dhe së treti, kemi shpenzime të disa të ashtuquajtura agjencione, sikurse që është Zyra e Rregullatorit për Energji, që ne për fat të mirë e kemi edhe raportin e tyre që do të analizohet sot, raportin vjetor që është në disproporcion shumë të madh shuma që ata harxhojnë për një vit me aktivitetin që e kanë. Këto janë disa nga vërejtjet e mia. Nuk do t'i përsëris ato të cilat u thanë deri më tash, por megjithatë shihet që nuk ka pasur një seriozitet dhe qasje të drejtë ndaj rishikimit të buxhetit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Fjalën e ka deputetja Qamile Morina. Le të përgatitet Safete Hadergjona.

QAMILE MORINA: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Sot janë bërë mjaftë vërejtje të përgjithshme lidhur me Projektbuxhetin e propozuar. Unë do të përqendrohem në buxhetin e paraparë për sektorin e shëndetësisë.

Ngritja e buxhetit për sektorin e shëndetësisë besoj se ka për qëllim të mundësojë zbatimin e projekteve të propozuara nga Ministria e Shëndetësisë. Vërejtjet e mia janë lidhur me paqartësitë, lidhur me këto projekte, duke pasur parasysh se këto projekte nuk janë të bazuara në prioritetet karshi gjendjes shumë të rëndë në sistemin shëndetësor.

Paqartësitë që ekzistojnë lidhur me këto projekte janë këto: Projekti për renovimin e kulmit të Klinikës Infektive, ky është një projekt që zgjat me vite dhe ka fituar statusin e një mega-projekti si dhe Kardiokirurgjia, Radioterapia dhe Onkologjia. Këto projekte nuk kanë qartësi në afate kohore kur do të mbarojnë dhe me vite të tëra i kemi në këto projektbuxhete me fazat e tyre.

Projekti i dytë është rindërtimi i kulmit të Klinikës së Gjinekologjisë që realisht ka qenë donacion i Karitasit. Në këtë tabelë këtu nuk figurojnë pagesat që janë bërë nga buxheti i QKUK-së në vitin 2008, - 85 mijë euro për këtë projekt.

Projekti tjetër është ndërrimi i dritareve të vertikales së ORL-së. Ky në fakt asnjëherë nuk ka ekzistuar si projekt, por mjetet që janë ndarë për projektin shumë të diskutueshëm përpara ka qenë për projektin e zgjerimit dhe renovimit të Mjekimit Qendror Intensiv. Këto mjete janë shfrytëzuar për ndërrimin e dritareve të vertikales, që ka qenë në kundërshtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe fare nuk duhet të figurojë në këtë radhë të projekteve për vitin 2008.

Është shumë e paqartë çka nënkupton projekti - Intervenime emergjente në radiologji, për të cilin ndahen 5 milionë e 343 mijë euro. Është e papranueshme gjithashtu që janë larguar nga lista e projekteve që është projekti me prioritet shumë të lartë, gazi qendror, për të cilën janë paguar deri tani 65 mijë euro dhe tri vite me radhë ka qenë në listën e prioriteteve. Unë nuk e di si mendohet të ngritët cilësia e kujdesit shëndetësor pa u realizuar ky projekt në klinikat tona.

Me këtë projektbuxhetit të rritur për sektorin shëndetësor fare nuk parashihet ngritja e pagave të mjerueshme të punëtorëve shëndetësorë, si dhe nuk parashihet pranimi i kuadrove të reja që ka ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e punës në sektorin e shëndetësorë. Brenga natyrisht më e madhe mbetet që Qeveria e Kosovës nuk duket që i ka pranuar sigurimet shëndetësore si domosdoshmëri akute në Kosovë me arsyetimin se tregu i dobët i punës do të mbingarkohet dhe do ta dobësojë ekonominë. Mirëpo, bazuar në përvojat e shumë vendeve në zhvillim dhe hulumtimet shkencore që janë duke u bërë në 10 vitet, e fundit e vërteta është krejt ndryshe. Sigurimet shëndetësore i mbrojnë qytetarët, pacientët, mjekët dhe të paktën do të parandalonin varfërimin ekstrem të së paku 1000 familjeve në vit në Kosovë si dhe buxhetit të Kosovës si pasojë e shpenzimeve katastrofike për shërim jashtë vendi.

Në fund, mund të konkludoj se mungesa e një vizioni të qartë, mungesa e një plani serioz financiar të bazuar në prioritete, duke pasur parasysh gjendjen shumë të rëndë të sistemit shëndetësor edhe për kundër ngritjes së buxhetit, është dekurajuese që do të kemi avancim të sistemit shëndetësor. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete!

Driton, një votë e ke, edhe 10 herë po që se ta jap fjalën, asgjë nuk ndryshon. Faleminderit shumë!

Ramadan Avdiu e ka fjalën, le të përgatitet Bajram Kosumi.

RAMADAN AVDIU: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Të nderuar ministra,

Të respektuar kolegë deputetë,

E dhëna se Kosova do të anëtarësohet së shpejti në institucionet financiare ndërkombëtare është një e dhënë shumë e mirë dhe unë atë e shoh si rezultat i performancës shumë të mirë dhe nikoqirllëkut të mirë të Qeverisë në menaxhimin e buxhetit. Unë do të përpiqem në maksimum që të mos i përsëris atë debatin dhe të dhënat, fjalët e kolegëve deputetë të mëhershëm, por ajo që është shumë inkurajuese për vendin tonë, është se gjatë kësaj periudhe të qeverisjes së koalicionit të PDK-së dhe të LDK-së, shihet se ka trende

pozitive, ka ngritje në buxhet dhe ulje të shpenzimeve. Kjo është një e dhënë shumë inkurajuese.

E dyta, ajo çka Qeveria tregon një profesionalizëm të shkallës së lartë, ashtu siç e tregoi edhe në Konferencën e Donatorëve, është se i ka shqyrtuar të gjitha kërkesat gjatë periudhës së rishikimit të buxhetit dhe brenda mundësive të saj të gjithave u është përgjigjur pozitivisht dhe, mbi të gjitha, është e rëndësishme sepse i ka kushtuar një rëndësi hierarkisë së prioritetëve. Do të thotë, i është kushtuar rëndësi më të madhe asaj çka ka nevojë, pra infrastrukturës, Ministria e Transportit është ndihmua më së shumti të them kushtimisht, pastaj kalohet në shëndetësi, në arsim, në kulturë, që është shumë inkurajuese edhe kjo që kultura gradualisht po zhvendoset nga një stigmatizim i vazhdueshëm në të cilin ka qenë dhe gradualisht po e merr vendin që duhet ta ketë.

Unë vetëm për të mos e zgjatur shumë, dua ta sforcojë heqjen e një dileme që nga disa kolegë deputetë u potencua disa herë se Qeveria ka hequr dorë nga prioritetet ose nga projektet kapitale për të futur në mini projekte. Shkoni, të nderuar deputetë, dhe pyetni qytetarët që jetojnë nëpër rrugica çka do të thotë për ta ndërtimi, asfaltimi i rrugës dhe rregullimi i kanalizimit. Këtu janë zhvendosur 42 milionë, të cilat kanë qenë në Stendbaj, të cilat kanë qenë duke pritur dhe do të kishin shkuar suficit, sepse 49 milionë nga buxheti janë paraparë në fillim të vitit për kompensimin dhe për procedurat e eksproprijimit të tokave. Tash ne mund të operojmë edhe me 7 milionë të cilët kanë ngelur në atë fond. Ai është fond i mjaftueshëm për të operuar në këtë vit, kurse 42 milionë në vend se të shkojnë në suficit, do të mund t'ua shpërndajmë ministrive të tjera të cilat do t'i realizojnë këto projekte të vogla, që dikush me cinizëm po thotë “rrugica”, por që janë shumë të rëndësishme, sepse të gjithë jemi zotuar se gjatë mandatit tonë ne do të punojmë me përkushtim të madh për ta përmirësuar kualitetin e jetës së qytetarit dhe kjo është që t'i përmirësohet kualiteti i jetës edhe të riut, edhe fëmijës, edhe plakut.

Dhe 1/3, çka është e rëndësishme që po e vërej sot tek Qeveria, nuk ka qasje në një zhvillim asimetrik, gjë që disa deputetë e kërkojnë këtu. Domethënë, të gjitha komunat janë përfituese të riallokimit të mjeteve, të gjitha organizatat tjera buxhetore janë përfituese, mirëpo është shumë mirë dhe e inkurajoj Qeverinë që të vazhdojë me këtë trend që ta bëjë hierarkinë e prioritetëve. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka Bajram Kosumi, le të përgatitet Hydajet Hyseni - Kaloshi.

BAJRAM KOSUMI: Faleminderit, i nderuari Kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Fillimisht do të konstatoj edhe njëherë se ne po e bëjmë rishqyrtimin e buxhetit për këtë vit pa e parë raportin për shpenzime 6 mujore, gjë që është një mungesë e madhe dhe, të them kushtimisht, një mbështetje për muri e deputetëve të Kuvendit, sepse nuk mund të japim votën “për” ose “kundër” pa i pasur pasqyrat e shpenzimeve të 6 mujorit të parë. Por, me qenë se tash veç është debati për këtë rishikim, le të mbetet përgjegjësi e Qeverisë në këtë çështje.

Diskutimin tim do ta përqendroj në dy çështje të tjera që janë thelbësore, kapitale dhe kanë të bëjnë me konceptin e menaxhimit me parane publike, me buxhetin e Kosovës.

Çështja e parë lidhet me atë që u fol shumë deri tash, me 50 milionët e autostradës. Dhe të them fillimisht se nuk është kjo një çështje thjeshtë teknike, por nga ajo që dëgjuam prej ministrit të Financave, është një çështje që ka të bëjë me konceptin e politikave buxhetore.

Ministri i Financave tha, e u përsërit disa herë edhe prej kolegëve deputetë këtu, se këto para kanë qenë të alokuara për autostradën, por me qenë se procedurat kanë ngecur diku se nuk kanë mund të shkojnë me dinamikën e duhur, që të mos mbeten këto para në suficit, janë tërhequr, duan të tërhiqen dhe të qiten në projekte tjera minore, gjithsesi më të vogla, do të thotë, në daç quani me ironi, në daç pa ironi, por projekte shumë të vogla në krahasim me projektin e autostradës.

Më lejoni këtu tash këtë çështje ta diskutojmë dhe të them se në kohën kur qeveria është përcaktuar që autostrada Merdare – Prizren është prioritet për Qeverinë dhe për Kuvendin e Kosovës, besoj për të gjitha partitë politike, nuk e ka pasur gabim, ky është një projekt parësor. Por, tash, tërheqja e parave prej një projekti parësor dhe gjuajtja e parave të buxhetit në projektet që nuk kanë qenë të parapara si prioritete, do të thotë këtu është problemi themelor në këtë çështje.

Pyetja që është shtruar para Qeverisë, e që shtrohet tash edhe para Kuvendit është kjo: A është më mirë 50 milionë që nuk mund të shpenzohen me dinamikën e paraparë në këtë vit, të ruhen në suficit për vitin e ardhshëm ose të mos mbetet në suficit për shkak të presionit të madh publik që është bërë vite të tëra se qeveritë s'po i shfrytëzojnë paratë si duhet, e tjera, e tjera, ato 50 milionë të gjuhen në projekte të cilat janë të rëndësishme, askush nuk po thotë që nuk janë të rëndësishme, por janë të dorës së dytë dhe dorës së tretë. Qeveria deri sa ka ardhur me këtë propozim kështu, ka vendosur, do të thotë, që këto 50 milionë t'i bartë në projekte, po i quaj, kushtimisht, minore, në krahasim me autostradën, minore. Është e rëndësishme edhe 1 metër asfalt që shtrohet në Kosovë. Ne jemi të gjithë qytetarë të Kosovës, ne nuk jetojmë ndryshe nga qytetarët e tjerë. Edhe ne jetojmë në këto rrugica me baltë, edhe ne e dimë që është i rëndësishëm asfaltimi i rrugëve tona, por në krahasim me autostradën e cila ka qenë prioritet për Qeverinë, bartja e këtyre parave në çfarëdo projekti dytësor ose dorës së tretë me të vërtetë tregon një vendim të gabuar të Qeverisë për harxhimin e ... të parave publike.

Kuvendi i Kosovës duhet ta thotë fjalën e vet për këtë çështje. Nëse Qeveria ka marrë një vendim të tillë të ngutshëm, nuk është fjala më këtu për deputetë të pozitës dhe të opozitës, por është fjala për përdorimin e 50 milionë eurove. Kuvendi i Kosovës nuk do ta lejojë Qeverinë që këto 50 milionë euro t'i orientojë në projekte të dorës së dytë, ad-hoc, aty për aty të menduar dhe të cilat nuk janë të kategorizuar si prioritete as për Qeverinë, as për Kuvendin dhe për të tjerët. Dhe kjo çështje esencialisht e kthen problemin të konceptit i hartimit dhe i menaxhimit të buxhetit të Kosovës nga një koncept investues, që ka qenë në fillim të vitit kur është miratuar buxheti i Kosovës, Qeveria ka ardhur të një buxhet konsumues, do të thotë të konceptit vetëm sa për të konsumuar, sa për të harxhuar që të mos mbetet asgjë në suficit. Është gabim që nën presionin e politikave, do të thotë, të ditës, të harxhohen 50 milionë euro në projektet e dorës së dytë dhe të tretë. Është më mirë ato para të kalojnë në suficit dhe të orientohen për autostradë në vitin 2009, se sa të themi, po, i kemi harxhuar në këtë vit, por i kemi harxhuar në projekte të kota e tjera.

Çështja e dytë ka të bëjë përsëri me konceptin e investimeve nga ajo që shihet në këtë rishikim. Pjesa më e madhe e atyre që quhen investime kapitale janë orientuar, të them

tash figurativisht, aty që quhet kapital i vdekur, do të thotë pjesa më e madhe është tulla, zall, asfalt e tjera, e tjera. Nuk është keq, do të thotë, në parim, Kosova ka nevojë për rrugë, Kosova ka nevojë për objekte qeveritare, Kosova ka nevojë për shkolla, për të gjitha këto ka nevojë Kosova dhe duhet të investohet në këto, por orientimi i pjesës më të madhe të investimeve kapitale në këto çështje do të thotë tregon se koncepti nuk është i menduar mirë deri në fund. Duhet të investohen në këto, por duhet një pjesë e këtyre investimeve të orientohet tek ai që quhet investim që e gjeneron kapitalin, duke përfshirë edhe resurset njerëzore.

Në fund të fundit, për këtë periudhë të ndjeshme historike në të cilën po kalojmë, pas 5 vjetëve ose në fund të mandatit qeverisës askush nuk e pyet Qeverinë a i ke kursyer 500 mijë euro apo si ke kursye 500 mijë euro, por e pyet çka ke bërë që të njihet Kosova shtet, që ne të ecim më shpejtë rrugën e tranzicionit drejt pranimi të Kosovës si shtet në OKB. Askush nuk të pyet a i ke hëngër 3 dreka më shumë apo më pak, por pyet nëse 50 milionë eurot po shkojnë në suficit dhe që të mos shkojnë në suficit po i orienton në projekte të dorës së dytë, pse s'po i jep në bujqësi, për shembull, pse këto 50 milionë euro të cilat nuk po dimë ku t'i çojmë, nuk i kemi çuar në subvencionime të bujqësisë, do të thotë në kapital që gjeneron kapitalin, në investime që gjenerojnë kapitalin, gjenerojnë të ardhura, krijojnë vende të reja të punës e tjera, e tjera. Domethënë, është pyetja e konceptimit a duhet të gjitha këto investime të orientohen në ato projekte që mund të krijojnë një marketing politik, apo duhet të shikojmë të orientohen në ato fusha ku me të vërtetë gjenerojnë vende të punës, gjenerojnë rritje të kapitalit, e jo vetëm kapital të vdekur. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Një replikë, zëvendëskryeministër, ose ndonjë sqarim.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Jo nuk kam ndërmend të bëj replikë, por mendoj që ka nevojë për një sqarim se u përmend disa herë.

Nuk është fjala që janë marrë mjetet nga autostrada dhe besoj që është mirë ta lexojmë mirë projektin, është fjala që ato mjete kanë qenë pjesë e kompensimit të pronave për pronarët të cilët duhet të bëjmë ekspropriimin. Këtë vit kemi menduar që 7 milionë prej Vërmice deri në Prizren mjaftojnë. Edhe ashtu kushtet fizike dhe atmosferike nuk lejojnë që të punohet më shumë. Nuk është ndalë autostrada, do të punohen dhe ato mjete kanë qenë vetëm ajo pjesë.

E dyta, që është mirë të përmendet, ndoshta, u theksua edhe në disa raste. Te Zyra e Kryeministrit, aty hynë edhe dy zëvendëskryeministra edhe këshilltarët e tyre, do me thanë është mirë që t'i keni sqarimet në tërësi sa herë që flisni.

Dhe e treta, çka është shumë me rëndësi, sa herë që po përmendet, ndoshta është mirë që të përmendet edhe me shifra edhe në forma të tjera. Ne jemi shumë fleksibil në diskutime që i bën Kuvendi. Ne do t'i pranojmë ndryshimet dhe sugjerimet që do t'i bëjnë grupet parlamentare, deputetët dhe Komisioni për Buxhet. Është një propozim që duhet ta diskutojmë, por jo mbi bazën e paragjykimeve, por mbi bazën e esencës çfarë ekziston edhe në projektbuxhet. Ajo çka po bëhet me investime, nuk kemi hequr dorë nga asnjë projekt, por kemi menduar që suficiti është një keqmenaxhim. Që në fillim i kemi thënë vetes, nëse dalim në suficit më shumë se parametrat e lejuara, do ta konsiderojmë keqmenaxhim. Ato 50 milionë kanë mbetur me vite, pse të besin edhe vitin tjetër. Ne do

t'i vazhdojmë projektet, unë mendoj me ndihmën dhe përkrahjen edhe të Kuvendit dhe të qytetarëve.

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka Hydajet Hyseni – Kaloshi, le të përgatitet Gani Geci.

Fjalën ia kaloni Bajram Kosumit, për replikë.

BAJRAM KOSUMI: Me qenë se u lidh zëvendëskryeministri edhe në diskutimin tim, dëshiroj për sqarim të theksoj këtë: 50 milionë kanë qenë të paraparë për projektin e autostradës, tash po kërkohet të tërhiqen prej atij projekti dhe të çohen në projekte që nuk kanë qenë të cilësuar si prioritete. Pyetja është për të gjithë, për Qeverinë dhe për Kuvendin: A është më mirë të pranohet suficiti, apo të harxhohet kot 50 milion, nën një.

Nën dy, nëse përcaktoheni për t'i harxhuar 50 milionë, pse s'po ia jepni bujqësisë? Jepni subvencionime bujqësisë, mos i çoni të gjitha në zallë, 50 milionë.

KRYETARI: Ju lutem, fjalën e ka Hydajet Hyseni - Kaloshi, le të përgatitet Gani Geci. Ju lutem, përsëri po e them, pa mikrofoni mos flisni se nuk është mirë!

HYDAJET HYSENI – KALOSHI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Zonja e zotërinj deputetë,

Më lejoni që duke ju përshëndetur të gjithëve, ta përshëndes edhe këtë debat që po i shkon edhe Kuvendit tonë edhe me tone të përballura pozitive- opozitive.

Ç'është e vërteta, është pak herët ndonjëherë edhe po tingëllojnë nga pak si të stisura, të shtirura, mendoj që ne ende jemi në gjendje të tillë, në të cilën do të kishte kuptim që opozita edhe përkundër toneve kritike, të kishte guximin edhe të theksonte si të arritura pozitive që Qeverisë ose si gjetje të qëlluara të Qeverisë, njëren ose tjetrën zgjidhje.

Dhe, në anën tjetër, edhe përfaqësuesit e opozitës këtu në Kuvend, krahas mbrojtjes së natyrshme që duhet t'i bëjnë Qeverisë së tyre, të jenë të lirë që edhe të bëjnë vërejtje me qëllim të përbashkët që politikat tona buxhetore të jenë edhe më të kompletuara dhe më efikase.

Unë nuk e kam ndërmend t'i bëjë apologji Qeverisë, sepse një e di që ajo është e zonja ta bëjë vet atë, dhe e dyta, jam i bindur se mënyra më e mirë për ta mbrojtur vetveten është puna konkrete, rezultatet. Pa u frikësuar se mund të bie në këtë pozicion, do të thotë, të mbrojtjes, megjithatë unë mund të them përshtypjen time që është përshtypje edhe e përhapur se Qeveria ka bërë punë të mira dhe po vazhdon të bëjë punë më të mira edhe në menaxhimin, përveç tjerash, të buxhetit dhe sot këtu patëm rastin të dëgjojmë fakte të shumta dhe zor të kontestueshme.

Është tash një rishikim i buxhetit në disa fusha dhe, për mendimin tim, është sukses edhe vetë funksionalizimi i kësaj mënyre të ndërtimit në ecje të buxhetit, që nuk e kemi pasur, zonja e zotërinj. Megjithatë, Qeveria është edhe në një vështirësi të natyrshme, duke qenë edhe e detyruar të ndjekë logjikën e një vazhdimësie dhe të ndryshimeve që ka premtuar dhe pretendon t'i bëjë, s'mund edhe t'i shpëtoj lehtë inercisë, prandaj unë dua edhe të vë theksin edhe te disa shprehje të kësaj inercie, që mendoj e pengon Qeverinë. Do t'ia bashkëngjitja asaj, që tha kolegu afër meje për inercinë e përdorimit të Buxhetit të konsoliduar, të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes, e tjera, edhe prirjen që në buxhet të kemi shifra paushall. Ministria e Punëve të Jashtme, 3 milionë

buxhet; TMK-ja 1 milion në këtë vit, 2 milionë vitin e ardhshëm, pa e sqaruar çka do të bëhet me procesin e transformimeve, e tjera, e tjera, ose zëra të ndryshëm: 200 mijë euro, 800 mijë euro, 400 mijë euro. E kam vështirë ta besoj se një ndërtim i buxhetit në parametra të qëndrueshëm, mund të rezultojë në shifra të tilla të rrumbullakuara. Krijohet përshtypja se janë paushall.

Mendoj që Qeveria ka vend aty eventualisht të shikojë dhe të gjejë hapësirë për të orientuar mjete që, ndoshta, nuk janë planifikuar mirë në vende ku ka më shumë nevojë dhe që janë prioritet.

Unë po e përmend, për shembull, ndonjë rast. Prioritet për Kosovën nuk mund të mos jetë prodhimi, vendet e punës. Nuk e shohim sa duhet orientimin e mjeteve edhe në investime që do të mund të krijojnë vende të reja pune.

Prioritet për Kosovën është integrimi evropian. E kam kërkuar me vëmendje, a thua çka është investuar, çka është orientuar në këtë drejtim, sepse të tjerët po ecin, ne po ngecim dhe këtu po has sharra në gozhdë. Ç'është e vërteta, ajo që është orientuar në Agjencinë për Integritet Evropian, është simbolike dhe ajo në automjete. Shtrohet puna, a automjetet janë prioritet në procesin e integriteteve evropiane? Automjetet që blihen prej UNMIK-ut. Shtrohet dilema, a thua nuk paska mundësi UNMIK-u që t'i huazojë ose t'i dhurojë Qeverisë sonë edhe si donacione automjetet, ato automjete u dashka t'i shes. Megjithatë, kemi qenë kaq kohë këtu, pse të mos e bëjë?!

Për më tepër, automjetet atje kanë njëfarë matematike të çuditshme. Ta zëmë, për Agjencinë e Integriteteve është një kalkulim, një çmim tjetër, por për Zyrën e Kryeministrit është një tjetër. Zyra e Kryeministrit del sikur blen vetura më të lira sesa Agjencioni për Integritet. Mendoj që te prioritetet, ndoshta duhet të mprehim më shumë dioptrinë dhe të ndalemi tek ato që i duhen Kosovës. Për shembull, çka kemi bërë në konkretisht për ta përgatitur veten në procesin e integriteteve evropiane? Madje, as dokumentacionin e duhur nuk e kemi siguruar.

Tek çdo komunë është e zbrazët rubrika për ambientin. Më kujtohet, në Slloveni janë bërë shumë përpjekje, janë harxhuar mijëra faqe letër dhe miliona që Sllovenia t'i përmbushë kriteret për integritet evropian në fushën e ambientit. Po ne, ku jemi? Asgjë!

Unë jam nga Gjilani dhe në Gjilan nuk mund të mos jetë prioritet, ta zëmë, ajo që ndodhë me kanalizimin, me ujërat e zeza. Pra, njerëzit në pjesë të tëra të qytetit nuk mund të jetojnë për shkak të gjendjes së padurueshme atje. Ka mundësi, ndoshta, që më shumë t'i kushtohet kujdes edhe këtyre nevojave dhe ato të harmonizohen me planin buxhetor.

Nuk e konsideroj se do të ishte prioritet që në ata parametra të kemi edhe ashtu siç është thënë "Vila Gërmia". Do të mund të gjenim edhe destinime më të mira edhe për këtë gabim të Kuvendit që është bërë shumë vjet dhe po na mbështillet rreth këmbëve me vite të tëra.

Konsideroj se ka pasur mundësi, ndoshta, që më shumë t'i kushtohet kujdes edhe forcimit të administratës nëpër komuna, që sipas vlerësimeve të atjeshme është pengesë e madhe edhe për realizimin e projekteve, madje edhe për hartimin e projekteve, kurse në planin e planifikimit hapësinor nuk iu është kushtuar sa duhet kujdes, sidomos zonave

kufitare, zonave malore dhe mendoj se ka pasur logjikë, nëse ka mundësi, do të ishte mirë të shikohet mundësia që mjetet që mund të jenë eventualisht në dispozicion nga destinacionet e tjera, të orientohen edhe në këtë drejtim.

Konsideroj të nevojshme, zonja dhe zotërinj deputetë, të theksoj rëndësinë si prioritet për Kosovën edhe të sundimit të ligjit dhe nevojën e investimeve suplementare në fushën e gjyqësisë, e në përgjithësi në sistemin e drejtësisë. Është fusha që më së paku është transformuar dhe shpesh si alibi përdoret edhe mungesa e mjeteve, e kushteve etj. Pa e lidhur domosdo njërën me tjetrën, megjithatë mendoj se në këtë fushë ka vend edhe për transformime, duke përfshirë edhe korrigjimin e padrejtësive të sistemeve të kaluara të padrejta. Ju e dini që Kosova ka qenë shembull i shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut në këtë fushë dhe e dini se një pjesë e madhe e shoqërisë kosovare ka qenë viktimë e drejtpërdrejtë e këtij sistemi të padrejtësisë dhe Qeveria e Kosovës duhet të mendojë për të siguruar mjetet financiare edhe për këtë nevojë që vendet tjera e kanë kryer dhe është jo vetëm një nevojë shoqërore, por është edhe një test i demokratizimit dhe i transformimit të shoqërisë së re kosovare.

Unë jam i bindur që Qeveria në ecje e sipër do të konsolidojë edhe më mirë politikat e saj, do ta konsolidojë edhe më mirë buxhetin, siç u tha këtu, vazhdimisht të konsoliduar dhe asnjëherë krejt të konsoliduar. Por, një konsolidim në ecje e sipër, jam i sigurt do ta bëjë Qeveria dhe unë kam besim se ajo do t'ia dalë. Suksese! Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka Gani Geci. Le të përgatitet Safete Hadergjonaj!

GANI GECI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Unë do të ndërlidhem në aspektin e sigurisë, sepse aty jam edhe në Komision, sepse ne, si deputetë të Parlamentit të Kosovës dhe anëtarë të Komisionit për Siguri, kemi vizituar Agjencinë Antikorrupsion, së bashku me të gjitha partitë dhe deputetë tjerë që ishin me ne, dhe kërkesa e tyre ishte që të financohen më tepër dhe që të kenë një mbrojtje institucionale nga njerëzit e korruptuar.

Them sinqerisht, Agjencia Antikorrupsion po punonte në një bodrum, ku nuk kishte as dritë as ajër të mjaftueshëm dhe këtë e dinë deputetët kolegë që kanë qenë me mua. Menjëherë, pasi që unë dëgjova në mjetet e informimit se drejtori i Agjencisë Antikorrupsion bëri një publikim para disa ditësh, shumë shpejt u thirr nga Qeveria për të sqaruar se mos rastësisht ka gabuar e ka folur për këtë Qeveri dhe, qysh atë ditë ai i ra pishman:” Jo, unë nuk kam folur për Qeverinë tuaj, jo more s’kam për të folur kurrë se nuk guxoj” Kjo jep të kuptosh se kjo Qeveri dëshiron që të gjitha institucionet, qofshin ato qeveritare, qofshin agjenci që janë të pavarura, t’i futë nën kontroll, qoftë Radiotelevizionin, qoftë Agjencinë Antikorrupsion, qoftë agjencitë e tjera që janë të dedikuara për të kontrolluar punën e Qeverisë dhe për të kontrolluar korrupsionin. Ajo që kanë parë popullata e Kosovës, zotin Preteni dhe sqarimet e tij, kanë lënë përshtypjen e tillë. Ndoshta nuk është ajo, por ka lënë këtë përshtypje.

Prandaj, unë personalisht, posa kthehem nga këtu, në rrugë takoj çdo ditë policë të Republikës së Kosovës, të cilët kthehen nga puna, qoftë në Merdare, atje ku e vunë shenjën e Republikës së Kosovës dhe u kacafytën me disa huliganë, qoftë në Mitrovicë, qoftë edhe nëpër rrugë dhe ata marrin nga 229 euro pagë. Sa për qind janë ngritur pagat

e atyre që do ta mbrojnë Kosovën dhe do ta mbrojnë qytetarin e Kosovës nëpër rrugët tona? Nuk po flasim për Forcën e Sigurisë së Kosovës, sa mjete janë ndarë nga ky buxhet, sepse mirë tha dikush që këtu e kemi fuqinë më të madhe të botës, NATON dhe nuk jemi duke u frikësuar aq tepër prej forcave të huaja, sepse NATO është këtu. Mirëpo, problemi qëndron te institucionet e Kosovës, te Shërbimi Policor i Kosovës. Jam shumë i gëzuar që ju e qeverisni Kosovën për disa arsye. Nën një, para Ministrisë së Arsimit nuk kemi më asnjë protestë, edhe pse nuk janë rritur pagat asnjë për qind. Jam shumë i gëzuar që mantelbardhët e Kosovës apo mjekët, infermierët nuk bëjnë më asnjë protestë edhe pse nuk janë rritur pagat asnjë për qind.

E shoh shqetësimin te Policia e Kosovës, sepse ata e kanë punën më të madhe dhe ata paralajmërojnë protesta dhe nuk janë ngritur pagat për ta. Jam shumë i gëzuar që ju jeni në pushtet, sepse sikur të ishin bërë disa punë, t' i kishte bërë Lidhja Demokratike e Kosovës, që edhe ne kemi qenë pjesë e tyre, do të kishte ardhur ai “revolucioni demokratik i vonuar” e do ta kishim vështirë të dilnim nga kjo gjendje. Por, për shumë arsye jam i gëzuar që ju e keni Qeverinë dhe tash nuk ka protesta, nuk ka ndryshim të pagave, por të gjitha sindikatat që e kanë udhëhequr, qoftë MASHT-in, qoftë Ministrinë e Shëndetësisë, punëtorët e shëndetësisë, kanë qenë të dirigjuara nga një parti politike për ta marrë pushtetin dhe për të mos i ngritur pagat.

Si mund të jetojë, ta zëmë, një infermiere me 160 euro pagë? Si mund të jetojë një polic ose të vijë nga Ferizaj në Skenderaj, që i kemi 120 policë që vijnë nga rajoni i Skenderajt dhe i Drenicës, shkojnë në Ferizaj dhe Gjilan dhe punojnë dhe vetëm për rrugë atyre u shkojnë mbi 120 euro, kurse për 100 euro pagë ata duhet ta ruajnë kufirin e Kosovës dhe duhet të punojnë për Kosovën.

Ne nuk po flasim për ato punë që Qeveria e Kosovës nuk ka fuqi t' i kryejë, ta zëmë ujësjellësin në Mitrovicë. Edhe më herët kemi thënë t' i ndihmojmë Bajram Rexhepit, se nuk mund t' i kryejë të gjitha ato punë vetë. Nuk po flasim për doganat që janë djegur dhe buxheti i Republikës së Kosovës brenda muajit ka humbje 5 milionë euro, sepse këto janë gjëra që po dihen dhe kjo Qeveri nuk ka fuqi t' i rregullojë. Ne nuk mund të presim nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës që ato edhe të llojnë për pavarësinë e Kosovës dhe ta ndërtojnë ujësjellësin në Suhadoll, sepse këto punë duhet t' i bëjë Qeveria. Prandaj, Shërbimi Policor i Kosovës, që do të ndalem edhe një herë aty, e ka barrën kryesore, sepse gjatë këtyre viteve ne kemi pasur disa të vrarë në punë nga Shërbimi Policor i Kosovës dhe ata dhe familjet e tyre nuk janë absolutisht të trajtuara mirë nga Qeveria e Kosovës, qoftë nga ajo e mëhershme, qoftë nga kjo e tashmja. Dhëntë Zoti dhe e harrojmë atë Qeveri tjetër, se na mbytët me atë qeverinë tjetër. Sa herë po duam të flasim, për këtë Qeveri, ju po merrni shembull atë tjetrën dhe nuk po mund të flasim asgjë, sepse po thonë se ne jemi të mirë se a e dini çfarë ka qenë ajo tjetra. Prandaj, ky është një problem që duhet të tejkalohet.

Sinqerisht po them, ne jemi duke jetuar në vitin 2008 dhe më asnjë njeri nuk e përmend që ka lindur në vitin 2007 dhe thotë tash do të merrem me problemet e vitit 2007. Ne po i përmendim problemet e vitit 2008, në momentin që juve po qeverisni, në momentin që juve në bashkëqeverisje me Lidhjen Demokratike të Kosovës i keni bërë disa gjëra që unë jam i gëzuar me atë që i keni bërë, që na e keni sjellë këtë flamur, që na e keni prurë këtë himn, sepse po ta kishim sjellë ne, do të na kishit mbytur dhe do të kishit thënë janë tradhtarë, i ka shti Beogradi, por shqyr që jeni ju. Prandaj, po them sinqerisht që kërkojmë nga kjo Qeveri, kërkojmë nga ju, këtu i pash disa shifra që edhe në Kuvendin e Kosovës është një bord i pavarur mbikëqyrës që është formuar tash dhe unë nuk e di

çka mund të jetë ky, se në ato letrat më herët nuk ishte. Prandaj, ky Bordi i pavarur i merr disa mjete, i merr nga 192.000 euro dhe kujt ia jap këto? Nuk e di kush është ky bordi i pavarur mbikëqyrës që e mbikëqyrë Kuvendin, a i mbikëqyrë deputetët? Pra, këtë nuk po mund ta di.

Mandej, është një problem tjetër, problem i sigurisë që ne kemi folur. Me hyrjen në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ju keni aluduar dhe keni thënë se do të formohen institucionet mbrojtëse - Ministria e Mbrojtjes apo Ministria e Forcës së Sigurisë, si të doni mund ta quani, dhe do të formohet Agjencioni i Inteligjencës. Tek të dy këto, si duket, nuk keni hasur mirëkuptim për ata drejtorë apo zëvendës drejtorë edhe ata kryeshafat dhe po na e shtyni tash edhe pushimin. Pra, edhe pse ka hyrë në fuqi Kushtetuta e Republikës së Kosovës, nuk po kemi mundësi që Kosova të funksionojë si shtet, sepse nëse këto agjencione do të funksiononin, ne nuk do t'i kishim disa probleme si ne Suhadoll apo si në Mitrovicë, ku janë djegur, ta zëmë, doganat e Republikës së Kosovës. Prandaj, unë besoj që këto kritika do të jenë të mirëseardhura për Qeverinë tuaj.

Për ne kanë qenë të mirëseardhura edhe ato tjerat që keni qenë ju në pushtet dhe nuk po heqim, sepse po të ishim ne në pushtet do të kishim hequr, vaj halli çka do të na kishte gjetur, por tash jeni ju e nuk po heqim, s'ka probleme, qetësi është. Sa i përket qetësisë, e keni arritur këtë, komplet e keni bërë, e keni qetësuar Kosovën. I keni qetësuar infermierët, i keni qetësuar punëtorët e arsimit, i keni qetësuar të gjithë. Për këtë ua jap dorën edhe i keni qetësuar edhe firmat e mëdha, sepse i keni thirrur firmat e mëdha dhe u keni thënë të gjithë keni punë. Të gjithë dhe tërë keni punë e nuk bën për t' u ankuar askush dhe kjo është një meritë e madhe juaja, sepse ata të tjerët i kanë dhënë vetëm njërrës e ato tjerat ankoreshin. Pra, ky është problemi që tani ai Hasan Preteni thoshte se korrupsioni është në rritje e sipër. Këto janë fakte dhe këto juve nëse nuk dilni të bisedoni me qytetarë dhe ju do t'i shihni që këto janë thatë. Prandaj, unë besoj se në një të ardhme të shkurtër, qytetarët e Kosovës do t'i shohin edhe disa dukuri tjera negative dhe do ta kenë guximin t'i thonë ato, sepse njëherë për njëherë mungon guximi. Juve e keni qeverisë Kosovën edhe kur nuk keni qenë në pushtet, jo tash kur jeni në pushtet, që e keni më lehtë ani me LDK-në, ani që ata umin prej kovaçi nuk janë të zotët për ta nxjerrë. Prandaj, ne besojmë që në një të ardhme shumë të shkurtër do të punojmë së bashku dhe për ato që keni punuar do të jemi mirënjohës. Çka keni punuar mirë, keni punuar mirë. Në Ministrinë e Arsimit disa gjëra kanë qenë mirë. Zoti Hydajet Hyseni tha se...

KRYETARI: Ju faleminderit për fjalë, edhe pse një pjesë e fjalës ishte jashtë rendit të ditës. Roli i KPM-së është i përcaktuar në Ligjin e shërbimit civil dhe mund ta konsultoni ligjin.

Fjalën e ka Safete Hadërgjonaj. Le të përgatitet Myrvete Pantina.

SAFETE HADERGJONAJ: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Kolegë deputetë,

Pas diskutimeve nga më të ndryshmet, herë në rend dite e herë jashtë rendit ditës, ndoshta humbi edhe efekti i diskutimit në lidhje me rishikimin gjashtëmujor të buxhetit, mirëpo këtu shumë kohë humb edhe me atë se nuk e kemi raportin gjashtëmujor të buxhetit dhe ne tash nuk mund të diskutojmë për prioritetet për gjashtëmujorin e ardhshëm.

Unë dua t'ua rikujtoj të gjithë atyre, të cilët ishin të shqetësuar në lidhje me raportin gjashtëmujor të buxhetit se në Ligjin për menaxhimin e financave publike është e paraparë se me 31 korrik, përkatësisht me 1 gusht, raporti i gjashtëmujorit të parë t'i dorëzohet Kuvendit dhe jam e sigurt që menjëherë pas pushimit, në muajin shtator, do ta kemi mundësinë ta diskutojmë edhe raportin gjashtëmujorë të buxhetit.

Sot e kemi në diskutim rishikimin e buxhetit për gjashtëmujorin e ardhshëm dhe është hera e parë që po zhvillojmë diskutim rreth një rishikimi gjashtëmujor të buxhetit. Asnjëherë më parë, deputetët në Kuvendin e Kosovës nuk kanë pasur mundësi të vendosin për rishpërndarjen e mjeteve në gjashtëmujorin e dytë e as nuk është ofruar ndonjë dokument sa për njoftim se si janë shpërndarë fondet që nuk kanë mund të shpenzohen në pjesën e parë të vitit.

Ministria e Ekonomisë dhe e Financave ka bërë një punë të mirë duke na e ofruar një dokument ku kemi mundësi të shikojmë se si do të jetë rrjedha e programit buxhetor për pjesën e dytë të vitit dhe kjo është një shenjë e mirë se po bëhet një shkëputje nga sistemi i mëparshëm i buxhetit jo aq transparent për Kuvendin dhe po vihen bazat e një sistemi të mirë të planifikimit dhe shfrytëzimit të mjeteve buxhetore, pra po vihen bazat e një sistemi të mirë të menaxhimit të mjeteve të taksapaguesve.

Nga materiali që na është ofruar vërejmë se ka një rritje të performancës së Qeverisë në mbledhjen e tatimeve dhe të taksave që ka pasuar me rritje të buxhetit dhe me rritje të investimeve.

Nëse shikojmë me kujdes këtë dokument, vërejmë se Qeveria ka bërë një punë të mirë me rialokimin e mjeteve të realizuara më tepër, në projektet që ka mundësi të përfundohen, sepse rrjedha e punimeve të atyre projekteve është më e mirë.

Ministria e Ekonomisë dhe Financave ka bërë një analizë të mirë të shpenzimeve dhe ka vendosur që pjesën më të madhe të fondeve të buxhetit t'i shpenzojë për edukim, për shëndetësi, për infrastrukturë rrugore dhe ky rivlerësim që e ka bërë Qeveria jep shenjat e para se buxheti do të orientohet në zhvillimin e vendit, se buxheti do të jetë në favor të mirëqenies dhe se me politikat e saja buxhetore do t'i jepet fund një menaxhimi jo aq të mirë të mjeteve.

Kjo Qeveri ka trashëguar një buxhet tërësisht konsumues pa kurrfarë ndikimi në zhvillimin ekonomik. Nga ky rivlerësim po vërejmë se Qeveria gradualisht me politikat e saja buxhetore po orientohet për një buxhet që do të japë efektet në zhvillimin ekonomik të vendi.

Nga shumë deputetë u diskutua 40 milionëshi i ndarë për shpronësimin e autostradës Merdare-Morinë. Më duket shqetësim i tepruar, por këto mjete, të nderuar deputetë, po të ishin shpenzuar në mënyrë të pakontrolluar dhe për interesa politike e grupe, është dashur, vërtet, të jetë shqetësim për ne, sepse ndarja e tyre nuk është bërë, nuk ka qenë krejt me qëllimin më të mirë, por nuk duhet të jetë shqetësim ri destinimi i këtyre mjeteve sipas procedurave ligjore në projekte kapitale ku faktikisht përfitojnë qytetarët.

Qeveria është e vetëdijshme për rëndësinë e ndërtimit të kësaj autostrade në zhvillimin ekonomik dhe padyshim që do ta përfundojë.

Qeveria ka dhënë prova në gatishmërinë e saj për të investuar në infrastrukturën rrugore. Besoj që askush nuk është kundër formimit të institucioneve të reja, kundër ndarjes së mjeteve për shëndetësi për blerjen e barërave esenciale, kundër ndarjes së mjeteve për arsim. Prandaj, nuk ka arsye për t'u shqetësuar për rritjen modeste që është bërë në kategorinë paga-mëditje dhe mallra dhe shërbime.

Qeveria duhet të ndërpresë politikën e trashëguar nga vitet e kaluara për ndarjen e mjeteve të gatshme për KEK-un. Në këtë vit, është e kuptueshme nga të gjithë, që ka qenë e pamundur të bëhet më shumë në energjetikë, sepse politika e viteve të kaluara ka lënë pasojë vështirë të riparueshme për këtë periudhë kohe.

U fol për palestra, për palestra sportive, ujësjellës e kanalizime, por ju të nderuar deputetë e dini se komuna duhet t'i ketë projektet për investime dhe të respektojnë procedurat për të përfituar mjetet për prioritetet e tyre. Prandaj, mungesa e këtyre projekteve në të shumtën e rasteve bëjnë të vështirë ndarjen e mjeteve për disa investime në komunat e ndryshme.

Këtu u thanë edhe shumë gjëra të pabazuara në dokumentin e rishikimit gjashtëmujor të buxhetit. Është mirë që para se të diskutohet, deputetët me seriozitet ta shikojnë dhe ta analizojnë materialin që e kanë në shqyrtim e të mos flasin me hamendje siç ndodhi sot, pa u bazuar, pa e analizuar mirë projektin e buxhetit, kanë dalë jashtë atyre konturave të cilat i përfshijnë tabelat buxhetore. Po të vlerësohet dhe të shikohet me seriozitet, nuk ka kurrfarë dyshimi apo dyfishimi të pozitave të prioritetëve buxhetore në projektin buxhetor.

Prandaj, unë dua t'u them në fund, se ne para veti kemi një dokument të përgatitur mirë, me prioritete të qartësuar. Për mua ishte një shqetësim shumë i madh kur deputetët thoshin se nuk i kemi prioritetet dhe nuk po i shohim. Është hera e parë që ne po kemi mundësi të gjitha projektet për investime kapitale t'i shohim në mënyrë të hollësishme në projektin e buxhetit për gjashtëmujorin e ardhshëm.

Prandaj, konsideroj se ia vlen të votohet dhe vota pro këtij buxheti, të rivlerësimit të buxhetit, do t'i krijojë mundësi Qeverisë që t'i realizojë këto projekte. Prandaj, vota pro e këtij buxheti është votë për të mirën e qytetarit të Kosovës.

KRYESUESI IBRAHIM GASHI: Ju faleminderit, deputete Hadërgjonaj! Fjalën e ka deputetja Myrvete Pantina, le të përgatitet deputeti Armend Zemaj.

MYRVETE PANTINA: Ju faleminderit!

I nderuari kryesues i Kuvendit,

Me rishikimin e buxhetit të përgjithshëm të Kosovës për vitin 2008, parashihet që edhe të hyrat edhe shpenzimet buxhetore të shënojnë rritje. Mirëpo, rritja e shpenzimeve buxhetore është dukshme më e lartë se sa e të hyrave buxhetore, prandaj do të thotë kjo paraqet një mosbalancim në buxhet dhe mosrespektim të rregullave fiskale, gjë që nuk do të duhej të ndodhte, meqenëse jemi në fazën fillestare të ndërtimit të shtetit.

Edhe unë do të pajtohem me një parafolës se deficit i buxhetit çdo herë nuk paraqet rrezik, meqenëse thjesht deficit i ndonjëherë mund të komentohet, domethënë thjeshtë si zotësi e Qeverisë për menaxhimin e mjeteve të saj që iu kanë besuar, mirëpo varet shumë prej asaj se në cilët sektorë dedikohen ato mjete. Nëse mjetet shkojnë në

sektorët, në të cilët mund të gjenerohen të ardhura, atëherë buxheti është ai që mund të përfitojë në të ardhmen.

Po e shoh se koncentrimi ka humbur, por megjithatë unë kam pasur durim, ju kam dëgjuar, keni durim, më dëgjoni edhe ju mua.

U dëgjua edhe më herët se të hyrat shtesë planifikohen të grumbullohen kryesisht nga të hyrat tatimore. Unë parashtoj tash një pyetje: A do të jenë këto të hyra shtesë të grumbulluara si rezultat i rritjes së efikasitetit të punës në grumbullimin e të hyrave apo i rritjes së importit? Besoj se do të marrë përgjigje prej ministrit të Financave.

Po ashtu, parashihet pra me rishikim edhe rritja e shpenzimeve edhe në kategorinë e pagave dhe të mëditjeve, të mallrave dhe të shërbimeve, të subvencioneve dhe të shpenzimeve kapitale. Nuk do të ndalem në këto e as në shifra, por nëse bazohemi në normën e inflacionit që është shënuar në këtë vit, që krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar është 14%, atëherë shumë lehtë do të mund të arsyetonim rritjen e pagave, por fatkeqësisht kjo nuk do të ndodhë. Prandaj, të gjithë ata që kanë pritur rritjen e pagave, do të thotë më kot se nuk do ndodhë kjo. Nga kjo ndarje e mjeteve do të përfitojë vetëm një pjesë apo janë këta arsimtarët, të cilët do të licencohen në periudhën e ardhshme dhe, u dëgjua edhe më herët, edhe një pjesë do të shkojë për rritjen e stafit në kuadër të administratës civile, gjë që thjeshtë nuk do të duhej të ndodhte.

Pse e thashë këtë? Rritjen e pagave ne do të mund ta arsyetonim, por edhe pse për subvencione u dëgjua mjaft, nuk do të mund ta anashkaloj edhe unë dhe thjeshtë rritjen e subvencioneve për KEK-un, nuk do ta mund ta arsyetoja kurrësi.

Subvencionet për KEK-un, për vitin 2008, do ta arrijnë, sipas rishikimit të buxhetit do ta arrijnë vlerën prej 49 milionë euro, që paraqet trefishin e subvencioneve të lejuara në vitin 2007. Do të thotë, edhe më tutje rritja e subvencioneve KEK-ut, në vend që të bëhet ulja graduale e tyre prej vitit në vit.

Me një ndarje të tillë të mjeteve, ne thjesht po kontribuojmë në vazhdimin e keqmenaxhimit në këtë kompani dhe nga ana tjetër po i dëmtojmë sektorët tjerë, të cilat kanë nevojë të madhe për mbështetje financiare, konkretisht bujqësia. Por, si po shihet, edhe subvencioni nuk po e zgjidh problemin meqenëse reduktime të rrymës kemi edhe në ditët më të ngrohta të verës. Prandaj, derisa KEK-u të mos kushtëzohet me rritje të inkasimit, vështirë se do të kemi përmirësim në gjendjen me furnizim me rrymë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Armend Zemaj e ka fjalën. Le të përgatitet Slobodan Petroviq.

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Zëvendëskryeministër, ministra,
Të nderuar deputetë,

Dola me qëllim se e pashë se i erdhi pak fundi durimit, nuk po dëgjojnë ndoshta, thashë këtu përballë janë pak më të vëmendshëm. Pra, duke marrë parasysh diskutimet që dëgjuam deri më tani, për një moment mu duk se mos jemi duke diskutuar buxhetin vjetor e jo rishikimin buxhetor, se sidomos disa po flasin prej fillimit e ky është rishikim, ata që e kuptojnë, ndoshta ata që kanë më shumë njohuri në ekonomi, ndërsa ata që nuk po e kuptojnë, po flasin ky projekt, ai projekt, po i përsërisin projektet prej

fillimit të vitit e deri më sot. Ndërsa, askush nuk e përmendi, besoni, as pozita, as opozita mundësinë e vogël të lëvizjes së këtyre fondeve përpos hitit të ditës sot që u bë ai investimi kapital i autostradës Merdare-Morinë apo Vermnicë – Merdare, ndërsa mua më ktheu pak vite prapa. Po më kujtohet kur Presidenti Ibrahim Rugova e pati propozuar këtë projekt, disa partizanë të atëhershëm thoshin se Ibrahim Rugova po do të na lidhë me Serbi, ndërsa sot u bënë fanatikë në mbrojtje të kësaj rruge apo të këtij projekti nacional.

Edhe unë në këtë kontest e kuptoj këtë mundësi të vogël të shtimit, domethënë, të kërkesave buxhetore, por me të vërtetë është për të ardhur keq se edhe kësaj radhe rinia ka mbetur pak anash apo ato 80.000 euro tani të premtuara me rishikim buxhetor, me të vërtetë nuk e tregojnë përkrahjen që duhet t'ia japin kësaj kategorie e cila po përmendet në shifra që është më se 60%, ndërsa para pak ditësh ne vetëm e kemi kthyer një ligj që ka qenë për përkrahjen dhe fuqizimin e rinisë, pikërisht për ankesat se nuk mund të implementohet për shkaqe buxhetore, ndërsa sot shohim që janë gjetur fonde edhe për gjëra tjera që për mua, ndoshta, janë më pak të rëndësishme.

E tha një kolege atje që mua më bëri përshtypje, 3 milionë euro promovimi për Kosovën, Ata që veç një herë në muajt e prekin pullën dhe e lëshojnë televizorin dhe shohin kanale të njohura televizive, nuk e di se sa i kushtojnë rëndësi një reklame, për shembull, për Kosovën. Po të ishte në këtë rast në CNN apo në ndonjë stacion tjetër të njohur ndërkombëtarisht që ne po përmendim vendet arabe, siç do të jetë Algjazira. Jo 3 milionë, por unë kisha propozuar që të jenë 10 milionë, që pikërisht në bazë të atyre reklamave, atij promovimi, do të krijohet mundësia e tërheqjeve edhe të investimeve të jashtme, e atëherë këto investime të jashtme të rigjenerojnë të hyra për të gjithë popullatën e Kosovës, jo për rrugica edhe jo për gjëra të imëta.

Ndërsa, krejt në fund, e pata unë kështu se mos të largohem, po i mbetem borxh lokalizmit, unë e pata pak në fund për në fshatin tim Strelc, jo që nuk ka bërë ajo Qeveri e kaluar, por unë tash jam në hall edhe në këtë Qeveri. Edhe në atë Qeveri nuk është shtruar asnjë rrugë edhe pse ishte LDK-ja, në pushtet, por edhe tash, por besoj që në vitin 2009, do të kem përkrahje pak më të madhe dhe do të realizohen edhe ato premtime që u kemi dhënë qytetarëve. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Diskutuesi i fundit për sot është Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Zoti kryeministër, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Nuk e kisha ndërmend të flas, sepse shumëçka u tha nga kolegët. Dikush vërtet dha sqarime të nevojshme, po u hodh këtu edhe një mjegull. Pikërisht për shkak të projekteve nacionale e shoh të nevojshme që t'i jap disa sqarime shumë të rëndësishme.

Askush nuk ka hequr dorë nga projektet nacionale, siç është autostrada Vermnicë – Merdare, përkundrazi jemi në procedurat e fundit parapërgatitore për fillimin e punimeve të kësaj autostrade dhe jo vetëm kaq. Qeveria ka arritur që të shpallë edhe tenderin dhe është përcaktuar shtëpia projektuese, e cila do të hartojë projektin për fillimin e punimeve të autostradës tjetër Hani i Elezit – Prishtinë, e cila do të vazhdojë në drejtim të Pejës dhe në drejtim të Malit të Zi.

Po ashtu, një projektet tepër i rëndësishëm nacional është duke u punuar edhe në drejtim të Mitrovicës, që në vitin e ardhshëm do të hartohet projekti për vazhdimin e autostradës Prishtinë-Mitrovicë.

Ministria e Transportit aktualisht në procedurë i ka më se 150 projekte të vogla dhe të mëdha. E them me përgjegjësi të plotë se nuk ka asnjë komunë të Kosovës, që sot nuk janë duke u realizuar të paktën tri apo më tepër projekte që nënkupton shpërndarjen e drejtë dhe proporcionale në të gjithë territorin e Kosovës dhe ky është një sukses mjaft i madh që ka arritur kjo Qeveri.

Populli thotë: “Një katund që shihet, kallauz nuk do”. Deshi dikush apo s’deshi, qytetari i Kosovës është duke e prekur ndryshimin pozitiv që ka arritur kjo Qeveri me menaxhimin e drejtë të parasë së qytetarit të Kosovës. Pra, mbi të gjitha, e arritura më e madhe të cilin e vlerësoj është rikthimi i besimit të qytetarit të Kosovës tek përfaqësuesit institucional të popullit. Nëse dikush mund t’i quajë rrugica apo rrugë, si të dojë, unë po i referohem vetëm një raporti të Bankës Botërore, ku në mes tjerash thuhet: “Shumë prej këtyre komuniteteve ballafaqohen me pengesa të konsiderueshme në plotësimin e nevojave të tyre themelore si pasojë e gjendjes së keqe të rrjetit rrugor lokal” Për Qeverinë e Kosovës, për kabinetin e ri qeverisës është me rëndësi që të investohet në çdo vend, në çdo mes të Kosovës, pa përjashtim. Nuk do të kishin rëndësinë dhe vlerën e vet projektet nacionale, autostradat, magjistralet dhe rrugët regjionale nëse ne nuk krijojmë kushte të komunikimit të drejtpërdrejtë të pjesës rurale me këto rrugë, me këtë rrjet rrugor i cili është më se i domosdoshëm.

Qeveria e Kosovës dhe ne nuk duhet të pretendojmë që të zbulojmë diçka tjetër vetëm t’i sjellim praktikën e vendeve të tjera, të cilat kanë kaluar fazën e tranzicionit dhe absolutisht asnjë vend nuk ka mund dhe në asnjë mjedis nuk mund të bëhet fjalë për një zhvillim të mirëfilltë ekonomik, përderisa nuk investohet dhe nuk përmirësohet rrjeti rrugor, hekurudhor dhe ai ajror, prandaj Qeveria e Kosovës i ka kushtuar dhe do t’iu kushtojë rëndësi të veçantë investimeve në këtë drejtim. Ju faleminderit!

KRYETARI: Pasi nuk ka tjerë të paraqitur për diskutim, e ka fjalën ministri për Ekonomi dhe Financa, zoti Ahmet Shala.

MINISTRI AHMET SHALA: Ju faleminderit, Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Të nderuar kolegë ministra,

Ishte kënaqësi, në fakt, që në shumicën e debateve të dëgjoja mendime shumë konstruktive, qëllimmira dhe të cilat shkojnë në dobi të përmirësimit të procesit buxhetor dhe i falënderoj të gjithë, pa marrë parasysh që shpeshherë disa nga mendimet kanë qenë mbase edhe të shkollave edhe të praktikave të ndryshme, të cilat, mbase, po përpiqemi t’i kuptojmë dhe ju thërras të gjithëve t’i kuptojmë.

Ka pasur edhe mendime, të cilat kanë për qëllim përmbushjen e vakumit televiziv edhe ato duhet t’i kuptojmë dhe unë i marrë të gjitha qëllimmira pa marrë parasysh se nga kushdo vijnë. Si ministër i Ekonomisë dhe Financave, e di që ky proces nuk është prefekt, mbase edhe propozimi nuk është prefekt, asnjë nga ne nuk jemi prefekt, por po përpiqemi që si proces të konsolidohemi bashkërisht. Tek e fundit, kjo shoqëri e meriton atë super strukturë legjislative dhe shoqërore që e ka. Ne nuk mund të jemi as më të mirë e as më të këqij nga ata që na kanë votuar ose që na kanë besuar.

Pra, konsideroj që dokumentin dhe, desha të them, propozimet e singerta dhe profesionale, unë bashkë me kolegët e mi në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave do të jemi shumë të gatshëm t'i marrim parasysh dhe natyrisht në Komisionin për Buxhet dhe Financa, qoftë sot, qoftë nesër, do t'i përmirësojmë aty ku ka mundësi. Pra, ky është një propozim buxhet, një projektbuxhet dhe derisa ta marrë votën tuaj, do të mbetet projekt. Andaj, jam i sigurt që kolegët e mi nëpër ministrinë e ndryshme do ta kenë mirëkuptimin edhe tuajin edhe tonin eventualisht për të bërë përmirësime, të cilat shkojnë në dobi të procesit.

Unë, posaçërisht i kam dëgjuar të gjitha vërejtjet dhe i kam shënuar shumicën prej tyre, nuk do të doja që tani të përgjigjem në secilën prej pyetjeve apo përgjigjeve. Shumica e shqetësimeve që u ngritën, morën përgjigjet nga një pjesë e deputetëve, kështu që më lejoni që në pika të përgjithshme t'i jap disa nga komentimet e mia.

Konsideroj që ky dokument i plotëson standardet për të ecur përpara dhe për t'u votuar. Kemi ruajtur strukturën buxhetore të këtij buxheti. Organizatat buxhetore kanë pasur kërkesa, mbase edhe të trefishta, karshi mundësive tona, ku u thanë edhe në mënyra alegorike këtu fjalë mjaftë të qëlluara se është një kulaç që duhet ta ndajmë të gjithë aq sa mundet të ndahet, kështu që ne jemi përpjekur, në besimin e nikoqirllëkut të mirë, të përpiqemi të japim përgjigjet tona aty ku ka pasur mundësi.

Konsideroj që struktura e buxhetit reflekton prioritetet e Qeverisë së Kosovës dhe atë konform edhe Programit, përkatësisht edhe të Kornizës afatmesme të shpenzimeve. Si strukturë dhe shtyllë ka qenë rritja ekonomike dhe në kuadër të rritjes ekonomike, i kemi parë në prezantim edhe sektorët, siç është: infrastruktura energjetike, infrastruktura rrugore, arsimi, shëndetësia, bujqësia dhe të parat këto, në fakt kanë marrë, andaj mbase edhe shumë kritika erdhën pse janë rritur aq shumë ato, duke ju rikujtuar se ato janë edhe në prioritetin e Qeverisë së Kosovës që është rritja ekonomike e Kosovës.

Përveç kësaj, ne jemi fokusuar edhe në funksionimin e institucioneve të reja, të cilat dalin si pasojë e statusit, përkatësisht statusit të ri të Kosovës si shtet i pavarur dhe sovran.

U dhanë vërejtje për kornizën afatmesme të shpenzimeve se a është ky në harmoni me kornizën afatmesme të shpenzimeve dhe mbase në kohën kur ne kemi studiuar, këtë kornizë e kemi quajtur plan afatmesëm i zhvillimit ose plan afatmesëm i shpenzimeve. Pra, një plan në kohë, është një orientim dhe si i tillë, korniza afatmesme, si e tillë Korniza afatmesme e shpenzimeve është diçka që do të pësojë vazhdimisht ndryshime, me vetë faktin që në Konferencën e Donatorëve ne kemi pasur pretendime se do të kemi mbështetje buxhetore të drejtpërdrejtë prej 500 milionë euro, ndërsa kemi marrë 210 milionë euro, ndërsa projekte 608 milionë euro, 613 milionë euro sa janë. Ne detyrimisht do të duhej ta korrigjonim Kornizën afatmesme të shpenzimeve dhe gjatë procesit të planifikimit të vitit 2009, do t'i reflektojmë këto doemos. Do të ketë Kornizë afatmesme të shpenzimeve të vitit 2009-2012, do të ketë Kornizë afatmesme të shpenzimeve të vitit 2010—2013. Për çdo vjet pra është një kornizë afatmesme e shpenzimeve, pra për çdo vit neve do të ecim nga një segment përpara dhe mbase në vitin e ardhshëm ne prapë do ta ndërrojmë Kornizën afatmesme të shpenzimeve.

Shumë projekte që u kërkuar dhe kërkohen me ngulm me të drejtë edhe nga ju, edhe nga ministrat, sigurisht që nuk do të mund të financohen as nga Buxheti i Kosovës, edhe

sikur të ishte dyfish më i madh, e as nga Konferenca e Donatorëve, përkatësisht nga donatorët.

Ne, si Qeveri, kemi marrë hapa konsideroj mjaft shpejt dhe sot u dëgjua edhe për Ligjin për koncesionet, i cili u hap mundësi të gjithë juve edhe kryetarëve të komunave edhe drejtorëve të institucioneve të ndryshme, qofshin shërbyese, qofshin prodhuese, qofshin institucione të tjera, të ecin përpara me futjen e sektorit priva nëpër këto shërbime dhe nëpër këto prodhime apo nëpër këto dikastere të ndryshme, andaj kjo do të jetë një nga elementet që ne do të ecim përpara.

Më lejoni që të komentoj disa nga shqetësimet e rritjes së punësimeve. Në fakt, ka rregullim të punësimit e jo rritje të punësimit. Më vjen keq dhe nuk dua të zhvilloj debat, sepse shumë punëtorë që kanë punuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në Ministrinë e Bujqësisë, statusi i tyre ka qenë i parregulluar. Ata 500 punëtorë, përveç atyre që janë transferuar për shkak të transferimit të vetë kompetencave nga UNMIK-u në Republikën e Kosovës, ne kemi bërë rregullimin e statusit të tyre si punëtorët civilë, atë që, më vjen keq, nuk keni arritur ta bëni. Kështu që do t'ju kisha lutur që, mbase është dashur që të shpjegohet edhe më thellësisht, por në Komisionin e Financave dhe të Buxhetit, ne e kemi shpjeguar këtë. Në qoftë se ka pasur mungesë të shpjegimeve, kërkoj falje, por duhet ta dijë edhe audienca edhe ju, që ka pasur rregullim të statusit të të punësuarve, kryesisht përveç bartjeve që janë bërë për shkak të vetë refleksionit të shtetit të Kosovës.

Sa u përket mallrave dhe shërbimeve, ka rritje, mund edhe të ketë shqetësime dhe kritika me vend, por konsideroj që karshi kritikave, mbase më të lehta janë kritikët për një rritje se sa mungesa e barërave esenciale, sidomos për shtresën e varfër dhe këtu kërkoj mirëkuptimin tuaj që të mbesim, të paktën në pozicionet që kemi propozuar ne. U dhanë shumë sugjerime, konsideroj valide, se shërimi jashtë vendit nuk do të duhej të ishte option, dhe pajtohem plotësisht.

Ne me ministrin e Shëndetësisë po përpiqemi që një pjesë të këtyre mjeteve, edhe pse janë planifikuar si të tilla, të përpiqemi t'i orientojmë në kapacitetet vendore, aty ku ka mundësi që spitalet ose institucionet tona kanë kapacitet për t'i trajtuar dhe me miratimin e koncesionit, shumë nga shërbimet të cilat nuk mund të ofrohen tani ose nuk mund të financohen, do të arrijmë që t'i tejkalojmë përmes partneritet publiko-privat.

Në mallra dhe shërbime ka pasur edhe rritje në dokumentet e Republikës së Kosovës, në dokumentet e reja, të cilat secili prej jush sigurisht që mezi pret t'i bartë me krenari dhe besoj që kjo definitivisht ka qenë pothuaj se e planifikuar, sepse është veç bartje e një kompetence, dhe në qoftë se kritikohet, atëherë kthehemi në vazhdimësinë e mbajtjes së dokumenteve të UNMIK-ut.

Kishte edhe disa shqetësime, mbase në mungesë të kapacitetit për të kuptuar, pati komentime mbase në mungesën e kapacitetit për t'i kuptuar tabelat, më vjen keq, por se a ka dyfishim të kodeve ndërmjet Agjencisë së Privatizimit dhe Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit.

Agjencia Kosovare e Mirëbesimit me mandat ka pasur efekte deri më 30 qershor të këtij viti, andaj ato patjetër duhet të reflektohen. Ekzekutimet që janë bërë duhet të reflektohen, ndërsa pjesa tjetër e bartur qoftë të ndërmarrjeve publike, qoftë të privatizimit, pasqyrohet në efektet...

KRYETARI: Për Shkak të ndërhyrjeve, edhe një minutë i vazhdohet ministrit.

Ju faleminderit, Kryetar!

Shpenzimet kapitale, vetëm edhe një përmbledhje dhe po e përfundoj, Qeveria e Kosovës konsideroj se ka bërë rregullim cilësor të ekzekutimit të investimeve kapitale. Aty ku nuk ka pasur mundësi teorike të eksproprijohet, për shembull, rruga prej 49.000.000, pse të mbahen sikur vitin e kaluar ato 49.000.000 euro. Kemi marrë 42.000.000 dhe i kemi futur në të njëjtën kategori. I kemi ruajtur 7 milionë për eksproprijim dhe besoj që Komuna e Prizrenit së bashku me Ministrinë e Transportit do ti ekzekutojë ato, ndërsa pjesa e autostradës nuk është prekur, aq sa ka qenë e planifikuar. Pra, ajo ekziston dhe do të mbetet si prioritet i Qeverisë së Kosovës dhe nuk ka qenë në plan që të ekzekutohet gjithë projekti nëpërmjet buxhetit, por me anë të një investimi, i cili do bëhet, qoftë nëpërmjet kredisë, qoftë nëpërmjet partneritetit publiko-privat.

Meqenëse koha është e shkurtër, unë sinqerisht do t'ju falënderoja të gjithëve, mund të përgjigjem në secilën pyetje që...

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër!

Të nderuar deputetë, koha e diskutimeve ka përfunduar me fjalën e ministrit. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.

Votojmë tash:

Në sallë janë 87 deputetë. Konstatohet se me 58 vota “për”, 23 “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet në parim Projektbuxheti, Projektligji për ndryshimet e Ligjit nr. 03/L-088 për miratimin e Buxhetit të Kosovës dhe shpenzimet e autorizuara për periudhën prej 1 janar deri më 31 dhjetor 2008.

Në bazë të Rregullës 35.10 të Rregullores së Punës së Kuvendit, ngarkohet Komisioni për Buxhet dhe Financa, si komision funksional raportues, që për seancën e radhës t'i paraqes Kuvendit Raportin me rekomandime.

Nesër paradite vazhdon seanca e sotme, kurse pas dite është seanca e re për shqyrtimin dhe miratimin e dytë të Projektligjit për rishikimin e buxhetit.

Ju faleminderit!

Më 30 korrik 2008
(Vazhdimi i seancës)

KRYETARI : Të nderuar deputetë,

I nderuari Kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Mirë se erdhët në seancë! Vazhdojmë punën e seancës së djeshme.

Në rend të ditës kemi pikën e katërt:

- **Shqyrtimi i parë i Projektligjit për partneritet publiko-privat dhe koncesionet për sigurimin e infrastrukturës të shërbimeve publike dhe procedurat për dhënien e tyre**

Në bazë të Rregullës 35 pika 1 të Rregullores së Punës së Kuvendit, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim, në parim, të këtij projektligji.

Projektligji u është shpërndarë deputetëve më 10 korrik 2008.

Ftoj ministrin e Ekonomisë dhe Financave, zotin Ahmet Shala, që në emër të Qeverisë të Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë projektligjin.

MINISTRI AHMET SHALA: Mirëmëngjesi, të gjithëve!

I nderuari zoti Kryetar,

I nderuari zoti Kryeministër, zëvendëskryeministër,

Të nderuar kolegë ministra,

Të nderuar deputetë,

Kam nderin dhe kënaqësinë e veçantë që para jush sot ta paraqes ekspozenë lidhur me Ligjin për partneritetin publiko-privat, përkatësisht Ligjin për koncesionet.

Kosova, si shtet i pavarur, ka nevojë urgjente për investime substanciale në infrastrukturën e saj publike dhe shërbimet në të gjithë sektorët.

Ne vlerësojmë se gjatë 5 vjetëve të ardhshëm nevoja, përkatësisht diferenca në infrastrukturën e Kosovë në mes mundësive financiare për infrastrukturë të Kosovës dhe resurseve financiare në dispozicion, do të jetë diku në mes 1.5 dhe 3 miliardë euro dhe nuk do të ketë buxhet i cili mund ta mbulojë këtë hendek.

Siç e dini, Qeveria e Kosovës ka resurse financiare të kufizuara, andaj duhet të veprojë me një maturi fiskale për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Vetëm me ndihmën e investimeve dhe ekspertizës menaxheriale private Kosova mund t'i plotësojë nevojat e veta për infrastrukturë dhe shërbime cilësore.

Partneriteti publiko-privat siguron mundësi dhe hap ose shton nivelin e investimeve, pa i ngarkuar financat publike të Kosovës, përkatësisht, pa i ngarkuar taksapaguesit e Kosovës ose pa i ngritur taksat në Kosovë. Përkundrazi, duke thithur kapitalin privat në ato segmente ku buxheti apo donatorët nuk donë apo nuk mund të futen.

Infuzioni i kapitalit dhe i menaxhmentit privat mund t'i lehtësojë kufizimet fiskale, ta shtojë efikasitetin dhe ta përshpejtojë zhvillimin e infrastrukturës, duke ofruar në mënyrë simultane infrastrukturën dhe shërbimet e reja më cilësore.

Të nderuar deputetë,

Në këtë kontest, ligji i propozuar për partneritet publiko-privat ka për qëllim krijimin e kornizës për partneritetin publiko-privat dhe të koncesioneve në të gjithë sektorët e ekonomisë, në: transport, shëndetësi, arsim, energji, punë komunale, shërbime publike etj. përkatësisht, aty ku ka nevojë për investime kapitale të mëdha.

Dua të cek se ky ligj është hartuar në konsultim të ngushtë me ekspertët e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, Ministrisë së Transportit dhe Post-Telekomunikacionit,

Ministritë së Tregtisë dhe Industrisë, Ministritë së Energjisë dhe Minierave, si dhe në mbështetje të ekspertëve ndërkombëtarë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Më lejoni t'i falënderoj edhe në emrin tuaj të gjithë kolegët nëpër ministritë që i përmenda dhe ekspertët ndërkombëtarë për ndihmën dhe punën e pakursyer që kanë bërë për ta sjellë këtë ligj para jush dhe nesh.

Për sa i takon përmbajtjes, dua të theksoj se ky projektligj është në harmoni me sistemin juridik dhe kushtetues të Kosovës, ndërsa edhe me tepër është shkruar dhe është në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare siç janë: modeli i Qendrës së Kombeve të Bashkuara për Ligjin e tregtisë ndërkombëtare Uncitral, dispozitat legislative për projektin e infrastrukturës të financuara në mënyrë private, me parimet themelore të Berzhit, përkatësisht të Bankës Evropiane për Zhvillim dhe Rindërtim, me udhëzimet e Komisionit Evropian për Partneritet Publiko-Privat të vitit 2003, me Komunikatën e Komisionit Evropian të vitit 2005 për Partneritetet Publiko-Privat dhe Ligjin e komunitetit për prokurim publik dhe koncesione të Komisionit Evropian.

Në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare ligji, gjithashtu, vendos edhe kornizën institucionale të partneritetit publiko-privat, duke përfshirë komitetin ndërministror drejtues dhe Njësinë e Partneritetit Publiko-Privat.

Modernizimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës dhe e shërbimeve publike në Kosovë është e nevojshëm për të mundur konkurrimin e suksesshëm të Kosovës me ekonominë e tjera në rajon.

Ligji i partneritetet publiko-privat do t'i mundësojë Kosovës të garojë me vendet e tjera rajonale për investimet private, si dhe do t'ia hapë derën për zhvillimin e saj të qëndrueshëm ekonomik.

Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij ligji, i cili përcakton kornizën ligjore për zvogëlimin e hendekut infrastrukturor përmes stimulimit të investimeve në infrastrukturën publike dhe në sigurimin e shërbimeve publike, si dhe duke ditur faktin se kjo formë e investimeve është në trend, në rritje, në rajon dhe kudo në botë, ju ftoj ta përkrahni këtë ligj.

Deputetë të nderuar,

Ky ligj është kyç për ardhmërinë e Kosovës. Me partneritetin publiko-privat ne mund të ndërtojmë infrastrukturën dhe bazën tonë ekonomike, ato të cilat i kemi kërkuar nga populli i Kosovës, ato që i kemi premtuar, andaj ju lus të gjithëve që në bashkëpunim dhe në dialog të sigurtë sot ta përkrahni këtë ligj, në mënyrë që sa më parë të ecim përpara në projektet tona madhore. Faleminderit!

KRYESUESI IBRAHIM GASHI: E falënderojmë ministrin për ekspozenë e tij dhe kalojmë në diskutimet sipas radhës.

Paraprakisht ju njoftoj se në seancë janë 71 deputetë. Ftoj kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, nëse e dëshiron fjalën, ose dikush në vend të tij nga Komisioni. Nëse jo, atëherë i ftoj kryetarët e komisioneve të përhershme, nëse ka të tillë.

Sipas radhës, fjalën e kanë shefat e grupeve parlamentare. Fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar të PDK-së, zoti Ramë Buja.

RAMË BUJA: I nderuar, zoti kryesues,
Të nderuar kolegë deputetë,
I nderuari zoti Kryeministër, zëvendësministra dhe Kabinet qeveritar,

Ne si grup parlamentar e kemi shqyrtuar me shumë vëmendje, duke pasur parasysh ndikimin që ka ky ligj , po u aprovua, në zhvillimin ekonomik të Kosovës edhe pse konsiderojmë se është i vonuar, por më mirë vonë se sa shumë vonë ose kurrë. Duke pasur parasysh ndikimin e tij, ne gjithsesi do ta mbështesim në lexim të parë, duke insistuar që në leximin e dytë t'i bëjmë disa plotësime që janë të domosdoshme për t'u bërë dhe konsiderojmë që ajo që do të duhej bërë në këtë projektligj që do të bëhet ligj pastaj, është çështja e sqarimit të ndikimit të Parlamentit në krejt procedurën e këtij procesi të partneritetit dhe të koncesioneve.

Prandaj, unë besoj që puna që do të bëhet në komisionet gjegjëse do të ndikojë që ky ligj të bëhet ashtu siç i duhet Kosovës për rrethana në të cilat jemi dhe nëpër të cilat duhet të kalojmë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Buja!
Fjalën e ka përfaqësuesi i Lidhjes Demokratike të Kosovës, profesor Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike e përkrah, në parim, ligjin e paraqitur dhe shpresojmë që në diskutimet dhe në procedurat e mëtejshme do të marrë formën më të përshtatshme deri në aprovimin final. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Sipas radhës Grupi Parlamentar i AKR-së, deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuar kryesues,
I nderuari Kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra,
Deputetë të respektuar,

Parimisht, në emër të Grupit kuvendor të partisë politike Aleanca Kosova e Re, referuar Ligjit për partneritetin publiko-privat dhe koncesionet për sigurimin e infrastrukturës së shërbimeve publike dhe procedurat për dhëniet e tyre, do t'i parashtoj disa vërejtje parimore, të përgjithshme.

Titulli i këtillë i këtij dokumenti juridik është i stërzgatur pa nevojë, madje konfuz dhe i paqartë, ndaj titullimi i tillë implikon dhe reflekton, deshëm s'deshëm, përmbajtje jashtë kontestit të këtij dokumenti. Me një titull nuk mund të përfshihet përmbajtja e dokumentit, po e zëmë për Kushtetutën ishte dashur një titull 5 – 6 faqesh.

Ndryshe, edhe pa këtë dokument juridik, me postulatet kushtetutare dhe parimet fundamentale të transaksioneve juridike, garantohen, stimulohen dhe sanksionohen: liria, barazia kontraktore e subjekteve, entiteteve legale e natyrale publike dhe private.

Dispozitat e nenit 2, paragrafi 2 të këtij dokumentit juridik bien ndesh me parimin e barazisë juridike të subjekteve të së drejtës në transaksionet biznesore, ngase postulatit ie jusdispozitivum ia kanë mbivënë pa nevojë jusipmrvitumin apo juskogencin, veçanërisht kur theksohet se dispozitat e tij zbatohen vetëm në raportet kontraktore, që do të thotë ky ligj do të zbatohet vetëm në kontrata- nëpërmjet kontratave.

Shkurtesat e nocioneve ligjore PPP e tjera, e tjera në tekstin ligjor në vend të tyre duhet kuroherë të shprehen në tekst të plotë. Në këtë dokument juridik për disa institute juridike, siç janë: koncesioni, koncorciumi, PPP institucionale e tjera, nuk është përcaktuar definim dhe specifikim nocional i plotë, i qartë, madje as i drejtë, siç është interpretuar nocioni i korporatës në kolizion me doktrinën juridike dhe me aktin ligjor për organizatat biznesore, që është aplikativ, valid.

Rrjedhimisht, në këtë dokument juridik autoritetit kontraktor- neni 6, nuk i është përcaktuar komponenti i statusit të entitetit legal që është parakusht kondikcio sine kvanon për kapacitetin juridik e kontraktor.

Te premisa e aseteve është definuar keq e gabimisht se autoriteti kontraktues i partnerit privat përkohësisht mund t'ia bartë pronësinë në objektin e infrastrukturës dhe në asetet e tjera, të cilat pas skadimit të marrëveshjes është menduar gabimisht për kontratën, e marrëveshja nuk është kontratë, sepse marrëveshja është njëra nga katër komponentët e kontratës, duhet t'i kthehen autoritetit kontraktues.

Vijimisht, tekstet e këtij dokumenti juridik në shqip, anglisht, serbisht e boshnjakisht, nuk janë identike, konzistene as adapte.

Po ashtu, në shumë raste teksti i këtij dokumenti përmban gabime gjuhësore-terminologjike-juridike. Megjithatë, duke llogaritur në procesin dhe procedurën vijuese, veçanërisht në kontributin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi që do të bëhen edhe amendime edhe modifikime adekuate, Grupi kuvendor i partisë politike Aleanca Kosova e Re, këtë dokument e mbështet në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputet Smaka!

Radhën e ka Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Gjylnaze Sylja.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti Kryesues!

Të nderuar qeveritarë,

Të nderuar kuvendarë,

Partneriteti publiko-privat është partneriteti në mes sektorit publik dhe privat me të cilin sigurohen shërbime më të mira përmes investimit dhe menaxhmentit të përmirësuar. Pra, partneriteti publiko-privat është çfarëdo partneriteti në mes sektorit publik, qoftë të nivelit lokal ose qendror dhe të kompanive private.

Prandaj, ky projektligj është i një rëndësie të veçantë për Kosovën, sepse hap dyert për investime infrastrukturore në Kosovë dhe investimin e kapitalit privat në pasurinë shtetërore.

Iniciativa për këtë projektligj duhet mbështetur nga Kuvendi i Kosovës. Megjithatë, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës ka katër vërejtje kryesore në përmbajtjen e ligjit.

Vërejtja e parë është se në këtë ligj nuk duhet të trajtohet procedura për koncesion. Koncesioni është një formë e partneritetit, por është formë tjetër e partneritetit, sepse me koncesion merren në shfrytëzim pasuritë natyrore ose infrastruktura nga personat privat,

ndërsa partneriteti publiko-privat është partneritet ose investim i përbashkët publik dhe privat në një sektor të caktuar.

Pos kësaj, Kuvendi i Kosovës, në tetor të vitit 2005 e ka miratuar Ligjin për procedurën e dhënies së koncesioneve.

Vërejtja e dytë është se ne jemi të mendimit se format e partneritetit duhet të definojnë më mirë në këtë projektligj. Kemi forma të ndryshme të partneritetit publiko-privat që aplikohen ndërkombëtarisht, në mënyrë që investitorët ta kenë të qartë se çfarë lloj partneriteti ofron shteti i Kosovës, duhet qartë të definojnë në këtë projektligj.

Vërejtja e tretë është se jemi të mendimit se autoriteti publik kontraktues duhet të përcaktohet në ligj. Nuk është e qartë se kush është kompetent për dhënien e koncesionit ose të partneritetit. Pra, nuk përcaktohet saktë kush është autoriteti adekuat.

Vërejtja e katërt është se ne kundërshtojmë formimin e Komisionit Drejtues Ndërmënyës, i cili është kryekëput qeveritar, pasi përmbajtja e këtij komisioni është nga 4 anëtarë, gjegjësisht ministri i Ekonomisë dhe Financave, ministri i Tregtisë dhe Industrisë dhe, po ashtu, është një përfaqësues i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe një përfaqësues i emëruar nga Kryeministri, do të thotë, është kryekëput ndër-qeveritar.

Duke marrë parasysh se ky komision ka rolin që përgatit projektet dhe vendos, atëherë ne propozojmë një zgjidhje tjetër, që dy anëtarë të jenë nga Qeveria, dy anëtarë nga Kuvendi dhe një anëtar të delegohet nga Shoqata Profesionale Ekonomiste ose nga Sindikata e Pavarur e Kosovës. Në këtë rast, ky komision do ta ketë autoritetin vendimmarrës për projekte.

Në këtë mënyrë, gjithashtu, do të kontribuonim në transparencën, zvogëlimin e ndikimit partiak në dhënien e koncesioneve dhe projekteve të partneritetit publiko-privat, si dhe në ngritjen e profesionalitetit në marrjen e vendimeve. Kjo do të ishte, gjithashtu, një sinjal i mirë për investitorët potencialë në Kosovë. Nuk është me rëndësi kush është në pushtet, sepse nesër edhe ne si opozitë do të jemi në pushtet, por me rëndësi është që të krijojmë mekanizma funksionalë dhe apolitikë me rastin e investimeve publike. Kjo është në të mirën e Kosovës dhe të ardhmën e popullit të Kosovës.

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah Projektligjin, nëse inkorporohen vërejtjet përmbajtëse. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputete Sylja!

Fjalën e ka Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, deputeti Berim Ramosaj.

BERIM RAMOSAJ: Faleminderit, zoti Kryesues!

Përshëndetje për ekipin qeveritar dhe deputetët e nderuar,

Para se të flasim për arsyeshmërinë e këtij ligji, kisha për të thënë se, duke u nisur nga fakti se mungon legjislativë e përshtatshme për krijimin e raporteve partneriste midis privatëve dhe publikëve në Kosovë dhe dihet fare mirë se ekziston një grup i madh i shërbimeve që ende janë në pronësi publike, e në anën tjetër dihet se menaxhimi dhe efikasiteti i tyre në Kosovë janë të mangëta, atëherë sigurisht nxjerrja e një ligji për

partneritet publiko-privat ka arsyeshmërinë shumë të madhe, sepse ajo do të jetë, sigurisht, një injeksion i fortë edhe në aspektin e ndërhyrjeve investive në ndërmarrjet publike ekzistuese dhe forma tjera të organizimit publik, por në anën tjetër do të reflektojë edhe në një menaxhim më të suksesshëm.

Vërejtja kryesore të ky ligj qëndron tek dy komponentë. Edhe për krijimin e raporteve të mira të partnerizmit publiko-privat, që ishte dashur të nxirret një ligj i veçantë për marrëdhëniet partneriste apo mundësinë e komunikimit partnerist midis pronës publike dhe pronës private dhe një ligj i veçantë për koncesione. Jemi fare të vetëdijshtë se ka pasur iniciativa shumë më herët për hartimin e një ligji të përshtatshëm për koncesione, por marrëdhëniet e tilla të parregulluara statusore të Kosovës e kanë penguar. Ne mendojmë se hartimi i një ligji vetëm për koncesione do t'i zgjidhte shumë probleme të natyrës së tillë të hapësirave të mundshme investive për partnerët e huaj apo për partnerët tanë në fushat e caktuara të cilat, në të vërtetë Kosova nuk ka aftësi buxhetore t'i fuqizojë kur është fjala për infrastrukturë, kur është fjala për shërbime të karakterit të gjerë, andaj një ligj i veçantë i koncesioneve kishte për të dhënë rezultate shumë më të mëdha. Ky kombinim midis koncesioneve, në njërën anë dhe partneritetit publiko-privat, në anën tjetër, frikohem se do të humbë edhe rëndësinë e elementit koncesional i cili është shumë i rëndësishëm për këtë fazë të zhvillimit të Kosovës.

Andaj ne, sigurisht, do të ishim më të kënaqur dhe do ta merrnim me një sens më proaktiv në qoftë se do t'ia kishim sjell këtij Parlamenti apo Qeveria do të sponsoronte dy ligje në fakt- Ligjin për partneritet publiko-privat dhe Ligjin për koncesione. Kjo do të ishte, ndoshta, formë më e mirë e komunikimit edhe me investitorët e huaj.

Sidoqoftë, duke marrë parasysh rëndësinë e hartimit të një ligji, duke u mbështetur në mungesën tonë për investime, në paaftësinë buxhetore të Kosovës për mbulimin apo format e tilla të investimeve, qoftë në shërbimet publike, qoftë në ato të tjerat, ne do të kemi qasje parimore, pra do ta përkrahim si ligj, andaj, duke marrë parasysh se janë fenomene të natyrës zhvillimore-ekonomike, Lidhja Demokratike e Dardanisë do t'i japë përkrahje këtij ligji, me kusht që në një të ardhme të afërt të hartojmë një ligj të veçantë për koncesione dhe një ligj të veçantë për partneritet, ashtu si e kanë shumica e vendeve edhe të rajonit, por të mos flasim edhe në nivel Evropian. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputetit Ramosaj!

Në emër të Grupit Parlamentar "7+" fjalën e ka kërkuar deputeti dhe anëtar i Kryesisë, Xhezair Murati.

DŽEZAIR MURATI: Hvala vam, gospodine predsjedavajući!

Dozvolite da pozdravim premijera, zamenike premijera, ministre i kolege poslanike i da u ime Parlamentarne Grupe „7+“ kažem da i mi mislimo da je ne samo realno, nego više nego potrebno usvajanje ovog zakona a time i stvaranje uslova za strana ulaganja koja su neophodna infuzija u mladu privredu kosovske države.

Tačno je da je tekst Nacrta glomazan i mi delimo mišljenje sa onima da je on nezgrapan, te ga treba sigurno i sažimati i pojasniti u daljem radu.

Sve u svemu, strana ulaganja koja će u zajedničku strategiju sa domaćim partnerima biće sigurno lokomotiva posrnule i zamrle privrede, koja će udahnuti svež dah celokupnom razvoju društva, omogućiti se samo razvoj, nego stvoriti kvalitetnu konkurenciju, i ne samo u okruženju, nego i šire, jer samo tako možemo očekivati da kosovska država bude

deo ne samo demokratskih, nego i ekonomskih promena kako u Jugoistočnoj Evropi, tako i šire. Mi, dakle, podržavamo ovaj zakon, ali smo mišljenja da treba otkloniti sve one nedostatke, nejasnoće koje postoje. Hvala vam! Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Radhën e ka Grupi SLS, përkatësisht deputeti Bojan Stojanović.

BOJAN STOJANOVIĆ: Poštovani predsedavajući,

Vladin kabinetu,

Drage kolege poslanici,

Želim da kažem da Samostalna liberalna stranka podržava ulazak ovog zakona u skupštinsku proceduru. Naravno, sledi period odmora, imaćemo dosta vremena da radimo na tome. Funkcionalne komisija će odraditi posao, nadam se kao i do sada. Svakako, smatramo da ulazak ovog zakona u skupštinsku proceduru može da donese boljitak, znači gde su veće investicije, prosta je činjenica, više novca, više hleba, bolji život. Gde ima para, ima para za sve zajednice, zajedno pa ćemo videti ko bude znao bolje da menadžira u svemu tome, bolje će snaći. Naravno, pošto se radi o zakonu koji po prvi put ulazi u skupštinsku proceduru, verovatno će biti potrebno da se donosi neka pozakonska akta kako bi se zakon usavršio, ali što pre krenemo sa usvajanjem zakona, pre ćemo i doći do podzakonskih akata i da ovu oblast regulišemo onako kako bude trebalo po evropskim standardima i propisima. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Nga deputetët që kanë kërkuar fjalën për diskutim është paraqitur vetëm deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Zoti Kryeministër, zëvendëskryeministra,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Mjafton njëri të flasë dhe të flasë ashtu si duhet. Po ia japim vulën këtij projektligji edhe pse i vonuar. Për kohëzgjatje po ndërlidhem me diskutimin e djeshëm që e patëm në lidhje me buxhetin e Kosovës dhe unë besoj se të gjithë pajtohem se ky buxhet nuk ka mjete të mjaftueshme që t'i financojë projektet e nevojshme apo projektet madhore në Kosovë.

Prandaj, duke marrë parasysh faktin se në Kosovë, në vendin tonë është një boshllëk i madh në mes të kërkesave për ndërtimin e infrastrukturës dhe shërbimeve dhe mundësisë së afrimit të infrastrukturës dhe shërbimeve, ky ligj besoj më në fund vendos themelet ku në sektorët e ndryshëm mund të involvohet kapitali privat, duke zvogëluar boshllëkun e lartpërmendur dhe duke liruar fondet nga buxheti i Kosovës, të cilat do të investohen në fusha shumë të rëndësishme apo të kërkuara, siç janë: arsimi, shëndetësia, mirëqenia sociale apo projekte të ndryshme.

Prandaj, me involvim të kapitalit privat dhe një ekspertizë të menaxhmentit nga infrastruktura publike, Kosova mund të tërheqë investime dhe teknologji të re nga jashtë dhe në të njëjtën kohë të ofrojë shërbime sa më efikase, duke pasur parasysh çmimet e arsyeshme për publikun dhe të jemi konkurrentë edhe në rajon.

Të nderuar kolegë deputetë,

Përveç beneficioneve ekonomike, unë besoj që Kosova jo vetëm që do të përfitojë edhe politikisht duke involvuar kapitalin e huaj në ndërtimin e vendit tonë dhe besoj do të jetë garanci dhe përkushtim nga fuqitë e mëdha ekonomike për ta ruajtur stabilitetin dhe sigurinë në Kosovë. E gjithë kjo, duke marrë parasysh që Projektligji për partneritetet publiko-privat dhe koncesionet do t'i ofrojnë këto kushte. Të gjithë kemi brengën edhe nga rajonet e ndryshme prej nga vijmë, ndoshta, me këtë projektligj sidomos, vendit tim- Deçanit i hapet një perspektivë shumë më e madhe, sepse do të përfitojë nga bukuria natyrore për ndërtimin e një sektori të fuqishëm të turizmit në Bjeshkët e Nemuna. Mendoj se partneriteti publiko-privat është e vetmja mundësi për ngjalljen e këtij sektori.

E vetmja vërejtje që unë mund ta jap dhe është mendim imi është te kohëzgjatja e një koncesioni. Unë besoj që është shumë i shkurtër në 40 vjet. Duke marrë parasysh praktikën më të mirë që janë në vende të njohura, unë mendoj dhe jap një propozim timin personal që do të jetë në 99 vjet. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputet Zemaj!
Ndërkohë, për fjalë është paraqitur deputetja Edita Tahiri. Urdhëroni!

EDITA TAHIRI: Faleminderit, zoti Kryesues!
Deputetë të nderuar,
Qeveritarë të nderuar,

Më lejoni që të vlerësoj se ky projektligj ka rëndësi të veçantë për proceset e zhvillimit, veçmas ekonomik të Kosovës edhe inkuadrimi i sektorit privat, jo vetëm që është i domosdoshëm, por kërkon të gjitha qasjet bashkëkohore në zhvillimin ekonomik të një vendi.

Duke marrë parasysh që ky projektligj, me atë sa kam vërejtur, e shfuqizon Ligjin për koncesione, unë mendoj se këtij projektligji duhet t'i bashkëngjitet një dokument i interesave nacionale, mirëpo kur jemi te dokumenti i interesave nacionale, në fakt Kosova që nga paslufta nuk ka arritur të hartojë një kornizë të tillë ku definohen fushat e interesit nacional të Kosovës dhe unë besoj që kjo Qeveri do ta mbushë këtë vakum shumë të rëndësishëm, i cili ka mbetur nga e kaluara, ndërsa në këtë projektligj mendoj se minimumi është që të figurojë lista e specifikuar e fushave ku mund të zbatohet pra ky partneritet publiko-privat. Pra, kam edhe një propozim tjetër që ndërlidhet edhe me propozimin që erdhi nga AAK-ja- është fjala e inkuadrimit të rolit të Parlamentit në këtë proces. Tash forma si do gjendet, unë mendoj se komisionet që do të punojnë në fazën e dytë do të arrijnë një zgjidhje, mirëpo është me rëndësi që të ketë një qasje integruese Qeveri- Parlament në kuadër të vendimeve për procesin e partneritetit publiko-privat. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Ndërkohë, për fjalë është paraqitur deputeti Vlladimir Todoroviq.

VLADIMIR TODOROVIC: Hvala, gospodine predsedavajući!
Gospodine Premijeru,
Dame i gospodo poslanici,

Ovaj zakon o kome je reć biće veoma dobar ukoliko se budžet dodeljuje na jednakim časima ili prioritetno. Ja ću da vam kažem da dosadašnji rad i dodeljivanje budžeta na lokalnom nivou je, ja iz koje sredine dolazim, to je Obilić i vi sigurno znate u kakvoj se

situaciji on nalazi. Na godišnjem nivou dodeljeno je 400 hiljade eura, na godišnjem nivou, zapamtite, a Obilić se nalazi možda na prvom mestu u čitavoj teritoriji Kosova koje je u veoma katastrofalnim odnosima, kažem odnos, a to je infrastruktura, zdravlja, prosvete i tako dalje. Mislim da tu i pozivam premijera da organizuje jedan ekspertni tim. Gospodine premijeru, ja vama govorim ovde, možda me ne naslušate!

Da dodjete u Obiliću i da vidite sa kakvim se problemima nalazi opština Obilić, jer Obilić ima negde sve skupa 35 hiljade stanovnika. Infrastruktura je na nuli sa 400 hiljade eura, kako sam juče doznao, ne možete napraviti ništa, a toliko zagađenosti, da samo jedno kažem, što se tiče zdravlja, da budete upoznati, svaki peti građanin boluje od kancera. Prema tome, tražim da se budžet u određenim slučajevima poveća u našoj opštini i da bi mogli da se steknu bolji uslovi za sve građane...

KRYESUESI: Zoti deputet, përmbajuni temës, diskutoni për Projektligjin në fjalë.

VLADIMIR TODOROVIĆ: ... Dozvolite, Zakon je veoma dobar ukoliko kažem date prednost stvarima na lokalnom nivou. Dobar je zakon ukoliko budete povećali budžet tamo gde je veoma mali da bi mogli sve potrebe građana da ispunjavamo. Hvala najlepše!

KRYESUESI: Faleminderit!

Ndërkohë, deputetët që sa po vijnë me vonesë, janë paraqitur për fjalë. Fjalën e ka kërkuar deputetja Myzejene Selmani, le të përgatitet deputeti Gani Koci.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje për Kabinetin qeveritar,

Përshëndetje për zotin Kryeministër me dy zëvendëskryeministrat,

Ligji është më se i mirëseardhur nga Qeveria, është një projektligji i cili ka munguar momentalisht Kosovës, mirëpo, siç po shihet, ka pak interesim për diskutim për këtë projektligj nga Kabineti qeveritar

Pra, ky projektligj është i mirëseardhur dhe përkundër vërejtjeve nga deputetët, me sa më duket, ne kemi miratuar Ligjin për ndërmarrjet publike, i cili është bazament për Ligjin për koncesione, ku të gjitha kompetencat i jepen Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave. Njëkohësisht, disa kompetenca u jepen edhe ministrive përkatëse, në të cilat zoti ministër ceku se do të bëhen koncesione, si në Ministrinë e Transportit, Ministrinë e Energjisë, dhe mesa më duket, edhe në atë të Shëndetësisë, që do të thotë se esenciale për këtë ligj do të jetë sa do të jenë vitet e koncesionit për partnerin i cili do të hyjë në koncesion në favor të Qeverisë, sepse kuptohet se Qeveria është partneri kryesor i cili bën koncesionet. Meqë nuk po kanë durim deputetët, çdo vërejtje që kemi për këtë projektligj do t'ia adresojmë komisionit përkatës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Para se të vazhdojmë me diskutime, ju njoftoj se në seancë janë 77 deputetë. Fjalën e ka deputeti Gani Koci.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti Kryesues.

Unë erdha me vonesë, sepse Komisioni për Buxhet kishte të bëjë me buxhetin tash që e kemi seancën pas dite, prandaj kërkoj falje.

Nuk e di në çfarë drejtimi janë zhvilluar diskutimet rreth këtij projektligji, por unë do të përpiqem të përqendrohem në tri çështje që mendoj se do të duhej të kihen parasysh gjatë miratimit dhe amendimit të këtij projektligji.

Në fillim dua të them se, vërtet, ky ligj ka munguar tash sa kohë dhe është i vonuar në Kuvendin e Kosovës dhe, ndoshta, si pasojë e mosekzistimit të bazës ligjore, janë vonuar edhe investimet dhe futja e kapitalit privat në Kosovë dhe në ekonominë e Kosovës. Dilemat kanë të bëjmë me atë, sepse ne kemi pasur një ligj të procedurave të koncesionit, ndërsa kërkesa shumë më herët ka qenë që të kemi një ligj të mirëfilltë të koncesionit dhe, sa kam mund të analizoj, është një përsëritje në shumë çështje nga ligji paraprak që është i proceduar për koncesionin, prandaj propozuesi është dashur ta ketë parasysh këtë fakt.

Fakti i dytë është se vetë titulli Ligji për partneritet publiko-privat dhe koncesione për mënyrën e sigurimit të shërbimeve publike është shumë i stërzgatur dhe do të duhet ndryshimi të ndodhë këtu së pari. Ndërsa, ajo që për mua është esenciale se në këtë ligj janë paraqitur në mënyrë të përgjysmuara objektet që mund të jenë ose të mirat kombëtare, të mirat natyrore që mund të jenë objekt i koncesioneve dhe konsideroj në këtë drejtim në mënyrë taksative duhet të përsëritet se çka mund të jetë lëndë e koncesionit dhe, natyrisht, kur thuhet çka mund të jetë, nënkupton se çka nuk mund të jetë lëndë e koncesionit nga të mirat edhe kombëtare, edhe natyrore në përgjithësi.

Çështja tjetër që ka të bëjë, është çështja e afatit. Sipas praktikave të regjioneve përreth, megjithatë konsideroj se afati për dhënien me koncesione është i zgatur, është më i madh se sa që duhet të jetë, prandaj duhet të shkurtohet afati i dhënies me koncesione. Unë po e marr si shembull, kohëzgjatja e një termoelektrane është 30 vjet më së shumti dhe me rehabilitime mund të zgjatet, ndoshta edhe 15 vjet tjera, por e ka afatin e vet të zhvillimit dhe të fuqisë për të cilën është projektuar, prandaj afati duhet të kihet parasysh. Ajo që për mua është shumë esenciale, është roli i Kuvendit në dhënien e koncesioneve, që ky ligj e përjashton absolutisht. Unë konsideroj se Kuvendi është ai që mund të krijojë sigurinë më të madhe edhe në tërheqjen e investitorëve, sepse vendimet e Kuvendit janë valide, qeveritë mund të ndërrohen, ndërsa vendimet e Kuvendit janë që sigurojnë dhe krijojnë siguri më të madhe për investitorët. E them këtë për vetë faktin, sepse në ligj, komplet roli i Kuvendit në këtë çështje dhe në këtë fushë është i përjashtuar dhe nuk do të duhej të ishte, prandaj mendoj se gjatë amendimit kjo do të kihet parasysh dhe duhet të dihet se në të cilat raste nevojitet vendimi i Kuvendit dhe për cilat objekte të koncesionit nevojitet vendimi i Kuvendit, sepse jo për të gjitha koncesionet edhe jo për të gjitha marrëveshjet për partneritet privato-publik do të duhej të pritet një vendim i Kuvendit. Këto ishin ato çështje për të cilat konsideroj se duhet të kihen parasysh gjatë amendimit të këtij projektligji dhe të sjelljes në Kuvend për miratim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Dhe diskutuesi i fundit i paraqitur, deputeti Ramadan Avdiu.

RAMADAN AVDIU: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar Kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,

Të respektuar kolegë deputetë,

Ligji të cilin po e shqyrtojmë sot, pa dyshim se plotëson një vakum ligjor në fushën e investimeve dhe do të ndikojë në adaptimin e ekonomisë kosovare në trendet e ekonomisë globale.

Ajo çka dua të theksoj unë është që gjatë procesit të shqyrtimit nëpër komisione funksionale, vërtet do të duhet të rishikohet titulli i ligjit, sikurse edhe fushat të cilat do të duhej të specifikoheshin si resurse të interesit nacional, në të cilat nuk do të mund të ketë partneritet, kurse përfshirja e Kuvendit është e rëndësishme, por jo në të gjitha fushat, por do të duhet të gjendet një dispozitë ligjore se ku do të duhet të jetë roli i Kuvendi për rëndësinë e një partneriteti ose mbi një shumë të caktuar, domethënë të atij partneriteti. Nuk është e domosdoshme që Kuvendi të jetë i involvuar në të gjithë procesin, por në disa fusha roli i Kuvendit është i domosdoshëm. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Para se t'i përmbyllim diskutimet, pyesim ministrin nëse ka për të shtuar diçka. Fjalën e ka ministri i Ekonomisë dhe Financave, zoti Ahmet Shala.

MINISTRI AHMET SHALA: Të nderuar deputetë,

Unë sinqerisht ju falënderoj për vërejtjet tuaja qëllimira, të cilat konsideroj që në ecje e sipër të miratimit të këtij ligji disa prej tyre me kënaqësi do t'i inkorporojmë. Mbase ka nevojë për sqarime, shumë nga sugjerimet, përkatësisht vërejtjet ishin edhe të karakterit të niveleve të ndryshme të njohjes së gjithë procesit dhe nuk dua të hy në debat tani, mbase ka nevojë për të sqaruar. Ne kemi pasur parasysh edhe përvojat në rajon, ka përvoja të mira, ka edhe të këqija, por nuk duhet të jemi kopjues kështu symbyllur se çfarë ka qenë në regjion. Konsideroj që Kosova ka një përparësi, nëse mund të them, në shumë aspekte. Disa nga gabimet që disa shtete i kanë përjetuar ato, janë duke i lëshuar dhe duke ecur nga një konsolidim më modern i ligjeve të koncesioneve ose të partneritetit publiko-privat.

Sa i përket numrit të ligjeve, pati vërejtje se a duhet të jetë një ligj apo më shumë ligje. Për investitorin, sa më i thjeshtë të jetë legjislacioni, sa më pak adresa në ligje të ketë, është më mirë. E di që në vitin 2005 është aprovuar Ligji për procedurat e koncesionit. Ne në këtë ligj i kemi shkruar të dy fazat, edhe procedurën, edhe dhënien, përkatësisht edhe përmbajtjen dhe për secilin investitor kur të shkosh në një shtet, qoftë edhe për vetë ndërmarrësit, është me rëndësi që të kenë një adresë. Shpeshherë dy ligje mund të vijnë në kundërshtim njëri me tjetrin, mund të ketë komentime të ndryshme. Kemi përvoja mjaft të këqija edhe gjatë këtyre 8 vjetëve në këtë drejtim, andaj kemi konsideruar dhe i kemi marrë përvoja më të mira dhe sugjerimet e ekspertëve të niveleve të larta botërore.

Sa i përket filtrit, përkatësisht involvimit të Parlamentit, ne kemi diskutuar me disa nga deputetët dhe në parim pajtohemi, mbase mund të pajtohemi që për disa nivele të projekteve të mëdha nacionale mund të kemi një konsultim apo një formë, nëse mund të them të involvimit të Kuvendit për dhënien e lejes për shuma të caktuara, por sugjerimi im si ministër edhe si ekonomist do të ishte që Kuvendi të mbajë pozicionin e vetë ligjdhënës. Pra, edhe në këtë ligj të mos ia lidh duart vetit të bëhet një operator, nëse mund të them, i përditshëm i dhënies së lejeve të koncesionit për shuma të vogla, për objektet e vogla.

Nëse më lejohet një sekondë, supozojmë le të japim një shtëpi shëndeti, me siguri mjekët do të më kritikojnë në këtë rast, ose le të themi një hallë sportive ose çfarëdo qoftë objekti që nuk ka nevojë Kuvendi të involvohet në te, por sigurisht në qoftë se duhet të

jepet për 50 vjet ose për ndonjë kohëzgjatje më të madhe, ku involvohen miliarda investime, mundet mbase dhe do të duhej që Kuvendi të ketë një formë apo tjetër të involvimit dhe me kënaqësi do të ulemi të bisedojmë, këtë e kemi biseduar edhe me disa grupe parlamentare në këtë drejtim.

Sa i përket strukturës së Këshillit Ndërmnistror, praktikat më të mira japin që kjo strukturë të jetë qeveritare, por të ketë transparencë, natyrisht, sepse tek e fundit përgjegjësinë për një politikë të mirë apo të keqe e merr Qeveria. Tek e fundit, shtetin e udhëheqin qeveritë dhe në qoftë se ka politikë të mirë apo të keqe, mekanizmi i votës jep fjalën e vet, kështu që në atë drejtim do të kisha kërkuar mirëkuptim dhe të ulemi të bisedojmë në këtë drejtim.

Sa i përket kohëzgjatjes, vetëm sa për sqarim, kohëzgjatja është në korrelacion të drejtë me disa elemente. Është në korrelacion të drejtë me vëllimin e investimeve dhe sa më i lartë të jetë vëllimi i investimeve, kohëzgjatja do të duhej të jetë më e lartë, sepse kur i kthen ai, tek e fundit pastaj barra për pagimin e taksës do të jetë shumë e lartë. Këtu supozojmë autostradën, në qoftë se japim, nëse kërkohej 1 miliard euro, nëse i jep për 25 vjet, çdo makinë do të duhej të paguante mbase nga 10 euro në qoftë se japim për 50 vjet do të zbritet taksë vjetore ose do të duhej që shteti të marrë përgjegjësinë çka në qoftë se ndërrohen struktura, se njerëzit udhëtojnë me avion, apo me tren, apo me diçka tjetër, kështu që janë të gjitha këto elemente që ekspertët tanë i kanë pasur parasysh dhe kanë dhënë fleksibilitet në këtë drejtim. Ligji do të ishte, ne kemi propozuar 40 vjet, me mundësi të vazhdimit edhe 10 vjet, por nuk do të thotë që për projekte të vogla ose të mesme të shfrytëzohen maksimalisht, varësisht nga vëllimi dhe nga elementet e tjera që janë të rëndësishme për shtetin.

Me kaq do të kisha përfunduar, në mënyrë që të japim mundësi që në grupet parlamentare, përkatësisht në komision të ulemi të bashkëbisedojmë. Jemi shumë të gatshëm, kam të involvuar një ekip të shkëlqyeshëm vendor dhe ndërkombëtar në këtë. Besoj që kemi bashkëkoordinuar shumë mirë me ministrinë përkatëse dhe ju lus për përkrahje në vazhdim të këtij procesi. Sa më shpejtë që e përmbyllim, aq më shpejtë projektet tona nacionale të cilat nuk kemi mund t' i zhvillojmë me buxhet, do t' i zhvillojmë. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër për sqarimet plotësuese!

Në vazhdim, kërkohej që të deklarohemi për miratimin në parim të Projektligjit.

Në sallë janë prezentë 86 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, vetëm me kartela. Votojmë tash:

Konstatohet se me 76 vota “për”, 7 “kundër” dhe 2 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për partneritet publiko-privat dhe koncesionet për sigurimin e infrastrukturës së shërbimeve publike dhe procedurat për dhënien e tyre.

Në bazë të rregullave 23.7 dhe 35.4 të Rregullores së Punës së Kuvendit, Kuvendi ngarkon këto komisione:

- Komisionin për Buxhet dhe Financa, si komision funksional dhe raportues,
- Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi,
- Komisionin për Komunitete dhe
- Komisionin për Integritet Evropian.

Komisionet, brenda 2 muajve nga shqyrtimi i parë, duhet që Kuvendit t'i paraqesin raportin me rekomandime.

Të nderuar deputetë,

Kalojmë në pikën e pestë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për vula në institucionet e Republikës së Kosovës

Miratimi në parim i këtij projektligji është bërë më 4 prill 2008. Komisionet parlamentare të përhershme kanë shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media, si komision funksional dhe raportues ka shqyrtuar Projektligjin për vula në institucionet e Republikës së Kosovës dhe i ka rekomanduar Kuvendit miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Raportet e komisioneve parlamentare u janë shpërndarë deputetëve. Para se të procedojmë me votim të amendamenteve të propozuara, ftoj kryetarin ose raportuesin e komisionit funksional, nëse e sheh të nevojshme për ta arsyetuar raportin me rekomandime. Këtë të drejtë e kanë edhe kryetarët e komisioneve kryesore, nëse e kërkojnë fjalën. Atëherë, fjalën e ka kryetari i Komisionit, Esat Brajshori.

ESAT BRAJSHORI: Faleminderit, zoti Kryesues!

Komisioni, në mbledhjet e veta që ka pasur dhe ka shqyrtuar këtë projektligj, ka propozuar një amendament. Duke parë se neni 6.3 në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe apo boshnjake dhe angleze nuk përputhen, ka propozuar amendamentin që në tekstin në gjuhën serbe dhe angleze, pas fjalës “institucioneve” të shtohet fjala “komunale”, domethënë vetëm ky ka qenë një amendament i ri nga Komisioni. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka kërkuar edhe deputeti dhe ministër njëkohësisht, zoti Mahir Jagcilar.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Të nderuar ministra dhe deputetët,

Derisa nuk votohet amendamenti numër 1, dëshiroj të jap disa shpjegime, por këtë herë në cilësinë e deputetit.

Për amendamentin në fjalë është folur edhe në Qeveri, ku ishte miratuar formulimi nga Ligji për përdorimin e gjuhëve 4.6, ku thuhet se emrat zyrtarë të institucioneve qendrore paraqiten në gjuhët zyrtare, si dhe në gjuhët zyrtare të komunës. Sigurisht, ndërkohë ka ndodhur ndonjë gabim teknik. Për ta tejkaluar situatën, mendoj, ose që të mos kontestohet edhe kushtetutshmëria e Projektligjit, mendoj se duhet të miratohet propozimi i Komisionit për Komunitete. Kështu do të veprohet në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Ligjin për përdorimin e gjuhëve. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Fjalën e ka kërkuar deputeti Bojan Stojanoviq.

BOJAN STOJANOVIĆ: Hvala, gospodine predsedavajući!

Ja želim da se obratim Skupštini kao predsednik Komisije za zaštitu prava i interesa zajednica. Naravno, hteo bih da zamolim da kasnije date reč gospodinu Enisu Kervanu, koji će u ime Komisije podrobnije izvesti o ovom amandmanu. Medjutim, radi se o jednoj stvari da kada se dešava da imamo dva ili više predloga vezano za jedan amandman, po uslovu član 81. stav od 1 do 7, u konkretnom slučaju vezano za stav 2. i 3. o službenoj upotrebi jezika, Skupština bi trebala da o amandmanima ili o zakonima koji se direktno tiču zajednica, gde postoji određena opravdanost ili sumnja da se time mogu ugroziti prava i interesi zajednica, glasati duplom prostom većinom.

Skupština do sada nije imala takav način izjašnjavanja, medjutim Ustav je jasan i precizan, zato vas pozivam da dok to ne razmotrimo, da u ime Komisije za prava i interese zajednica da Skupština u glasanju kao što smo do sada imali praksu, podrži amandmanu 1. opciju b), znači da se harmonizuju verzija na srpskom i engleskom sa verzijom na albanskom jeziku. Ja vas molim još jednom da date reč gospodinu Enisu Kervan, pošto je on konkretno radio na tom amandmanu, da bolje obrazloži u ime Komisije za prava i interese zajednica. Hvala!

KRYESUESI: Lidhur me diskutimin e fundit të zotit Stojanoviq, e pyesim kryetarin e komisionit funksional, a pajtohet?

ESAT BRAJSHORI: Faleminderit, zoti kryesues!

Nuk e di pse lidhet me Kushtetutën kjo çështje? Ne jemi brenda Kornizës Kushtetuese, brenda Kushtetutës. Këtu bëhet fjalë për institucionet komunale të nivelit komunal dhe ne kemi respektuar të drejtën e përdorimit të gjuhëve, domethënë, ne kërkojmë që të harmonizohet teksti në gjuhën angleze dhe serbe me atë shqip, siç e keni në amendamentin e propozuar nga komisioni funksional. Pra, krejt çka ne kërkojmë është që prapa fjalës “institucione” të shtohet dhe “komunale” dhe bëhet fjalë për përdorimin e gjuhës së komuniteteve në nivel komunal në këtë rast. Kaq është kjo, ne jemi brenda Kushtetutës.

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka kërkuar deputeti Fehmi Mujota, në emër të Komisionit.

FEHMI MUJOTA: Faleminderit, zoti kryesues!

Në fakt, për të përforcuar mendimin të cilin, posa e tha kryetari i komisionit përgjegjës parlamentar, duhet ta kemi vëmendjen e plotë të neni 6.3, ku tekstualisht thuhet se teksti i vulës së institucioneve komunale shkruhet me shkronja të mëdha të shtypit në madhësi dhe formë të njëjtë në gjuhët zyrtare të komunave. Propozimi i Komisionit për të Drejtat e Komuniteteve në fakt bie në kundërshtim me Kushtetutën, përkatësisht nenin 58, në 7 paragrafe dhe nenin 59, në 14 paragrafe, që obligojnë Republikën e Kosovës t'i respektojë të drejtat e komuniteteve. Për të sqaruar edhe më tepër në këtë rast, konkretisht, në Prizren do të mënjanohej e drejta e përdorimit të gjuhës turke në vulën institucionale komunale. Prandaj, ka qenë një lëshim i pavëmendshëm i Komisionit për të Drejtat e Komuniteteve dhe mendoj që si komision funksional kemi vepruar drejt dhe duhet të përkrahet pika a).

KRYESUESI: Faleminderit, deputet Mujota!

Për fjalë është paraqitur Enis Kervan, por pa kartelë.

ENIS KERVAN: Faleminderit, zoti kryesues!

Kërkoj falje që nuk e kam kartelën me veti dhe që 2 ditë as nuk po mund as të votoj dhe askush nuk na dha një sqarim pse deputetët pa kartelë nuk po mund të votojnë. Në qoftë se është marrë ndonjë vendim, kisha pasur dëshirë të njoftohem me këtë.

Edhe në shqyrtimin e parë të këtij projektligji unë kam kërkuar mirëkuptim dhe përkrahje nga komisioni funksional dhe, natyrisht, nga ju të nderuar kolegë lidhur me nenin 6.3 të këtij ligji. Për këtë unë me të vërtetë dua të falënderoj komisionin funksional që ka diskutuar propozimin tim, por mendoj që nuk jam kuptuar mirë, sepse propozimi im dhe i Grupit Parlamentar “7+” ka qenë se neni 6, paragrafi 3 i Projektligjit në fjalë, teksti në gjuhën shqipe duhet të harmonizohet me versionin në gjuhën serbe dhe angleze, duke fshirë fjalën “komunale” e jo duke shtuar dhe me përkrahjen e të gjithë anëtarëve të Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve, jo vetëm të komuniteteve pakicë, por edhe të anëtarëve të tjerë shumicës që ekzistojnë në këtë Komision, ne kemi amenduar këtë propozim: Bazuar në nenin 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili thotë që gjuhët janë në çdo nivel dhe i cili ndërlidhet me Ligjin për përdorimin e gjuhëve dhe parashihet kjo e drejtë, nuk është që nuk parashihet, prandaj, unë dëshiroj mirëkuptim dhe në një mënyrë edhe përkrah zbatimin e këtij ligji për përdorimin e gjuhëve prej juve dhe ju ftoj të votoni amendamentin 1, propozimin b) të Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve. Ju falënderoj për mirëkuptim!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Në këtë rast, para se të vazhdojmë me diskutime, e kisha ftuar deputetin Bahri Hyseni, në emër të Komisionit për Legjislacion, nëse ka për të shtuar diçka.

BAHRI HYSENI: Natyrisht, po!

Faleminderit, zoti kryesues!

Unë nuk do të shtoja asgjë më tepër se kryetari i komisionit funksional, mirëpo vetëm potencoj çështjen që nëse votohet propozimi si është menduar nga Komisioni i Komuniteteve, atëherë bie ndesh me Kushtetutën e Kosovës, sepse e drejta është dhënë për përdorim të vulave, mirëpo në institucionet komunale, në këtë rast. Prandaj, do të ishte një ndeshje ndërmjet përdorimit të vulave, sepse nuk është dhënë e drejta që në institucionet qendrore të përdoret vula e komunave përkatëse. Prandaj, është mirë që të miratohet propozimi i komisionit funksional, sepse përndryshe ndeshemi më vonë me bazën juridike të Kushtetutës.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet për sqarime të rëndësishme!

Në vazhdim, fjalën e ka kërkuar deputeti Numan Baliq.

NUMAN BALIĆ: Ako dozvolite da dam još jedno objašnjenje koje se tiče ovih stvari s obzirom da sam kao član ove Komisije učestvovao u donošenju ovog amandmana. Ne mislim da se ovde radi samo o odnosu komisije i ostalih ljudi u parlamentu, niti da postoje sukobi o kojima se govori. Predlažem da poslanici u Parlamentu Kosova pokažu razumevanje koje je vrlo važno. Ne radi se samo o članovima Komisije za zajednice, nego i o predstavnicima svih zajednica.

Ovaj amandman je i u interesu i većinske zajednice i svih zajednica u skladu sa svim standardima u skladu sa svim pravima međunarodnim, civilizacijskim i tako dalje, takodje i u skladu sa pravom na upotrebu jezika i pisma na osnovu kojeg znamo da su službeni jezici na nivou Kosova albanski i srpski, a na nivou opština su još i turski i bosanski. To

je izuzetno važno za te ljudi u tim opštinama koji u tim opštinama žele da svoj jezik zovu svojim imenom, posebno u opštinama gde uopšte nema stanovnika iz srpske zajednice, recimo u Peću, Prizrenu, Dragašu i tako dalje. Dakle razlozi su jako praktičke prirode i zato je vrlo važno da u ovoj situaciji poslanici u Parlamentu pokažu razumevanje i da ne tražimo sad neke argumente za ili protiv ili da tu sad vršimo neko pravno raščlanjivanje koje će trajti u nedogled. Apsolutno je opravdano i važno da poslanici podrže prjedlog koji je u interesu svih zajednica i koji je u interesu stanovnika ove zemlje. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Duke pasur parasysh se jemi në leximin e dytë, duhet më tepër vetëm përfaqësuesit e komisioneve përkatëse të flasin dhe jo gjithë deputetë, por patëm mirëkuptim për rëndësinë e çështjes. Fjalën e ka kërkuar edhe njëherë Fehmi Mujota, në emër të Komisionit.

FEHMI MUJOTA Faleminderit, zoti kryesues!

Dua të shfrytëzoj mundësinë që në emër të zëvendëskryetarit të Komisionit, në këtë rast, të bëj edhe një sqarim plotësues jo vetëm për zotin Baliq, por edhe për gjithë publikun dhe citoj saktë nenin 5 të Kushtetutës, ku thuhet: “Gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës janë gjuha shqipe dhe gjuha serbe”, dhe paragrafi 2, “Gjuha turke, boshnjake dhe ajo rome kanë statusin e gjuhëve zyrtare në nivel komunal ose do të jenë në përdorim zyrtar në cilindo nivel në pajtim me ligjin”. Në përputhje me këtë, komisioni funksional ka vepruar drejt dhe nuk do ta privojë nga e drejta e përdorimit të gjuhës turke, në këtë rast në Prizren, në përdorimin zyrtar në vula ose në forma tjera që ka të drejtë në këtë rast bashkësia turke. E kundërta e saj do ta privonte nga e drejta e përdorimit të gjuhës zyrtare në nivelin komunal komunitetin turk, ndërsa duke dashur të bëjmë një lloj mirëkuptimi, si thuhet, këtu nuk ka nevojë të themi mirëkuptim, këto çështje janë të përcaktuara qartë në Kushtetutë dhe Ligjin për përdorimin e gjuhëve. Mendoj që është shumë e qartë se komisioni funksional ka vepruar drejtë.

KRYETARI: Faleminderit!

Kemi hyrë në periudhën e votimit dhe shkojmë në votim.

Ju lutem, s’kemi nevojë për asnjë shpjegim tjetër, kemi amendamentet dhe shkojmë.

Amendamenti i parë i ka 2 variante, variantin a) dhe b), ne shkojmë së pari për variantin a).

Lus deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash, variantin a).

Konstatohet se me 62 vota “për”, 7 “kundër” 2 abstenime, miratohet amendamenti 1, varianti a). Faleminderit!

Në radhë është:

Amendamenti 2

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 59 vota “për” 3 “kundër” dhe 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 2.

Amendamenti 3

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 67 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 3.

Në sallë janë 77 deputetë.

Në radhë është amendamenti 4

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatoj se me 65 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 4.

Amendamenti 5

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatoj se me 70 vota “për”, 1 “kundër” dhe 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 5.

Në radhë është amendamenti 6

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, Votojmë tash:

Konstatoj se me 66 vota “për”, 1 “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 6.

Amendamenti 7.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatoj se me 66 vota “për”, 2 “kundër” dhe 1 abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 7.

Amendamenti 8.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatoj se me 64 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 8.

Lus deputetë dhe regjinë të përgatiten për votimin e tekstit të projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 66 vota “për”, 5 “kundër” dhe 2 abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin për vulat në institucionet e Republikës së Kosovës.

Ju falënderoj për votime.

Në radhë është pika e gjashtë e rendit të ditës:

- Shqyrtimi i rekomandimit të Organit të pavarur për zgjedhjes për emërimin e anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit

Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 96.4 të Ligjit për Prokurimin Publik ia ka propozuar Kuvendit listën e kandidatëve për anëtarë të Organit Shqyrtues të Prokurimit. Organi i pavarur për zgjedhjes për zgjedhjen e anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit, në pajtim me vendimin e Kuvendit, datë më 16 maj 2008, ka shqyrtuar listën prej 5 kandidatëve të propozuar nga Qeveria për anëtarë të Organit Shqyrtues të Prokurimit dhe Kuvendit ia ka rekomanduar listën për miratim me 3 kandidatë për anëtarë të Organit Shqyrtues të Prokurimit, si vijon:

1. Hysni Hoxha,
2. Tefik Sylejmani, dhe
3. Demë Keka.

Ndërkohë, Qeveria i ka propozuar edhe 2 kandidatë të tjerë për anëtarë të Organit Shqyrtues të Prokurimit. Organi i pavarur i zgjedhjes për zgjedhjen e anëtarëve të

Organit Shqyrtues të Prokurimit, më 23 korrik 2008 ka shqyrtuar kandidatët e propozuar nga Qeveria për anëtarë të Organit Shqyrtues të Prokurimit dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim listën me 2 kandidatë për anëtarë të Organit Shqyrtues të Prokurimit, si vijon:

1. Baki Krasniqi, dhe
2. Ekrem Salihu.

Raporti i Organit të pavarur të përzgjedhjes, së bashku me propozimin e Qeverisë u është shpërndarë deputetëve.

Në radhë janë shefat e grupeve parlamentare. Sipas radhës, shefi i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike. Nëse e do fjalën, Ramë Buja.

RAMË BUJA: I nderuari zoti Kryetar,
Meqë kjo çështje u bë odiseadë dhe u zgjat shumë, ne sot jemi të gëzuar që së paku lista është complete dhe Grupi Parlamentar do të votojë “pro”.

KRYETARI: Faleminderit!

Radha është e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, shefi i Grupit, Lutfi Haziri e ka fjalën!

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Zoti Kryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i LDK-së e mbështet propozimin e Qeverisë për emërimin e këtij organi dhe janë pjekur të gjitha kushtet përfundimisht që sot të përmbyllet ky proces i emërimit, duke shpresuar që të funksionalizohet sa më shpjet organi dhe t’ia fillojë punës, në mënyrë që t’i eliminojë ato defekte që i kemi biseduar në 2 seancat e kaluara lidhur me zbatimin e ligjit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Sipas radhës, shefi i Grupit parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar.

Zoti Kryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Për të mos i përsëritur ato të cilat i kemi thënë edhe në seancat paraprake përkitazi me këto emërimë, Grupi Parlamentar i Aleancës Kosova e Re nuk i mbështet këto propozime të Qeverisë, në radhë të parë për shkak se asnjëri nga të propozuarit nuk i plotëson kushtet sipas nenit 96.5 të Ligjit të prokurimit publik.

Së dyti, janë militantë të subjekteve politike dhe, së treti, kemi konsideruar dhe konsiderojmë se këto janë përpjekje që këto institucione shumë të rëndësishme të futen nën ombrellën e subjekteve politike, prandaj Grupi Parlamentar i AKR-së deklarohet kundër këtyre propozimeve. Faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Kjo çështje ka qenë e Organit përzgjedhës dhe Organi përzgjedhës ka bërë përzgjedhjen në bazë të ligjit. Faleminderit për këtë që e the.

Radhën e ka Grupi Parlamentar i AAK-së, deputeti Ardian Gjini, e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Mendoj se nuk ka ndryshuar asgjë prej diskutimeve të cilat i kemi pasur më herët në lidhje me këtë çështje, që ka ardhur dy herë para nesh. Realisht, ekziston një ndryshim, e ai ndryshim është se tani dy partnerët e koalicionit janë marrë vesh, i kanë marrë edhe dy emra të tjerë dhe i kanë sjellë këtu.

Kemi të bëjmë me një organ i cili është tepër i rëndësishëm dhe ajo që shohim tani është ekzakt ajo për të cilën kemi folur edhe dje. Do të thotë, kemi njerëz partiak, tipik partiak të cilët janë zgjedhur në një organ për të cilin pretendohet se është i pavarur dhe i paanshëm.

Çështja tjetër është se këta njerëz, me të vërtetë unë nuk e di, ne jemi në shekullin XXI sot, nuk jemi në shekullin XIX. Dikush na sjell këtu një certifikatë se e ka kryer një kurs për Windows 98, na ka pru bile edhe fotokopjet e notave të indeksit. Mendoj se kushdo që i sheh këto tuba të letrave që na kanë ardhur prej njerëzve që na ka sjellë Qeveria dhe që pretendon se i ka zgjedhur njerëzit më të mirë, edhe një herë po them atë që e thashë dje, duhet të mendojmë, a qeveriset vendi kështu në shekullin XXI ? A është kjo mënyra për t'i zgjedhur njerëzit të cilët e kanë një barrë tepër të rëndësishme për funksionimin e këtij vendi? Unë mendoj se kjo është një formë kur njerëzit mendojnë që bën çka dush se punët kryhen vetë. Mendoj se është plotësisht e gabueshme dhe ne definitivisht nuk do ta votojmë, nuk do të mund ta votojmë në asnjë variant, e lëre më në këtë variant. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Po ju, Ardian, e dini që partitë luftojnë për pushtet. Faleminderit!

Fjalën e ka Grupi Parlamentar i LDD-së, Adem Salihaj.

ADEM SALIHAI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Të nderuar kolegë deputetë,

Siç e dimë, procesi i emërimit të Organit Shqyrtues të Prokurimit ka shkuar me probleme të mëdha deri edhe në situata ekseseve që janë shkaktuar në Kuvend këtu, ne i kemi shumë të freskëta ato situata që kanë ndodhur në një seancë të kaluar.

Së pari kishim 3 propozime, në vend të 5 propozimeve sa ishin të nevojshme, gjë që e kundërshtoj partneri qeveritar, LDK-ja, për çështje interesi, por edhe opozita për çështje parimore.

Pas gjithë asaj rrëmuje tash na vinë edhe 2 propozime. Nëse i shikojmë me kujdes biografitë e të propozuarve, shohim se janë kryesisht aktivistë partiak, kryesisht të PDK-së apo të afërt me te. Nuk e di ku është LDK-ja në gjithë këtë tollovi që po ndodh rreth Organit Shqyrtues të Prokurimit. Sipas gjasave, ajo nuk ka ndonjë qasje serioze në këtë organ e as vetë në procesin e prokurimit.

Është me rëndësi se si është zhvilluar procesi i përzgjedhjes së kandidatëve për të cilin thoni se është bërë në bazë të ligjit, por ne do ta shohim këtu se ka ndodhur diçka tjetër. Unë po e lexoj pikën 1 të raportit të Organit përzgjedhës, i cili gjëja se është një organ i

pavarur. Në fakt, nga pika 1 e raportit të këtij organi del se ai nuk është aspak i pavarur, por vetëm i ka zbatuar urdhërat që i ka dhënë Qeveria lidhur me këtë çështje.

Unë po e lexoj pikë për pikë pikën 1 të këtij raporti dhe do të shohim se është kështu, siç po them unë. Raporti i organit, gjëja të pavarur për përzgjedhjen e kandidatëve, në pikën 1 thotë: “Organi i pavarur për përzgjedhjen e kandidatëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit ka konstatuar që Qeveria e Republikës së Kosovës nuk ka propozuar numër të mjaftueshëm të kandidatëve që organi i pavarur përzgjedhës të ketë mundësinë e përzgjedhjes së tyre, por ka propozuar 5 kandidatë, aq sa duhet të emërohen në Organin Shqyrtues të Prokurimit sipas nenit 96.5 të Ligjit të prokurimit publik, prandaj, mundësia për përzgjedhje ka qenë e kufizuar. Do të thotë, edhe vetë ky organ, që sipas Ligjit quhet Organ i pavarur, nuk e ka pasur mundësinë e përzgjedhjes, por vetëm i ka përcjellë propozimet që i ka dërguar Qeveria, pa asnjë mundësi të përzgjedhjes së kandidatëve. Nga e gjithë kjo që thashë, del se Organi Shqyrtues i Prokurimit tash na del një organ, anëtarët e të cilit janë aktivistë partiakë të PDK-së, ndërsa vetë çështjet e prokurimit me të cilat do të merret ky organ do të jenë nën kontrollin partiak të PDK-së dhe e gjithë kjo do të jetë në dëm të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Mendoj se ky Kuvend nuk duhet të bie pre e këtyre manipulimeve dhe nuk duhet t’i votojë kandidatët e propozuar, prandaj edhe Grupi Parlamentar i LDD-së nuk i përkrah këto propozime për Organin Shqyrtues të Prokurimit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Për hir të opinionit, unë dua të them se Komisioni Shqyrtues Përzgjedhës ka qenë i pavarur dhe këtë e vërteton raporti i tij, pika 3, ku thuhet: “Organi i pavarur i përzgjedhjes gjatë shqyrtimit të dokumentacionit ka konstatuar se 2 kandidatë -Ahmet Krasniqi dhe Lulzim Blakaj, nuk i plotësojnë kriteret e parapara sipas nenit 96.5 të Ligjit për prokurimin publik për t’u zgjedhur anëtarë të Organit Shqyrtues të Prokurimit”. Do të thotë, ka qenë i pavarur dhe i ka kthyer 2 kandidatë dhe në anën tjetër e njoftoj Kuvendin dhe opinion se kërkesa e Kuvendit ka qenë që të jetë numri 5 i përzgjedhur dhe faktikisht kjo kërkesë e Kuvendit tani është e plotësuar.

Fjalën sipas radhës e ka shefi i Grupit Parlamentar “7+”, Sadik Idriz.

SADIK IDRIZ: Hvala predsedniče!

Parlamentarna gupa „7+“ neće glasati za ovaj predlog, za ovu listu, iz razloga što medju predloženim kandidatima nema predstavnika durgih, odnosno ostalih zajednica: Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, fjalën e ka Bojan Stojanoviq.

BOJAN STOJANOVIĆ: Gospodine predsedniče,

Ja sam i prošli put kad je ovo izašlo iz procedure pa sačekalo sadašnji dan, rekao istu stvar koju ću ponoviti i danas. Ovo se izgleda ne tiče zajednica, nema nijednog predstavnika zajednice, a moža i zbog toga što zajednice sa svojim privatnim kompanijama i predezećima teško pod ovim uslovima mogu da konkurišu uopšte u javnim nabavkama, ali o tom potom. Naravno, možda ovo nije direktno vezano sa našim učešćem u Vladi i mi to ne porićemo. Ušli sm u Vladi, znači mi smo se borili za vlast, ali ovoga puta izgleda da smo prebaćeni u rezerve, tako da će Vlada morati utakmicu doa odigra sama, mi ćemo biti uzdražani. Hvala vam!

KRYETARI: Deputetja sipas radhës, Melihate Tërmkolli e ka kërkuar fjalën.

MELIHATE TËRMKOLLI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Në fakt, pjesën më të madhe të asaj që desha të them, e thanë një pjesë këtu e deputetëve më herët, si kryetarë të grupeve parlamentare ose në formë tjetër. Unë mendoj që thjesht ka shumë kohë, ka shumë muaj, do të thotë e në veçanti në këto kohë të fundit, jo më larg edhe se dje, kur Kryeministri i Kosovës deklarohet ose na bombardon me deklarata verbale për luftë kundër korrupsionit dhe krimit.

Me këto përzgjedhje që i ka bërë Qeveria, në krye me zotin Thaçi, unë mendoj që më shumë është favorizuar edhe korrupsioni, edhe krimi, edhe një politizim i skajshëm i institucioneve të Kosovës, se sa që është bërë e kundërta.

Unë tek tash e mora, do të thotë, atë listën definitive, sepse ka një ngatërresë këtu në emrat e njerëzve që janë propozuar, po si do që të jetë, nuk e ndryshon kjo hiq esencën e këtyre propozimeve të cilat i ka bërë Qeveria.

Zoti Hysni Hoxha, zoti Kryeministër, është një kandidat me akuzë në gjyq dhe nëse ju keni mbërri për t'ia mbyllur atë akuzë, është punë e juaja dhe kjo, me gjasë, nuk është hiq larg mendsh, sepse me këto diktate që po i bëni në të gjitha institucionet, edhe kjo mund të jetë e mundshme.

Ai është për shumë vite, do të thotë, për disa mandate këshilltar komunal në Prizren. Këtu kemi kandidatë me diploma të Papoviqit zotëri. Merreni këqyreni diplomën e njërit prej tyre është me diplomë të Papoviqit. Ju e dini shumë mirë çfarë kohe ka qenë ajo dhe nëpër çka ka kaluar krejt populli i Kosovës.

Dhe, po ky tjetri, njësoj, është sekretar i degës së PDK-së në Vushtrri. Do të thotë, është një njeri aktiv, nëse nuk e keni ndërruar edhe atë, brenda natës, thashë. Mund të ndodhë që e keni ndërruar ose ka dhënë dorëheqje ose diçka tjetër.

Kështu që, unë mendoj se kjo duhet t'i rikthehet Qeverisë. Në fakt, Qeveria duhet ta rikthejë, ta rishqyrtojë, të sjellë emra të cilët i plotësojnë kushtet për të qenë ky organ një organ i pavarur dhe një organ profesional. Përndryshe, nëse kjo miratohet, Qeveria bën vetëm deklarime verbale për luftë kundër krejt këtyre të këqijave që po përmenden e në të kundërtën favorizon korrupsionin, favorizon krimin dhe bën, edhe njëherë po e përsëris, politizim të skajshëm të institucioneve të pavarura shtetërore. Kaq, faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Për fjalë është paraqitur deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: Respekt, zoti Kryetar!

Zoti Kryeministër,

Zëvendësministra, zëvendëskryeministra, ministra,

Deputetë të respektuar,

Parimisht i kam dy vërejtje:

E para, plot e kemi gojën dhe me vend e kemi, për ekspertë, për ekspertë, për ekspertë. Përfundimisht, njëherë e përgjithmonë duhet të bëjmë dinstikcion prej profesionalisti dhe

specialisti tek eksperti. Në këtë rast, konkretisht, njëri nga kandidatët e propozuar e ka notën mesatare 6. 6 deri te 10 është Nederlent edhe Mont Everest, prandaj kjo komponentë duhet të jetë gjithmonë, me qenë se kemi zgjidhje. Prandaj, angazhohem parimisht, ju lutem, për njerëz me kualitete profesionale.

E dyta, është fakt se tjetri kandidat e ka mbaruar fakultetin, siç e tha zonjusha Tërmmkollli, në Universitetin politik, atëherë kur Universiteti legal i Prishtinës ishte në ekzodus violent të Papoviqi. Prandaj, këto dy komponente do të duhej të jenë relevante për një rishikim serioz dhe për propozim të kandidatëve me vlera. Faleminderit, shumë!

Kryetari: Faleminderit, profesor, po nuk kemi ndërmend të diferencojmë, se po të nisim diferencime, nuk di sa do të ishim këtu në këtë sallë.

Fjalën e ka deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Unë e di se Qeveria është në hall në përzgjedhjen e njerëzve të pavarur, se në Kosovë ka shumë pak të pavarur. Edhe fati ka dashur që popullata është gjysma LDK e gjysma PDK, tash nuk kemi çka të bëjmë, s'kemi ku t' i marrim kështu të pavarur.

Për mua janë të pranueshëm personat që do ta udhëheqin këtë organ, duke marrë parasysh që së paku e kanë kryer fakultetin para se të hynë në politikë apo para se të jenë deputetë, apo në poste të larta udhëheqëse. Bile, këtë e kanë minimumin që është kërkuar, sepse dikush po kërkon qasje profesionale, e dimë se ndoshta shkollën e mesme s'e ka kryer, e fakultetin e ka kryer, po ajo le t' i mbetet gjithkujt në ndërgjegjen e vet.

Zoti Kryeministër,

Unë e kam një brengë në këtë rast, të cilën do ta paraqes. Që nga 1 korriku

KRPP-ja nuk ka pasur mandat për t' i shqyrtuar ankesat, ndërsa e kam një informatë që së paku apo më shumë se 30 ankesa janë që presin aty dhe kërkojnë zgjidhje. Tash është një problem që ne jemi vonuar. Faktikisht i dimë edhe arsyet e vonësës. Jam shumë i vetëdijshëm, po për këtë duhet të bëhet një zgjidhje, sepse ndoshta është dashur t' ju zgjatet mandati, ka qenë kompetencë e dikujt tjetër, por këtu Qeveria ka qenë dashur të jetë më e vëmendshme dhe në këtë rast ato 30 ankesa, a janë të drejta apo të padrejta, ato presin zgjidhje, është brengë e imja dhe e atyre personave juridikë apo fizikë që i kanë paraqitur. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Fjalën e ka kërkuar Naim Maloku.

NAIM MALOKU: Faleminderit, zoti Kryetar!

Është fakt që partitë politike bëjnë garë dhe luftojnë për pushtet, por kur e marrin pushtetin, nuk duhet të abuzojnë me te dhe ta shkelin ligjin.

Ky organ është vonuar të votohet në Kuvend dhe pasojat, siç tha edhe parafolësi im, pra janë evidente. Qeveria nuk i ka shqyrtuar mirë propozimet. Nuk është dashur që Organin e pavarur për përzgjedhje të kandidatëve ta vë para aktit të kryer dhe t'ia dërgojë vetëm 2 kandidatë e jo më shumë. Nuk akuzoj Qeverinë që ka sjellë para Kuvendit njerëz militantë të partive politike, se partitë politike kanë formuar Qeverinë dhe grupet parlamentare i zgjedhin dhe nuk ka mënyrë dhe formë tjetër të përzgjedhjes së tyre, përveç njerëzve të vet. Së paku është dashur të respektohet ligji dhe Organi i pavarur për përzgjedhje të ketë mundësinë e një numri më të madh të kandidatëve të propozuar për t' i

propozuar Kuvendit të Kosovës njerëzit më të mirë që i ka pasur para vetit si të kandiduar nga Qeveria e Kosovës, por nuk është plotësuar ligji për përzgjedhjen e këtyre kandidatëve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Fjalën e ka kërkuar Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti Kryetar!
Përshëndetje, zoti Kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra,
Kolegë deputetë,

Mendoj se duhet ta kemi parasysh një fakt. Kuvendi i Kosovës ka emëruar Organin përzgjedhës dhe Ligji nuk e thotë qartë se Organi përzgjedhës ka të drejtë ta përzgjedhë, mirëpo Organi përzgjedhës duke u bazuar në Ligjin ekzistues të prokurimit publik vetëm shikon kandidatët e propozuar a i plotësojnë kriteret e përgjithshme për emërim në Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik.

Prandaj, duke marrë parasysh Ligjin ekzistues, propozimet që janë bërë nga Qeveria, Organi përzgjedhës ka vepruar konform Ligjit të prokurimit publik, duke u bazuar në nenin 96.4 dhe ka marrë parasysh edhe aktivitetin politik të kandidatëve. Pra, askund nuk është e ndaluar që dikush të jetë anëtar i partisë politike dhe të mos jetë i përzgjedhur në Organin e shqyrtimit publik. Natyrisht që, sa për dijeni të Kuvendit të Kosovës, edhe zoti Ahmet Krasniqi i ka plotësuar të gjitha kriteret e përgjithshme, por pasi që drejton degën e Partisë Demokratike të Kosovës, është eliminuar nga ky propozim. Prandaj, si Kuvend ne duhet t'i miratojmë propozimet dhe ne nuk marrim asnjë përgjegjësi, sepse njerëzit të cilët janë në këtë Organ përzgjedhës janë njerëz që i drejtojnë apo gjykojnë për çdo ditë në Gjykatën Supreme të Kosovës. Prandaj, unë konsideroj që duhet të votohet për propozimet e bëra konform Ligjit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
E fundja për diskutim është deputetja Donika Kadaj -Bujupi.

DONIKA KADAJ- BUJUPI: Faleminderit, Kryetar!
Unë me të vërtetë po shqetësohem edhe për punën e Qeverisë dhe mënyrën qysh po bëhet hajgare me Kuvendin e Kosovës dhe me popullin e Kosovës. Po ia përkujtoj edhe një herë kolegut tim, Armendit, që 60% të qytetarëve të Kosovës janë të paanshëm, sepse veç 40% na kanë votuar në zgjedhjet e kaluara. Prandaj, sigurisht që Kosova ka shumë profesionistë, ka shumë njerëz të cilët mund t'i kryejnë punët adekuate e Qeveria sjell njerëz që sjellin këto certifikata të kamerierëve. Këtu është një certifikatë e kamerierit, që është sjellë para Kuvendit dhe kërkohet që ky njeri të jetë në një organ të pavarur, njeri i cili ka një pozitë në Partinë Demokratike të Kosovës. Ju lutem, i politizuat ndërmarrjet politike, non-stop duke thënë jemi kundër politizimit, në borde do të kem profesionistë, në ndërmarrjet publike do të sjellim profesionistë, në organet e pavarura profesionistë, e çka keni pru. Keni pru njerëz, përveç që janë tipik të partive politike, të partisë PDK, ju sillni kamerierë. Kjo është turp, turp për Qeverinë, turp është për Kuvendin. Mos bëni hajgare me ne!

KRYETARI: Ju lutem, do të duhej deputetja ta tërheqë fjalën. Kandidatët janë njerëz që kanë kryer fakultetin juridik, kanë kryer provimin për jurisprudencë dhe plotësojnë kushtet për të qenë gjyqtarë, prandaj, deputetja duhet, edhe njëherë po them, ta tërheq fjalën. Ju lutem!

Kërkoj nga deputetja Donika Kadaaj- Bujupi ta tërheqë fjalën!

DONIKA KADAJ- BUJUPI: Fjalën, cilën fjalë, cilën konkretisht edhe për çka?

KRYETARI: Ne nuk po votojmë dhe nuk kanë ardhur kamerier këtu, por kanë ardhur juristë që i plotësojnë kushtet për të qenë gjyqtarë.

DONIKA KADAJ- BUJUPI: Kryetar, këqyre certifikatën, unë po flas me fakte, këqyre certifikatën, e ka pru vetë ose ja keni pru ju.

KRYETARI: Ju lutem, ti ke thënë turp, turp për Qeverinë dhe nga kjo duhet ta tërheqësh fjalën!

Nëse secili e mban përgjegjësinë për fjalën që e thotë dhe, vërtet, deputeti që përdor fjalë jo parlamentare dhe që i përsërit bukur shpesh, vërtet nuk e meriton të jetë pjesë e këtij Parlamenti, por megjithatë partitë politike kanë sjellë edhe njerëz që nuk do të duhej të ishin në këtë sallë.

Unë e ndërpres debatin. Kemi hyrë në procedurën e votimit dhe votojmë. Megjithatë, deputetët është dashur ta lexojnë ligjin dhe duhet ta dinë se kandidatët i plotësojnë kushtet me ligj. Kemi votuar Organin përzgjedhës në këtë Parlament dhe ne kemi obligim t'i besojmë Organit përzgjedhës dhe jo tash ta vëmë në këto pozita.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 44 vota “për”, 35 “kundër” dhe 1 abstenim, Kuvendi përzgjedhi Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik.

Ju faleminderit!

Në radhë është pika e shtatë e rendit të ditës:

- Shqyrtimi i Raportit vjetor të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin 2007

Kryesuesi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë ka paraqitur Raportin vjetor të punës për vitin 2007.

Komisioni funksional për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport e Telekomunikacion e ka shqyrtuar Raportin vjetor të punës së Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin 2007 dhe ka rekomanduar që të miratohet në seancën plenare.

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar dhe miratuar në parim Raportin vjetor të punës së Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin 2007 dhe ka rekomanduar që të radhitet për shqyrtim në seancën plenare.

Rekomandimet e Komisionit së bashku me Raportin e Zyrës së Rregullatorit për Energji u janë shpërndarë deputetëve.

Radha e diskutimeve është: kryetarja ose raportuesi i Komisionit funksional për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport e Telekomunikacion, nëse e kërkon fjalën, mund ta marrë. Urdhëro, deputete Myzeje Selmani, e ke fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Në bazë të Rregullës nr. 36 dhe 46 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Komisioni më datë 08.07.2008 shqyrtoi raportin vjetor për vitin 2007 të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë dhe nxori këtë

R e k o m a n d i m

I rekomandohet Kuvendit të Kosovës të miratojë Raportin vjetor të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin 2007.

Njëkohësisht, kisha pasur dëshirë të flas edhe në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së.

Kryetar, a mund të flas edhe në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së? Faleminderit!

Gjatë shqyrtimit të Raportit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, Grupi Parlamentar i AKR-së ka shumë vërejtje në këtë raport, kur dihet se numri i punëtorëve brenda kësaj zyre është 15 punëtorë të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë. Vetëm për paga dhe mëditje kanë shpenzuar hiq më pak se 186 mijë e 799 euro. Po të bëjmë një llogari, del se secili punëtor i Zyrës së Rregullatorit brenda një viti ka marrë si pagë vjetore 12 mijë e 453 euro, mjete këto të buxhetit të Kosovës. Shuma të konsiderueshme të mjeteve të shpenzuara për vitin 2007 Zyra e Rregullatorit të Energjisë, në bazë të raportit vjetor që ju ka dërguar Kuvendit të Kosovës, por edhe Komisionit, shihet se vetëm paga dhe mëditje për 15 punëtorë është një shumë shumë e madhe. Njëkohësisht, nëse bëjmë një llogari, del se secili punëtor i Zyrës së Rregullatorit ka pagë përafërsisht, pavarësisht prej profesionit të tij, baras me një deputet të Kuvendit të Kosovës.

Përpos pagave, zyrtarët e kësaj zyre kanë bërë shpenzime në një shumë të konsiderueshme të mjeteve për mallra dhe shërbime, ku shihet se diku vetëm për udhëtime hiq më pak se 11 mijë 313 euro, shpenzime të telefonit 8.343 euro, që do të thotë se Zyra e Rregullatorit përveç shpenzimeve...

Një moment, zoti Kryetar, të lutem, kam të drejtë në emër të Grupit Parlamentar, të lutem, si Grup Parlamentar kam të drejt, mos e ndërpre fjalën kur të flas!

KRYETARI: Ju lutem, ju kam thënë dje, po e përsëris edhe sot, kush do ta marrë fjalën, le ta kërkojë fjalën. Ju lutem, ajo shumë mirë tha, po flas herën e parë në emër të Komisionit, tani po flet në emër të Grupit. Pastaj, ju anëtarët e tjerë të Komisionit keni të drejtë ta merrni fjalën. Prandaj, ju lutem, e kërkon fjalën, e merr fjalën. Dihet kush e jep fjalën në Parlament, s'mund të bëjë pazar këtu. Vazhdo, zonja deputete!

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Në raportin e saj vjetor, Zyra e Rregullatorit ka nxjerrë të dhëna edhe rreth prodhimit të energjisë elektrike në Kosovë. Sipas tyre, prodhimi i energjisë elektrike në vend, krahasuar me vetin 2006 është rritur për 9.5%. Prodhimi i energjisë në termocentrale në vitin 2006 ka qenë 3872 gigavat orë energji elektrike, ndërsa në vitin 2007 ka qenë 4293 gigavat orë energji elektrike, thuhet në Raportin e Zyrës së Rregullatorit, i cili nuk është shumë i saktë për momentin. Sipas raportit, prodhimi i energjisë në hidrocentrale për vitin 2007 ka rënë 25.8, ku shihet se edhe me Ligjin nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë ajo bën pengesa mjaftë të mëdha edhe Ligji, tash për tash nuk mund të gjejë zbatim në favor të hidrocentraleve.

Nuk kisha dashur ta zgjasë më shumë, në mënyrë që të diskutojë edhe dikush tjetër. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Nëse jeni të disponuar, e po më duket që jeni, atëherë bëjmë 15 – 20 minuta pauzë.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYETARI : Të nderuar deputetë, mund t'ia fillojmë punës.

Fjalën e kanë shefat e grupeve parlamentare.

Në shqyrtim kemi Raportin vjetor të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin 2007.

AKR-ja e ka kryer diskutimin e vet. Tani janë në radhë PDK-ja, LDK-ja dhe të tjerët.

Kush e dëshiron fjalën nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike? Gani Koci!

GANI KOCI: Zoti Kryetar,

Unë jam i përgatitur që të flas në emër të Komisionit, si kryetar i Komisionit, dhe vetëm për pjesën e buxhetit që ka të bëjë me buxhetin dhe jo me gjithë aktivitetin e kësaj zyre. Unë, paraprakisht dua t'i kërkoj falje koleges, sepse mendoja se po flet për buxhetin në emër të Komisionit dhe ajo ka folur në emër të Grupit Parlamentar dhe kështu as unë nuk desha të ngatërrohem njëherë për Komisionin dhe pastaj për Grupin Parlamentar.

Por, megjithatë, po përpiqem të them, sepse mendimi i Komisionit për Buxhet nuk dallon shumë nga mendimi i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës. Ne, në mbledhjen e mbajtur më 11. 7. 2008 kemi sjellë këto rekomandime, si Komisioni i Buxhetit, që të miratohet në parim Raporti i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë elektrike për vitin 2007 dhe i rekomandohet edhe Kuvendit që të radhisë në rendin e ditës, të cilin ne sot po e shqyrtojmë.

Sa i përket pjesës së buxhetit, Raporti i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë elektrike i plotëson të gjitha kushtet dhe kriteret që kërkohen mbi bazë të Ligjit për menaxhimin e financave publike për raportimin financiar. Dua ta tërheq vëmendjen këtu, për hir të së vërtetës edhe të informimit të deputetëve, se nganjëherë duket se kjo zyrë, që është një agjencion i pavarur dhe që rregullon një fushë mjaft të rëndësishme këtu te ne, në aspektin e buxhetimit duket se sikur i ka kaluar normat e harxhimeve buxhetore, mirëpo raporti i buxhetit, ashtu siç është miratuar në këtë vit dhe është realizuar sipas parametrave dhe parashikimeve që i kanë pasur kjo zyrë.

Dua të tërheq vërejtjen sa i përket asaj që thuhet se kanë paga të larta, ne duhet të ndryshojmë Ligjin për rregullatorin e energjisë elektrike, sepse me ligj janë të përcaktuara pagat e kësaj zyre dhe mënyra e menaxhimit të financave që realizon kjo zyrë e Rregullatorit të Energjisë Elektrike. Ju e dini që kjo zyrë vetëfinancohet dhe ligji përcakton se cila është mënyra e financimit të kësaj zyre dhe mënyra e realizimit të tyre, që nganjëherë duket një shpërprurje mbi bazë të Ligjit të menaxhimit të financave publike, prandaj i mbetet Ministrisë së Energjisë dhe të Minierave, Komisionit përkatës që të marrë në dorë dhe të shqyrtojë këtë ligj, në mënyrë që kjo çështje të rregullohet dhe ne kemi tërhequr vërejtjen edhe më herët se do të duhej një rregullativë unike për financimin dhe buxhetimin e organeve të pavarura, gjë që nuk e kemi.

Ç' është më e keqja, kjo zyrë nuk është kuptuar drejt nga Zyra e Thesarit, pikërisht në mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve që ajo i realizon. Sipas ligjit, ky agjencion ka xhirollogarinë që e menaxhon vetë, por ligji e përcakton mirë se si duhet dhe për çka duhet të menaxhohen ato mjete. Nuk dua të përmend nenet, i kemi edhe këto, dhe nëse dëshirojmë një mënyrë tjetër të buxhetimit të kësaj zyre dhe të zyrave të tjera, urdhëroni si Kuvend të marrim iniciativën dhe ta ndryshojmë këtë ligj që e rregullon këtë sferë në fushën e energjisë në përgjithësi.

Prandaj, raporti duhet të miratohet, vërejtje ka, vërejtje mund të kenë, natyrisht, në mënyrën se si kanë vepruar, sepse ka mungesë të kuadrit të ekspertëve, në nivelin e ekspertëve. Ju e dini, zyrat e tilla janë zyra ekspertësh dhe në këto zyra nuk punojnë njerëzit me nivelin e pagesave që e kemi sot, prandaj Qeveria duhet ta mendojë këtë çështje shumë drejt. Që të kompletohet kjo zyrë, tash e 6 muaj janë 2 vende vakante në bordin e kësaj zyre, për të cilat Ministria e Energjetikës duhet të propozojë njerëzit që ky Kuvend t'i përzgjedhë dhe të plotësohet Zyra e Rregullatorit të Energjisë Elektrike.

Në këtë drejtim i mbetet Ministrisë së Minierave dhe të Energjisë, Komisionit, por edhe Kuvendit dhe, në radhë të parë, Qeverisë që të gjejë formën dhe mënyrën e buxhetimit të agjencioneve rregullative në të cilat problemet janë të shumta dhe jo vetëm sot, por tash e tri mandate. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Radha është e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Për fjalë nga Lidhja Demokratike është paraqitur Haki Shatri .

HAKI SHATRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike e ka shqyrtuar Raportin vjetor të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë dhe në përgjithësi e vlerëson si raport të mirë, i cili është në pajtim me kërkesat që obligon Ligji për rregullatorin, për raportim. Konsiderojmë që Rregullatori i Energjisë si organ i pavarur ka punuar me sukses në çështjet që i ka të përcaktuara me ligj, siç është monitorimi dhe licencimi. Pra, ka punuar me sukses dhe angazhim të plotë në mbrojtjen e konsumatorëve, në analizat dhe në hapjen e tregut të energjisë dhe, po ashtu, ka dhënë maksimumin në përgatitjen e akteve nënligjore për hapjen e tregut.

Mund të them që në përgjithësi raporti, edhe pjesa financiare, edhe e aktiviteteve, duhet të mbështeten dhe të përkrahen për arsye se as sa i përket numrit të të punësuarve Rregullatori nuk e ka tejkaluar numrin e atyre që ua ka lejuar me vendim Kuvendi i Kosovës. pra, e kanë të lejuar, kanë pasur 25 për vitin 2007 dhe aktualisht kanë të punësuar 22 persona, por është një çështje që, ndoshta, lidhet me punën e Kuvendit. Mungojnë 2 anëtarë të bordit që është një mungesë, një hendikep për një punë normale dhe kërkohet që Kuvendi të bëjë plotësimin e këtyre 2 anëtarëve me qëllim që puna e Rregullatorit të jetë edhe më e suksesshme.

Në pjesën financiare kemi vlerësuar që të dhënat janë të sakta dhe në asnjë pikë të zërave të shpenzimeve nuk i kanë tejkaluar ato që i kanë pasur të parapara me buxhet të miratuar në Kuvend, prandaj si grup parlamentar e përkrahim dhe e vlerësojmë se duhet të mbështetet edhe më tej puna e suksesshme e Rregullatorit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, edhe prej teje!

Fjalën e ka Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Është në rregull, do të thotë, është konform asaj për të cilën kemi biseduar, por kjo është çështje tjetër që do vijë në sesionin vjeshtor të Kuvendit.

Me qenë se po bisedojmë për Rregullatorin e Energjisë dhe Raportin e Rregullatorit të Energjisë, tani një pyetje është kështu: Kuvendi e ka krijuar Rregullatorin, domethënë me vendim të Kuvendit është krijuar Rregullatori ose Zyra e Rregullatorit të Energjisë jo, energjisë elektrike, por energjisë.

Kur e kemi krijuar, kemi pasur arsye pse, jo vetëm për të ekzistuar ky rregullator për vetveten, që të ketë financat në rregull vetë, që t' i shpenzojë mjetet në rregull vetë dhe të mos kemi ne vërejtje. Është krijuar për shkak se i është nevojitur Kosovës, do të thotë është nevojitur që të ketë një agjencion i pavarur, një zyre të pavarur në mes Qeverisë dhe asaj që ndodhë në aspektin e energjisë që t' i rregullojë disa çështje, që të mos kemi situata të cilat, ndoshta, për hir të deputetëve, këtu nuk ka nevojë as të shpjegohen për çka ekzistojnë rregullatorët.

Tani, ne marrim raport edhe fakti se ka ligj i cili kërkon nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë që të na sjellë raport neve, një herë në vjet, nuk ka të bëjë me atë se si i kanë shpenzuar ata mjetet e veta, sa kanë shpenzuar telefon e blla – blla, e tjera, e tjera. Krejt ato janë në rregull, por ne na intereson cili është autputi, cila është dalja, çka ka ndodhur në Kosovë për shkak se ekziston Rregullatori. Kjo është ajo çka na nevojitet ne si Kuvend, e jo vetëm financat edhe kemi bë këtë, kemi bë këtë.

Tani, çka ka ndodhur në Kosovë vitin e fundit e që ka të bëjë drejtpërdrejt me punën e Rregullatorit, është që është rritur çmimi i energjisë. Tani, kush e ka fajin pse është rritur çmimi i energjisë? Fajin fiktiv e ka Rregullatori për shkak se Rregullatori, domethënë, është ai i cili i bën këto rekomandime e tjera. Mirëpo, fajin është, ndoshta, edhe diku tjetër, për shkak se nëse 30% e njerëzve në Kosovë paguajnë rrymë, unë mendoj se çmimi është tepër i ulët për t' i mbuluar shpenzimet të cilat ndodhin për shkak të prodhimit të energjisë.

Ajo çka dua të them, nuk po shkoj më tutje me qenë se realisht do të kisha dalë jashtë temës për të cilën po bisedojmë, është që mendoj se jemi në rrugë të gabuar si Kuvend të gjithë ne, mendoj se po flasim për raportet teknike të Rregullatorit dhe nuk po flasim për esencën pse ekziston ai rregullator, çka ka bërë ai rregullator edhe çka i duhet Kosovës ai rregullator nëse ne bisedojmë se sa të holla i ka shpenzuar për telefon rregullatori. Ne mund ta heqim fare rregullatorin edhe pse do të ishte keq, të mos keqkuptohem, do të ishte një veprim tejte i keq nëse hiqet rregullatori. Mirëpo, ajo çka kemi sot përpara është një temë shumë serioze, nuk po flitet për te.

Ne si Grup Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës kemi kërkuar nga të gjithë deputetët që të jenë të lirë të votojnë për miratimin ose jo të këtij raporti. Unë personalisht mendoj se në rastin më të mirë duhet të abstenohet për shkak se nuk ka debat, për shkak se nuk ka raport esencial për punën të cilën duhet ta kryej Rregullatori, ka raport shumë sipërfaqësor çështjeve teknike edhe mendoj se pjesën dërmuese të fajit në këtë rast e ka Qeveria, e cila nuk ka kërkuar prej Rregullatorit që të ketë raport tjetër, e cila nuk i ka asistuar Rregullatorit që të ketë pagesë më të madhe të energjisë elektrike në Kosovës, në mënyrë që njerëzit që paguajnë të mos ngarkohen edhe më tepër me çmime, e tjera, e tjera. Faleminderit, zoti Kryetar!

KRYETARI: Faleminderit!

Nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, fjalën e ka deputeti Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Së pari, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë nuk e vlerëson pozitivisht Raportin e Zyrës së Rregullatorit për vitin 2007 dhe vlerësimi ynë bazohet në dy fakte: duke pasur për bazë gjendjen energjetike në vend dhe, nën dy, procesin e licencimit. Mbi këto dy argumente të fuqishme, vota jonë do të jetë kundër. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, edhe prej teje!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, deputeti Zylfi Merxha e ka fjalën.

ZYLFI MERXHA: Zonja e zotërinj deputetë,

Unë sot nuk e kam Grupin Parlamentar këtu sepse, siç e dini, më parë e ka lëshuar seancën, kurse vetë nuk mund të deklarohej, prandaj kërkoj falje.

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, Bojan Stojanović.

BOJAN STOJANOVIĆ: Hvala, gospodine predsjedniče!

Nas uvek ima 7. i nije toliko pitanje dali smo tu ili nismo. Naravno, ima nekih stvari koje i nama ne odgovaraju u tom izveštaju. Medjutim, i oduševljenje i razočaranje zavisi od nivoa iščekivanja. Pitanje je koliko je ta situacija mogla da se popravi, koliko Regulator mogao da uradi nešto konkretno u tom pravcu i koliko se trudio vezano za sve to. Naravno, možda i oni sinu imali električne energije pa nisu mogli dovoljno da rade i možda će im to biti podsticaj. U svakom slučaju, da bi podržali ovaj izveštaj i Vladu, mi ćemo glasati za. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputete Myzeje Selmani, a dëshironi të replikoni? Jo! Nëse ke replikë, se sa për sqarim, e ke kryer fjalën.

Fjalën e ka deputetja Vezira Emrush.

VEZIRA EMRUŠ: Ja se srdačno zahvaljujem!

Pozdravljam Predsedništvo i sve kolege i molim za malo pažnje.

Imamo izveštaj Kancelarije regulatora električne energije, koja odgovara Skupštini i očekivali smo da nam da jedan valjani izveštaj za 2007. godinu.

Ja ću da vam kažem, gospodo kolege, da neću da panavljam sve ono što je rečeno ovde, ali da vam kažem da je ovo samo prošlogodišnji prepisani izveštaj sa promenjenim brojkama i mi više ne smemo da dozvolimo da nam se serviraju ovakvi izveštaji.

Prvo, nije nas ta ista kancelarija ispoštovala, da dodje sama, da prezentuje jedan od članova izveštaj, kako bi mi bili u situaciji da diskutujemo zajedno sa tom kancelarijom na istom nivou, u istim uslovima.

Ja ću pažnju da usredsredim, neću da razgovaram, da govorim o tome koliko je kancelarija analizarala samu sebe, a ona ne postoji zbog sebe, ona postoji zbog energetske situacije na Kosovu i zbog namenske situacije za gasifikaciju i elektrifikaciju kosovskih gradova i Kosova.

Ova kancelarija, prvo, daje analize mnogo sintetički, tojest analizarala je samu sebe i malo se zalaže kada je u pitanju pravi segment, kao što je energija, malo opisno daje proizvodnju, da ne zamaramo kolege, pa onda distribucija, a nemamo nikakve pokazatelje naplate gubitaka, što je bolna tačka kosovskog društva. Ako mi ovako nastavimo, mi ćemo biti još 20. godina u mraku, ja vam to kažem, a vi možete da razmislite malo pa ćemo da vidimo da li je to ovo što ja kažem kao poslanica, da li će biti u skoroj budućnosti da imamo struju, kao prvo struju, a što se gasa tiče, to će biti neki sporazumi, gas će stići, ali za razliku, mi možemo da proizvodimo struju zato što vidimo iz ovog izveštaja da smo bogati lignitom.

Ja ću posebno da se zadržim kada je kršenje od strane ove agencije, kršenje kada je bilo povećanje električne energije za 5%. Mi moramo da znamo gde živimo, u kojoj regiji i koje su cene oko nas. Ako smo najskuliji u regiji, gde je naš kilovat 34 centi a u regiji od 12 do 14 centi. Ovo stalno pominjem i niko se ne bavi analizom cene. Mi plaćamo, zašto plaćamo toliko cenu, zato što je naplata od strane KEK-a, koji drži monopolističku situaciju na terenu i koji nam servira najskuplju struju u regionu. Da li je to u redu sa 30% naplate i lošeg menažiranja, da poštenu potrošači koji plaćaju struju, plaćaju 3 puta skuplju struju za onih 60% što uopšte ne plaćaju.

Molim da se ova Kancelarija pozabavi malo više sa menadžmentom KEK-a, sa ljudskim resursom, sa svim izvorima, sa naplatom, sa gubicima i da izadje ovde sa jednom dobrom analizom, gde ne vidimo uopšte koliko, kao što vidimo kada je u pitanju gas, ovu analizu, gde je izvršena analiza stope naplate u distribucijama kada je u pitanju u distributivnim mrežama, kada je u pitanju gas, a dok nije izvršena analiza iste agencije kada su u pitanju stope naplate u distribucijama KEK-a za sezonu 2006 - 2007. godinu i stopa gubitaka koji su glavni razlozi visoke cene struje na Kosovu.

I u oba slučaja nije izvršena analiza ljudskog resursa, što sam rekla, i ova Agencija, niti ova vlada nije se pojavila ovde, jer mi smo samo telo koje možemo da povećamo struju, nije nam dato na razmatranje povećanje struje, što je za mene isto kršenje ljudskih prava.

Zašto ovo kažem. Vidimo da je Kancelarija RUE konstatovala lobirajući, ja tako imam običaj da kažem, jer ona je pravilno samo lobirala, održavala je javne sastanke, direktne razgovore sa interesovanim stranama, kaže ovde sa licenciranim subjektima, predstavnicima Vlade i Parlamenta, kao i potrošača. A da li je ta ista kancelarija dala nama kao predmet, kao tačku da mi odlučimo o povećanju cene električne energije, Mi nismo ispoštovani kao Skupština i ovo je vršilo važno, vrlo važno, jer samo ova Skupština može da poveća struju.

I, za kraj, ne bi opterćivala mnogo kolege, samo hoću da kažem da sa ovakvim menadžmentom i sa ovakvim tarifnim stavovima, gde je svaki potrošač oštećen, gde mora iznad 200 kilovata da plaća dodatnu cenu za potrošene kilovate i gde ispašta kao potrošač ili kao platiša kada je u pitanju grupisanje potrošača, kao što je Grupa A; B i C. Ja ću malo da se našaljim malo na kraju, pošto u Prizrenu, odakle dolazim iz Dragaša, kažu ovako. Samo još jednu činjenicu hoću da vam dam doznanja. Nama nije dostupna televizija, to su fiksni troškovi na računu KEK-a i hoću da ovo naidje na razumevanje, što ću kao parlamentarno pitanje da postavim da te troškove nemamo u računu kada je naša regija u pitanju, a još našalila bih se sa ovim parlamentom da smo dosta umorni. Kod nas u Prizrenu i u Dragašu kažu, u grupi A su Albanci, u grupi B su Bošnjaci i ostali, a u grupi C kažu da su Srbi ili Cigani, ako čitate ćirilicu ili latinicu. Molim vas, ovakva

grupacija KEK ima svakakvu mogućnost da izađe na terenu, da radi i da zaradi, isključenje i sve ostalo, ima armiju radnika od 11 hiljada. Hvala!

KRYETARI: Edhe pse fjalët nganjëherë nuk janë me vend, mendoj se nuk qëndrojnë konstatimet e fundit. Vazhdojmë me debatin. Fjalën e ka Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuari Kryeministër,
Ministra të nderuar,
Kolegë deputetë,

Para vetes e kemi raportin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë që është përmbledhur kryesisht në 3 faqe të Raportit të kësaj zyre dhe shumica e kësaj është raport i KEK-ut dhe Raport i punës së ngrohtoreve.

Do të përqendrohem vetëm në një çështje që këtu u tha se kanë buxhetin e tyre dhe mund ta shpenzojmë ashtu si duhet.

Nëse shikoni tabelën 1.3 të shpenzimeve, mallrat dhe shërbimet, po përmendi vetëm 3 rubrika.

Shpenzimet tjera, çka nënkupton me shpenzimet e tjera? Është dashur të specifikohen se cilat janë shpenzimet e tjera.

Mirëmbajtja, çka është nënkuptuar me mirëmbajtje?

Pastaj, po ashtu, edhe shërbimet e marketingut, thuajse kjo zyre do të duhej të ketë shumë marketing.

E dyta, është që përpos kësaj, Zyra e Rregullatorit për Energji kërkon edhe mjete shtesë për paga dhe mëditje. Këtu u cilësua si një nga zyrat kryesore dhe nuk mund të punojnë gjithfarë njerëz në të, por unë nuk e besoj që edhe institucionet e tjera janë më pak të rëndësishme, nuk është më pak i rëndësishëm një mjek, nuk është më pak i rëndësishëm një gjyqtar e të tjera. Prandaj, po pajtohem gjithsesi që duhet të rishikohet ligji për këtë zyrë dhe gjithçka të jetë në pajtim me këtë.

Por, seriozisht po e them, është skandaloz raporti financiar që e ka sjellë kjo zyrë, sepse absolutisht nuk korrespondon me aktivitetet që ka ndërmarrë gjatë vitit 2007.

KRYETARI: Faleminderit!

Pasi Ganiu nuk po kërkon Replikë, Heset Cakolli e ka fjalën.

HESET CAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuari Kryeministër,
Zëvendëskryeministra, ministra dhe
Të respektuar kolegë deputetë,

Zyra e Rregullatorit për Energji është themeluar si autoritet i pavarur me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë numër 2004/9. Përgjegjësitë e Zyrës së Rregullatorit për Energji janë përcaktuar në nenin 15 të këtij ligji.

Në raportin vjetor për vitin 2007 të Zyrës së Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës janë dhënë në formë të përmbledhur punët dhe aktivitetet kryesore të Bordit drejtues dhe të shërbimeve teknike të saj, janë përfshirë edhe raportet financiare, të dhënat teknike të sistemit energjetik dhe ekonomik të kësaj zyre.

Në raport shihet se prodhimi i energjisë në vitin 2007 ka pasur një ngritje prej 9.5% në krahasim me vitin 2006, po ashtu edhe konsumi i energjisë elektrike ka shënuar një rritje diku rreth 7.4%. Edhe ky trend i rritjes së prodhimit dëshirojmë të vazhdojë edhe në vitin në vazhdim, respektivisht në vitin 2008.

Mirëpo, gjatë vitit 2007 ka pasur eksport të energjisë me çmim mesatar 38.45 euro për megavat orë, ndërsa importi i energjisë është bërë me çmim mesatar prej 83.66 euro për megavat orë energji dhe ky ndryshim i çmimit të energjisë duhet të jetë një sfidë, mendoj unë, për Zyrën e Rregullatorit të Energjisë dhe operatorët e tjerë.

Humbjet në rrjetin e bartjes dhe të shpërndarjes në vitin 2007 kanë shënuar rritje krahasuar me vitin paraprak. Nga tabela 3.9 dhe figurat 3.11 shihet se humbjet e energjisë janë shumë më të mëdha në sezonin e dimrit krahasuar me muajt e verës. Kjo diferencë e humbjeve sigurisht është si pasojë e keqpërdorimeve të një pjese të konsumatorëve, por ndoshta edhe për shkak të humbjeve teknike të cilat janë shumë të mëdha. Prandaj, në të ardhmen duhet t'i kushtohet kujdes iu veçantë humbjeve teknike dhe atyre jo teknike me qëllim të zvogëlimit të humbjeve të energjisë.

Çmimin e energjisë e rregullojnë nenet 45, 46, 47 dhe 48 të ligjit në fjalë, ndërsa tarifat për shitjen e energjisë me pakicë për konsumatorët shtëpiak dhe të miratuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë dhe të zbatueshme nga 1 maji i vitit 2007, ku janë paraqitur në tabelën 3.11, janë shumë të larta nëse i krahasojmë me çmimin e energjisë të eksportuar. Për shembull, konsumatori shtëpiak vetëm për një megavat orë energji elektrike nëse e harxhon brenda muajit sipas tarifës së lartë gjatë sezonit dimëror duhet të paguaj rreth 75 euro, ndërsa sipas tarifës së ulët gjatë sezonit veror diku rreth 54 euro. Prandaj, unë mendoj se dobësitë e operatorëve gjenerues, transmetues dhe distribues nuk mund të mbulohen me ngritjen e çmimeve, por me ngritjen e efikasitetit dhe të përgjegjësisë në punë, prandaj mendoj se duhet të zvogëlohet çmimi i energjisë me të vetmin qëllim që të rritet inkasimi i rrymës së faturuar. Ju faleminderit!

KRYTARI: Faleminderit!

Duhet ta keni parasysh, është Rregullator për Energji dhe jo për rrymë elektrike. Fjalën e ka Ramadan Avdiu.

RAMADAN AVDIU: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuari zoti Kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra,
Të nderuar kolegë deputetë,

Mbase për shkak të krizës dhe të gjendjes së rëndë në fushën e energjetikës ka bërë që unë të përqendrohem më shumë në këtë raport dhe ta lexoj me një vëmendje të përkushtuar. Shihet që Zyra e Rregullatorit të Energjisë është përpjekur që brenda fushave që ia definojnë ligji t'i kryejë detyrat dhe obligimet e saja, por unë nga leximi i raportit jam përpjekur që të nxjerrë një pasqyrë apo një gjendje në sistemin e energjetikës përgjithësisht në Kosovë dhe nga kjo shihet, do me thanë, dhe mund të dalë që pasqyrohet gjendja e rëndë.

Lidhur me raportin, në faqen 10 vetëm do të kisha precizuar, pasi mund të jetë edhe ndonjë gabim teknik, por thuhet në paragrafin 4 se deri në fund të vitit 2007 janë licencuar 15 operatorë apo subjekte juridike, ndërkaq kur bëhet specifikimi i tyre, dalin se janë licencuar 24. Besoj se ky gabim mund të përmirësohet. Ndërkaq, më ka bërë shumë përshtypje diferenca e madhe në çmim në mes të eksportit dhe importit, domethënë në eksportojmë rrymë me një çmim thuaj se dy fish më të ulët, gjë që nuk është punë e Zyrës së Rregullatorit, mirëpo po e ngreh këtë si çështje që ta kemi parasysh në të ardhmen, sikurse edhe inkasimi nga bartja nga transmissioni ndërlidhës intrekonektues nëpërmjet rrjetit të distribucionit në Kosovë, inkasimi nga rrjeti elektrik i Serbisë dhe këtë besoj që do të duhet të preventohet kjo që të mos inkasojë, domethënë nga shfrytëzimi i infrastrukturës së Kosovës të inkasojë rrjeti elektrik i Serbisë, domethënë i një shteti tjetër. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Më nuk ka të paraqitur për diskutim.

Po ju njoftoj se në sallë janë 76 deputetë.

Tani jemi në procedurën e votimit.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim të raportit. Votojmë tash:

Konstatohet se më 49 vota “për”, 17 “kundër”, 7 abstenime, Kuvendi miratoi Raportin vjetor të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin 2007. Ju faleminderit!

Kalojmë në pikën e tetë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i kërkesës së Qeverisë së Kosovës për tërheqjen e ligjeve nga procedura e shpalljes

Qeveria e Republikës së Kosovës ka kërkuar që 10 ligjet e miratuara, por të pashpallura nga PSSP-ja, të tërhiqen nga procedura e shpalljes dhe të kthehen për ripunim në Qeveri., konform rrethanave të krijuara në Kosovë.

Kërkesa e Qeverisë, së bashku me listën e ligjeve të pashpallura, u është shpërndarë deputetëve. Nëse ka nevojë, Qeveria më duket nuk e ka bërë kërkesën për ta arsyetuar, mendoj që nuk është e nevojshme as shëfat e grupeve parlamentare ta bëjnë këtë, por po shkojmë menjëherë në procedurën e votimit. A jeni dakord?

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 74 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 2 abstenime, Kuvendi miratoi kërkesën e Qeverisë për tërheqjen e 10 ligjeve nga procedura e shpalljes dhe kthimin në ripunim, në Qeveri.

Vazhdojmë pikën e nëntë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i kërkesës së grupeve parlamentare të Kuvendit për procedimin e ligjeve të pashpallura në rishqyrtim në komisionet parlamentare

Gjashtë grupe parlamentare përmes përfaqësuesve të tyre kanë kërkuar që 16 ligjet e miratuara, por të pashpallura nga PSSP-ja, të tërhiqen nga procedura e shpalljes dhe të rikthehen për rishqyrtim në komisionet parlamentare, konform rrethanave të krijuara në Kosovë.

Kërkesa e grupeve parlamentare, së bashku me listën e ligjeve të pashpallura, u është shpërndarë deputetëve.

Edhe këtu po shkojmë sipas së njëjtës procedurë.

Për fjalë është paraqitur shefi i Grupit Parlament të AAK-së, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, Kryetar!

Desha ta jap vetëm një sqarim. Në listë nuk figuron nënshkrimi im, edhe pse i kam treguar administratës që po, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës pajtohet, për çështje të mosprezencës sime fizike nuk është nënshkruar. Pra, ky ishte sqarimi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Atëherë, po hymë në procedurën e votimit.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 76 vota “për”, 1 “kundër” dhe 1 abstenim, Kuvendi miratoi kërkesën e grupeve parlamentare për tërheqjen e 16 ligjeve nga procedura e shpalljes dhe kthimin për rishqyrtim në komisionet parlamentare. Me vendim të veçantë komisionet e Parlamentit do të ngarkohen për raportim të mëtutjeshëm.

Ju faleminderit!

Pra, jap 15 minuta pauzë, e pastaj vazhdojmë seancën tjetër.

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve